RAPORT PËRFUNDIMTAR

MBI

(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)

"BASHKIA BERAT"

Tiranë, Dhjetor 2019

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**

II.HYRJA **13**

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT **19**

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT DHE GJETJET **21**

V. REKOMANDIMET **282**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 606/1, datë 26.08.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.09.2019 deri në datë 15.11.2019, në subjektin Bashkia Berat, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 30.09.2019, u krye auditimi financiar dhe i përputhshmërsë.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2017 deri 31.12.2017 si dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare të vitit 2018, mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Berat dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 "paga"; 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"; 467 "Kreditore te ndryshëm"; 602 "shpenzime operative" dhe 230- 231 "investime", si dhe procedurat prokurimit me zgjedhje me vlerë 80% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi (2017 – 2019).
Në përfundim të auditimit në terren, janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 15 aktkonstatime dhe 5 akverifikime dhe, pas kryerjes së takimit përmbyllës, me shkresën nr. 4378/3, (Prot. B. Berat) datë 25.11.2019 u paraqitën observacione nga Bashkia Berat për aktet e mbajtura, pas vlerësimit pjesor të tyre u përgatit projektraporti i auditimit i cili u përcoll në Bashkinë Berat me shkresë nr. 606/3, datë 29.11.2019, u vlerësuan observacionet mbi aktet e mbajtura në fund të auditimit, observacionet e ardhura me shkresë pëecjellëse si dhe argumentet e paraqitura nga subjekti në takimin përmbyllës në KLSH, organizuar në datën 24.12.2019 dhe u përgatit ky raport përfundimtar auditimi, në mënyrë të përmbledhur, rezulton si më poshtë:

I. Në zbatimin e kontratave për punë publike u konstatua dëm ekonomik në shumën **8,946,578 lekë,** për punime të pakryera por të likuiduara si më poshtë:

-Vlera prej 211,888 lekë pa tvsh nga OE "B." SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 3080 prot datë 04.07.2017, me objekt "Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

-Vlera prej 464,600 lekë pa tvsh nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016, me objekt "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

-Vlera prej 6,482,720 lekë pa TVSH nga BOE "G." shpk &"B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratat me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 dhe Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017, përkatësisht me objekt "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat dhe "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

-Vlera prej 583,470 lekë pa TVSH nga (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, për kryerjen e punimeve me objekt "Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re", Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

-Vlera prej 1,015,500 lekë pa TVSH nga (BOE) "T." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej 1,015,500 lekë pa TVSH të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, për kryerjen e punimeve me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë", Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

-Vlera prej 188,400 lekë sigurim kontrate OE "K." SHPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt **"**Blerje materialesh elektrike**",** bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24 pasi nuk është sekuestruar sigurimi i kontratës për procedurën e cila është anuluar nga AK si pasojë e shkresës së bërë nga OE.

II. Në auditimin e procedurave të prokurimit u konstatuan shpenzime jo sipas 3-E në shumën **19,171,364 lekë** në 11 procedura**,** si më poshtë:

1. Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt "Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit "Tomorri", në bulevardin Republika", me FL në vlerën 72,480,695 lekë, OE i shpallur fitues "Z." SHPK me vlerë të ofertës 70,247,274 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE "Z." shpk me ofertë 70,247,274 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 2,921,952 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "B." shpk në vlerën 67,325,322 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2. Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt "Rikonstruksion i Muzeut Historik Sinjë", me FL në vlerën 8,446,819 lekë, OE i shpallur fitues "P." me vlerë të ofertës 7,634,330 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon*

procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit". Duke kualifikuar OE "P." shpk me ofertë 7,634,330 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,677,352 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 5,956,978 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

3. Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt "Blerje karburanti për Bashkinë Berat dhe për drejtori", me FL në vlerën 13,190,550 lekë, OE i shpallur fitues "P." me vlerë të ofertës 13,127,576 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE "P." shpk me ofertë 13,127,576 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,445,678 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "A." shpk në vlerën 11,681,898 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

4. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Restaurim i mureve të Kalasë Berat*", me FL në vlerën 7,676,667 lekë, OE i shpallur fitues "M." me vlerë të ofertës 6,826,124 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE "M." shpk me ofertë 6,826,124 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 514,569 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 6,311,555 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

5. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Mirëmbajtje kanale ujitëse dhe kulluese*", me FL në vlerën 3,801,667 lekë, OE i shpallur fitues "S." me vlerë të ofertës 2,965,565 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e*

përcaktuara në dokumentet e tenderit". Duke kualifikuar OE "S." shpk me ofertë 2,965,565 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 359,087 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "A." shpk në vlerën 2,606,478 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

6. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Rikonstruksion i repartit të pediatrisë në spitalin e Beratit*", me FL në vlerën 12,452,108 lekë, BOE i shpallur fitues "B." & "Sh." shpk me vlerë të ofertës 9,638,841 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE "B." & "Sh." shpk me ofertë 9,638,841 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 180,596 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 9,458,245 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

7. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Rikonstruksion i fasadave në lagjen Murad Çelebiu*", me FL në vlerën 37,589,184 lekë, BOE i shpallur fitues "S." & "M." shpk me vlerë të ofertës 37,024,857 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE "S." & "M." shpk me ofertë 37,024,857 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 8,822,789 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 28,202,068 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

8. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Rikonstruksion i çerdhes Uznovë*", me FL në vlerën 7,076,528 lekë, OE i shpallur fitues "B." shpk me vlerë të ofertës 5,101,460 lekë. KVO ka s'kualifikuar OE "C." shpk me ofertë në vlerën 5,056,846 e cili plotësonte të gjitha kriteret e vendosura nga NJP. Duke shpallur fitues OE "B." shpk me ofertë 5,101,460 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 44,614 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "C." shpk në vlerën 5,056,846 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

9. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Mirëmbajtje ujësjellës, rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Kostren 1 dhe veprës së marrjes*", me FL në vlerën 4,166,588 lekë, OE i shpallur fitues "Z." shpk me vlerë të ofertës 4,134,613 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE "Z." shpk me ofertë 4,166,588 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 458,788 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "Sh." shpk në vlerën 3,675,824 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

10. Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt "*Sistemi i kondicionimit për godinën e Bashkisë Berat*", me FL në vlerën 18,333,332 lekë, OE i shpallur fitues "L." shpk me vlerë të ofertës 17,964,893 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE "L." shpk me ofertë 17,964,893 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,293,393 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "M.i" shpk & "B." shpk në vlerën 16,671,500 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

11. Në procedurën e prokurimit të vitit 2019 me objekt "*Ujësjellësi fshati Mbreshtan, Njësia Administrative Sinjë*", me FL në vlerën 31,065,619 lekë, OE i shpallur fitues "F." shpk me vlerë të ofertës 21,956,747 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE "F." shpk me ofertë 21,956,747 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,452,546 lekë, si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "K." shpk në vlerën 20,504,201 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

IV. Në fushën e të ardhurave nga taksat, tarifat, qiradhëniet dhe gjobat u konstatuan të ardhura të munguara në shumën **176,329,134 lekë** nga të cilat: -59,300,000 lekë, gjoba dhe kamata për mos arkëtim për ndërtimet pa leje, -26,225,134 lekë mosarkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objekte që legalizohen, -75,504,000 lekë mos lidhje kontrate për lejet minerare dhe, -15,300,000 lekë për lejet e tregëtimit fundor të karburanteve.

-Gjithashtu janë konstatuar mos pagimi në afat të detyrimit tatimore nga subjektet në Bashkinë Berat dhe 4 Njësitë Administrative më datën 30.09.2019 detyrimet për taksat dhe tarifat vendore *në shumën **prej 267,055,110** lekë, debitor si më poshtë:*

-563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh,në vlerën 68,838,416 lekë

-10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë

*-Për taksën e ndërtimit,tarifat e pastrimit në vlerën **135,403,069 lekë**, nga të cila:*

- rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Berat.

- 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,

-700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastruktrurë për vlerën 26,225,134 lekë.

Stoku i faturave të palikuiduara paraqitet në shumën 75,276,256 lekë.

V. Në lidhje shkallën e auditimit dhe analizën e procedurave të prokurimit, për cdo vit rezulton:

2017

Nga **27** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 488,919,731 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **20** procedura me vlerë kontrate prej 513,903 mijë lekë, ose 94% e totalit të kontratave, ku **6** procedura ose rreth 30% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **6,233,383 lekë**.

2018

-Për vitin 2018, janë zhvilluar gjithsej 27 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 249,636,491 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 221,410,495 lekë me diferencë nga FL në vlerën **28,225,996 lekë**, nga të cilat 7 procedura të llojit tender i hapur, 20 procedura të llojit kërkesë për propozim dhe nuk ka procedura me negocim pa shpallje paraprake.

Nga **27** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 249,636,491 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **14** procedura me vlerë kontrate prej 218,657 mijë lekë, ose 87% e totalit të kontratave, ku **7** procedura ose 50% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **11,673,836 lekë**.

9-mujori I-rë, 2019

Në totalin e procedurave të planifikuara për periudhën 01.01.2019 – 30.9.2019, konstatohet se nga

AK janë zhvilluar gjithsej 5 procedura deri në 30.09.2019 të cilat janë anulluar nga AK, me fondin limit në shumën 68,611,900 lekë pa tvsh dhe fondin e fituar në shumën 27,869,991 lekë pa tvsh. Pas shpalljes së fituesit nga ana e KVO-së dhe përfundimit të procedurës së ankimimit, AK nuk ka vazhduar më tej me fazën e lidhjes së kontratës siç është parashikuar në LPP por ka vendosur anullimin e procedurave të prokurimit.

Për këto procedura bazuar në Urdhërin e Kryetarit me nr. 589 protokolluar me nr. 4224 prot., datë 14.08.2019 është urdhëruar anullimi i tyre për shkak të mungesës së fondeve dhe situatës problematike që shqaf 6-mujori i dytë i vitit 2019 duke u nisur nga MEMO me nr. 4154 prot., datë 08.08.2019 e Drejtorisë së Financave në lidhje me situatën financiare të Bashkisë Berat. Nga ana e AK është hatuar për çdo procedurë Formulari Nr. 3 dhe pasqyruar në SEP anullimi i procedurave të sipërcituara. Nga ana e OE të shpallur fitues deri në momentin e mbajtjes së Akt-Verifikimit nuk është bërë asnjë ankesë pranë AK apo gjykatës për anullimin e procedurës.

-Sipas drejtimeve të auditimit janë konstatuar disa anomali për pjesën financiare por jo të përhapura për të cilat do të jepet një opinion i kualifikuar. Për MFK janë plotësuar pyetësor dhe intervista ku konkluzionet do të shërbejnë për të implementuar kontrollet e vendosura më me eficencë në këtë drejtim si dhe për të parashikuar strategji zhvillimi jo duke u mjaftuar me përcaktimin e objektivave dhe politikave vetëm në pjesën e PBA si detyrim ligjor.

Janë parashikuar paraprakisht 14 masa organizative, 6 masa për shpërblim dëmi, një masë për 11 procedura prokurimi për shpenzime jo sipas 3-E, një propozim APP për përjshtim të OE nga tenderat. Disa nga observacionet mbi aktet e mbajtura në fund të auditimit në terren do të trajtohen në Raportin Përfundimtar të auditimit.

I/c. OPINIONI I AUDITIMIT

<u>Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.</u>

Për drejtimin e Bashkisë Berat.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Berat për vitin ushtrimor 2018 të cilat përfshijnë:

1. Pasqyrën e pozicionit financiar;
2. Pasqyrën e performancës financiare;
3. Pasqyrën e flukseve monetare;
4. Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
5. Pasqyrën mbi shënimet shpjeguese si dhe pasqyrat statistikore.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi sipas parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Veprimtaria është audituar sipas kërkesave të përputhjes me parimet e kontabilitetit të pranuara ligjit organik të buxhetit, si kërkesat: e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël "Kapitulli I, pika 1 dhe UMF nr.14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj" Kapitulli IV **"**Disa veçori për llogarite vjetore te njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj", ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 58,59 dhe 60 "Shërbimi i borxhit", me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore "neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjit

nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 41 "Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm" pika 2 nënpika (ç/iii).
Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

Opinion i kualifikuar[1]:
Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e "Bazës për Opinionin e kualifikuar", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2018, referuar ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion e kualifikuar:
Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Baashkisë Berat, për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2018, e cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.
Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.
Kemi konstatuar se në disa llogari të pasqyrave financiare, janë kryer veprime kontabël të gabuara duke natyruar përmbajtjen e tyre dhe duke pakësuar vlera kontabël, çka i bëjnë ato të pa sakta:
- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera.
- Për vitin 2018, nga Drejtoria e Financës, *nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit* financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit.
Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Berat[2]
Ne kemi audituar përputhshmërinë[3] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

[1] **Opinioni i kualifikuar.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale, por jo të përhapura**, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë **dëshmi të mjaftueshme** dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.
[2] **ISSAI 4100 –** Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.
[3] Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Berat, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017 dhe 2018.

Opinion i kualifikuar.
Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Berat, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Kualifikuar", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinion e kualifikuar:
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

- Në Bashkinë Berat, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

- Detyrimet e faturuara të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2019 janë në vlerën **75,276,256 lekë**.

- Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

- Janë konstatuar mos pagimi në afat të detyrimit tatimore nga subjektet në Bashkinë Berat dhe 4 Njësitë Administrative më datën 30.09.2019 detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në shumën prej **267,055 mijë lekë**, debitor si më poshtë:
- 563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh,në vlerën 68,838,416 lekë
- 10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë
- për taksën e ndërtimit,tarifat e pastrimit në vlerën 135,403,069 lekë, nga të cila:
- rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Berat.
- 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,
- 700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastruktrurë për vlerën 26,225,134 lekë.

  Stoku i faturave të palikuiduara paraqitet në shumën 75,276,256 lekë.

- Në fushën e të ardhurave nga taksat, tarifat, qiradhëniet dhe gjobat u konstatuan të ardhura të munguara në shumën 176,329 mijë lekë nga të cilat: -59,300 mijë lekë, gjoba dhe kamata për mos arkëtim për ndërtimet pa leje, -26,225 mijë lekë mosarkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objekte që legalizohen, -75,504 mijë lekë mos lidhje kontrate për lejet minerare dhe, -15,300 mijë lekë për lejet e tregëtimit fundor të karburanteve.

- Në zbatimin e punimeve të 6 kontratave u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **15,526 mije lekë**.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime në paligjshmërisë ligjore dhe shpalljes fitues të operatorëve me vlerë kontrate 148,967 mijë lekë, me efekt negativ në vlerën **19,171 mijë lekë**, nga e cila me dëm ekonomik për vlerën **188 mijë lekë**.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Berat.

Drejtimi i Bashkisë Berat, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 606/1, datë 26.08.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 02.09.2019 deri në datë 15.11.2019, në subjektin Bashkia Berat, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 30.09.2019, u krye auditimi "Auditim financiar dhe përputhshmërie" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. Th., Përgjegjës Grupi
2. G. H., Auditues
3. A. Gj.j, Auditues
4. N. N., K/Auditues
5. Sh.H., Auditues
6. Ing. S. M., Auditues
7. Ing. A. Z., K/Auditues

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Berat.

Marrësi: Bashkia Berat

Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2017-2018,transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve;
Procedura e ndjekur*:* Projekt Raport auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Berat, pasi nga grupi i auditimit janë dorëzuar në protokoll aktet e mbajtura në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti me shkresat përcjellëse janë paraqitur kundërshtitë, të cilat u analizuan me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri në Raportin Përfundimtar të auditimit.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit*:*

- ***Qëllimi i auditimit:***

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e **përputhshmëris**ë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.
Objektivat e auditimit synojnë***:***
Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:
-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
-verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Identifikimi i çështjes:

Raporti përfundimtar i auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit; në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Berat, si dhe përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaje komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Berat.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit*)*.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Berat janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave finaciare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njejtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhsmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për Planifikimin, Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Auditin e Brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të aparatit të Bashkisë Berat dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit. Auditimi është kryer në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Kriteret e vlerësimit. Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014,datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;

Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar;

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës

Evropiane të Audituesve;
Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi "Auditimin e përputhshmërisë", Manualet e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore";
Udhëzimi i MF nr. 10/1,datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor";
Udhëzimin plotësues i MF nr. 02, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetin të vitit 2018";
Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte te monitorimit te buxhetit te Njësive te vetëqeverisjes vendore";
Udhëzimi i MF nr. 14, date 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si,.." ; Udhëzimi i MF nr. 26,datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006;
Udhëzimi i MF nr. 08, date 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël"; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë;
Standardet e auditimit Auditimi është kryer sipas standarteve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë"* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit*:*
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe vlerësimit të observacioneve u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Berat dhe përputhshmërinë e aktivitetit, në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare.
Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë proçesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin Bashkia Berat, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

***Parimet e auditimit financiar*:** Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:
- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:
***Përkatësia*:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Saktësia*:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
***Periudha*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
***Klasifikimi*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
***Ligjshmëria dhe rregullsia*:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.
Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës
***Ekzistenca*:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
***Të drejtat dhe detyrimet*:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
***Plotësia*:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Vlerësimi dhe alokimi*:** Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.
Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
***Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet*:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
***Klasifikimi dhe kuptueshmëria*:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
***Saktësia dhe vlerësimi*:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.
Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të

gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialiteti në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesit konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialiteti janë marrë shpenzimet. Nën gjykimin profesional të audituesit, për institucionin Bashkia Berat grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialiteti grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit*:*

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.
Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
7. Intervistimi
8. Raporte dhe Informacione
9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi në Bashkinë Berat u krye në kuadër të planifikimit fillestar vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës por jo të përhapura si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve si dhe me dëm ekonomik në disa projekte zbatimi në fushën e investimeve për punë publike. Ky auditim ka rëndësi për KLSH duke qenë se është njësi me peshë në vetëqeverisjen vendore.

Bashkia e Beratit shtrihet në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum i cili kalon përmes qytetit të Beratit. Shtrirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peisazheve gjeografike.

Me ndarjen e re administrative, Bashkia Berat, përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Beratit, njësitë Administrtaive ;Roshnik, Otllak, Velabisht dhe Sinjë.

Sipërfaqja totale e Bashkisë Berat është 380 km², nga 22.4 km² që ishte para Reformës Administrative Territoriale 2014, nga e cila 170 km2 eshte toke bujqesore (ketu perfshihen tokat e kultivuara dhe jo te kultivuara) dhe 180 km2 eshte toke natyrore (pyje, kullota). Njesite Otllak e Velabisht kane perqendrimin me te larte te tokes bujqesore e cila kryesisht kultivohet me dru frutore e ullinj e fidanishte. Njesia Sinje e Roshnik karakterizohen nga toke bujqesore e fragmentizuar e siperfaqen me te madhe te tokes natyrore (reliev kodrinor e malor). Bashkia Berat pershkohet nga lumi i Osumit dhe eshte teper i pasur me ujera nentokesor e burime ujore siperfaqesore. Siperfaqja totale ujore eshte 9 km2. Industria dhe ekonomia shtrihen ne nje siperfaqe prej 1.34 km2. Sipefaqja qe zene sherbimet jane te perqendruara ne qytetin e Beratit dhe fshatrat kryesore te kater njesive. Banimi shtrihet ne nje siperfaqe to vogel, krahasuar me token bujqesore dhe natyrore, 4.63 km2. Qyteti i Beratit karakterizohet nga zona urbane te konsoliduara. Ne njesite e tjera zonat e banuara jane te vendosura pergjate akseve rrugore. Ne total bashkia Berat ka 812 km rruge lineare.

Bashkia kufizohet ne veri me bashkine Kucove, ne lindje me Bashkine e Gramshit, ne juglindje me Bashkine Polican dhe Sktapar, ne perendim me bashkine Mallakaser dhe Fier.

Bashkia Berat eshte qendra me e rendesishme demografike, administrative dhe e konomike e qarkut Berat. Qyteti I Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detet dhe ka nje sip. 22.4 km 2 nga e cila 6.3 km 2 jane siperfaqe urbane.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Objekti i këtij auditimi është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit.
Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit për pasqyrat financiare dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin dhe operacionet për efekt të ligjit të prokurimit dhe mnaxhimit financiar dhe kontrollit.
Fushëveprimi i këtij auditimi përfshin të gjithë aktivitetin e aparatit të Bashkisë Berat.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Berat.
Misioni për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*
Objektivat burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".
Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.
Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.
Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.
Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë
Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre

në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.
Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT DHE GJETJET

A. PLANIFIKIMI DHE IDENTIFIKIMI I RISKUT; STRATEGJIA DHE VLERËSIMI I RISKUT; KONTROLLI I BRENDSHËM.

A/3.1. ***Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon;***
Në zbatim të pikës A, 3.1 të programit të auditimit u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

-Rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Njësisë.
-Stretegjitë e përgjithshme dhe sektoriale.
-Informacione me shkrim nga drejtuesit e nivelit të lartë mbi veprimtarinë e sektorëve që mbulojnë si dhe objektivat e planet periodike të punës.
-Projektbuxhetet dhe buxhetet vjetore të miratuara.
-Raportet periodike mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.
-Vendime të Këshillit Bashkiak, 2018.
-Intervista dhe raporte me shkrim të punonjësve të administratës.
Për qëllim të verifikimit sa më sipër u përdorën teknika auditimi për grumbullimin e evidencës dhe auditimin si fizike, dokumentare, verbale dhe analitike.

Për të verifikuar funksionimin e kontrolleve të vendosura, të raportuara nga komunikimi me grupin e auditimit, për qëllim të auditimit u kërkua me shkrim drejtorive informacion të shoqëruar me dokumentacion për çështjet e mëposhtme:

1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që Ju drejtoni dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.

2. Objektivat dhe Prioritetet e funksionit që ju ushtroni për vitin 2018.

3. Risqet e identifikuara në punën tuaj për vitin 2018 dhe vlerësimin, kontrollin e risqeve që mund të kenë vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që Ju drejtoni.

4. Komtributi juaj në garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që Ju drejtoni, bazuar në rregullat e vendosura nga Titullari i Institucionit, si dhe raportet tuaja periodike tek nëpunësi autorizues për çdo dobësi të sistemit. Raportet periodike mbi zbatimin e strategjisë 2018-2022, për vitin 2018.

5. Informacionin në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që Ju drejtoni, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e të metave.

6. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.

8. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive si dhe kontrollet e vendosura dhe funksionimi i tyre për çdo përgjegjës sektori dhe specialist, referenca e akteve ku mbështeten.

9. Informacion mbi ngarkesën e strukturës që Ju drejtoni në drejtim të aktiviteteve, burimeve njerëzore, aseteve dhe buxhetit pas reformës territoriale administrative."

dhe përgjigjet respektive, të cilat administrohen nga Grupi i Auditimit, janë reflektuar në aktverifikimin e mbajtur për këtë qëllim.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Berat, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit, për të gjithë komponentët si: *Mjedisi i kontrollit*", "*Menaxhimi i riskut*", "*Aktivitetet e kontrollit*", "*Informimi dhe Komunikimi*" si dhe "*Monitorimi*", në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "*Për disa shtesa dhe ndryshime*", ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.
Me synimin e implementimit të këtij ligji dhe të akteve rregullatore është kërkuar: regjistri i riskut, pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportet vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, koordinatorit të riskut, sekretarit të GMS, procesverbalet e mbledhjeve të GMS, rishikimi i regjistrit të riskut, rivlerësimi dhe plani i veprimit me masa korrigjuese, dokumentimi i gjurmës së auditimit, harta e proceseve të punës si dhe u aplikuan intervista me shkrim me nivelet e mesme dhe të larta drejtuese dhe pyetësor në rang institucional.
Disa nga objektivat e veprimtarisë së Bashkisë Berat parashikuar në PBA janë si në vijim:

1. Menaxhim me efikacitet të Burimeve Njerëzore, për krijimin e një administrate vendore profesionale në bazë të meritës, aftësive dhe profesionalizmit.
2. Sigurimi i informimit të vazhdueshëm, transparent për publikun dhe mediat me qëllim krijimin e një mjedisi pozitiv komunikimi dhe bashkëpunimi institucion – komunitet duke rritur nivelin e shërbimit për komunitetin.
3. Përqasja e integruar e zhvillimit ekonomik të bashkisë për përmiresimin e jetës së qytetarëve, të mbrojtjes së ambientit kundrejt zhvillimit të rrjetit rrugor dhe një transport publik të shpejtë, të besueshëm dhe konfort.
4. Ndjekja e problemit të sinjalistikës rrugore në të tre komponentet e saj (sinjalistika elektronike; sinjalistika horizontale; sinjalistika vertikale).
5. Evidentimi dhe hartimi i planit të masave paraprake për emergjencat civile.

   Hartimi politikave për rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat në zbatim të paketës fiskale dhe planit të të ardhurave në funksion të realizimit të buxhetit të bashkisë.
6. Të hartojë dhe të mbështesë realizimin e projekteve që nxisin politikat parësore të turizmit, të jetës kulturore, artistike, sportive e rinore të qytetit, duke vlerësuar veprimtaritë e përvitshme që janë bërë pjesë e traditës së kalendarit turistik, kulturorë e sportiv të qytetit dhe projekte që synojnë veprimtari elitare.
7. Të promovoj vlerat e Trashëgimisë Kulturore të qytetit, tashmë **si të UNESCO-s** si edhe të resurseve turistike të njësive administrative duke rritur shkallën e informacionit

për vizitorët, futjen në axhendat ndërkombëtare të turizmit, kulturës e sportit të qytetit, të nxis bashkëpunimet me organizatat, institucione të huaja .

8. Zbatimi i Planit të detajuar vendor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të Qytetit dhe Njësive administrative.
9. Zhvillimi i territorit duke respektuar politikat rajonale dhe kombëtare për Planifikimin dhe Zhvillimin të Territorit.
10. Sigurimi i kushteve të përshtatshme të infrastrukturës dhe sigurisë për arsimin bazë sipas standardeve dhe rritja e numrit të fëmijëve që ndjekin arsim parashkollor me cilësi.
11. Menaxhimi korrekt i financave vendore, sigurimi i përdorimit të fondeve publike në respektim të parimeve të ekonomicitetit, eficences dhe efektivitetit, në funksion të realizimit të misionit të bashkisë.
12. Ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave për realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
13. Nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
14. Rritja e të ardhurave të bashkisë nëpërmjet një menaxhim sa më të mirë të pronave të bashkisë, rritjen e numrit të pronave të regjistruara në Z.V.R.P.P, me qëllim rritjen e numrit të ambienteve të dhëna me qira ose kontrata të tjera si dhe monitorim sa më efikas i tyre.
15. Objektiva emergjente në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
    - Parashikimin e kostove sipas VKM Nr. 319, datë 31.05.2018 " Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".
    - Në Njësitë Administrative ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standardin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.
16. Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe përmirësimi i klimës së biznesit përmes dhënies dhe aksesit të lehtësuar të informacionit për të bërit biznes në Berat.
17. Përmirësimin e raportit midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale në favor të atyre kapitale.
18. Politika lehtësuese për bizneset e hapura, nga familjet e reja, dhe të drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative.
19. Gjallërimin e jetës social - kulturore dhe artistike nëpërmjet mbështetjes së aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive në qytete në bashkëpunim me donator dhe partner vendas dhe të huaj për të gjallëruar jetën e qytetit.

Evidentohet qartë fakti që këto janë objektiva të përgjithshëm prioritar për çdo vit buxhetor të shoqëruara me politika të programeve respektive në PBA dhe aktivitete për zbatimin e objektivave por nuk rezulton të ketë objektiva specifik në zbërthim të atyre të përgjithshëm për çdo vit buxhetor sipas specifikave dhe dinamikës së aktivitetit të institucionit.

- **Për vitin 2017** Bashkia Berat ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendimin Nr.890 Prot, datë 23.12.2016 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj", për vitin 2017, i ndryshuar me vendimin nr. 194, datë 31.01.2017, vendimin nr. 269, datë 20.02.2017, vendimin nr. 411 datë 05.04.2017, vendimin nr. 667 datë 24.08.2017, vendimin nr. 710 datë 13.09.2017 "Për ndryshime në vendimin nr. Nr.890 Prot, datë 23.12.2016 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2017, me vendimin nr. 482 , datë 08.05.2017, "Për disa shtesa ne vendimin nr. Nr.890 Prot,

datë 23.12.2016 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2017, ku numëri i miratuar i punonjësve është 684 së bashku me gjendjen civile dhe Sportelin QKB janë 697.

- Për vitin 2018 ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryetari Bashkisë me vendimin nr. 855 Prot, datë 30.11.2017 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj "për vitin 2018, i ndryshuar me vendimin nr. 75, datë 31.01.2018, vendimin nr. 142, datë 23.02.2018, vendimin nr. 334 datë 10.05.2018, vendimin nr. 499 datë 09.07.2018, vendimin nr. 682 datë 28.08.2018 "Për ndryshime në vendimin nr. Nr.855 Prot, datë 30.11.2017 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2018, ku numëri i miratuar i punonjësve është 704 së bashku me gjendjen civile dhe Sportelin QKB janë 717.

- **Për vitin 2019** ka funksionuar me strukturën e miratuar me urdhrin Nr. 925 Prot, datë 26.11.2018 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2019, i ndryshuar me vendimin nr. 80 datë 22.01.2019, vendimin nr.169, datë 04.03.2019, vendimin nr. 325 datë 23.04.2019, vendimin nr. 380 datë 09.05.2019 "Për ndryshime në vendimin nr. Nr. 925 Prot, datë 26.11.2018 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2019, ku numri i miratuar i punonjësve është 724 së bashku me gjendjen civile dhe Sportelin QKB janë 737.

Grupi i auditimit në zbatim të përgjegjësive menaxheriale, sipas nenit 11 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, administroi informacione lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin që nëpunësi zbatues ka si detyrim ndaj nëpunësit autorizues. Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë për periudhën objekt auditimi, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike. Nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Ky institucion, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 2 gërma a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike", Institucioni i Bashkisë Berat ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, miratuar në vitin 2013 me vendim të Këshillit të Bashkisë Berat nr. 38, datë 31.10.2013 dhe përditësuar në vitin 2018 me shkresën nr. 721/1, datë 07.02.2018.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Bashkia Berat ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendimin Nr. 890 Prot, datë 23.12.2016 "Mbi miratimin e strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2017, i ndryshuar".

Për vitin 2018 Bashkia Berat ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendimin nr. 855, datë 30.11.2017 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2018, i ndryshuar.

Për vitin 2019 bashkia Berat ka funksionuar me strukturën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me vendimin nr. 925, datë 26.11.2018 "Mbi miratimin e Strukturës organike të Administratës së Bashkisë dhe Njësive Shpenzuese në varësi të saj" për vitin 2019, i ndryshuar.

Bashkia Berat ushtron veprimtarinë e saj mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore dhe mbi bazën e **Rregullores së Brendshme** të miratuar me Urdhër nr. 444, datë 14.04.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë" për vitin 2017 si edhe **Rregullores së Brendshme** të miratuar me shkresës nr. 721, datë 07.02.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë" për vitin 2018.

Për vitin 2019 nuk janë bërë ndryshime, është në fuqi po e njëjta rregullore e miratuar, pasi edhe ndryshimet e ndodhura në strukturë nuk krijojnë funksione të reja dhe nuk cënojnë funksionimin e brendshëm të administratës së bashkisë.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Punonjësit e Bashkisë Berat i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit mbi nëpunësin civil, në bazë të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Aktualisht administrata e bashkisë përbëhet nga 77 punonjës me status të nëpunësit civil dhe 47 punonjës me kontrata individuale pune në bazë të Kodit të Punës të RSH.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ky institucion ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, orarin dhe kohën e punës etj. Nga institucioni është bërë vlerësimi vjetor i punës për nëpunësit civil në periudhe prove dhe vlerësimi 6- mujor i punës për çdo Nëpunës civil të konfirmuar, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Stafi i Bashkisë Berat është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas kërkesave të vendit të punës. Stafi është rekrutuar nëpërmjet konkurrimit të kryer nga Njësia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në rastin kur rekrutimi i punonjësit bëhet sipas ligjit të nëpunësit civil.

Punonjësit për vitin 2017 kanë zhvilluar trajnime, të realizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ku kryesisht kanë të bëjnë për punonjësit në periudhë prove dhe trajnime të tjera për nëpunësit civil të konfirmuar për përfitim të njohurive shtesë sipas pozicioneve respektive të punës.

P**ër vitin 2018** kanë zhvilluar trajnime, të realizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ku kryesisht kanë të bëjnë për punonjësit në periudhë prove dhe trajnime të tjera për nëpunësit civil të konfirmuar për përfitim të njohurive shtesë sipas pozicioneve respektive të punës cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me ndryshimet në legjislacion, mbi procedurat e prokurime publike,

mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, mbi menaxhimin e financave dhe kontabilitetit, Menaxhim mjedisi dhe mbetjesh.
P**ër vitin 2019** kanë zhvilluar trajnime, të realizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ku kryesisht kanë të bëjnë për punonjësit në periudhë prove dhe trajnime të tjera për nëpunësit civil të konfirmuar për përfitim të njohurive shtesë sipas pozicioneve respektive të punës të cilët janë përgjegjës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke përfshirë trajnimin lidhur me ndryshimet në legjislacion, mbi procedurat e prokurime publike, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore, mbi menaxhimin e financave dhe kontabilitetit, Menaxhim mjedisi dhe mbetjesh, Planifikim Operacional etj.
Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konflikt interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar në lidhje me "ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".
- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH", si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 "Për organizimin e administratës shtetërore" si dhe janë njoftuar Njësia Qëndrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial).
- ***Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS)*.** Në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", nga Bashkia Berat është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.349, datë 20.03.2017 ''**Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)''** si dhe ''**Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve**'' me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 196 datë 15.03.2018 u ngrit ''**Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)** si dhe **Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve Buxhetore''**.

Për vitin 2019; me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. nr.207 dt.07.03.2019 u ngrit **Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)** si dhe **Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve**, Urdhëri nr. 537 datë 25.07.2019 "Për zevendësim në grupin për menaxhim strategjik", me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. nr.632 datë 04.09.2019 u ngrit **Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)** si dhe **Ekipet e Menaxhimit të Programeve të Shpenzimeve.**

Nga auditimi konstatohet se ka mangësi të njohurive të stafit në lidhje me menaxhimin e riskut, për të cilën nga institucioni, pavarësisht se që në fillim të vitit 2018 është hartuar Plani i Zhvillimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, çështjet e të cilit janë të lidhur me komponentë të MFK.

Për vitin 2019 Bashkia Berat është mbështetur nga Projekti Menaxhimi Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes Vendore, financuar nga SECO. Faza e parë shërbeu si proces i diagnostikimit të gjendjes aktuale të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportimit financiar për secilën bashki pilote me qëllim të vlerësimit të aftësive për trajtimin e çështjeve në nivel individual dhe organizativ, u formuluar Plani i Zhvillimit në përputhje me objektivat e institucionit, duke përfshirë trajnimet dhe ndryshimet e tjera që do të nevojiten për të siguruar zbatimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportimit financiar.

Nga sa më sipër arrijmë në përfundimin se Mjedisi i kontrollit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

2. Menaxhimi i riskut

Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut kanë qënë të lidhura ngushtë me realizimin e misionit, vizionit dhe objektivat dhe qëllimet e Bashkisë Berat. Menaxhimi i riskut është parë si një element i ciklit të planifikimit dhe të marrjes së vendimeve. Me rëndësi ka qënë përkufizimi i të gjitha fushave të riskut dhe përdorimi i një metodike të unifikuar në identifikimin, analizën dhe raportimin e riskut. Ka funksionuar proçesi i vlerësimit dhe kundërveprimit ndaj pasojave të riskut, që përfshijnë të gjitha njësitë, që janë në varësi të Bashkisë Berat.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Menaxhimi i riskut nuk është një proces linear, por ai është balancimi i një numri të elementeve të ndërthurur që ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe të cilat duhet të jenë në ekuilibër me njëri-tjetrin me qëllim që menaxhimi i riskut të jetë efektiv. Për më tepër, risqet specifike nuk mund të trajtohen në mënyrë të izoluar nga njëri-tjetri, menaxhimi i një prej risqeve mund të ketë një ndikim në një tjetër, apo veprimet e menaxhimit të cilat janë të efektshme në kontrollin e më shumë se një risku në të njëjtën kohë, mund të jetë i arritshëm.

Kufizimi i riskut është bërë nëpërmjet marrjes në kohën e duhur të masave të përshtatshme korrigjuese dhe riparuese.

Elementët kryesorë të strategjisë së menaxhimit të riskut në Bashkinë Berat janë :

1. Programi buxhetor afatmesëm 2018-2020, 2019-2021 dhe 2020-2022 (në proces) i Bashkisë Berat, ku janë të vendosura objektivat për çdo program, aktivitetet që do të kryhen dhe produktet që do të arrihen.
2. Hartimi i Planit Vjetor të Punës i Bashkisë Berat.
3. Evidentimi i fushave themelore të funksionimit të Bashkisë Berat.
4. Përcaktimi i objektivave të përgjithëshme për Bashkinë si dhe për çdo specialist për 6-mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2017, 2018, 2019 për Nënpunësin Civil.
5. Identifikimi i zonave të riskut në kuadër të fushave të veprimit të përcaktuara.
6. Përkufizimi dhe përshkrimi i risqeve, vlerësimi i impaktit të risqeve.
7. Përgjigja ndaj riskut – masa parandaluese, duke përfshirë ato që janë zbatuar dhe ato që janë të domosdoshme në të ardhmen (të planifikuara).
8. Caktimi i detyrave konkrete që lidhen me kundërveprimin ndaj një lloji të caktuar risku, për punonjës të caktuar të Bashkisë Berat.
9. Rishikimi i regjistrit të riskut, përcaktimi i zonave të riskut, me peshë dhe impakt të ndryshëm.

Adresimi i riskut:

Risqet e idetifikuar mund të zvogëlohen nëprmjet aktiviteteve të tilla:

i. Kontollet parandaluese (ndarjen e qartë të detyrave, delegim të autorizuar të detyrës etj.)
ii. Kontrolle korrigjuese (rikuperim të pagesave të pasakta, plotësim me dokumetacionin e duhur etj.)
iii. Kontrolle udhëzuese (masat për ruajtjen e shëndetit dhe të jetës së punonjësve)

iv. Kontrollle zbuluese (kontrollet për verifikimin e lëvizjes së vlerave materiale,inventarizim në magazinë për gjendjen e mallit dhe mënyren e lëvizjes së tij, akt rakordimet per të ardhurat dhe shpenzimet)

Përgjegjësitë: Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 10 të Ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", strukturat përgjegjëse janë:
- Titullari i njësive publike është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë së tij.
- Nëpunësi Autorizues është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar; është Koordinatori i Riskut dhe përgjigjet për monitorimin e kontrolleve për minimizimin e risqeve brenda njësisë. Sidoqoftë, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Nëpunësi autorizues mund të delegojë detyra që kanë lidhje me koordinimin e riskut, një menaxheri tjetër të njësisë në vartësi direkt prej tij.
- Auditimi i brendshëm në rolin e vlerësuesit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe këshilluesit. Për vitin 2019 auditi i brendshëm ka bërë vlerësimin e nivelit të riskut, të subjekteve për tu audituar.
Nga auditimi rezultoi se në lidhje me i*dentifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut:*
Në përmbushje të përgjegjësive ligjore, (ligji 68/2017, Për finacat vetëqeverisjes vendore neni 52) **për menaxhimin e aktiveve,** është miratuar me **Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 18.05.2018 rregullorja për përcaktimin e rregullave për menaxhimin e aktiveve**, **stategjia e menaxhimit të riskut të aktiveve të Bashkisë Berat**, me synimin e standartizimit të rregullave dhe të procedurave për zbatimin e sistemit të menaxhimit finaciar dhe kontrollit, caktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e inventarizimit fizik, vlerësimin e aseteve dhe nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve si dhe stategjinë e menaxhimit të riskut të aktiveve të Bashkisë Berat.

Për vitin 2019, Kryertari i Bashkisë me Urdhrin nr. 135, datë 13.02.2019 "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe manaxhimit të riskut në Bashkinë Berat, ka vendosur:

1. Kordinatori i deleguar për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe riskun në Bashkinë Berat do të jetë znj, A. C., përgjegjëse e sektorit të Financë Kontabilitetit, në Drejtorinë e Financës.
2. Të krijohet ekipi i Menaxhimit të Riskut me përfaqësues nga çdo strukturë e Bashkisë Berat për funksionimin normal dhe vijimin e procesit të menaxhimit të financiar dhe kontrollit dhe koordinimit të riskut,

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet organizata ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

- Për vitet objekt auditimi, në lidhje me hartimin e regjistrit të riskut për institucionin, në përcaktimin e risqeve sipas objektivave për çdo drejtori, sektor dhe njësi shpenzuese në mbështetje të nenit 21 Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, *paraqitet sipas njësive shpenzuese kjo situatë:*
1. Bashkia Berat ka hartuar rregjistër rrisku.
2. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, nuk ka rregjistër rrisku.
3. Ndërmarrja e Gjelbërimit, ka rregjistër rrisku.
4. Drejtoria e Arsimit, ka rregjistër rrisku.

5. Drejtoria e Bujqësië, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar ka rregjistër rrisku.
6. Qëndra Kulturore "Margarita Tutulani", ka rregjistër rrisku.
7. Qëndra "Lira", nuk ka rregjistër rrisku.

Sipas Drejtorive brenda bashkisë rezulton:

Drejtoria e Burimeve Njërzore ka pregatitur rregjistër risku

1. Drejtoria e Shërbimit Social ka pregatitur rregjistër risku
2. Drejtoria e Të Ardhurave ka pregatitur rregjistër risku
3. Drejtoria e Financës ka pregatitur rregjistër risku
4. Drejtoria e Prokurimeve ka pregatitur rregjistër risku
5. Drejtoria e Emergjencave, Shërbimeve, Transportit dhe Pronave ka pregatitur rregjistër risku
6. Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Integrimit Europian ka pregatitur regjistër risku
7. Drejtoria e Planifikimit Urban ka pregatitur regjistër risku

Nuk kanë dorëzuar regjistër risku

1. Drejtoria e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi
2. Inspektoriati Mbrojtjes Territorit.
3. Policia bashkiake.

Hapi I "Organizimi i procesit", përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike.
Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. GMS duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, dhe duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit, ku këto takime duhet të regjistrohen nga sekretari dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe të udhëzimit të MF nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike" pika 2.2.4.
Nga auditimi rezulton se për vitet 2017-2018 janë kryer takime me *stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe është rishqyrtuar vlerësimi i riskut, por duhet të kishin gjetur reflektim të plotë në raportin vjetor, i cili duhet të ishte përgatitur nga GMS*.
- Gjithashtu konstatohet se ka mangësi të njohurive të stafit në lidhje me menaxhimin e riskut, për drejtoritë dhe njësitë e vartësie. *Pra duhet theksuar se menaxhimi i riskut është një komponent thelbësor në implementimin e një sistemi modern të MFK, për të cilin institucionet publike kanë nevojë për asistencë teknike dhe rritje ndërgjegjësimi në periudhën në vijim. Nga Bashkia Berat janë bërë hapa në drejtim të ngritjes dhe funksionimit sistemit të menaxhimit të risqeve, por të mos jetë fokusuar vetëm në strukturat e financës, por të shtrijë në të gjithë institucionin dhe njësitë e vartësisë.*

3. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme, ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.
Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.
Metoda e përgjithshme e rekomanduar për krijimin, vlerësimin dhe raportimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit përmblidhet në disa hapa kryesore.

Duke pasur parasysh kërkesat e kapitullit III të Ligjit Nr. l0296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, vlerësimet në bashkinë Berat për çdo Komponent të MFK.
Në bashkinë Berat:

A. Kontrollet parandaluese , parandalojne humbjet dhe kufizojnë risqet.
i. Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave;
ii.Sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e NA dhe NZ;
iii.Të drejtat për përdorimin e aktiveve, lëshimin e autorizimineve për lëvizjen e aktiveve brenda njësisës nga personat e autorizuar nga Titullari i njësisë.
iv.Para kryerjes së procedures së prokurimit publik merret konfirmimi nga drejtoria e financës për disponobilitetin e fondeve me qëllim që të mos krijojmë detyrime dhe çdo procedurë blerje të mbështetet me fonde.
v.Para likujdimit të një fature për blerje malli apo kryerje shërbimi, kontrollohet saktësia e veprimeve matematikore dhe dokumentacioni justifikues i shpenzimit.
vi.Respektimi i sasisë dhe çmimit sipas kontratës ose ofertës së ofruar nga operatori fitues.
vii.Para likujdimit të një fature për punë civile, shërbime ose furnizim malli sipas procedurës së prokurimit elektonik kontrollohet realizimi i kontratës dhe fondet e disponueshme në thesar sipas strukturës së klasifikimit ekonomik të miratuar nga MF.
B.Kontrollet zbuluese. Këto kontrolle synojnë të ulin rriskun e pasojave të padëshirueshme, pasi mundësojnë marrjen e masave korrektuese. Disa nga kontrollet që zbatohen në Bashkinë Berat.
i.Grupit të punës për përcaktimin e fondit limit për blerjet e vogla apo për prokurimet me vlerë të lartë ka dhënë fond limit brenda rregjistrit të parashikuar të prokurimit?
ii. Komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara kontrollon sasinë, cilësinë sipas specifikimeve të kërkuar në ftesën për ofertë mbi bazën e proceverbalit të mbajtjes në vend bëhet hyrje malli që dokumentohet me Fletë Hyrje .
iii.Kontrollet periodike të lëvizjes së vlerave monetare në Njësitë administrative, në bashki, (gjendja e arkës dhe mënyra e mbajtjes së kontabilitetit, libri dhe ditari i arkës)
iv.Kontrolli periodik i lëvizjes së letrave me vlerë, (Biletat e tregu, blloqet e gjobave të policisë bashkiake etj.) si dokumetohet marrja, arkëtimet dhe nxjerrja e rezultateve, pasqyrimi me p.verbalin përkatës.
v.Kontrolli periodik i tërheqjes së pullave të taksës për gjendjen civile me shumën e arkëtuar nga secili person materialisht përgjegjes, nxjerrja e rezultatit, pasqyrimi me poces verbalin përkatës.
vi.Kontroll periodik mbi fondet e shpenzuara mbi bazën e situacionit mujor dhe progresiv të shpenzimeve sipas strukturave të miratuara me VKB.
vii.Raporet periodike (Evidencave të realizimit të të ardhurave sipas llojit të të ardhurave të miratura me VKB dhe atyre të vendosura me akte ligjore) për të parë ecurinë e këtij procesi.
viii.Kontroll periodik mbi mbajtjen e kontabilitetit me qëllim që çdo trasaksion financiar të evidentohet, rregjistrohet dhe kontabilizohet në mënyrën e duhur të përcaktuar me akte ligjore.
ix.Kryerja e procesit të inventarizimit-vlerësimit –asgjësimit të aktiveve sipas kritereve të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Kontrolli i dokumentacionit të procedurës së inventarizimi dhe miratimi nga Titullari.
x.Raportimet në këshill bashkiak nëpërmjet pregatitjes së tre Raporteve të monitorimit të zbatimit të Buxhetit të vitit 2018, për cdo 4- mujor.

xi Pas 30 prillit në zbatim të ligjit 68/2017, kemi paraqitur në Këshillin Bashkiak raport mujor të realizimit të të ardhurave-shpenzimeve.
xii.Miratimi në Këshillin Bashkiak të Raportit të Konsoliduar të Buxhetit, përfshi dhe bilancin kontabël (Sipas ligjit 68/2017).

Hapi IV- *Harta ose Lista e proceseve të punës*.
Nga auditimi u konstatua se në vitet objekt auditimi është hartuar një listë mbi proceset e punës nga Drejtoria e Financës, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, Drejtoria e Arsimit.
Lista e proceseve të punës shërben për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, e cila garanton kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe ruan ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/ transaksioni, ku përgjegjësitë janë ndarë në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin, marrjen e vendimit, zbatimit, kontabilitetit dhe kontrollit.

Janë hartuar lista e proceseve të punës :

- Për inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve ;
- Për ndjekjen e shpenznimeve të kryera në objektet arsimore si çerdhe, kopshte, konvikte;
- Për kryerjen e inventarizimit në institcionet arsimore që mirëmbahen nga bashkia;
- Hartimi i situacionit mujor dhe progresiv të shpenzimeve;
- Ndjekja e qirave të banesave sociale;
- Hartimi i ditarit të të ardhurave;
- Për ditarin e bankës; etj.

Nëpunësi Autorizues ka monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Bashkisë Berat, gjatë vitit raportues 2017- 2018, nëpërmjet Pyetësorit për Vetë-Vlerësimin e Komponentëve të MFK. Ky pyetësor ka qënë një metodë e dobishme dhe efiçente për titullarin dhe menaxherët e tjerë, për të shqyrtuar dhe vlerësuar proçedurat e kontrollit që janë ngritur dhe zbatuar brenda Bashkisë. Proçedurat e vendosura për monitorimin e kontrollit të brendshëm, kanë qënë në përputhje me kulturën e njësisë dhe me rregullat e brendshme të vendosura, për të garantuar përshtatshmërinë me ligjin. Vlerësimi është kryer nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme. Gjetjet nga auditimet dhe defektet e identifikuara nga titullari ose nga stafi, kanë qënë një burim shumë i mirë të dhënash mbi cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, garantimin se të gjitha problemet e identifikuara, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen, por edhe se rezultatet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm apo vetë-vlerësimit merren në konsideratë dhe analizohen nga ana e titullarit. Zbatimi i komponentëve të kontrollit të brendshëm është bërë në bazë të kushteve konkrete të Bashkisë Berat, e cila pas ndarjes se re territoriale përfshin në juridiksionin e saj 4 njësi administrative, me 48 fshatra në juridiksion dhe shtrirje të gjerë gjeografike.

Sistemi i kontrollit të brendshëm është ndërtuar kryesisht me qëllim menaxhimin e riskut në një nivel të arsyeshëm, se sa me qëllim eliminimin e të gjitha risqeve që mund të çojnë në dështimin e politikave, qëllimeve dhe objektivave të njësisë: prandaj, ofron vetëm garanci të arsyeshme dhe jo garanci absolute për efektivitetin. Sistemi i kontrollit të brendshëm mbështetet në një proçes të vazhdueshëm, i ndërtuar për të identifikuar dhe renditur risqet sipas prioritetit të tyre në raport me arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Berat, për të vlerësuar probabilitetin e materializimit të këtyre risqeve si dhe impaktin që do të kishin ato, në rast se do të materializoheshin si dhe për menaxhimin e tyre efektiv, efiçent dhe ekonomik.

Ndërsa për drejtoritë e tjera nuk është hartuar harta e proceseve të punës. Për vitin 2019 Bashkia Berat, duke u mbështetur nga Projekti Menaxhimi Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes Vendore, financuar nga SECO, është duke zbatuar Planin e Zhvillimit të MFK, në përputhje me objektivat e institucionit. *Nga sa mësipër arrijmë në përfundimin se duhet të vijoj puna për hartimin e proceseve të punës nga të gjitha drejtoritë e bashkisë dhe të njësive të vartësisë. Procedura ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.*

Hapi 5 "***Gjurmët e auditimit***", Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore të punës që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proçes.

Nga auditimi u konstatua se drejtoritë e institucionit, përjashtuar atë të financës nuk kanë përpiluar gjurmët e auditimi për funksionimin e tyre, ku në 2017 në total kanë qenë 9 dhe në 2018 e 2019, 8 drejtori. Po kështu nuk kanë përpiluar gjurmë auditimi Inspektorati Mbrojtjes Territorit, Inspektoriati Policisë Bashkiake, Njësia e Auditit të Brendshëm dhe 6 njësitë shpenzuese.

Përgatitja e Gjurmëve të Auditimit, e cila përdoret gjithashtu nga audituesit (të brendshëm dhe të jashtëm) për të përshkruar fushën që mbulohet nga auditimi ndihmon në, identifikimin e proceseve të njësisë, e nën-proceseve; Identifikimi i të gjithë bazës së të dhënave si dhe të dokumenteve ligjore, financiare, apo të një natyre tjetër që normojnë dhe mbështesin zbatimin e aktiviteteve të një njësie.

Mungesa e njohurive të stafit menaxhues në lidhje me kontrollin e brendshëm ka ndikuar në mos përgatitjen nga strukturat të gjurmëve të auditimit, të cilat përshkruajnë ecurinë e saktë të operacioneve.

Ndarja e detyrave

Në pjesën më të madhe të njësive publike ekzistojnë përshkrimet e punës, të cilat përfshihen në rregulloret e brendshme ose në kontratat e punës. Por ndryshimet e vazhdueshme të strukturave si dhe të formatimit të drejtorive kërkojnë dhe rishikimin në vazhdimësi të rregulloreve të brendshme të institucioneve si rrjedhojë edhe rishikimet e pozicioneve të punës.

Në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare është kryer ndarja e detyrave, për të cilën është përdorur sistemi me dy firma, ku janë përcaktuar rregulla të qarta për ruajtjen e pronës.

4. Informim dhe komunikimi.

Mënyra e komunikimit në Bashkinë Berat është mënyra me shkrim (rruga protokollare) sipas së cilës çdo drejtori komunikon me sektorët brenda institucionit dhe korrespodencën me institucionet jashtë bashkisë. Gjithashtu ekziston edhe komunikimi elektronik, çdo punonjës ka adresë zyrtare **@bashkiaberat.gov.al,** që mbikëqyren nga AKSH, si kundër edhe komunikimi verbal.

- Titullari i institucionit dhe drejtuesit informohen për shpenzimet buxhetore krahasuar me totalin e planifikuar në buxhet për çdo program që ka përgjegjësi dhe ka një strukturë për dhënien e këtij informacioni.
- Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në vendime.al. etj.
- Organizimi i dëgjesave publike në çdo njësi administrative dhe lagje të qytetit, grupet e interest dhe shoqerinë civile, sipas planit të masave dhe veprimit për programin buxhetor afatmesëm, shkresa nr.4749 prot, datë 18.07.2018, publikuar dhe në faqen zyrtare, rubrika buxheti, klik, faza e rishikuar e PBA 2019-2021. 2020-2022.
- Organizimi i mbedhjeve të hapura të këshillit bashkiak.
- Funksionimi i zyrës me një ndalesë me rregjistrimin on-line të kërkesë ankesave

- Transparenca në përdorimin e fondeve publike në ***Rritje të transparencës mbi* shpenzime dhe buxhete.** *Projekti i USAID –Për Planifikim dhe Qeverisje Vendore (PLGP)* në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Shkencave *(AIS)* kanë ideuar dhe finalizuar një platformë me disa instrumente ICT **për transparencë mbi shpenzime dhe buxhete të njësive të qeverisjes vendore.**
- Aksesi i çdo të interesuari në faqen zyrtare të bashkisë në rubrikën Buxheti, Investime, Projekte, Turizmi, Publikime, Programi transparences. Vendime.al.

Bashkia Berat ka faqen e saj zyrtare dhe nëpërmjet këtij ëbsite të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth punës së përditshme të saj.

5. Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë.

Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet:

- Monitorimit të vazhdueshëm;
- Vetëvlerësimit;
- Auditimit të brendshëm.

Nëpunësi Autorizues i Bashkisë Berat ka monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Bashkisë Berat, gjatë vitit raportues 2017, 2018, nëpërmjet Pyetësorit për Vetë-Vlerësimin e Komponentëve të MFK. Ky pyetësor ka qënë një metodë e dobishme dhe efiçente për titullarin dhe menaxherët e tjerë, për të shqyrtuar dhe vlerësuar proçedurat e kontrollit që janë ngritur dhe zbatuar brenda Bashkisë. Proçedurat e vendosura për monitorimin e kontrollit të brendshëm, kanë qënë në përputhje me kulturën e njësisë dhe me rregullat e brendshme të vendosura, për të garantuar përshtatshmërinë me ligjin. Vlerësimi është kryer nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme. Gjetjet nga auditimet dhe defektet e identifikuara nga titullari ose nga stafi, kanë qënë një burim shumë i mirë të dhënash mbi cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, garantimin se të gjitha problemet e identifikuara, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen, por edhe se rezultatet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm apo vetë-vlerësimit merren në konsideratë dhe analizohen nga ana e titullarit. Zbatimi i komponentëve të kontrollit të brendshëm është bërë në bazë të kushteve konkrete të Bashkisë Berat, e cila pas ndarjes së re territoriale përfshin në juridiksionin e saj 4 njësi administrative, me rreth 50 fshatra në juridiksion dhe shtrirje të gjerë gjeografike. Sistemi i kontrollit të brendshëm është ndërtuar kryesisht me qëllim menaxhimin e riskut në një nivel të arsyeshëm, se sa me qëllim eliminimin e të gjitha risqeve që mund të çojnë në dështimin e politikave, qëllimeve dhe objektivave të njësisë: prandaj, ofron vetëm garanci të arsyeshme dhe jo garanci absolute për efektivitetin. Sistemi i kontrollit të brendshëm mbështetet në një proçes të vazhdueshëm, i ndërtuar për të identifikuar dhe renditur risqet sipas prioritetit të tyre në raport me arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Berat, për të vlerësuar probabilitetin e materializimit të këtyre risqeve si dhe impaktin që do të kishin ato, në rast se do të materializoheshin si dhe për menaxhimin e tyre efektiv, efiçent dhe ekonomik.

Rishikimi nga ana e NA e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë mbi bazën e informimit nga audituesit e brendshëm dhe nga drejtuesit e strukturave të njësisë, të cilët janë përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e kuadrit të kontrollit të brendshëm në strukturat përkatëse dhe vetë-vlerësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe në bazë të komenteve, të bëra nga audituesit e jashtëm të shprehura në raportet e tyre.

- Pyetësori i vetëvlerësimit për vitin 2017- 2018, i cili është plotësuar nga institucioni dhe i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në afat.
Me shkresën nr. 336/1 date 14.02.2019, në lidhje me plotësimin e pyetësorit për vetëvlerësimin për funksionimin e sistemit të MFK për vitin 2018, duke e vlerësuar procesin gjithpërfshirës, është kërkuar angazhim maksimal nga të gjitha strukturat për të dhënë informacion të plotë, të saktë dhe sipas kërkesave ligjore.
- Monitorimi i buxhetit faktik është raportuar çdo 4 muaj (maj, shator dhe janar) në këshillin Bashkiak dhe një kopje raporti është dërguar në Drejtorinë e Financave Vendore në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, për periudhën 2018, (9 mujori 2019), në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018, si dhe në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor", nenit 65 të ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperise", nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, të ligjit 139/215 " Për vetëqeverisjen vendore". Raportet e monitorimit janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë; ***bashkiaberat.gov.al*** Rubrika Buxheti (Monitorime 2018, 2019).

- Në zbatim të Hapit VII-Analiza e kontrolleve ekzistuese dhe të pritshme. Raporti përmbledhës mbi Cilësinë dhe Gjendjen e Kontrollit të Brendshëm, nga auditimi u konstatua se për vitet 2017, 2018 është hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave "Raporti përmbledhës mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm", në zbatim të nenit 18.1 të ligjit "Për MFK", (brenda muajit shkurt);
Nga auditimi i dokumentacioneve vlerësojmë se frekuenca dhe mënyra e raportimit apo monitorimit duhen përmirësuar dhe të mos jetë e fokusuar vetëm në raportime financiare, por edhe në monitorime të performancës në funksion të arritjes së objektivave, përgatitjes dhe zbatimit të politikave të mira, sjelljes dhe efektivitetit të nëpunësve civilë në menaxhimin e fondeve/burimeve publike, kryerjen e funksioneve rregullatore, implementimit të politikave publike, të cilët janë faktorë përcaktues të cilësisë së qeverisjes së një njësie publike.
Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe duke mos kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raportimi periodik shërben për monitorimin e vazhdueshëm të aktivitetit për çdo proces e pozicion pune.
Konkluzion: Pavarësisht përpjekjeve që kanë bërë menaxherët dhe punonjësit e njësisë, për njohjet e duhura për ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollin, konstatohet se ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, dhe punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.
Gjithashtu konstatohet se ka mangësi të njohurive të stafit në lidhje me menaxhimin e riskut, për drejtoritë dhe njësitë e vartësië, (për shkak të paqëndrueshmërisë së stafeve përfshirë edhe NA), *Nga Bashkia Berat janë bërë hapa në drejtim të ngritjes dhe funksionimit sistemit të menaxhimit të risqeve, por të mos jetë fokusuar vetëm në strukturat e financës, por të shtrijë në të gjithë institucionin dhe njësitë e vartësisë.*
Mungesa e njohurive të stafit menaxhues në lidhje me kontrollin e brendshëm ka ndikuar në mos përgatitjen nga strukturat të gjurmëve të auditimit, të cilat përshkruajnë ecurinë e saktë të operacioneve.
Nga auditimi konstatohet se ka mangësi të njohurive të stafit në lidhje me menaxhimin e riskut, për të cilën nga institucioni, pavarësisht se që në fillim të vitit 2018 është hartuar Plani i

Zhvillimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, çështjet e të cilit janë të lidhur me komponente të MFK.
Për vitin 2019 Bashkia Berat, duke u mbështetur nga Projekti Menaxhimi Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes Vendore, financuar nga SECO, është duke zbatuar Planin e Zhvillimit të MFK, në përputhje me objektivat e institucionit por, n*ga sa kemi parashtruar më sipër arrijmë në përfundimin se duhet të vijoj puna për hartimin e proceseve të punës nga të gjitha drejtoritë e bashkisë dhe të njësive të vartësisë. Procedura ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.*
- Që në fazën e planifikimit njësia e AB ka identifikuar fushat me risk të ulët, të mesëm dhe të lartë mbi të cilat është bërë dhe **plani vjetor i punës,** është hartuar Plani Stategjik 2017-2019.

Përgatitja e Gjurmëve të Auditimit, e cila përdoret gjithashtu nga audituesit (të brendshëm dhe të jashtëm) për të përshkruar fushën që mbulohet nga auditimi ndihmon në, Identifikimin e proceseve të njësisë, e nën-proceseve; Identifikimi i të gjithë bazës së të dhënave si dhe të dokumenteve ligjore, financiare, apo të një natyre tjetër që normojnë dhe mbështesin zbatimin e aktiviteteve të një njësie.
Si përfundim konstatojmë se në përgjithësi veprimtaria ekonomike-financiare e njësive të audituara nga viti në vitë ka përmirësim të menaxhimit të fondeve, uljen e rasteve të shkeljeve, por gjatë misionit të auditimit të gjithë njësive janë vërejtur dhe të meta për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse.

Për vitin 2017, edhe si rezultat i trajnimeve të zhvilluara, Bashkia Berat ka përdorur elementët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për të përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm për të arritur objektivat dhe rezultatet e dëshirueshme nga ana e tyre.
Për qëllim të auditimit u përdorën teknikat e intervistimit të niveleve bazë dhe drejtuese të institucionit dhe konkretisht kërkesë me shkrim për nivelet drejtuese, pyetësor pa identifikim për nivelet drejtuese dhe specialistë.
Për nivelet drejtuese sipas pyetjeve rezultojnë përgjigjet e mëposhtme:
1. Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018-2019 në krahasim me vitin 2017?- rreth 67% e 15 drejtuesve të intervistuar raportojnë për ngarkesë më të lartë, 27% pa ndryshime dhe 7% e papërballueshme.
2. Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?-rreth 47% raportojnë për shumë të motivuar, 7% të pamotivuar dhe 33% presin më shumë.
3. Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga dhe shpërblimet në vitin 2018 në raport me vitin 2017?-20% raportojnë për të ardhura më të larta, 67% në të njëjtin nivel, 7% më të ulëta dhe 7% nuk kanë përgjigje.
4. Në pozicionin e drejtuesit a jeni të përfshirë në vendimmarrjen e Bashkisë?-si drejtues janë përfshirë në vendimmarrje rreth 40% të të intervistuarve, 20% nuk jnë përfshirë, 33% vetëm kur ju kërkohet dhe 7% kanë dhënë vetëm mendime.
5. A jeni njohur zyrtarisht me përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicionit që mbani?-rreth 80%
6. A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018-2019?-rreth 67% raportojnë se kanë kryer trajnime, 27% nuk kanë kryer dhe 7% jashtë bashkisë.
7. A jeni njohur me strategjinë e Bashkisë për periudhën 2018-2021?-rreth 47% e të intervistuarve raportojnë se janë njohur me strategjinë, 27% nuk janë njohur, 13% janë njohur pjesërisht dhe 7% çfarë kanë dëgjuar rastësisht.
8. Nëse përgjigja e pikës 7 është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018 e në vazhdim?-13% raportojnë tek buxheti, 47% tek plani strategjik, 13% tek përshkrimi i përgjegjësive.
9. Për realizimin e objektivave të njësisë që drejtoni sa mendoni se ushtroni kompetencat tuaja?-67% raportojnë se i ushtrojnë kompetencat e parashikuara, 7% raportojnë për formalitet dhe 13% në varësi të situatës.

10. A jeni përfshirë në procesin e rekrutimit përsa i përket plotësimit të stafit në njësinë që drejtoni?-40% raportojnë se janë përfshirë dhe 46% nuk janë përfshirë.

Për nivelet specialistë sipas pyetjeve rezultojnë përgjigjet e mëposhtme:
1. Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018, 2019 në krahasim me vitin 2016?-rreth 53% e 75 të *intervistuarve raportojnë për të ardhura më të larta dhe 44% pa ndryshime.*
2. Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?-69% raportojnë që janë shumë të motivuar, 11-nuk janë të motivuar dhe 19% presin më shumë.
3. Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga dhe shpërblimet në vitin 2018, 2019 në raport me vitin 2016?-20% raportojnë për të ardhura më të larta, 68% në të njëjtin nivel, dhe 8% nuk kanë një përgjigje.
4. Si është raporti i marrëdhëneve të eprorit tuaj me JU?-95% raportojnë për marrëdhënie korrekte.
5. A jeni njohur zyrtarisht me detyrat e vendit të punës dhe të drejtat tuaja?-91% raportojnë se janë njohur zyrtarisht.
6. A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018, 2019?-49% raportojnë se kanë marrë pjesë në trajnime dhe 48% nuk kanë qenë pjesë e trajnimeve në bashki.
7. A jeni njohur me strategjinë e **Bashkisë** për vitin 2018, 2019?-40% janë njohur, 37% nuk e kanë idenë, 19% janë njohur pjesërisht dhe 4% vetëm çfarë kanë dëgjuar.
8. Nëse përgjigja e pikës 8 është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018-2019?-25% tek buxheti, 41% tek plani strategjik dhe 9% tek përshkrimi i detyrave.
9. Ku mbështeten marrëdhëniet tuaja të punës?-55% raportojnë tek statusi i nëpunësit civil, 15% tek kodi i punës, 3% tek kontrata kolektive dhe 28% tek kontrata individuale e punës.
10. A keni dijeni dhe a keni nënshkruar formularin për vlerësimin periodik të punës tuaj?-65% raportojnë për po, 13% raportojnë për jo dhe 21% nuk kanë fare dijeni.

A/3.2 Mbulimi me auditim i aktivitetit të bashkisë referuar kërkesave ligjore. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

1. Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë Auditit të Brendshëm Publik.

Situata:

***I.* Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditimit të brendshëm publik**

Në bashkinë Berat me vendimin e Këshillit Bashkiak është krijuar dhe funksionon struktura e njësisë së auditimit të brendshëm publik në shkallë sektori me 3 punonjës. Ndërsa në Rregulloren e brendshme te Bashkisë Berat miratuar nga z. P. S. ish- kryetari i bashkisë Berat dhe Regjistruar nr.731,Prot,datë 07.02.2018,neni 20-Njësia e auditimit të brendshëm publik, nuk është përcaktuar menyra e organizimit, në nivel drejtorie apo sektori dhe konkretisht:

1.Xh. M.,përgjegjësi i sektorit Njësisë auditimit (certifikuar)
2.A. R., Audituese, (certifikuar)
3.O. H., Audituese, (certifikuar)

III. Planifikimi,realizimi i programit vjetor të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe II. Kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet,

Konstatime të përgjithshme nga grupi i auditimit të KLSH:

1) Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017-2019,

ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6

2) Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017, 2018 dhe 2019, edhe pse janë përgatitur rregullisht,ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2

3**) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit** të Auditit të Brendshëm për vitin 2017, dhe 2018, dhe pasqyrat shoqëruese, janë dërguar në afat, por pjesa përshkruese e raportit nuk është përgatitur sipas standarteve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.(Raporti i Monitorimit i **Drejtorisë Përgjithshme të Harmonizimit** në **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**. (*edhe pse është publikuar në faqen zyrtare elektronike nuk disponohej dhe nuk njihej nga të 3 punonjësit e Sektorit të Auditimit bashkia Berat).*

4) Struktura e projekt raportit dhe e raportit Final të auditimit nuk është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11 (Raportet Finale janë shume te gjata, ka mjaft përsëritje dhe në shumë raste janë "Copy Paste"

5**)Në mjaft raste kur janë trajtuar gjetjet dhe rekomandimet** nuk janë shoqëruar me referencën ligjore përkatëse, neni, pika, VKM apo Ligje, për pasojë një pjesë e këtyre rekomandimeve janë ta paqarta dhe të pazbatueshme. Në trajtimet që u bëhet materialeve të auditimit si referencë ligjore nuk mbështetet në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë apo Institucionit që auditohet.

6) Dosjet e auditimit jo në të gjitha rastet janë plotësuar me letrat e punës, apo fotokopje të dokumentacionit mbështetës,argumentues, etj, si pasqyra të buxhetit, lista e objekteve të prokuruara, marrja në dorëzim e materialeve apo punimeve të ndërtimit etj. Kjo më e theksuar në dosjet, auditimet e Drejtorisë të ardhurave të Bashkisë dhe 4 Njësive administrative (**Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik).**

7) Në rastet kur ka moszbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi nuk është përcaktuar personi përgjegjës.

8) Nga ana e Njësisë së auditimit publik Bashkia B**erat** nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është mjaftuar vetëm me përgjigjen e subjekteve të audituara, ndërsa disa subjekte nuk kanë kthyer asnjë përgjigje për pranimin apo jo të rekomandimeve dhe hartimin e plan veprimeve për realizimin e tyre,

Nuk ishte përgatitur një Raport përmbledhës mbi gjetjet, rekomandimet e dhëna dhe zbatimi i tyre qoftë në auditimin e radhës qoftë sipas përgjigjeve të subjekteve, me qëllim që të Informohej Kryetari i bashkisë për shkallën e nivelin e realizimit të rekomandimeve dhe impakti i tyre në njësitë e audituara. **(Sqarojmë se ky raport përmbledhës u përgatit gjatë periudhës së auditimit dhe duhet ti bëhet prezent Kryetarit të Bashkisë.)**

Pothuajse shumica e rekomandimeve **mbi 70% e tyre janë për zbatimin e ligjeve apo VKM**, kur këto janë të detyruara të zbatohen,dhe jepet llogari kur nuk zbatohen, p.sh:

9- *Te zbatohet drejt te ligjin Nr 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik",me ndryshimet përkatëse, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" e Udhëzimit nr 3, date 27.01.2015" Per procedure e prokurimit me vlera te vogla" , ne lidhje me respektimin e kufirit limit te përcaktuar per prokurimin e fondeve .*

Detyra është realizuar pjesërisht

1. *Te ndiqen dhe te zbatohen me korrektësi te gjitha ndryshimet ligjore te Udhëzimeve dhe Vendimeve qe nxjerr APP-ja ne lidhje me procedurat e prokurimit shkresor, prokurimin per emergjencat dhe prokurimet per blerjet e vogla;*

Në kundërshtim me pikën **4.1.13.2 Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, 4.2 Komunikimi i audituesit.**

Standardi 2420 -Cilësia e Komunikimeve Komunikimet duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, koncize, konstruktive, të plota, dhe në kohë.

9) Në planet vjetore të auditimit 2017-2018-2019 nuk është parashikuar për auditim **Inspektorati i Mbrojtjes Territorit,** bashkia Berat.*(Ndoshta nga pakujdesia, harresa etj.)*

Nga auditimi që ushtroi KLSH në IMT Bashkia Berat,rezulton se në total, për periudhën e 4 vjet e 9 muaj respektivisht periudha nga data **01.01.2015 deri 30.09.2019**,për ndërtime të kundërligjshme/mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me gjobë **125 kundërvajtës**, me vlerë totale **38,650,000** lekë,(të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare llogaria 468 më datë 31.12.2018) prej tyre deri më datën 01.11.2019, janë **arkëtuar** gjobat vetëm nga **17 subjekte** në vlerën **2,200,000** lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar nga Gjykata e Shkallës së parë Berat, lëshimi i urdhrave ekzekutiv për vendimet e gjobave, por deri më datën 01.11.2019 janë lëshuar vetëm 4 urdhra ekzekutive për vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata,dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim.

Pasqyrë përmbledhëse e Vendimeve të gjobave dhe arkëtimi për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019, IMT Bashkia Berat, **Aneksi nr. 1 bashkëlidhur**.

Shënim[2]. *Listat analitike dhe dënimet me gjobë me numër serial për secilin kundravajtës dhe shumat e gjobave të vendosura nga 3 ish-kryeinseptorët e IMT për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019 janë trajtuar në Aktkonstatimin nr. 04,datë 14.11.2019 i cili ndodhet në zyrën e Protokollit Bashkia Berat dhe tek Kryeinspektori i IMTV* ***z. F. M.)***

Nga auditimi rezulton se për **100 vendime gjobe në vlerën prej 28,400,000** lekë, të vendosura për periudhën 4 vjeçare e 9 muaj respektivisht nga data 01.01.2015 deri 30.09.2019,prej tyre **31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë,** të vendosura për **periudhën 2 vjeçare e 10 muaj**, nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017 të cilave u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar (pra nuk mund të vilen më) dhe asnjë nga ish-kryeinspektorët e IMT pasardhës respektivisht. **z.R. B. dhe z.L. S., Bashkia Berat** juristja e IMTV **znj. E. T.** dhe ish kryetari i Bashkisë Berat **z.P.S. ,** nuk kanë ndërmarrë asnjë nga hapat ligjore/nënligjore dhe për pasojë **u ka kaluar 2 vjeçar i arkëtimit,pra janë parashkruar dhe nuk mund të vilen më.**

IV.Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi;

A.Për Vitin 2017,sipas të dhënave të paraqitura nga Njësia e auditit të Brendshëm Publik, Bashkia Berat, janë programuar 11 auditime të cilat janë realizuar në masën 100% , nga të cilat 5 ndërmarrje me bilanc me vete e 6 njësi shpenzuese. *Për vitin 2017 janë rekomanduar 92 Masa organizative dhe deri me datën 15.11.2019, ishin realizuar 72 masa, ndërsa 20 masat e tjera janë*

raportuar në proces zbatimi. Janë rekomanduar per shpërblim dëmi vlera ***586.168 leke****, prej tyre janë zbatuar* ***524.624 lekë,*** *ose në masën 90 %, duke mos u zbatuar vlera* ***61,544 mijë lekë*** *.Duhet theksuar se në planin e veprimit të hartuara nga Njësitë shpenzuese (Subjektet) e audituara janë pranuar dhe janë mare parasysh në mase të plotë të gjitha rekomandimet për shpërblim dëmi dhe masat organizative.*

B.**Për Vitin 2018,** sipas të dhënave të paraqitura nga Njësia e auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, janë programuar 10 auditime te cilat janë realizuar në masën 100 %, ku sipas llojeve të auditimit, 7 auditime të përputhshmërisë, 2 auditime të kombinuara dhe me urdhër të kryetarit të Bashkisë 1 auditim këshillim konsultimi.

Për vitin 2018 janë rekomanduar ***86*** *Masa organizative dhe deri me datën 15.11.2019, ishin realizuar* ***78 masa ,*** *ndërsa 8 masat e tjera janë raportuar në proces zbatimi. Janë rekomanduar masa për shpërblim dëmi në* ***shumën 3.700.810 lekë****, prej tyre janë zbatuar* ***3.428.261 lekë****, ose në masën 92 %, duke mos u zbatuar* ***vlera 272,549 lekë.*** Gjetjet me të mëdha për vitin 2018 ka qene në sistemin e të ardhurave ne shumen 2.302 000 leke, ose në masën 75%. Në fushën e pagave, shpërblime, trajtime e komisione ne shumen 660.000 leke, ose 22 % të gjetjeve me dem ekonomik dhe ne fushën e administrimit te pronës e pasurisë ne shumen 80,000 leke, ose ne masën 3 %.

Duhet theksuar se edhe për vitin 2018 në planin e veprimit të hartuara nga Njësitë shpenzuese (Subjektet) e audituara, janë pranuar dhe janë mare parasysh në masë të plotë të gjitha rekomandimet për shpërblim dëmi dhe masat organizative.

C. **Për 9 mujorin 2019,** sipas të dhënave të paraqitura nga Njësia e auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, *janë rekomanduar për shpërblim dëmi shuma* ***2.042.395 lekë,*** *të cilat janë në proces zbatimi. Masa organizative janë rekomanduar 55 masa të cilat janë në proces zbatimi.*

Në mënyrë më të detajuar për secilën Njësi shpenzuese,masat e rekomanduara, dhe afatet e dërgimit të Projekt raporteve,Raporteve Finale dhe përgjigja e Njësisë Shpenzuese të audituar paraqiten në Pasqyrën bashkëlidhur.

Shënim[1]: *Të dhënat për zbatimin e rekomandimeve janë shënuar bazuar në përgjgjjet e Njësive shpenzuese të audituara,pasi verifikimi i zbatimit të rekomandimeve nuk është kryer me program tematik të veçantë.*

Shënim[2]:*Per periudhën nga muaji Korrik 2018 deri me 31 Dhjetor 2018 është punuar nga 2 audit, pasi një audituese ka qenë me leje raport barrlindje dhe nuk është zëvendësuar.*

Mbi ndjekjen e zbatimit rekomandimeve

Nga ana e Njësisë së auditimit publik Bashkia B**erat** nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është mjaftuar vetëm me përgjigjen e subjekteve të audituara, në kundërshtim me Manualin e auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016"Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik",pikën 4.1.13.2 Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve, ku përcaktohet se**:***Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t'i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njësisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rëna dakord më parë. Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës të subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit.*

Drejtuesi i NjAB në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve për të kursyer burimet, duhet të konsiderojë raportimet e bëra nga njësia e audituar sipas afateve të përcaktuar në plan veprimin e hartuar për këtë qëllim ose me kërkesë të drejtuesit të NjAB,njësia publike e audituar raporton zbatimin e rekomandimeve.

4.1.13.3 Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB

Një njësi e mirë menaxhuar vendos procedura për t'u siguruar se çdo rekomandim i bërë nga njësia e AB, zbatohet ashtu siç duhet.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në bashkëpunim me menaxhimin cakton një punonjës me përvojë që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë për progresin që është bërë për zbatimin e tyre.

Kjo do të ndihmojë që të sigurohet se përmirësimi i kontrolleve të brendshme është përgjegjësi e menaxhimit të njësisë publike dhe jo rol i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

4.2 Komunikimi i audituesit

Standardi 2420 – Cilësia e Komunikimeve

Komunikimet duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, koncize, konstruktive, të plota, dhe në kohë.

Mbi monitorimin e performancës dhe vlerësimin e cilësisë së raportimit të Audituesve të Brendshëm bashkia Berat,*për aktivitetin e vitit 2017, nga ana e Drejtorisë Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.*

Gjetjet e konstatuara për aktivitetin e vitit 2017,nga grupi i auditimit të KLSsë, për cilësinë e raportimit të audituesve të brendshëm bashkia Berat janë konstatuar edhe nga Ministria e Financave të cilat janë publikuar në muajin Maj 2018,në faqen elektronike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,konkretisht në faqen 58-60 të këtij Raporti ku në mënyrë ***eksplicite tekstualisht shkruhet****:*

-Cilësia e Raportimit të Audituesve të Brendshëm, kjo njësi është vlerësuar me 15 pikë nga 30 të mundshme për cilësinë e raportimit të punës së NJAB. Gjatë vitit 2017 ka programuar 12 dhe realizuar 11 angazhime auditimi (6 a. përputhshmërie, 3 a. të kombinuara dhe 2 a. me kërkesë të titullarit), **gjë që tregon për një planifikim jo të saktë të burimeve në dispozicion.** Në të ardhmen duhet të përqendrohet në drejtim të kryerjes së auditimeve të performancës dhe të shtrirjes së veprimtarisë në të gjitha **drejtoritë e njësisë publike (aparati i Bashkisë**).

Nga mbikëqyrja e disa praktikave për auditimet e kryera u konstatua se nga stafi auditues i bashkisë Berat, pak njihet Manuali i auditimit miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.16"Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", materialet e hartuara nuk janë cilësore dhe jo në përputhje me standartet e auditimit, mangësi të cilat janë konstatuar në 6 Dosjet e mbikëqyrura nga KLSH dhe konkretisht:

I-Auditimi *në Drejtorinë e Mbrojtes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MKZSH)*

-Shkresa e autorizimit të titullarit Nr. 182 Prot, Date 12.01.2018.

-Grupi i auditit: Xhevahir Muzhaka dhe Argita Ruku.

-Periudha e auditimit: 01.11.2016-31.12.2017.

-Afati i kryerjes së auditimit: 15.01.2018-09.02.2018

-Shkresa përcjellëse e Raportit Final Nr.. 182/2, datë 09.04.2018.

-Kthimi i përgjigjes nga subjekti i audituar nr.. 160, date 15.05.2018
Në aneksin e rekomandimeve nuk përshkruhet referenca e faqes të gjetjes në Raportin Final të Auditimit gjë e cila vështirëson identifikimi dhe adresimin e sakte te gjetjes dhe rekomandimit.

1. Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat në Faqen 13 të Raportiti Final të MZSH-së përshkruhet se: Nga kontrolli me zgjedhje i dosjeve te personelit ne zbatim te VKM nr. 355, date 07.07.2000 " Per plotësimin e dosjes se regjistrit te personelit", u konstatua se janë hapur dosjet e personelit të MZSH-se si punonjësit me grada, po ashtu dhe ata administrativ.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së. VKM nr. 355, date 07.07.2000"Për plotësimin e dosjes se regjistrit te personelit", është shfuqizuar me VKM nr.117, datë 5.3.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit"; prandaj nga audituesit duhet të përditësohen me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

2. Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat në Faqen 13 të Raportit Final të MZSH- së përshkruhet se :Nga auditimi i dokumentacionit te karburantit per periudhën 01.12.2017-04.12.2017 **u pa se**:

1. Mungon nje kërkesë me shkrim drejtuar titullarit te bashkisë per tu furnizuar me karburant ne periudhën e përmbytjeve (01.12.2017- 04.12.2017).
2. Mungon miratimi me shkrim i nënpunësit autorizues per furnizimin me karburant dhe procedurat e qarta te daljes se tij.(pika 41 e udhëzimit nr 30).

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së. Nuk duhet vendosur fjala " u pa" por u konstatua .

Gjatë auditimit të materialeve që përdor Njësia e audititi të Brendshëm Publik Bashkia Berat, që nga Njoftimet deri në dërgimin e Raportet Finale nuk zbatohet gramatika gjuhësore, duke mos vendosur shkronjat (Ë,dhe Ç)

3. Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat në faqen 14 të Raportiti Final të MZSH- së përshkruhet se: Nga auditimi u konstatua se dosjet e mjeteve nuk kane dokumentacion te plote.

Ne dosje mungojnë libreza dhe kartela e mjetit. Mjetet janë te pasiguruara, pa targa dhe te pa kolauduara. Veprimi i mësipërm bie ndesh me Udhëzimin e MF nr 30 date 27.12.2011 " Per menaxhimin e aseteve ne sektorin publik" i ndryshuar, Kreu II , pika 38,57, me ligjin nr. 10070, date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshëm ne sektorin e transportit" si edhe me ligjin nr. 8378 Date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i RSH" i ndryshuar.

Rekomandojmë :

1- Te merren te gjitha masat per plotësimin e dosjeve te mjeteve motorike me dokumentacion te plote dhe te gjenden te gjitha mënyrat per sigurimin dhe kolaudimin e tyre.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së: Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat shkruhet se : Dosjet e mjeteve nuk kane dokumentacion te plote,ndërkohë nuk përmenden cilët mjete nuk janë të pajisur me dokumentacion, pasi sipas inventarit MZSH **disponon 5 mjete dhe 2 motopompa**, tip Volsëagen 122/30

1. Mjeti Tip Stayer
2. Mjeti Tip Volsvagen
3. Mjeti Tip Savjem
4. Mjeti Tip Mitsubishi
5. Mjeti Tip Iveco

6. Motopompa Tip Volsvagen 122/30 me rrota
7. Motopompa tip Volsvagen 122/30 qe vendoset ne Iveco
Në subjektin e Drejtorisë së **MZSH** janë rekomanduar gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa organizative nga të cilat janë realizuar 16 (gjashtëmbëdhjetë)

II- <u>Auditimi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat</u>.
-Shkresa e autorizimit të titullarit Nr. 4165 prot, date 12.06.2018.
-Grupi i auditit : Xh. M., A. R., O. H.
-Periudha e auditimit: 01.01.2017-28.02.2018
-Afati i kryerjes së auditimit : 11.06.2018- 06.07.2018
-Shkresa përcjellëse e Raportit Final nr. 4165/2prot, datë 28.08.2018.
-Kthimi i përgjigjes nga subjekti i audituar, shkresa nr.. 323, datë 24.09.2018
-Në subjektin **Drejtoria e Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat** janë rekomanduar gjithsej 10 masa organizative nga të cilat janë realizuar 8 (tetë) dhe nuk janë realizuar 2 masa.
<u>Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat</u> Drejtoria e Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat, **Faqe 18 të Raportit Final**, **<u>përshkruhet se:</u>** Urdhëri i punës i miratuar nga titullari gjendej vetëm një kopje tek dokumentet e magazinës. Nga personat përgjegjës u argumentua qe është ndjekur kjo procedure per mungese blloku ne disa kopje, situate e cila është rregulluar ne fillim te vitit 2018.
Ne situacione u panë qe shume zëra materialesh si çakell, zhavorr lumi, gure lumi, çakall mbeturine është i raportuar ne këto situacione me vlere "0" dhe këto materiale janë shume te përdorura ne ato situacione te cilat u audituan.
Nga auditi i vjetshëm është lëne rekomandim qe te behet hyrje e materialeve te përdorura ose te dhuruara dhe te vlerësohen nga ndërmarrja këto asete mbështetur ne Udhëzimin e MF nr. 30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar;
Ky rekomandim nuk ka gjetur zbatim per periudhën e audituar dhe ende per këto materiale nuk behet vlerësimi dhe nuk bëhen hyrje ne magazine, por vetëm raportohen si materiale te përdoruara per punimet e kryera.
Rekomandojmë:
1.Per materialet e dhuruara dhe te përdorura, te bëhen hyrje dhe te vlerësohen nga ndërmarrja mbështetur ne Udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik", i ndryshuar;
2.Preventivat e hartuar nga inxhinieri i ndërtimit per punimet qe do te kryhen, te shoqërohen nga planimetria përkatëse per mirëmbajtjen e rrugëve;

<u>Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së:</u> Për deri sa nuk është zbatuar rekomandimi i mëparshëm dhe gjetja është me impakt e cila përbën shkelje të disiplinës financiare, dhe ndaj personave përgjegjës të cilët nuk pranojnë të bëjnë hyrje materialet dhe ndihmat, pra të mos zbatojnë *Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne Njësitë e Sektorit Publik",* nga ana e audituesve të Brendshëm Publik Bashkia Berat, duhej të kërkohej të dilte përgjegjësia deri në kallëzim penal apo dërgimi për investigim të mëtejshëm në Inspektimin Financiar (*bazuar në nenin 8, pika 2/ç, e ligjit nr. 10 294, datë 1.7.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik")*

Në programin e auditimit të <u>Drejtorisë Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat,</u> nuk është vendosur si çështje më vete auditim mbi zbatimin e ligjit për **Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm,** bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 20.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit publik"

III – <u>Auditimi në Drejtorinë e te Ardhurave</u>

-Shkresa e autorizimit të titullarit me nr.3370 ,prot datë 20.06.2019
-Grupi i auditit: Xh. M., O. H. dhe A. R.
-Periudha e auditimit 01.01.2017 -31.12.2018
-Afati i kryerjes së audititimit 26.06.2019 - 19.07.2019
-Shkresa përcjellëse e Raportit Final me nr. 3370/2 prot datë 25.09.2019
-Kthimi i përgjigjes nga subjekti i audituar më nr. extra prot date 06.11.2019

Në subjektin Drejtoria e të Ardhurave janë rekomanduar gjithsej 12 (dymbëdhjetë) masa organizative dhe 3 (tre) masa shpërblim dëmi.

<u>Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat në Drejtorinë e të Ardhurave ,</u> Faqen 27 të Raportit Final të Drejtorisë të Ardhurave **është përshkruar se:** Nga auditimi u vu re qe pasqyrat përmbledhëse nuk janë te firmosura nga specialist i taksave dhe tregjeve qe duhet te mbikëqyr te gjithë ketë proces. Mandat arkëtimi me te cilin janë arkëtuar paratë çash nga taksapaguesit nuk i janë qepur faturës per arkëtim me te cilin është bere derdhja ne banke.

Nxjerrja e bllokut te mandate arkëtimeve është kërkuar nga auditi ne detyre dhe janë gjetur mandatet sipas datave te pagesave. Ne disa raste ka pasur mosrakordim te mandate arkëtimit me datën e faturës per arkëtim dhe ky dokumentacion është gjendur ne zyrën e Financës, pasi një kopje e tyre depozitohet atje ne momentin e hartimit te faturës per arkëtim.

Nga kontrolli i tyre ka mangësia si ne arkëtim ashtu edhe ne disa raste mungesa te numrave serial nëpërmjet blloqeve te ndryshme. I është kërkuar agjentit pse ka kapërcime te numrave serial te blloqeve te mandate arkëtimeve pa pasur përgjigje te argumentuar te mungesës se tyre, por përgjigjja e tij ka qene qe një kopje te mandate arkëtimit e depozitonte te zyra e financës ne momentin qe hartohej fatura per arkëtim.

Blloqet e mandat arkëtimeve janë letra me vlere me numër serial te cilat administrohen nga financa, por per te cilat **nuk është ndjekur** gjurmimi i tyre ne vazhdimësi ne zbatim te Udhëzimit MF nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik", te ndryshuar, pika 80 *"Përcaktimi i gjendjes se vlerave monetare ne arke dhe letrave me vlere behet nga nëpunësi zbatues me ane te inventarizimit fizik minimalisht një here ne muaj.";*

Mangësitë e vërejtura janë si me poshtë:

Ka kapërcime të numrave serial gjate auditimit analitik, përkatësisht numrat serial 0007120, 0007136 (periudha 2018);

Ka kapërcime te numrave serial gjatë auditimit analitik, përkatësisht numrat serial '0007157, 155658 (periudha 2017);

Ka kapërcime te numrave serial gjate auditimit analitik, përkatësisht numrat serial '0007268, 0007273 (periudha 2016);

Afatet kohore te pageses janë te ndryshme dhe përgjithësisht janë paguar me një here (12 ose 9) muaj ose dy here (6 ose 4.5) muaj pa pasur një grafik te miratuar per vjeljen e tyre duke kundërshtuar paketa fiskale e cila përcakton qe

detyrime te paguhet me tre këste, ne fillim te periudhës përkatëse.
Nga auditimi i te gjithë elementeve te evidencës se detyrimit total vihet re se vlera debitore e papaguar nga tatimpaguesit per periudhën e audituar është *997,715 (nëntëqind e nëntëdhjete e shtate mije e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) leke*, vlere e cila ***nuk gjendet*** e dokumentuar si vlere debitore ne bilancet vjetore te Bashkisë Berat.
Gjetje:Specialisti përkatës i cili duhet te mbikëqyre gjithë procesin e arkëtimit te ardhurave nga tregjet nuk ka kryer kontrollin e brendshëm ne zbatim te ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 3 ku thuhet se"Kontroll i brendshëm" është procesi integral i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe i auditimit të brendshëm, i vendosur nga titullari i njësisë publike, brenda objektivave të tij qeverisës, për të ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të njësisë publike, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë."
Mungese dokumentacioni per hartimin e detyrimit vjetor te subjektit përkatës, te paazhornuara ne vite (e fundit daton me 03.05.2017);
Grupi i punës i cili ka hartuar akt-verifikimet ne lidhje me sipërfaqet e hapësirës publike te zëne i cili është i përbëre per 2 (dy) pjestaret e grupit, te cilat e kane detyre funksionale arkëtimin e te ardhurave nga kjo tarife;
Vlera debitorë prej **997,715 leke**, e ardhur nga mungesa e arkëtimit te tarifës per zënien e hapësirës publike nuk është e dokumentuar si vlere debitore ne bilancet vjetore te Bashkisë Berat.

Rekomandim.Specilisti përkatës ne arkëtimin e te ardhurave nga tregjet duhet te kryeje kontrollin e brendshëm ne zbatim te Ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 3;
Te kryhen akt –verifikimet përkatëse per subjektet tatimpagues dhe te hartohen evidencat per detyrimin vjetor dhe arkëtimet per secilin prej tyre;
Grupi i punës duhet te jete i përbëre nga persona te tjerë nga ata qe e kane detyre funksionale arkëtimin e te ardhurave nga tarifa e zënies se hapësirës publike ne zbatim te Ligjit nr. 10296 date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 22 "Veprimtaritë e Kontrollit", pika 3 germa b;
Te merren te gjitha masat e nevojshme per arkëtimin e vlerës debitore për secilin tatimpagues dhe te pasqyrohen ne evidencat përkatëse.
Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së*:* *Përderisa grupi i auditimit të brendshëm të Bashkisë Berat,ka konstatuar kapërcime të numrit rendor të mandat arkëtimeve të cilat klasifikohen si letra me vlerë me dëm ekonomik në vlerën 997,715 lekë, nga ana e grupit të auditimit duhej të mos mjaftohej vetëm me rekomandimin për pagesën e vlerës prej 997,715 lekë, por bazuar në nenin 8, pika 2/ç, e ligjit nr. 10 294, datë 1.7.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik", për shkeljet e konstatuara, Bashkia Berat duhej të kërkonte pranë Inspektimit Financiar ose vetë Auditi i Brendshëm i Bashkisë Berat, ti propozonte kryetarit Bashkisë që ndaj personave përgjegjës të merej masa disiplinore.*

2.Nga grupi i auditimit të Brendshëm i Bashkisë Berat në Drejtorinë e të Ardhurave, faqen 15 të Raportit Final është përshkruar se: Te ardhurat nga Aluizni per vitin 2016, 2017, 2018 janë planifikuar ne vlerën 6,000,000

leke ndërkohe qe realizimi i saj është 0 %. Një fakt i tille justifikohet ne materialin e buxhetit se kjo është një e ardhur qe mblidhet nga Aluizni ndërkohe qe bashkia qe e planifikon dhe duhet ta mbledhë ketë te ardhur nuk ka zbatuar VKM nr. 860, date 10.12.2014 "Per përcaktimin e mënyrës se mbledhjes se te ardhurave per ndërtimet pa leje dhe vlerave te zbatueshme per legalizim", pika 5 dhe ligjin nr. 9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar neni 27 pika 3. *Drejtoria e urbanistikes ne lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje nuk disponon liste te individëve per pagesën e taksës se ndikimit ne infrastrukture dhe nuk ka marre me shkrese zyrtare listat e qytetareve shoqëruar edhe me lejet e legalizimit te cilat janë te destinuara per regjistrim.*

Gjetje: Drejtoria e Taksave, Drejtoria e Urbanistikes dhe Drejtoria e Financës ka kryer një planifikim jo te mirë studiuar të ardhurave te krijuara nga taksat dhe Tarifat per vitin 2016,2017,2018 , konkluzion i cili del nëpërmjet analizës se zërave te caktuar taksave dhe tarifave qe u morën per shqyrtim. Drejtori i Taksave dhe Tarifave qe ka mbuluar punën e drejtorisë per periudhën e audituar nuk ka qene prezent gjate auditimit.

Rekomandojmë: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ne bashkëpunim me drejtoritë e tjera te kryejnë planifikimin e te ardhurave mbështetur ne aktet ligjore dhe nënligjore, studime dhe analiza te detajuara;

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së: Gjetja dhe rekomandimi i audituesve të brendshëm të bashkisë Berat është formal, pasi nuk janë nxjerrë lista konkrete me qytetarët të cilët kanë legalizuar ndërtimet e paligjshme dhe nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

KLSH,taksën e ndikimit në infrastrukturë prej 26,225,134 lekë, e ka trajtuar duke nxjerrë edhe listat me 700 emra të qytetarëve të cilët nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Dhe konkretisht: Nga auditimi në Bashkinë Berat për vitin 2017-2018 dhe 9 mujorin 2019 për vjeljen dhe grumbullimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë bazuar në VKM. nr.860 datë 10.12.2014 2014 "Per përcaktimin e mënyrës se mbledhjes se te ardhurave per ndërtimet pa leje dhe vlerave te zbatueshme per legalizim", pika 5 dhe ligjin nr 963, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar neni 27 pika 3. *Drejtoria e urbanistikes ne lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje nuk disponon liste te individëve per pagesën e taksës se ndikimit ne infrastrukture dhe nuk ka marre me shkrese zyrtare listat e qytetareve shoqëruar edhe me lejet e legalizimit te cilat janë te destinuara per regjistrim,*janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it **1443 qytetarëve dhe subjekte. Nga këta 739 qytetarë dhe subjekte kanë shlyer taksën e ndikimit në infrastrukturë. Debitor të mbetur për vitin 2017, 2018 dhe 9 mujorin 2019 janë 704 qytetar dhe subjekte në vlerën 26,225,134 lekë të ardhura të munguara.**

6. Taksë ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është realizuar 51,382,000 ose 73% kundejt planit vjetor.

<u>Të ardhurat nga tarifat vendore</u>

Kryesisht këto tarifa mblidhen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë.

Realizimi i këtyre zërave, për vitin 2018 ishte në masën 90%.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mblidhen nga biznesi dhe nga familjet.

1. Tarifë Pastrimi, është realizuar 65,605,000 lekë ose 86% kundrejt planit vjetor
2. Tarifë Ndricimi është realizuar 25,018,000 lekë ose 88% kundrejt planit vjetor
3. Tarifë Gjelbërimi është realizuar 12,738,000 lekë ose 87% kundrejt planit vjetor
4. Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit 10,632,000 lekë ose 42% kundrejt planit vjetor.

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel të mirë realizimi, por prape puna vazhdon per te arritur tregues edhe me te mire realizimi.

Përvec realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifat e institucioneve shtetërore.(Gjithësej 44 institucione)

Theksojmë se Bashkia Berat i ka kushtuar vëmendje maksimale arkëtimit të të ardhurave nga tarifat e familjës. Nëpërmjet futjes së këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm është zgjeruar baza e tatimpaguesve dhe ka sjellë rezultate pozitive në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu ndaj cdo qytetari, i cili kërkon që ti ofrohet një shërbim i caktuar administrativ nga bashkia, kërkohet që ai të paraqesë librezën e taksave ku të ketë likujduar taksat dhe tarifat vendore.

- Mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale, kjo per arsye se ka pasur ndryshime ne legjislacion ,duke u ndryshuar kategorizimi per tatimpaguesit ne baze te qarkullimit.

-Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga taksa e kalimit te se drejtes se pronsisë, të ardhura të cilat mblidhen kryesisht nga ZRPP,dhe bashkia perfiton nje % te caktuar me transferte.

PASQYRA E REALIZIMIT TE PLANIT TE TE ARDHURAVE PER VITIN 2018.

000/leke

Nr	Emertimi	Plani Vjetor 2018	Fakti vjetor 2018	Realizimi %
I	**Tatimi i thj. mbi fitimin per b.v. , tatimi mbi te ardhurat personale.**	**6,761**	**2,303**	**34%**
II	**Taksat vendore**	**236,538**	**169,475**	**72%**
1	Takse tabele	8,843	4,538	51%
•	Tabelë për qëllime identifikimi	6,455	3,374	52%
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,388	1,164	49%
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	14,533	13,247	91%
3	Takse ndikimi ne infras. nga ndertimet e reja	70,000	51,382	73%
4	Takse fjetje ne hotel	4,642	4,690	101%
5	Takse mbi token bujqesore	27,391	15,619	57%
6	Takse e mjeteve te perdorura	27,032	26,572	98%
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesise	3,200	1,904	60%
8	Takse mbi ndertesat	71,366	44,360	62%
9	Takse Trualli	9,511	7,150	75%
10	Te tjera taksa lokale	20	13	65%
III	**Tarifat vendore**	**128,637**	**113,462**	88%
1	Tarife e pastrimit	76,441	65,605	86%
2	Tarife e ndriçimit publik	28,420	25,018	88%
3	Tarife gjelberimi publik	14,700	12,738	87%
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	2,067	1,753	85%
5	Tarifa urbanistike	969	2,237	231%
6	Tarifa te sherbimit administrativ	905	204	23%
7	Tarife per license/certifikate transportit rrugor	300	1,635	545%
8	Tarifa per zenie sallave& celje kartele lexuesi	275	0	0%
9	Tarifa te sherbimit te varrimit			
10	Tarife per lende drusore	1,750	2,092	120%

11	Tarife uji i pijshem(Ujitje)	1,800		0%
12	Tarife therje	570	1,060	186%
13	Te tjera tarifa	440	1,120	255%
IV	**Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit**	**25,338**	**10,632**	**42%**
1	Te ardhura nga konviktet	1,446	341	24%
2	Te ardhura nga cerdhet	6,600	485	7%
3	Te ardhura nga kopshtet	17,292	9,806	57%
V	**Te ardhura te tjera**	**101,797**	**38,374**	**38%**
1	Te ardhura nga parkimi	2,326	2,952	127%
2	Te ardhura nga qerate + banesat sociale	69,974	29,608	42%
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	5,234	3,132	60%
4	Te tjera te ardhura nga pronesia			0%
5	Te ardhura nga biletat			
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	22,400		0%
7	Te ardhura nga M.Z.SH	1,863	2,682	144%
VI	**Te ardhura nga legalizimet**	**6,000**		**0%**
TOTALI		**505,071**	**334,246**	**66%**

Ne lidhjen me dheniet me **kontrate qiraje , t**e fondit pyjor dhe kullusor publik per ushtrimin e veprimtarive per nxjerrje , prodhim dhe depozitim materiale inerte ,direct nga siperfaqja (karriere), evidentohet mosrealizim plani duke argumentuar: ne lidhje me tarifen dysheme per dhenien me kontrate qiraje , te fondit pyjor dhe kullusor publik per ushtrimin e veprimtarive per nxjerrje , prodhim dhe depozitim materiale inerte ,direct nga siperfaqja (karriere), VKM nr.391, dt.21.6.2006 , e ndryshuar me VKM nr.1064 dt. 22.12.2010, parashikon Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë). Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit

Mbi bazen e ketij vendimi prej mujit nentor 2016, nga bashkia jane bere ne menyre te vazhdueshme shkresa, drejtuar subjekteve te pajisur me leje shfrytezimi nga METE , per te lidhur kontrate qiraje me bashkine ne cilesine e pronarit per siperfaqen qe ato shfrytezojne, si dhe ju jane derguar faturat per arketim te detyrimit te llogaritur ne baze te VKM se sipercitur. Gjithashtu me urdher te Kryetarit te Bashkise nr. 858, date 30.11.2017 eshte urdheruar bllokimi i aktiviteteve te ketyre subjekteve .

Nga ana e subjekteve nuk eshte bere asnje pagese, por jane kundershtuar ne menyre verbale apo me shkrim, me pretendimin se nuk eshte kompetence e bashkise. Ne nje rast fatura per arketim eshte kundershtuar ne Gjykaten Administrative te Shkalles se Pare Vlore , nga subjekti "B.", ne perfundim gjykata ka vendosur "Konstatimin absolutisht te pavlefshem te

shkreses me nr. 5139/3 dt. 11.12.2017 "Dergim fature per arketim, ne zbatim te VKM nr. 1064 dt. 22.12.2010" . Ky vendim eshte ankimuar nga bashkia ne gjykaten e apelit.
Nga ana tjeter bashkia ka kerkuar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat , detyrimin e subjektit "P.", per te paguar shperblimin e qirase mujore te papagur qe prej dates 01.07.2016 e ne vazhdim. Çeshtja eshte ne gjykim ne shkalle te pare .
Gjithashtu ne ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" në nenin 15, pika 5 shprehet: "Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, zëri "Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore", dhe regjistrohet në zërin "Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare", sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. "Pavaresisht nga parashikimi i ligjit te mesiperm siperfaqet qe shfrytezohen nga subjektet private deri tani nuk jane hequr nga fondi pyjor /kullusor me VKM.

3. REALIZIMI I PLANIT TE SHPENZIMEVE PER VITIN 2018

Bashkia Berat planifikoi me VKB nr.98 date date 15 .12.2017 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2018 dhe PBA Perfundimtare 2018-2020", 1 010 163 000 leke, duke paraqitur nje buxhet te ballancuar. VKM nr. 16 dhe 87, korrigjoi buxhetin dhe totali i shpenzimeve kapi shumen prej 1 164 990 000 leke.

Në përputhje me nenin 48 te ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 " Per financat e vetëqeverisjes vendore", Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor", nenit 65 te ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, te ligjit 139/215 " Per veteqeverisjen vendore" , Ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr.22 date 30.07.2018, bashkia berat paraqiti ne kshillin bashkia tre raporte monitorimit te zbatimit te treguesve te buxhetit qe i perket periudhes 12 mujore 2018, raporti i pare informoi zbatimin e buxhetit per 4- Mujorin e Pare (Janar Prill 2018), raporti i dyte informoi keshillin bashkiak per 4- Mujorin e dyte Maj-Gusht 2018., raporti i trete 4- mujorin tetor-dhjetor 2018.

Materialet jane derguar ne kohe Ministrise se Financave dhe Ekonomise, dhe jane publikuar ne faqen zyrtare te bashkise ëëë.bashkiakberat.gov.al.

3.1 Realizimi i planit te shpenzimeve per vitin 2018 sipas njesive shpenzuese

Buxheti i Bashkise Berat menaxhohet nga 7 Njesi Shpenzuese;

1. Bashkia Berat
2. Ndermarrja e Sherbimeve Publike
3. Ndermarrja e Gjelberimit
4. Drejtoria e Arsimit
5. Drejtoria e Bujqesie, Administrimit te Pyjeve, Ujrave dhe Sherbimit Veterinar
6. Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"
7. Qendra "Lira"

A. NJESIA SHPENZUESE: BASHKIA BERAT

Menaxhon 47% te totalit te buxhetit te bashkise. Fondet jane planifikuar, alokuar dhe realizuar ne programet:

26. Planifikim menaxhim administrim, perfshi fondin rezerve , emergjencen dhe kontigjencen, transferimin e kuotes se Kshillit te Qarkut , dhe transferta te tjera si Ndermarrjes UK, dhe Drejtorise Rajonale te Tatimeve.
27. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi,
28. Sherbime publike vendore , pastrim qyteti she zona rurale, mirembajtje varrezash publike dhe te deshmoreve.
29. Zhvillimi ekonomik
30. Sporti dhe argetimi (transferta FK Tomori dhe Investime)
31. Sherbime sociale.
32. Banesa sociale
33. Ujitja dhe kullimi (Investime)
34. Transporti (Investime)
35. Ujesjelleses kanalizime (Investime)
36. Sherbimi shendetesor (Investime)
37. Kultura dhe turizmi (Investime)
38. Arsimi (Investime)

PASQYRA E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE

Ne 000/ lek

Titulli	Emertimi Programit	Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	PBA Plan Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	Buxheti Vjetor Plani Rishikuar Viti 2018	Fakti i Vitit 2018	Diferenca
01110	Administrata	178,442	192,731	192,731	218,043	162,036	56,007
10910	MZSH	30,322	34,955	34,955	37,954	29,588	8,366
10660	Zhvillimi ekonomik	0	890	890	890	0	890
08140	Sporti dhe argetimi	42,300	50,000	50,000	50,530	46,030	4,500
06260	Sherbimet publike	62,821	68,325	68,325	68,459	61,273	7,186
10430	Sherbimi Social	1,146	2,000	2,000	3,238	2,040	1,198
10660	Banesat Sociale	0	0	0	396	0	396
04240	Ujitja dhe kullimi	9,646	6,204	6,204	6,775	2,212	4,563
04530	Transporti	84,409	151,621	151,621	194,470	93,515	100,955

06370	Ujesjelles,kanalizime	3,938	15,000	15,000	23,008	17,047	5,961
07330	Sherbimi shendetsor	0	3,000	3,000	3,000	2,106	894
08250	Kultura dhe turizmi	0	13,000	13,000	15,900	2,771	13,129
09120	Arsimi	0	10,995	10,995	17,113	7,390	9,723
	Totali Aparati	**413,024**	**548,721**	**548,721**	**639,776**	**426,008**	**213,768**

NJESIA SHPENZUESE NDERMARRJA E GJELBERIMIT

Menaxhon 3.5 % te buxhetit total . Fondet jane planifikar, celur dhe realizuar ne nje program: Sherbime publike vendore. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor te rishikuar, rezulton si me poshte:

Shpenzimet korente, plani vjetor 41.236.000 leke

Plani 12 mujorit te pare, 41.236.000 leke,

Fakti 12 mujorit te pare 37.894.180 leke

Realizimi 91 %.

Politika e kétij programi eshte permirésimi i kushteve mjedisore sa me te kendshem dhe funksionale, brenda standardeve bashkekohore, krijimit te nje ambienti shlodhes dhe qetesie ku qytetaret te kalojne nje pjese te kohes se tyre, duke nderhyre edhe ne blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti.

Sipas ndarjes ekonomike paraqiten keta tregues te permbledhurte realizimit te buxhetit 000 leke

Emertimi i shpenzimeve	**Plan Buxhet vjetor 2018**	**Plan buxheti 12 mujor 2018**	**Realizimi i 12 mujorit 2018**	**% e realizimit**
600+601	33316	33316	32978.5	98
602-609	7620	7620	4656.5	61
230-231	300	300	259	86
Totali	41236	41236	37894	91

NJESIA SHPENZUESE: NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE menaxhon 7.53% te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

1. Programi 4530: Mirembajtje rrugesh, trotuaresh sheshesh , kalldremesh, ndicim publik , sinjalistike rrugore, rrjetesh te kullimite te ujrave te bardha.

2. Programi 4520: Mirembajtje rrugesh rurale.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente,

Plani Vjetor	45 786 000 leke
Plani i 12 mujori 2018	45 786 000 leke
Fakti I 12 -mujorit 2018	39 634 209 leke
Realizimi ne %	86 %

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te ndicimit publik. Mirembajtja e rrugeve rurale.

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018sipas PBA	Plan buxheti 12-mujori Janar-Dhjetor 2018	Realizimi buxhetit Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	37984	37984	37254	98%
602-609	45922	45922	39770	86%
230-231	2 214	2 214	300	15%
Totali	86120	86120	77324	89%

NJESIA SHPENZUESE: DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat ka si program kryesor pune veprimtarine ekonomike, financiare dhe ate te sherbimit ne mirembajtjen e kopshteve,cerdheve dhe shkollave 9-te vjecare,te mesme te pergjithshme dhe profesionale qe jane brenda teritorrit dhe juridiksionit te Bashkise Berat, duke synuar realizimin e **objektivave:**

- ✓ Permbushjen me sukses e te gjitha detyrimeve ligjore ne fushen e arsimit.
- ✓ Synimi i permbushjes se standarteve te miratuara nga M.A.SH ne Strategjine e Arsimit.
- ✓ Permiresimin dhe rritjen e efektivitetit ne cilesine e sherbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe ne forcimin e kontrollit te fondeve te planifikuara ne buxhetin e arsimit.
- ✓ Kontrollin e servirjes dhe cilesine e menyse ushqimore per femijet ne kopeshte,cerdhe

dhe konvikt.

- ✓ Te realizoje mirembajtjen e kopshteve, cerdheve,konviktit dhe shkollave te qytetit, duke synuar ne pembushjen e standarteve optimal ne ambientet e mesimdhenies

Shpenzimet korente, plani vjetor i korigjuar 284,339,000 leke,

fakti 12- mujorit 235,487,000 leke
realizimi 83 %.
Totali i shpenzimeve kapitale realizimi ne masen 53 %,

Njesia Shpenzuese Drejtoria e Arsimit , sipas programeve paraqet keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

Programi	Buxheti Vjetor 2018	Buxheti i Korigjuar 2018	Fakt 12 -Mujor 2018	%
9120	159537	160,497	151428	95%
10140	24669	24,669	22516	91%
9230	72309	72,310	36034	50%
1110	26863	26,863	25509	95%
Total Drejtoria	283 378	284,339	235487	83%

Njesia Shpenzuese Drejtoria e Arsimit , sipas ndarjes ekonomike paraqet keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Programi	Emertimi shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Buxheti i Korigjuar 2018	Fakti12Mujori 2018	% e realizimit
9120	600+601	134932	134751	134751	100%
	602-609	23540	24681	16112	65%
	230-231	1065	1065	565	53%
10140	600+601	19369	19289	18196	94%
	602-609	5300	5380	4320	80%
	230-231				
9230	600+601	21382	21352	21352	100%
	602-609	50928	50958	14682	29%

	230-231				
1110	600+601	25703	25633	25171	98%
	602-609	1160	1230	338	27%
	230-231	0	0	0	0

NJESIA SHPENZUESE: DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT TE PYJEVE , UJRAVE DHE SHERBIMIT VETERINAR,

Menaxhon 4.25 % te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

- *Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitse dhe kulluese*
- *Planifikimit te mbrojtjes dhe shtimin e siperfaqes pyjore*
- *Programi i sektorit te bujqesise*

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018 sipas PBA	Plan Buxhet 12/mujor 2018	Realizimi12 mujor Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	22774	22774	**20995**	**92**
602-609	23671	23671	**16795**	**71**
230-231	2298	2298	**2297**	**99**
Totali	**48743**	**48743**	**40087**	**82**

NJESIA SHPENZUESE: QËNDRA KULTURORE "MARGARITA TUTULANI"

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor 35,718,447 leke,

plani 12- mujorit , 36,569,000 leke

fakti 12- mujorit 34,157,495 leke

realizimi 93%.

Sipas ndarjes ekonomike paraqiten keta tregues te permbedhur te realizimit te buxhetit:

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan Buxhet 12/mujor 2018	Rrealizimi i Buxhetit 12mujor Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	19,024,000	18,982,000	18,143,000	0.96
602-609	15,894,447	17,187,000	16,014,495	0.93
230-231	800,000	400,000	0	0
Totali	35,718,447	36,569,000	34,157,495	0.93

NJESIA SHPENZUESE: QENDRA E ZHVILLIMIT EDUKIMIT INTEGRIMIT "LIRA"

Per shpenzimet korente te vitit buxhetor 2018 jane keto realizime;

Plani vjetor	Vlera	shenime
Plani 12 mujor	26611	
Fakti 12 mujor	21860	
	82 %	

Politikat e programit buxhetor ne kete qender konsistojne ne ofrimin e sherbimeve sipas standarteve . Femijet qe jane rezident dhe ata ditore duhet tu sherbehet sipas normave te caktuara ne ligjin 9355 "Per ndihmen dhe perkujdesin shoqeror" .

Ne Qendren Lira trajtohen 46- persona nga keta jane resident 16 , jo resident 30 dhe persona nga komuniteti qe marrin sherbime ditore. Qellimi kryesor eshte qe te gjitha sherbimet e kryera te garantojne ruajtjen e aftesive fizike, sociale dhe pavaresi individuale.

Sipas ndarjes ekonomike treguesit jane realizuar sipas tabeles;

Ne 000 leke

Emertimi I shpenz	Buxheti vjetor	Buxheti I ndyshuar	realizuar	% e realizimit
600+601(paga +sig)	17720	18619	16433	88
602(shenz mat dhe sherb)	5776	7990	5427	67
231	0	0	105	
totali	23496	26611	21964	81

3.2 Realizimi i planit te shpenzimeve per vitin 2018 sipas ndarjes ekonomike.

Artikulli 600 , PAGA; Planifikuan ne total 424 715 000 leke ne zerin paga te punonjesve te bashkise perfshi dhe njesite shpenzuese ne varesi te saj, me burim financimi transferten e pakushtezuar, te ardhurat lokale dhe transferten specifike. Realizuam gjithesej 405 624 000 leke ,

Artikulli 601, sigurime shoqerore dhe shendetesore , Planifikuam ne total 68 694 000 leke dhe realizuam 65 800 000

Totali I shpenzimeve te personeli ne plan 493 409 000 leke, ne fakt 471 424 000 leke, ose realizimi ne masen 96%.

Pasqyra e realizimit te pagave dhe sigurimve shoqerore e shendetesore per vitin 2018:

000/lek

Nr	Emertimi i institucionit	Paga		Sigurimet shoqerore		Total Shpenzime personeli		% e realizimit
		Plani Vjetor	Fakti 12-mujor	Plani Vjetor	Fakti 12-mujor	Plani Vjetor	Fakti 12-mujor	
Totali i shp. me fonde te bashkise		**240,318**	**226,667**	**39,292**	**36,790**	**279,610**	**263,457**	**94%**
1	**Planif., Menaxh. Adm.**	**113,602**	**104,054**	**18,664**	**16,860**	**132,266**	**120,914**	**91%**
a	Administrata e Bashkise	109,803	102,978	18,058	16,860	127,861	119,838	94%
h	MZSH me fonde te bashkise	3,799	1,076	606	0	4,405	1,076	24%
2	**Sherbimet publike**	**71,754**	**69,892**	**11,686**	**11,140**	**83,440**	**81,032**	**97%**
a	Gjelberimi	28,662	28,434	4,654	4,545	33,316	32,979	99%
b	Nd. E Sherbimve publike	30,567	29,939	4,978	4,876	35,545	34,815	98%
c	Bujqesia	12,525	11,519	2,054	1,719	14,579	13,238	91%
3	**Arsimi dhe edukimi**	**38,634**	**37,083**	**6,288**	**6,284**	**44,922**	**43,367**	**97%**
a	Arsimi parashkollor dhe ai baze	22,047	21,585	3,586	3,586	25,633	25,171	98%

b	Cerdhet	16,587	15,498	2,702	2,698	19,289	18,196	94%
4	**Kultura dhe sportet**	**16,328**	**15,638**	**2,654**	**2,506**	**18,982**	**18,144**	**96%**
a	Shume sportet	1,151	1,129	193	166	1,344	1,295	96%
b	Kultura	15,177	14,509	2,461	2,340	17,638	16,849	96%
c	Futbolli							
Funksionet e deleguara(Tr. Specif.)		**184,397**	**178,957**	**29,402**	**29,010**	**213,799**	**207,967**	**97%**
1	MZSH	24,665	21,496	3,921	3,738	28,586	25,234	88%
2	Qendra "Lira"	16,058	14,081	2,561	2,352	18,619	16,433	88%
3	Mbrojtja sociale					0	0	
4	Arsimi parashkollor dhe ai baze	116,260	116,260	18,491	18,491	134,751	134,751	100%
5	Konviktet e arsimit parauniversitar	18,372	18,372	2,980	2,980	21,352	21,352	100%
6	Administrimi i pyjeve	3,269	3,174	526	526	3,795	3,700	97%
7	Ujitja dhe kullimi	3,669	3,470	588	588	4,257	4,058	95%
8	Rruget rurale	2,104	2,104	335	335	2,439	2,439	100%
Totali: Fonde te veta +Tr. Specif.		**424,715**	**405,624**	**68,694**	**65,800**	**493,409**	**471,424**	**96%**

Kjo pasqyre jep te dhena analitike per cdo njesi shpenzuese per realizimin e shpenimeve te personelit. Sic shihet realizimi eshte me masen 96%, Per sa i perket shpenzimit te ketij zeri me fondet e bashkise realizimi paraqitet ne masen 94% dhe me fondet e transfertes specifike ne masen 97%.

Mosrealizimi 100% i ketij zeri vjen si rezultat i vendeve vakant dhe procedurave te rekrutimit te punonjesve qe kan afate te caktuara (nenpunesit civil) dhe mos perdorim te fondit vecante me perjashtim te shpebimit me rastin e daljes ne pension te punonjesve.

Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe dificit prane organeve tatimore.

Pothuajse te gjitha njesite shpenzuese paraqesin nivel te kenaqshem realizimin. Nr.total i pun onjesve, perfshi dhe 5 punonjesit sezonal te drejtorise se Bujqesise eshte 704.

ARTIKULLI 602-609.

Artikulli shpenzime operative dhe te mirembajtjes (602).

Bashkia Berat planifikoi ne vitin 2018 ne kete artikull shumen 347 227 000 leke dhe realizoi 237 653 000 leke , ndersa ne vitin 2017, planifikoi 300 342 000 leke dhe realizoi 230 812 000 leke ose realizimi 76.9 %. Ne vitin 2016 fakti I realizimit te ketij grup shpenzimi ishte ne Shumen 186 578 000 leke.

Ky grup shpenzimi ka trend rritesh me synimin e permiresimit te cilesise se sherbimeve publike vendore , administrimit dhe mirembajtjes me te mire te ambjenteve mesimore , infrastruktures rrugore, mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta, permiresisit te ndicimit public etj.

Pasqyra e realizimit te shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes per vitin 2018:

000/lek

Nr	Emertimi i institucionit		SHPENZIME OPERATIVE DHE TE MIREMBAJTJES		
			Plani Vjetor	Fakti 12-mujor	% e realizimit
Totali i shp. me fonde te bashkise			**257,833**	**194,440**	**75%**
1	**Planif., Menaxh. Adm.**		**63,620**	**30,281**	**48%**
a	Administrata e Bashkise		40,130	26,598	66%
b	F. Rez.+Emergj.+ F. Kontigj.		15,841	894	6%
c	Kesh. I Qarkut	D.Rajonale Tatimeve	1,500	723	48%
d	BID Berati+Ujesjellesi		2,340	1,258	54%
e	Sherbime Sociale		2,396	808	34%
g	Zhvillimi Ekonomik		890	0	0%
h	MZSH me fonde te bashkise		523	0	0%
2	**Sherbimet publike**		**118,387**	**104,018**	88%
a	Gjelberimi		7,620	4,657	61%
b	Nd. E Sherbimve publike		43,585	37,433	86%
c	Bujqesia		1,423	655	46%
d	Sherbimet Publike		65,759	61,273	93%
3	**Arsimi dhe edukimi**		**31,110**	**20,651**	66%
a	Arsimi parashkollor dhe ai baze		25,730	16,331	63%
b	Cerdhet		5,380	4,320	80%
4	**Kultura dhe sportet**		**44,716**	**39,490**	88%
a	Shume sportet		4,458	3,932	88%
b	Kultura		12,728	12,082	95%
c	Futbolli		27,530	23,476	85%
Funksionet e deleguara(Tr. Specif.)			**89,394**	**43,213**	48%

1	MZSH	4,440	3,278	74%
2	Qendra "Lira"	7,992	5,427	68%
3	Mbrojtja sociale	1,238	1,232	100%
4	Arsimi parashkollor dhe ai baze	181	118	65%
5	Konviktet e arsimit parauniversitar	50,958	14,681	29%
6	Administrimi i pyjeve	1,023	629	61%
7	Ujitja dhe kullimi	21,225	15,511	73%
8	Rruget rurale	2,337	2,337	100%
Totali: Fonde te veta +Tr. Specif.		**347,227**	**237,653**	**68%**

Pasqyra e realizimit te shpenzimeve te sherbimeve publike vendore 2018:

000 /lek

Pershkrimi	**Plan 2018**	**Fakt 2018**	**% realizimit**
Pastrimi Qytet	54,497	51,163	94
Pastrimi Fshat	7,202	6,774	94
Mirembajtje e Varrezave	4,060	3,336	82
Totali Sherbime Publike	**65,759**	**61,273**	**93**

Transferta tek organizatat dhe individë.

Ne transfertat qe bashkia Berat, kreu per vitin 2018 , mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme jene:

1. Transferte Keshillit te Qarkut (Kuote) sipas ligjit 68/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, neni 38 pika 3.
2. Detyrim kontraktual Ndermarrjes Ujesjelles-kanalizime ne rolin e agjentit tatimor, per sherbimin qe kryen per mbedhjen e tarifave vendore te pastrimit, gjelberimit dhe ndicimit nepermjet fatures mujore te ujit.
3. Transferimi i tarifave vendore qe paguan biznesi i zones BID (Pedonalja)
4. Transferte Drejtorise Rajonale te Tatime per tatimin e thjeshtur (1 % mbi shumen e arketuar , percaktuar me ligj.)

Transfertat	**Pl. 2018**	**F. 2018**
Keshilli I Qarku	1000	700
Detyrim kontraktual UKBK	1200	1158

Partneritet Shoqata BID		1340	100
Transferte per DRT		300	237

Shpenzimet për subvencione.

000/lek

Emertimi	**P.2018**	**F.2018**	**% realiz.**
Futbolli	27,530	23,376	85
Bonus Strehimi	1,200	808	67

Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondi i emergjencave civile.

Bazuar në ligjin nr.139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet **Fondi Rezervë.**

Per të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet **Fondi i Kontigjences**. Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne **3 (tre) %** të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjences u realizuan per te përballuar situata emergjente. Ne zbatim te nenit 16 te ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 "Per Emergjencat Civile " te ndryshuar, te nenit 29 te ligjit nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", te pikes III/3 te VKM nr.329,date 16.05.2012, "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"

Perdorimi i fondeve te emergjencave civile dhe fondit rezerve eshte bere ne zbatim te Vendimeve te Keshillit Bashkiak te marre rast pas rasti sipas materialit te paraqitur nga Drejtoria perkatese, ndersa fondi I kontigjence parashikohet per here te pare ne vitin 2017 dhe u perdor ne zbatim te VKB nr. 18 date 28.02.2017, ne vitin 2018 nuk evidentohet perdorim i fondeve te emergjences.

Emertimi	**P.2018**	**F. 2018**	**% realiz.**
Fondi Rezerve	1540	0	
Fondi i Emergjences	2500	893	
Fondi i Kontigjences	11801	0	
Totali			

ARTIKULLI 230-231 (Investime)

Realizimi i planit te investimeve sipas programeve dhe sipas objekteve jepet ne aneksin nr. 5 bashkelidhur:

Ndryshimet e Buxhetit per vitin 2018:

Eshte bere ne kohe përgatitja dhe paraqitja e materialeve per ndryshimet e buxhetit ne Keshillin Bashkiak (lëvizjet ndermjet programeve) ose jane miratuar nga ana e Kryetarit te Bashkise, (Ndryshimet brenda shpenzimeve korrente). Detajimi sipas pasqyres se meposhtme.

Buxheti sipas ndarjes ekonomike dhe ndryshimet perkatese per vitin 2018

ne 000 leke

Artik.	Emertimi	Plani Buxheti Vjetor	Shtesat e Buxhetit (+)	Pakesimet e Buxhetit (-)	Buxheti me ndryshimet
	Bashkia (planifikim,menxh)	**177,891**	**23,885**	**(2,074)**	**199,702**
600	Pagat	111,377		(1,574)	109,803
601	Sigurimet shoqerore	18,058			18,058
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	38,956	1,350	(500)	39,806
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	324		324
231	Investime	9,500	22,211		31,711
	MZSH	**34,955**	**2,999**	**-**	**37,954**
600	Pagat	27,794	670		28,464
601	Sigurimet shoqerore	4,421	106		4,527
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	2,740	2,223		4,963
	Shuma	**335,875**	**69,116**	**(1,531)**	**403,460**
602	Partneritet BID Berati	1,340			1,340
604	Keshilli I Qarkut	1,000			1,000
604	Transferte UKBK + DRT	1,500			1,500
606	Fond Rezerve, Emergjenca	5,000		(960)	4,040
609	Fondi i Kontigjences	6,000	5,801		11,801
602	Zhvillimi Ekonomik	890			890
603	Futbolli	27,000	530		27,530
602	Sherbime Publike	65,625	134		65,759

606	Bonus Strehimi + Sherbimi Social	2,000	1,238		3,238
602	Banesat Sociale	-	396		396
231	Investime	6,204	571		6,775
230	Projekte	7,000	7,728		14,728
231	Investime	144,621	35,692	(571)	179,742
231	Investime	2,700			2,700
231	Investime	15,000	8,008		23,008
231	Investime	3,000			3,000
231	Investime	23,000			23,000
231	Investime	13,000	2,900		15,900
231	Investime	10,995	6,118		17,113
	Nd.Gjelberimit	**40,236**	**1,511**	**(511)**	**41,236**
600	Pagat	28,393	350	(81)	28,662
601	Sigurimet shoqerore	4,604	50		4,654
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	6,939	1,000	(430)	7,509
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	111		111
231	Investime	300			300
	Nd. Sherbimeve Publike	**78,380**	**3,100**	**(136)**	**81,344**
600	Pagat	30,703		(136)	30,567
601	Sigurimet shoqerore	4,978			4,978
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	42,199	1,250		43,449
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	136		136
231	Investime	500	1,714		2,214
	Rruget rurale	**4,776**	**-**	**-**	**4,776**
600	Pagat	2,104			2,104
601	Sigurimet shoqerore	335			335
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	2,337			2,337
	Administrata e Drejtorise Arsimore	26,863	70	(70)	26,863
600	Paga	22,117		(70)	22,047
601	Sigurime	3,586			3,586

602	Mallra dhe shpenz. te tjera	1,160			1,160
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	70		70
	Arsimi I parashkollor dhe baze	155,345	5,333	(181)	160,497
600	Pagat	113,891	2,550	(181)	116,260
601	Sigurimet shoqerore	18,114	377		18,491
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	22,840	1,660		24,500
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	181		181
231	**Investime**	500	565		1,065
	Cerdhet	24,069	680	(80)	24,669
600	Pagat	16,667		(80)	16,587
601	Sigurimet shoqerore	2,702			2,702
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	4,700	600		5,300
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	80		80
	Konviktet	40,682	31,658	(30)	72,310
600	Pagat	11,830	6,572	(30)	18,372
601	Sigurimet shoqerore	1,882	1,098		2,980
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	26,970	23,958		50,928
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	30		30
	Shume Sportet	5,252	592	(42)	5,802
600	Pagat	1,193		(42)	1,151
601	Sigurimet shoqerore	193			193
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	3,866	550		4,416
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	42		42
	Qendra Kulturore "M.T"	27,216	3,950	-	31,166
600	Pagat	15,177			15,177
601	Sigurimet shoqerore	2,461			2,461
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	8,778	3,950		12,728
231	Investime	800			800
	Qendra "LIRA"	23,496	3,115	-	26,611
600	Pagat	15,288	770		16,058
601	Sigurimet shoqerore	2,432	129		2,561

602	Mallra dhe shpenz. te tjera	5,776	2,216		7,992
	Bujqesia	16,302	2,141	(143)	18,300
600	Pagat	12,668		(143)	12,525
601	Sigurimet shoqerore	2,054			2,054
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	1,280			1,280
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	143		143
231	Investime	300	1,998		2,298
	Ujitja dhe kullimi	14,250	11,232	-	25,482
600	Pagat	2,914	755		3,669
601	Sigurimet shoqerore	463	125		588
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	10,873	10,352		21,225
	Pyjorja	4,575	275	(32)	4,818
600	Pagat	3,190	111	(32)	3,269
601	Sigurimet shoqerore	507	19		526
602	Mallra dhe shpenz. te tjera	878	113		991
606	Perdorimi i fondit te vecante	-	32		32
	TOTAL BUXHETI	**1,010,163**	**159,657**	**(4830)**	**1,164,990**

Treguesit Financiare (sipas percaktimeve te nenit 54 te ligjit 68/2017)

Nr	Treguesit kyc financiar	Formula	Fakti I vitit 2017	Plani I vitit 2018	Plani I vitit 2019	Plani I vitit 2020	Plani I vitit 2021
1	Raporti I shpenzimeve te pergjithshme ndaj te ardhurave te pergjithshme	Shpenzime / Ardhura *100	86%	100%	100%	100%	100%

2	Raportimi I te ardhuravete veta vendore ndaj te ardhurave te pergjithshme	Te ardhurat e veta *100 / Te ardhurat e Pergjithshme	41%	43%	48%	49.60%	47.50%
3	Raporti I te ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit te tyre	Te ardh faktike nga taks dhe tarif *100 Plani I taksave dhe tarifave	82%	100%	100%	100%	100%
4	Raporti I shpenzimeve per investime kapitale ndaj shpenzimeve te pergjithshme.	Shpenzime e Kapitale *100 / Shpenzime te pergjithshme	17%	52%	26%	25%	26.40%
5	Raporti I shpenzimeve per personelin ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Shpenzimet e Personelit *100 / Shpenzime te Pergjithshme	48%	48%	48%	48%	47.20%
6	Raporti I huamarrjes afatgjate ndaj te ardhurave te pergjithshme	Borxhi afatgjate i akumuluar *100 / Te Ardhura te Pergjithshme	5.03%	4.97%	3.30%	2.44%	1.55%
7	Raporti i huamarrjes afatgjat ndaj te ardhurave te veta.	Borxhi afatgjate I akumuluar *100 / Te ardhurat e veta	9.30%	8.90%	6.90%	5.08%	3.30%
8	Raporti I huamarrjes afatshkurter ndaj te ardhurave te pergjithshme	Borxhi afatshkurter *100 / Te ardhurat e pergjithshme	ska	ska	ska	ska	ska
9	Raporti I detyrimeve tatimore te paarketuara ne kohe ndaj te ardhurave tatimore	DetyrimeTatimor te Paarketuara *100 Te ardhura nga taksa dhe tarifat	14%	34%	14%	14%	14%
10	Raporti I Shpenzimeve per partneritet publik-private ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Shpenzimet e PPP *100 / Shpenzime te Pergjithshme te njesise					
11	Raporti I shpenzimeve per politikat e kujdesit shoqeror ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Shpenzime per sherbime sociale *100 / Shpenzime te pergjithshme	2.90%	2.80%	2.69%	2.62%	2.52%

12	Raporti I shpenzimeve per politikat qe mbeshtesin barazin gjinore ndaj shpenzimeve te pergjithshme	Shpenz per ceshtjete barazive gjinore*100 Shpenzimet e pergjithshme	3.80%	3.80%	3.96%	3.71%	3.66%

Raporti përmbledhës për detyrimet e mbetura nga Investimet financuar nga FZHR për tremujorin IV te vitit 2018

Emertimi i projektit	Ministria e Linjes	Kodi i Projektit	Viti I financimit te projektit	**Vlera e plote e kontrates**	Vlera e financuar **ne vitin 2016**	Vlera e financuar **ne vitin 2017**	Vlera e financuar **ne vitin 2018**	**Detyrimi i mbetur per financim**
Vlera totale				**304,737,947**	**168,684,029**	**57,526,456**	**78,481,347**	**46,115**
Rivitalizim i shetitores Republika dhe sheshit qendror Teodor Muzaka	56	M991340	2,015	153,190,662	147,778,140	0	5,404,320	**8,202**
Rikonstruksion i Trotuarit, ndricimit dhe riveshje asfaltike RR. "Antipatrea" segenti Ura e Varur-Ura e Gorices	56	M991428	2,016	48,850,889	20,905,889	16,932,130	11,012,869	**1**
"Platforma multifunksionale e informacionit per turistet dhe qytetaret permes ëeb, infokiosk dhe mobile app per qytetin e beratit" (Shqiperia dixhitale)	56	M991464	2,016	14,363,880	0	0	14,363,880	**0**
Rikonstruksion i fasadave te ndertesave te banimit dhe stadiumit Tomori	56	M991502	2,017	84,296,730	0	36,558,540	47,700,278	**37,912**

ne Bulevardin Republika								
Ndertimi i Kulles se Sahatit	56	M990312	2,015	4,035,786	0	4,035,786	0	**0**

Për vitin 2019, Bashkia Berat ka ndjekur procedurat e projektbuxhetit 2019 dhe PBA 2019-2020 sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi. Në përfudnim ka miratuar në Këshillin Bashkiak buxhetin e Bashkisë për vitin 2019 dhe PBA 2019-2020 me Vendimin nr. 140, datë 07.12.2018, konfirmuar ligjshmëria nga Prefektura me nr. 2763/1, datë 19.12.2018 dhe depozituar në Degën e Thesarit Berat me nr. 57, datë 04.01.2019 dhe në Ministrinë e Financave me nr. 7271, datë 13.12.2018 ku janë miratuar të ardhurat vjetore dhe shpenzimet në 000/lekë, si më poshtë:

-Të ardhura gjithësej 1,036,051 lekë

-Të ardhurat lokale, buxheti i pavarur 498,966 lekë

-Transferta e pakushtëzuar 285,474 lekë

-Transferta specifike 251,611 lekë

-Shpenzime gjithësej 1,036,051 lekë

-Shpenzime korrente 515,340 lekë

-Shpenzimet për funksione specifike 251,611 lekë

-Shpenzime për investime 269,100 lekë

Numri i përgjithshëm i punonjësve i miratuar për vitin 2019 është 699 punonjës, nga të cilët 403 punonjës të planifikuar për tu mbuluar nga të ardhurat e veta dhe 296 punonjës nga transferta specifike.

Buxheti është në zbatim, monitorimi është realizuar dhe raportuar për 6-mujorin e I-rë, 2019 sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Te ardhurat:

2.Gjendja e faturave të pa likuiduara në fund të periudhave 2017-2018, në llogarinë 401-408 dhe 467, fatura të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2018 dhe 9/mujorit 2019, konstatuar kjo nga testet e kryera në likuidimin të këtyre periudhave.

Situata: Bashkia Berat e mbylli vitin Buxhetor 2018 me detyrime të prapambetura sipas bilancit (llog. 486) në shumën **39,836,177** lekë. Gjatë 9-mujorit 2019 likujdoi fatura në shumën **34,807,895** lekë, mbetur pa likujduar detyrime në shumën **5,028,282** lekë sipas Aneksit nr. 8 bashkelidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.Vlerën më të lartë të detyrimeve e zënë shpenzimet për energji të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, detyrim i vitit 2007 në shumën 9,294,942

lekë, detyrimet gjyqësore në shumën 5,470,961 leke, fatura nr. 7 datë 27.08.2018 e operatorit B., për objektin "Ndërtim i ujësjellësit Qereshnik" me shumën 4,155,960 lekë, fatura nr.86 datë 15.10.2018 e operatorit P. shpk me objekt "Rikonstruksion i muzeut historik Sinjë" me shumën 2,612,283 lekë, si dhe fatura të tjera të përshkruara në pasqyrën më sipër. Sic shihet dhe nga pasqyra është likujduar 87 % e detyrimeve të prapambetura të vitit 2018.

Është relatuar në Ministrinë e Financave në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 17.01.2019 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019" pika 106 dhe 109, shuma 11,431,283 lekë, nga të cilat 9,289,322 lekë detyrimet për energji të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, 789,308 lekë Blerje ushqimesh Drejtoria Arsimore, 1,333,333 lekë supervizim i punimeve në objektin "Rivitalizim i shëtitores Republika", 12,240 lekë kolaudim" Ndërtim i linjës Uznovë-Bilçë" si dhe 7,080 lekë kolaudim Rivit Shëtitore Republika Loti 3. Shuma e detyrimeve e relatuar në Ministrine e Financave dhe të Ekonomiksë nuk përputhet me shumën sipas bilancit të vitit 2018, pasi sipas udhëzimit relatohen vetëm faturat që kanë kaluar 60 ditë dhe sipas orientimit të Ministrisë janë zbritur detyrimet që u krijuan për shkak të limitit të vendosur nga Ministria e Financave më date 07.11.2019.

***Gjetje nga auditimi**: Vendime Gjyqësore për paga punonjësish më datë **30.09.2019, është në shumën prej 9,061,735** lekë, nga të cilat vlera prej 186,000 të Ago Tahiraj nuk është kontabilizuar pasi punonjësi është lirurar nga detyra nga Minstria e Mjedisit dhe nuk ka qënë punonjës i Bashkisë Berat për asnjë ditë. Zëri detyrime për Vendime Gjyqësore Agjent Tatimor etj, është 7,506,864 kontabilizuar tërësisht. Zëri detyrime për Vendime Gjyqësore për shpronësime është **57,456,320 lekë** nga të cilat, shuma e detyrimi 2,621,773 e Kujtim dhe Lavdie Bego është pezulluar nga Gjykata **dhe shuma nuk është kontabilizuar.** Shuma 850,000 lekë e paditësit A. L. ka humbur në shkallën e parë, çështja është në apel, shuma nuk është kontabilizuar. Për dy shpronësimet që i takojnë Y. R. në shumën e 1,297,693 lekë si dhe Sh. I. dhe R. Ç., në shumën 51,647,846 lekë , të dyja shuma të llogaritura si 1/3 e detyrimit të paraqitur nga përmbaruesi gjyqësor, **pa kontabilizuar**. Për të dy këto vendime Bashkia Berat është në diskutim me Këshillin e Minsitrave pasi shpronësimet e sipërcituara për interes publik janë bërë nga Këshilli i Ministrave. Nëse nuk konkuldohet për këto dy vendime deri në fund të vitit, Bashkia do të bëjë kontabilizimin për pjesën solidare të detyrimit.*

Kriteri: 1-ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH",ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016)

2-ligji nr. 48/2014 date 24.04.2014"Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregetare" ndryshuar me ligjin nr.24/2015, date 19.903.2015,

3-udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*"ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

4-Udhëzimin plotësues te Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*",

5-Udhëzimin plotësues te Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njësitë e qeverisjes vendore''*.

6.Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarte te monitorimit te buxhetiti te Njësive te vetëqeverisjes vendore*",

7.Udhëzimin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 09.03.2018 "Per

procedurat e zbatimit te buxhetit per njësitë e Qeverisjes se përgjithshme qe përdor Sistemin Informatikë Financiar te Qeverise", pika 42 shprehet:

"Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore dhe zërin e detyrimeve të prapambetura të tyre ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, "Shpenzime të periudhave të ardhshme", në varësi të natyrës së tyre:

- Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore;

- Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për shërbime;

-Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje;

- Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për investime;

- Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura të tjera.".

8. Udhëzimin plotësues nr. 2 date 19.01.2018 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2018", pika 82 e cila shprehet *"Detyrime te prapambetura konsiderohen detyrimet financiare te konstatuara dhe te papaguara nda te treteve, te gjitha llojet e detyrimeve financiare, te cilat nuk janë paguar Brenda afateve te përcaktuara ne ligj; ne marrëveshjet kontrakture respektive; ne vendimet e gjykatës se formës se prere, qe mbeten te papaguara 60 dite pas datës se specifikuar ne kontrate apo me ligj, duke përfshire edhe periudhën kontraktuake te shtyrjes se pagesës, te cilat kane lindur ne njësitë e vetëqeverisjes vendore (si edhe kontratat e financuara nga qeveria qendrore),* ka kryer plotësimin e Shtojcës 5 dhe ia ka nisur Ministrisë se Financave, brenda datës 30 Janar 2019 detyrimet e prapambetura qe ka Bashkia Berat (si njësi vendore) me date 31.12.2018.

Impakti: Nuk është respektuar radha e likuidimit të detyrimeve për faturat e periudhave të mëparshme me buxhetin e vitit pasardhës, nuk është bërë analizë për vendimet e gjykatave nga titullari i institucionit si dhe nxjerrja e përgjegjësisë administrative përpara se të bëhej likuidimi.

Shkaku: Mosveprim i nëpunësit zbatues. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura dhe analizimin e të gjitha detyrimeve për vendime Gjykate.

Rëndësia: **E lartë**.

Rekomandimi: Bashkia Berat (Drejtoria e Financës), bazuar ne; Udhëzimin plotësues te Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*"dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njësitë e qeverisjes vendore''*.të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e detyrimeve të prapambetura faturave të pa likuiduara në vite deh vendimet gfjyqësore, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën prej 14,0900,017, nga e cila vlera e faturave të palikujduara në shumën **5,028,282** lekë ***dhe vendime gjyqësore për shumën prej 9,061,735*** *lekë* **(Bashkëlidhur Aneksi nr.8 mbi**

gjendjen e faturave te palikujduara me datën 30.09.2019)

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

Për auditimin e arkëtimit të ardhurave nga vendimet e gjobave të vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit IMTV të Bashkisë Berat për periudhën e viteve 2015-2016-2017-2018 deri 30.09.2019)

Situata:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në **Bashkinë Berat** ka një strukturë të përbëre nga 3 punonjës, një Kryeinspektor dhe dy inspektor.Marrëdheniet e punës rregullohet me Kodin e Punës, për periudhën 01.01.2015 deri -30.09.2019 janë **ndryshuar 4 Kryeinspektorë të IMTV**.

-Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve, (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likujdimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur.

Për ndërtimet e kryera gjatë viteve 2017- 9 /mujori 2019 nga 64 Subjektet (objektet) private dhe Subjektet ndërtuese me fondet shtetërore, në vlerën **1,147,490,963 lekë**, **respektivisht:**

-Viti 2017 për 27 subjekte në vlerën 488,919,700lekë

-Viti 2018 për 27 subjekte në vlerën 249,636,491 lekë

-Viti 2019 për 10 objekte në vlerën 408,932,742 lekë

Në zyrën e IMT ndodheshin të pa protokolluara dhe të pa shoqëruara me inventar dosje dhe jo të nisura zyrtarisht nëpërmjet Zyrës protokollit (me përjashtim të 10-15 subjekteve në periudhën kur ka qene ish kryeinspektor z. Roland Bushi)

Po kështu edhe për lejet e zhvillimit të dhëna për periudhën objekt auditimi nuk ishin hapur dosje për secilin subjekt.

Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Berat nuk janë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka mare zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim të nenit 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1014" Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.Neni 9 ku përcaktohet se: *Për të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3, zbatuesi i punimeve duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës dhe inspektoratin ndërtimor e urbanistik, në nivel bashkie/komune/qarku, përpara fillimit të punimeve.*

Inspektorati ndërtimor urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut,brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të dosjes,duhet të pajisë subjektin me vërtetim për plotësimin ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur. Në përfundim të afatit 5-ditor,nëse inspektorati ndërtimor urbanistik i bashkisë/ komunës/ qarkut nuk shprehet,atëherë dokumentacioni tekniko-ligjor i paraqitur nga subjekti,konsiderohet si i pranuar i plotë nga inspektorati i sipërpërmendur.

Në disa nga subjektet ndërtimore me fonde shtetërore nuk është zbatuar grafiku i përfundimit të objekteve, pasi nuk janë dorëzuar objektet në afat dhe nuk është hartuar akt kolaudimi i objekteve,ndërkohë për këto raste nga IMT nuk janë zbatuar sanksione për dënim me gjobë apo anulimin e

lejeve të ndërtimit, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017, neni 52, Kundërvajtjet administrative shkronja (dh)

-Nuk është mbajtur regjistri për gjobat e vendosura nga IMT Bashkia Berat, edhe një regjistër që është mbajtur, ai nuk është i azhurnuar për pagesat dhe nuk i ka shërbyer njohjes së gjendjes së nivelit të arkëtimittë gjobave, në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 darë 01.10.2014" për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ndryshuar me ligjin nr.73/215, datë 09.07.2015 dhe nr 28/2017, datë 23.03.2017 neni 51-Inspektimi**, ku parashikohet se:**

1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.
2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.
3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësive, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar.
4. Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.
5. Të dhënat e përmbledhura dhe konkluzionet e veprimtarisë së inspektimit janë pjesë e raportit vjetor për zhvillimet në territor.

Sipas Informacioneve të paraqitura nga IMTV, Bashkia Berat,rezulton se në total, për periudhën e viteve **01.01.2015 deri 30.09.2019** , për ndërtime të kundërligjshme /mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me **gjobë 125 kundërvajtës, me vlerë totale 38,650,000 lekë**,(të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare llogaria 468 më datën 31.12.2019) prej tyre deri më datën 01.11.2019, janë arkëtuar gjobat vetëm nga 17 subjekte në vlerën 2,200,000 lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar pranë Gjykatës Shkallës së parë Berat, lëshimi i urdhrave ekzekutiv të vendimeve të gjobave por deri më datën 01.11.2019 janë lëshuar urdhra ekzekutiv vetëm 4 vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata,dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim.**Pasqyrë përmbledhëse e Vendimeve të gjobave dhe arkëtimi për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019, IMT Bashkia Berat, paraqiten në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi**

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se nga 122 gjoba të vendosura për vlerën 38,650,000 lekë, rreth 63 % të numrit të gjobave ose 55 gjoba x 500,000 lekë dhe 81.5% të vlerës prej 31,500,000 lekë e zënë gjobat minimale **prej 500,000 lekë për secilin rast**.
Pra më datën 01.11.2019 për **100 vendime gjobe** nuk është vepruar duke mbetur të pa arkëtuara vit pas viti dhe shkaktuar mungesë të ardhurash në Bashkinë Berat, **në vlerën prej 28,400,000 lekë** (Për vendimet e 100 gjobave në vlerën prej 28,400,000 lekë nuk janë llogaritur kamat vonesat në vlerën 60 % të shumës ose 17,040,000 lekë duke shkuar vlera **prej 45,440,000 lekë** (28,400,000+ 17,040,000)
Nga auditimi rezulton se për **100 vendime gjobe në vlerën prej 28,400,000** lekë, të vendosura për periudhën 4 vjeçare e 9 muaj respektivisht nga data 01.01.2015 deri 30.09.2019,prej tyre **31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë,** të vendosura për **periudhën 2 vjeçare e 10 muaj**, nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017 të cilave u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar (pra nuk mund të vilen më) dhe asnjë nga ish-kryeinspektorët e IMT pasardhës konkretisht **z.R. B. dhe z.L. S.,Drejtoria Juridike Bashkia Berat** juristja e IMTV **znj. E. T.** dhe ish kryetari i Bashkisë Berat **z.P. S.,** nuk kanë ndërmarrë asnjë nga hapat,pasi **u ka kaluar 2 vjeçar i arkëtimit,pra janë parashkruar dhe nuk mund të vilen më.**
Për mos veprim të punonjësve të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, sipas periudhave përkatëse mbajnë përgjegjësi: 3 ish kryeinspektorët e IMT **z.R. B. dhe z.L. S.,Sektori Juridik Bashkia Berat** dhe juristja e IMTV **znj. E. T.**, pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre nuk kanë zbatuar kërkesat e ligji nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" dhe konkretisht nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative, ku parashikohet se: Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, **atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.**
Sa sipër, me veprimet apo mos veprimet e tyre, 3 ish-Kryeinspektorët e IMT Bashkisë Berat kanë shkelur ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore ku përcaktohet se: Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme**:**
b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit (nuk ka vendosur gjoba));
c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit (nuk

ka bërë asnjë kërkesë për heqje licence);
dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi (**nuk kanë paraqitur në prokurori asnjë kallëzim penal).Pretendimi i i punonjësve të IMT Berat se janë dërguar në prokri nuk pranohet pasi nuk disponohen shkresa dhe padi konkrete, duke u justifikuar me denoncimet që kanë bërë punonjësit e Policisë të Rendit, etj)**

Pasqyrë **përmbledhëse e 125 vendimeve gjobave për shumën** 38,650,000 **lekë të vendosura për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019 nga të 4 Kryeinspektorët e IMT Bashkia Berat, janë trajtuar në Aneksi nr. 1**

e. Nga znj. N. K. ish përgjegjëse e sektorit juridik dhe znj. E. T. ish juriste e IMTV, nuk kanë kërkuar në Gjykatë, lëshimin e urdhrave ekzekutiv, në kundërshtim me Rregulloren e brendshme te Bashkisë Berat Miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Regjistruar nr.737,Prot , datë 07.02.2018. ku në mënyrë eksplicite shkruhet se:Përgjegjësi i Sektorit Juridik,Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit Juridik janë:
pika 10. Kthimi në tituj ekzekutivë të gjobave të vendosura në bazë të ligjit të posaçëm apo Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 09.12.2013 "Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse.
Për këtë konstatim znj. N. K. ish përgjegjëse e sektorit juridik ka bërë komentet dhe sqarimet të cilat janë sqaruar më poshtë.

Pasqyrë përmbledhëse e 125 vendimeve gjobave për shumën **38,650,000** lekë të vendosura për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019 nga të 4 Kryeinspektorët e IMT Bashkia Berat.
Aneksi nr. 1
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi 3 ish- Kryeinspektorët e IMT bashkai Berat sipas periudhave si më poshtë:

1.z.S. K.. ish -Kryeinspektor me arsimim, Matematikë, Informatikë, ka punuar në detyrën e Kryeinspektorit për një **periudhë prej 4 vjet dhe 2 muaj**, emëruar me vendimin nr. 166, datë 15.07.2013,larguar më datën 06.09.2017 me vendimin nr.693 datë 31.08. 2017, nuk ka dorëzuar blloqet e gjobave dhe detyrën me inventar dhe proces verbal ,ndërkohë që i është dhënë Libreza e punës. Për veprimet apo mos veprimet e procedurave ligjore dhe nënligjore për **39 vendimet e** gjobave të vendosura në periudhën kur ka qenë me detyrën e Kryeinspektorit,duke shkaktuar mungesë të ardhurave në Bashkinë Berat për shumën **15,250,000 lekë** (Gjatë 4 vjetëve ka arkëtuar vetëm 1 vendim gjobe në vlerën 100,000 lekë) (listat me vendimet e gjobave janë përshkruar në **Aneksin nr. 3** me emërtimin periudha e **z.S. K. Ish-**Kryeinspektor, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).
2. z. **R. B.** ish- Kryeinspektor i IMT bashkia Berat me arsimim Inxhinier Ndërtimi ka punuar në detyrën e Kryeinspektorit për një periudhë **prej 8 muaj** emëruar më datë 06.09.2017 me vendimin nr. 695, datë 31.08.2017,

larguar më datën 17.04.2018 me vendimin nr. 254, datë 11.04.2018,për veprimet apo mos veprime e procedurave ligjore dhe nënligjore për **30 vendimet e** gjobave të vendosura në periudhën kur ka qenë me detyrën e Kryeinspektorit, dukë shkaktuar mungesë të të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Berat për shumën **13,650,000 lekë**. (listat me vendimet e gjobave janë përshkruar në **Aneksin nr. 4 me** emërtimin periudha e **z. R. B. ish-** Kryeinspektor, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi).Gjatë 8 muajve të qëndrimit në detyrën e Kryeinspektorit të IMTV Bashkia Berat, z**. R. B.** ka arkëtuar **vetëm 4 vendim gjobe në vlerën 950,000 lekë**).
Po kështu **z. R. B.** nuk ka vepruar edhe për **39 vendimet** e gjobave të vendosura nga pasardhësi i tij z. S. K.,duke shkaktuar mungesë të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Berat për shumën **15,250,000 lekë** (**Anekset nr. 3 dhe 4** bashkëlidhur këtij Aktkonstatimi).

3. z. **L. S., ish-**Kryeinspektor i IMT, me arsimim Inxhinier Ndërtimi ka punuar në detyrën e Kryeinspektorit për një periudhë **prej 1 vit dhe 4 muaj,** emëruar datë 23.04.2018 me vendimin nr.269, datë 20.04 2018, larguar më datë 14.08.2019 me vendimin nr. 591 datë 13.08.2019, **pasi** me veprimet apo mos veprimet e tij në lidhje e procedurave ligjore dhe nënligjore për **31 vendimet e** gjobave të vendosura në periudhën kur ka qenë me detyrën e Kryeinspektorit, duke shkaktuar mungesë të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Berat në shumën **7,450,000 lekë** (Gjatë një viti 1ë ka qëndruar në detyrën e Kryeinspektorit të IMTV, ka arkëtuar vetëm 5 vendim gjobe në vlerën 1,050,000 lekë) (listat me vendimet e gjobave janë përshkruar në Aneksin nr. 5 m emërtimin periudha e z..L S. ish kryeinspektor , bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)
Po kështu z. **L. S., ish-**Kryeinspektor i IMT, nuk ka vepruar :
a. Edhe për **39 vendimet e** e gjobave të vendosura nga paraardhësi i tij z. S. K.,duke shkaktuar mungesë të të ardhurave në Buxhetin e Bashkisë Berat për shumën **15,250,000 lekë**. (Aneksi nr. 4 bashkëlidhur këtij Aktkonstatimi)
b. edhe për 30 vendimeve të gjobave të vendosura nga paraardhësi i tij z. R. B. në periudhën kur ka qenë me detyrën e Kryeinspektorit , duke shkaktuar mungesë të të ardhurave në shumën **13,650,000 lekë**. (listat me vendimet e gjobave janë përshkruar në Aneksi nr. 3, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi)

Komente dhe sqarime nga z.L. S. ish kryeinspektor i IMT
Në E-mailin e datës 23.11.2019 z.L. S., ish kryeinspektor i IMT Bashkia Berat sqaron: Me fillimin tim në këtë pozicion fillimisht jam marrë me ndërtimin e një database me të gjitha të dhënat për vendimet e marra nga IMT-ja në vite (gjobat). Ky database plotësohej periodikisht rast pas rasti (materiali bashkangjitur është pjesë e analizës vjetorë të bashkisë Berat për vitin 2018)
Përsa i përket pajisjes së zbatuesve të punimeve (subjekteve ndërtimore) me vërtetim për shlyerjen e detyrimeve gjobave apo për plotësim të dokumentacionit ligjor teknik të paraqitur dua të sqaroj se në bashkinë Berat procedura e dhënies së lejeve të ndërtimit vazhdon në sistemin e-lejet. Çdo dokumentacion apo korrespodencë kryhet në sistemin e-lejet

deri në përfundimin e objektit dhe dërgimin e dosjes në hipotekë për hipotekim. IMT-ja ka akses ne këtë sistem ku dhe operohet aktualisht (per vërtetimin e gjobave , vënien e gjobave , et.) . Për këtë problem kemi diskutuar verbalisht me përfaqësuesit e IKMT-së Tiranë dhe e kanë quajtur të drejtë komunikimin në sistemin e-lejet.
Doja te theksoja faktin se gjatë gjithë periudhës që unë kam qënë në krye të IMT-së nuk kam patur asnjëherë kontroll apo konsulencë nga auditi i brendshëm i bashkisë , (detyra të përcaktuara tek Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Berat, neni 230, Miratuar dhe Regjistruar nr.737 Prot , datë 07.02.2018.)
Në këto kushte është hera e parë që përballem me ligjin nr.10279 "Për kundravajtjet administrative" pasi nuk kam patur dijeni dhe informacion.
Përsa i përket faktit që nuk kam bërë asnjë kallëzim penal për shkelësit e ligjit sqaroj se:
Për vendimet e dënimit me gjobë të vendosura në kohën kur unë isha k/inspektor (gjobat mbi 500,000 lekë) vetëm në një rast është bërë kallëzim penal shkresa nr.2228 Prof dt 24.04.2019 Kallëzim për veprën penale (ndërtim pa leje) (dokumenti bashkangjitur) , ndërsa për rastet e tjera ishte ngritur padia që më parë nga organet e rendit dhe ne i jemi përgjigjur prokurorisë me dokumentacionin përkatës të kërkuar nga ana e tyre (proces verbal konstatimi , vendim për dënim me gjobë dhe shkresa njoftim për dënim me gjobë) . Për këtë janë korrespodencat zyrtare me Prokurorinë e rrethit Gjyqësor Berat .
Ne lidhje me vendimet për dënim me gjobë nga ana ime për periudhën 23.04.2018 deri 14.08.2019 në shumën 7,450,000 lekë dua të sqaroj se ato janë brenda limiteve kohore për të nisur procedurat e vjeljes s¢ tyre dhe nuk mund të quhen dëm ekonomik. Po kështu edhe për një pjesë të vendimeve për dënim me gjobë të vendosura në periudhën 13.08.2017 deri ne 23.04.2018 nuk mund të quhen dëm ekonomik për arsye si më sipër (shuma 1,6500,000 lekë). Në bashkëpunim me sektorin juridik janë nisur procedurat gjyqësore për 7 shtatë raste në shumen ,3500,000 lekë.
Dua të theksoj dhe faktin që gjysma e parë e vitit 2019 ishte vit elektoral : ka pasur shume presione e ndërhyrje për mosveprim.
Për sa më sipër nuk mendoj se ishte detyrim ligjor i IMT-se ndjekja e procedurave për vjeljen e gjobave.
Këto ishin disa nga sqarimet e mia në lidhje me problemet e ngritura nga ana juaj.
<u>Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së.</u>
*Periudha e **z. L. S. , ish-** Kryeinspektor,për **30 vendimet e gjobave për shumën 7,450,000 lekë**, **Aneksi nr. 5,**për një periudhë 1 vit e 4 muaj kur ka qenë me detyrën e Kryeinspektorit të IMT. Emëruar datë 23.04.2018 me vendimin nr.269, datë 20.04 2018, larguar më datë 14.08.2019 me vendimin nr. 591 datë 13.08.2019,*
z. L. S., ish-Kryeinpektor i IMT me veprimet apo mos veprimet e tij nuk kanë zbatuar kërkesat e ligji nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" dhe konkretisht nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative, ku parashikohet se: Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të

kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.
Sa sipër, me veprimet apo mos veprimet e tij z. L. S. ish Kryeinspektor i Bashkisë Berat ka shkelur ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 24.02.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", neni 5-Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore ku përcaktohet se: Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:
***c)** paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit (nuk ka bërë asnjë kërkesë për heqje licence);*
dh)** përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi **(nuk ka paraqitur në prokurori asnjë kallëzim penal).
Në bashkëpunim me sektorin Juridik pranë bashkisë ndihmonim në përgatitjen e dokumentacionit për ndjekjen procedurave për vjeljen e gjobave .

4. **z.F. M.** aktualisht Kryeinspektor i IMT, me arsimim Fakulteti i Drejtësisë, deri më datën 10.11.2019 , **ka 3 muaj punë**, emëruar më datë 15.08.2019 me vendimin nr. 593, datë 13.08.2019, është në vazhdim.

5. znj.E. T. ish juriste në IMT Bashkia Berat, për një periudhë **prej 2 vjet e 4 muaj,** emëruar me urdhërin nr.354, datë 28.09.2015 dhe me urdhrin nr.84, datë 01.02.2018 është liruar nga pozicioni i punës në IMT, aktualisht është specialiste Juriste në Sektorin Juridik. (nuk ka dorëzuar detyrën dosjet dhe dokumentacionin tjetër etj, me proces verbal)

Komente dhe sqarime nga znj. E.T. ish juriste e IMT
Në E-Mailin e datës 23.11.2019 përsëritur edhe me shkresën nr datë për kthimin e projektraportit të auditimit sqaron: Marrëdhënia ime e punës si jurist pranë IMT-së të Bashkisë Berat është e rregulluar me kontratat e punës të datës 31.12.2015, e cila i fillon efektet në datën 01.01.2016 dhe i përfundon në datën 31.12.2016 dhe në kontratën e punës të datës 30.12.2016, e cila i fillon efektet në datën 01.01.2017 dhe i përfundon 01.01.2018, të konfirmuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.949, datë 29.12.2017.
Bazuar në këto kontrata unë si juriste pranë IMT jam në cilësinë e punëmarrësit dhe Kryetari i Bashkisë është në cilësinë e punëdhënësit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet lidhur me pozicionin tim të punës burojnë nga kjo kontratë. Theksoj se në asnjë nen të këtyre kontratave, nuk ngarkohem me detyrën për të bërë kërkesat për urdhër ekzekutimi të vendimeve të IMT, apo me procedurat për vënien në ekzekutim të

kundërvajtjes administrative.
Bazuar në ligjin Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", Kreu V Procedura të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit për kundërvajtjen administrative, Neni 30, Arkëtimi i shumave të detyrimeve, pika 4, Kjo është një kompetencë e kryeinspektorit si titullar i organit që nxjerr aktin administrativ dhe Kryetarit të Bashkisë .
Në Kreun V, neni 30,pika 4 citohet:
- Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
a) kryetari i bashkisë apo komunës;
b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.
Nga interpretimi i nenit të sipërcituar nuk jam personi përgjegjës për të bërë kërkesa për te nxjerrë urdhrin e ekzekutimit dhe ligji e ka të shprehur në mënyrë të qartë se kush janë personat përgjegjës.
Në referim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007" Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" i ndryshuar, Neni 4, Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, citohet se:

*Pranë çdo njësie vendore ngrihet Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, i cili, nëpërmjet **kryeinspektorit dhe inspektorëve**, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe **të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.***

Në interpretim të këtij neni Kryeinspektori mban përgjegjësi për zbatimin e detyrimeve që i ngarkon Ligji Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", neni 30, pika 4, lidhur me ekzekutimin e vendimit për kundërvajtjen administrative.
Me urdhrin nr.218 datë 28.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë jam emëruar si specialist jurist në Sektorin Juridik të Drejtorisë s¢ Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Juridike.
Në Akt Konstatimin tuaj shprehet lidhur me përgjegjësinë sipas nenit 44 të Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative", rrethanat e fakti dhe argumentimi ligjor.
Neni 44
Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ
Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.
IMT si organi që ka nxjerrë aktet administrative të dënimeve me gjobë kryen gjithë procedurën nga momenti i kryerjes së konstatimit deri në marrjen e vendimit nga inspektorët dhe kryeinspektori dhe në asnjë rast të këtyre procedurave nuk merr pjesë juristi, pasi ligji ka përcaktuar në mënyrë specifike se kush është struktura përbërëse e IMT-së dhe cilët janë personat përgjegjës për kryerjen e procedurave ligjore. Procesverbalet e konstatimit mbahen nga kryeinspektori dhe inspektorët ,

ose jo më pak se dy inspektorë dhe në asnjë rast nga juristi. Ky fakt është lehtësisht i verifikueshëm nga kontrolli fizik i procesverbaleve dhe vendimeve të dënimeve të IMTV. Unë si juriste pranë IMTV- së nuk kam marrë pjesë në asnjë procedurë të inspektoratit të mbrojtjes së territorit duke filluar nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes deri në daljen e vendimit të nënshkruar nga kryeinspektori, që do të thotë se nuk kam punonjës që ka miratuar vendimin për kundërvajtje administrative. Nuk jam as punonjësi i cili ka në administrim blloqet e vendimeve të gjobave apo ka detyrimin ligjor për inventarizimin e tyre si letra me vlerë.

Unë si jurist nuk jam pjesë e punonjësve të IMTV të cilët kanë mbajtur procesverbalin dhe kanë nxjerrë vendimet, fakt ky i cili vërtetohet nga procesverbalet dhe vendimet e IMTV-së të cilët nuk janë të nënshkruara nga Juristi.

Në pozicionin e punës Jurist pranë IMTV-së . i kam ardhur në ndihmë duke dhënë konsulencë ligjore, si dhe kam ndjekur çështjet gjyqësore në të cilat IMTV ka qenë palë në gjykim dhe si rezultat i punës sime deri tani të gjitha çështjet në të cilat IMTV ka qenë palë e paditur janë rrëzuar duke mbetur në fugi akti administrativ i IMTV.

b-Në Akt Konstatimin tuaj shprehet për mosnisje të procedurës për vënien në ekzekutim të akteve administrative, për 31 vendime me gjobë në vlerën 20,650,000 lekë, argumentimi ligjor dhe rrethanat e faktit :

Në përfundim duke u mbështetur në argumentimin ligjor të sipërcituar, nuk kam përgjegjësi për mosndjekjen e procedurave për vënien në ekzekutim të vendimeve të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit, i cili është detyrim ligjor i ***Kryeinspektorit si titullar i organit,që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.***

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së:

Nuk jemi dakord me komentet dhe argumentet që paraqet nga ish juristja e IMT ***znj.E. T.****, pasi veprimet apo mos veprimet e saj për mos ndjekjen e procedurave ligjore dhe nënligjore,për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT, janë në kundërshtim me Rregulloren e brendshme te Bashkisë Berat, miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Regjistruar nr.737,Prot , datë 07.02.2018. ku në mënyrë eksplicite shkruhet se: Përgjegjësi i Sektorit Juridik,Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit Juridik janë:*

pika 10*. Kthimi në tituj ekzekutivë të gjobave të vendosura në bazë të ligjit të posaçëm apo Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 09.12.2013 "Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse.*

6.z.L. Dh. ,inspektor IMTV Ing.ndërtimi për një periudhe prej 3 vjet e 7 muaj, emëruar me vendimin nr. 167, dt.02.06.2014, larguar me urdhrin nr. 774, datë 23.10.2017 (pa dorëzuar detyrën dosjet dhe blloqet e gjobave, etj, me proces verbal).

7.z.E. V.,inspektor jurist, 2 vjet e 1 muaj, emëruar me urdhrin nr.780, datë 23.10.2017, vazhdon.

8.z.D. H., inspektor jurist, 1 vit e 9 muaj, emëruar me urdhrin nr.78, datë 01.02.2018, vazhdon.

Për mos kërkesë llogarie dhe mos kontrollin e punës në lidhje me

ndjekjen e procedurave ligjor dhe nënligjore për arkëtimin e vendimeve të gjobave duke mos zbatuar Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Berat "Për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së administratës së Bashkisë" nr. 737, dt.07.02.2018 -Detyrat e përgjegjësit të sektorit juridik pika 10, ku përcaktohet: Kthimi në tituj ekzekutiv të vendosura në bazë të ligjit të posaçëm apo të këshillit Bashkiak nr. 46, datë 09.12.2013" Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Berat.

Kriteri:

Sa sipër nuk janë zbatuar dispozitat ligjore **të mëposhtme:**

a-neni 16 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se: -**Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr.9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr.9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3)

b-nga Bashkia Berat, 3 ish kryeinspektorët e IMT, Sektori Juridik Bashkisë Berat përgjatë harkut kohor të 2 viteve e 10 muaj nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017, nuk kanë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) **për 31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë,** të përcaktuara në ligjin nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", përkatësisht: neni 9 -Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative; neni 22 -Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv" dhe neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve

c-Nga Sektori Juridik, Bashkia Berat, nuk është kërkuar në Gjykatë, lëshimi i urdhrave ekzekutiv në përputhje me nenin 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

d-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMT) dhe Sektori Juridik Bashkia Berat nuk ka marrë masat dhe nuk kanë kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime me gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015,deri më dt. 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë,** në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996,"Kodi i Procedurës Civile në RSH " i ndryshuar, dhe konkretisht:

-Nenin 151,Rivendosja në afat, ku përcaktohet se: Kur palët ose prokurori që ka ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kërkojnë prej saj rivendosjen në afat, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.

-Nenin 152, Kërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Komenet dhe sqarime: Për këtë konstatim **znj. N. K., ish përgjegjës e sektorit Juridik në Bashkinë Berat,aktualisht juriste, në observacionin nr. 5792/4, prot, datë 25.11.2019**
Ju bëjmë me dije se pretendimi i shprehur më sipër,përsa i përket sektorit juridik, në Drejtorinë e MPMBNJ dhe Juridike, është i pa bazuar në ligj dhe prova, për arsyet e mëposhtme:
Së pari: Gjykata nuk bën kthimin e vendimit të gjobës në titull ekzekutiv apo vënien në afat,ndryshe nga sa ju pretendoni,por pranimin ose jo të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit,për titullin ekzekutiv,mbështetur në Kodin e procedurës Civile neni 511 "Urdhri i ekzekutimit" .

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSh-së. *Grupi i auditimit në vend që të përdorte fjainë kërkim në gjykatë të lëshimit të urdhrit ekzekutiv, ka përdorur fjalinë,për kthimin e vendimit në titull ekzekutiv.*
Kjo nuk shtë ndonjë "hata" e madhe, është "'lojë fjalësh" për tu shmangur përgjegjësisë, pasi thelbi është se Bashkia Berat, nuk ka vënë në lëvizje gjykatën për lëshimin e urdhrave ekzekutive, me qëllim që të zbatohen nga ana e përmbaruësit. Për pasojë 100 vendime gjobe të vendosura nga IMTV për periudhën 01.01.2015,deri më dt. 31.10.2017 për shumën **20,650,000 lekë, nuk është e mundur të arkëtohen,pasi ka kaluar afati 2 vjeçar i kërkimit,pra janë parashkruar.**
Për të qënë më të saktë KLSH për kthimin në tituj ekzekutiv i është referuar edhe Rregullores së brendshme te Bashkisë Berat Miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Regjistruar nr.737,Prot , datë 07.02.2018, ku në mënyrë eksplicite shkruhet se: Përgjegjësi i Sektorit Juridik,Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit Juridik janë: **pika 10. Kthimi në tituj ekzekutivë** të gjobave të vendosura në bazë të ligjit të posaçëm apo Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 09.12.2013 "Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse.

Së dyti: Sektori juridik nuk mund të ndjeke procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimeve të gjobave të nxjera nga IMTV,Bashkia Berat,për shkak se nuk disponon asnjë informacion dhe dokumentacion në lidhje me këto vendime. IMTV, ka përgjegjësi bazuar në ligji nr. nr.10279,datë 20.05.2010"Për kundravajtjet administrative",Kreu i V-të,"Procedura të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit për kundërvajtjen administrative", neni 30, pika 4,kërkesa për ë nxjerr urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga b) Titullari i organit që ka nxjerr vendimin për kundërvajtjen administrative.
Së treti: Sektori Juridik në bazë të kërkesës dhe provave shkresore dërguar nga IMTV, ka ndjekur gjithë procediurën ligjore parashikuar nga ligji "Për kundërvajtjen administrative", deri në dërgimin e titullit

për ekzekutim pranë shërbimit përmbarimor për 7 gjoba e shprehura në kërkesën nr .ska, datë 04.09.2018 "Kërkesë për bashkëpunim",drejtuar drejtorisë Juridike,Bashkia Berat.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH-së.

Sipas Informacioneve të paraqitura nga IMTV, Bashkia Berat,rezulton se në total, për periudhën e viteve 01.01.2015 deri 30.09.2019 , për ndërtime të kundërligjshme /mos zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime **për Dënim me gjobë 125 kundërvajtës, me vlerë totale 38,650,000 lekë,** prej tyre deri më datën 01.11.2019, ishin arkëtuar gjobat vetëm nga 17 subjekte në vlerën 2,200,000 lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar pranë Gjykatës Shkallës së parë Berat, lëshimi i urdhrave ekzekutiv të vendimeve të gjobave por deri më datën 01.11.2019 janë lëshuar urdhra ekzekutiv vetëm për 4 vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata,dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim.

Dhe për më keq, është fakti se 100 vendime gjobe të vendosura nga IMT për periudhën 01.01.2015,deri më dt. 31.10.2017 për shumën **20,650,000 lekë, nuk është e mundur të arkëtohen,pasi ka kaluar afati 2 vjeçar i kërkimit, pra janë parashkruar** .

KLSH ka bërë prezent se për arkëtimin e vlerës gjobave vetëm në **masën 5,6%,** përgjegjësinë kryesore e kanë 3 ish kryeinspektorët e IMT sipas periudhave të qëndrimit në detyrë, dhe nish juristja znj. **E. T.,** por përgjegjësi mban edhe ish Përgjegjëse e sektorit Juridik juristja znj. **N. K.. Detyrë kjo e ngarkuar** në Rregulloren e brendshme te Bashkisë Berat Miratuar nga kryetari i bashkisë dhe Regjistruar nr.737,Prot , datë 07.02.2018. ku në mënyrë eksplicite shkruhet se:Përgjegjësi i Sektorit Juridik,Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit Juridik janë: **pika 10.** Kthimi në tituj ekzekutivë të gjobave të vendosura në bazë të ligjit të posaçëm apo Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.46, datë 09.12.2013 "Për miratimin e shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksioneve përkatëse

Impakti: Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penalieteve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Shkaku: Përgjegjësi e inspektorëve të IMTV, nga mos njohja dhe zbatimi i ligjit për mos arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMT -ja.

Rëndësia: **E lartë**.

Rekomandimi: a. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Berat,bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH", të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime gjobe për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015,deri më datën 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë,** (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën

60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar).**Aneksi nr. 2 bashkëlidhur**

b.Njëherazi Bashkia Berat, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për kërkimin në Gjykatë të lëshimit të urdhrave ekzekutive të 125 vendimeve të gjobave në vlerën **38,650,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar). **Aneksi nr. 1.bashkelidhur**

1) Dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujori 2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1)Nga ana e Bashkisë Berat, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në

VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar.

Përsa i përket arkëtimit të të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore dhe Inproduktive që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat.

Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 9/4 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar,

në të përcaktohet që:

Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifat dysheme, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

LIDHJA NR.2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

*Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit***

1 vit, 2-5 vjet, 6-10 vjet

*1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / **440 000***

Pika 9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe

*Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lek/ha/vit***

1-5vjet 6-10 vjet

1 Pyll trungishte 120 000 96 000

2 Pyll cungishte 96 000 78 000

3 Pyll shkurre 96 000 78 000

*4 Kullota 96 / 000 / **78 000***

Nga auditimi rezultoi që:

B.Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit me ndryshimet e tij.

4.Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor..

Në auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Energjetikës që ndodhen në territorin e Bashkisë

Berat, për periudhën sipas programit të auditimit nga viti 2017, 2018 dhe 9 mujori i vitit 2019 u krye auditimi për arkëtimin e të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat dhe të ish Komunave sot Njësi Administrative në vartësi të Bashkisë Berat.

Nga auditimi i kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujori i vitit 2019, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore dhe inproduktive, nga ku konstatohet se nga Bashkia Berat, nuk ka kontrata të lidhur me subjektet të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullosore që administrohen nga kjo bashki dhe duhen të merren masa të menjëhershme për të lidhur kontrata qiraje, me subjektet që paraqiten në aneksin 5/1:

Aneksi 5/1.Subjekte të pajisur me leje minerare por që nuk janë lidhur kontrata qiraje.

Nr	Nr Lejes	Data	Emri i Subjektit	Vendndodhja	Sipërfaqja ha	Tarifa lek/ha	Vlera 1 vit	Muaj shfrytëzimi	Vlera në lekë
1	1368	18.06.2009	"B."	Sinjë	7	440,000	3108000	33	
2	1694	27.03.2014	"T."	Sinjë	11	440,000	4840000	33	
3	1379	03.07.2009	"B."	Roshnik	16.7	440,000	7348000	33	
4	1359	08.06.2009	"P."	Roshnik	11.5	440,000	5060000	33	
5	1597	19.11.2012	"E."	Roshnik	9.2	440,000	4048000	33	
6	1101	06.12.2009	"T."	Roshnik	7	440,000	3080000	33	
			Totali		**62.4**		**27,484,000**		**75,581,000**

Nga ana e Bashkisë Berat është bërë njoftim për lidhje kontrate qiraje me nr.127 prot, datë 11.01.2017 për subjektet debitor nga ku ka rezultuar:
Dhe me njoftimet nga ana bashkisë përsëri këto subjekte nuk kanë lidhur kontratë qiraje me bashkinë, por janë mjaftuar vetëm me lejen e marrë nga ministria përkatëse, nga ana e strukturave përgjegjëse nuk është bërë e mundur bllokimi i aktivitetit me masat shtrënguese(policia bashkiake e policia e shtetit) deri në lidhjen e kontratës, të cilësuara dhe në shkresat e Kryetarit të Bashkisë ndaj këtyre subjekteve. Gjithashtu nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit është bërë njoftim për dokumenta ndaj këtyre subjekteve debitor me nr.5139 prot, datë 14.11.2017 dhe po nga kjo drejtori është dërguar fatur për arkëtim për dy subjekte T. Shpk me vlerë 9,680,000 lekë dhe subjekti B. me vlerë 14,696,000 lekë për dy vite aktivitet.
Subjekti "B." për periudhën 2016-2017 për njoftimin për lidhje kontrate qiraje me nr.127 prot, datë 11.01.2017 me vlerë 14,696,000 lekë i është drejtuar Gjykatës për pavleshmëri absolute të këtij akti administrativ dhe është në proces gjykimi. Ky subjekt i paisur nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë me leje nr.1379 datë 03.07.2009 ka shfrytëzuar asete e bashkisë (kullota) Berat, pa lidhur një kontratë dhe pa derdhur detyrimet ndaj kësaj bashkie në bazë të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.
Nga kjo drejtori është bërë fatur për arkëtim për vitin 2017 vetëm për këto dy subjekte dhe jo për të gjithë subjektet që ushrojnë aktivitet për leje minerale pa kontrata qiraje.
Nga ana e inxhinjerëve dhe teknikikut të pyjeve të "Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar" nuk është bërë asgjë në drejtim të lidhjeve të kontratave dhe arkëtimit të detyrimeve për këto subjekte që ushtrojnë aktivitet për lejet minerale në territorin e bashkisë Berat, që nga krijimi i kësaj drejtorie me vendim nr.10, datë 20.01.2016.
Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2 "Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive",
pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, 6-10 vjet, Inproduktive është 440 000 lek/ha/vit dhe
Pika 9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe Pyll cungishte, Pyll shkurre, Kullota, tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, 6-10 vjet është 78,000 lek/ha/vit
Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
-Nga Bashkia Berat, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore me sipërfaqe totale prej 62.4 ha, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi:
a)Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është **440,000 leke/ha/vit në territor tokë Inproduktive;**
b)Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, me afat 6-10 vjet ku tarifa vjetore është **78,000 leke/ha/vit në territor Kullotë,** të trajtuara në aneksin nr.5.1, veprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Berat, në vlerën 75,581,000 lekë.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
-VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 9,

Vlera prej 75,581,000 Lekë, e cila do të konsiderohet si të ardhura të munguara shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Berat.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
z.A. H., me detyrë ish/Inxhinier të Pyjeve dhe Kullotave nga data 2.02.2016-01.02.2018,
z.V. K.i, me detyrë ish/Inxhinier të Pyjeve dhe Kullotave nga data 17.03.2016-20.07.2018,
z.K. B., me detyrë Inxhinier të Pyjeve dhe Kullotave nga data 12.01.2017 e në vazhdim,
z.A. F., me detyrë Inxhinier të Pyjeve dhe Kullotave nga data 02.08.2018 e në vazhdim,
z.K. B., me detyrë teknik Pyjesh nga data 23.02.2016 e në vazhdim,
znj.M. S., me detyrë përgjegjëse e menaxhimit të pronave dhe strehimit.

Në zbatim të pikës B.1.4, të programit të auditimit "Nr.606/1 datë 26.08.2019", Dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë për subjektet debitor.

2.Titulli gjetjes	-Mos arkëtim detyrimi nga dhënia me qira e aseteve pyje kullota.
Situata:	-Në Bashkinë Berat ushtrojnë aktivitet disa biznese të pajisur me leje minerare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të cilat shfrytëzojnë asetet e bashkisë si Pyje dhe Kullota përkatësisht: - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1368 datë 18.06.2009, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 (shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë. - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1694 datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 (njëmbëdhjetë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,310,000 lekë - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1379 datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7(gjashtëmbëdhjetë.shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 20,207,000 lekë. - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "P." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1359 datë 08.06.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5(njëmbëdhjetë.pesë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,915,000 lekë. - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "E." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1597 datë 19.11.2012, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2(nëntë.dy) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 11,132,000lekë. - Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1101 datë 06.12.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7(shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

Kriteri	VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.
Ndikimi/Efekti	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku	-Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	-I lartë.
Rekomandimi	-Të merren masa nga Bashkia, që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimit në vlerën 75,504,000 lekë në zbatim VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.

1-Komente dhe sqarime të subjektit: *paraqitur me shkresën me nr. 5430/2 prot, datë 31.10.2019 nga ana e z. K. B., z.A. F., z.K. B.*

Të gjitha subjektet kanë filluar aktivitetin e tyre para se të dalë VKM 433 datë 08/06/2016 "Për transferimin e Pronave Pyjore dhe Kullosore", me daljen e VKM 433 Ish Drejtoria E SHërbimit Pyjor Berat dhe Ministria Turizmit dhe Mjedisit në Bashkia Berat Drejtoria e Bujqësisë Administrimi Pyjeve Ujërave dhe Shërbimi Veterinar ***nuk kanë sjell asnjë dokument përkatës në lidhjet me subjektet që prodhojnë gurë dhe materiale inerte.***

Për prodhimin e gurit dhe materialeve inerte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka nxjerr asnjë VKM ose VENDIM si nxorri VENDIMIN nr 438 datë 08/06/2016"Për kriteret dhe rregullat eshfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore,Udhëzimit nr2 datë 03/03/2017,të Ministrisë së Mjedisit "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese,rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje".

VKM nr.104 është i vitit 2010 ndërsa ndryshimi i Ligjit të Pyjeve i cili heq të drejtën e dhënies së guroreve me qera,është i vitit 2012.

*Pika 1.Pjesë të fondit pyjor kombëtar,që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore,për tu kthyer në truall,për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale,për ndërtimin e strukturave turistike,të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime te tjera publike,për rrugë automobilistike apo hekurudhore,për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit,****për veprimtari minerare e gjeologjike****, për aeroporte dhe struktura te telekomunikacionit,për qëllime të strukturave ushtarake,qendra industriale,* ***hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve.***

Në bazë të këtij ndryshimi strukturat e pyjeve nuk kanë të drejtë të lidhin kontrata me subjektet që kanë aplikuar në Ministrinë përkatëse për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor pjesën e sipërfaqes të marrë në përdorim ose shfrytëzim të paraqitur në lejen mjedisore.

Kryetari i Bashkisë Berat ka nxjerrë URDHËRIN nr.858 datë 30/11/2017"Për bllokim të aktivitetit,prodhim,nxjerrje,materialesh inerte.(bashkalidhur kopje e urdhërit)

Pëe sa më sipër në tabelën e paraqitur në materialin tuaj subjekti "Bedini 07"sh.p.k ka paraqitur pranë drejtorisë tonë një dokument me nr.8122 me datë 15/12/2015 nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, sipas të cilit këtij subjekti i është revokuar leja minerare me nr.1368 datë 18/06/2009, për gëlqerore pllakore.(bashkëlidhur kopje shkresa) dhe në raportin e lejes minerarë të rinovuara dhe të printuara nga A.K.B.N nuk rezulton ky subjekt me leje minerare.

<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:</u> *-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga personat e mësipërm, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se vlera* ***75,504,000 lekë qëndron*** *dhe duhet të mblidhet e të arkëtohet nga ana e bashkisë në zbatim, VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr.2, pikat 6. Nga ana e inxhinjerëve dhe teknikut të pyjeve në drejtorinë e bujqësisë është detyrë funksionale e tyre për administrimin e pyjeve dhe kullotave në bazë të rregullores së brendshme të kësaj drejtorie.*
Nga ana jonë nuk merret në konsideratë pretendimet e tyre në bazë të argumenteve e dokumentacionit të paraqitur dhe ngarkoheni me përgjegjësi., vlera e mësipërme do të qëndroj në projektraport

<u>1-Komente dhe sqarime të subjektit:</u> *paraqitur me shkresën me nr. 5430/1 prot, datë 30.10.2019 theksoj se 1. Mbështetur në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Adminitratës së Bashkisë për vitin 2017, faqja 67,68, Menaxhimi dhe Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave nuk është detyrë funksionale e Drejtorisë së Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit,e cila objekt të punës ka menaxhimin e pronave"Truall dhe objekte" që kanë kaluar në pronësi te Bashkisë Berat me VKM nr.834, datë 21.11.2012 "Pr miratimin e listës përfundimtare tëpronave të paluajtshme publike,shtetërore,që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat.*
II.Nuk ekziston asnjë urdhër i Kryetarit të Bashkisë që ti ngarkoj për zbaim Drejtorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit,detyrën e administrimit të pyjeve/kullotave apo ndjekjen e subjekteve të pajisur me leje shfrytëzimi.
III.Nga Drejtori i Menaxhimit te Pronave dhe Strehimit me porosi të kryetarit të bashkisë i janë dërguar faturë për arkëtim të gjitha subjekteve që nuk kanë lidhur kontrata qiraje me bashkinë.
IV. Theksoj se administrimi i pyjeve dhe kullotve është objekt i veprimtarisë së Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Kullotave, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar,mbështetur në VKB nr.10,datë 20.01.2016.
Sqaroj se në pozicionin e *Drejtorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit kam qenë vetëm në vitin 2017 dhe jo në vitin 2018 dhe 2019.*

<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:</u> *Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga znj.M. S..*
Pika 1, që nuk është detyrë e saj funksionale shpjegojmë se:
Për vitin 2017 ushtrojnë aktivitet 6 subjekte në bashkinë Berat të paisura nga Ministria me leje minerale dhe pa kontrata qiraje të lidhura me këtë bashki.
Znj. M. S. me detyrë Drejtoreshë e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, nga ana e saj u ka dërguar subjekteve fatur për arkëtim për vitin 2017 vetëm dy subjekteve debitor me nr.5139 prot, datë 14.11.2017, ndërsa 4 subjektet e tjerë që ushrojnë aktivitet dhe pa kontrata qiraje, nuk është dërguar fatur për arkëtim. Kjo tregon se nga znj.M. ka punuar me standarte të dyfishta.
Pika 2.Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat i ka ngarkuar Drejtoreshsës së Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit urdhrin nr.858 datë 30.11.2017.
Pika 3. Nga Drejtori i Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit me porosi të Kryetarit të Bashkisë i janë dërguar faturë për arkëtim të gjitha subjekteve që nuk kanë lidhur kontrata qiraje me bashkinë ku bie në kundërshtim me pikën 2.
Për kujtesë në bazë të shkresave me nr.5139/7,9 datë 10.01.2018 drejtuar Kryetarit të Bashkisëjanë konceptuar nga ana jua.

Nga ana jonë nuk merret në konsideratë pretendimet nga ana juaj në bazë të argumenteve e dokumentacionit të paraqitur, dhe ngarkohen me përgjegjësi

2.Gjetje nga auditimi: -Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:
Nga ana e Bashkisë Berat në asnjë rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet që janë paisur me leje minerale nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullosore që administrohen nga kjo bashki.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1368 datë 18.06.2009, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 (shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1694 datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 (njëmbëdhjetë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,310,000 lekë
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1379 datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7(gjashtëmbëdhjetë.shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 20,207,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "P." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1359 datë 08.06.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5(njëmbëdhjetë.pesë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,915,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "E." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1597 datë 19.11.2012, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2(nëntë.dy) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 11,132,000lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1101 datë 06.12.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7(shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6. Në gjashtë raste sipas aneksit B/2, në vlerën **75,504,000 lekë**.
2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Berat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara në vlerën **75,504,000 lekë** dhe lidhjen e kontratave me subjektet "B." me vlerë 8,470,000 lekë, "T." me vlerë 13,310,000 lekë , "B." me vlerë 20,207,000 lekë, "P." me vlerë 13,915,000 lekë ,"E." me vlerë 11,132,000lekë, "T." me vlerë 8,470,000 lekë.

Aneksi B/4/2

Nr	Nr Lejes	Data	Emri i Subjektit	Vendndodhja	Sipërfaqja ha	Tarifa lek/ha	Vlera 1 vit	Muaj shfrytëzimi	Vlera në lekë
1	1368	18.06.2009	"B."	Sinjë	7	440,000	3080000	33	8470000
2	1694	27.03.2014	"T."	Sinjë	11	440,000	4840000	33	13310000
3	1379	03.07.2009	"B."	Roshnik	16.7	440,000	7348000	33	20207000
4	1359	08.06.2009	"P."	Roshnik	11.5	440,000	5060000	33	13915000

5	1597	19.11.2012	"E."	Roshnik	9.2	440,000	4048000	33	11132000
6	1101	06.12.2009	"T."	Roshnik	7	440,000	3080000	33	8470000
			Totali		**62.4**		**27,456,000**		**75,504,000**

1)Dokumentet evidencat për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Berat, për periudhën e viteve, 2017,2018 dhe 9 mujori i vitit 2019.

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***:**Nga Bashkia Berat dhe në njësit administrative Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujori i vitit 2019 nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar. VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017, për arkëtimin e të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Berat.
Referuar kapitullit II, kapitullit III, pika 4, të VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, në të përcaktohet që:

II. Procedura për dhënien e autorizimeve
Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.
III. Pagesat
Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:
1. për lejet e tregtimit të llojit " A " 500 000 lekë
2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë
3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200000 lekë
4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm l00 000 lekë
5. për autorizime për njësitë e lëndeve djegëse 50000 lekë.
Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave te mësipërme.

Referuar kapitullit II, pikës 1; germës "b" të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj "i ndryshuar, në të përcaktohet që:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë
1.Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:
b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.
9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës ***dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera****.*
- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me vkm nr.344, dt. 19.4.2017.
"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.".
10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.
- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me vkm nr.344, dt. 19.4.2017.
"10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe ***100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."***
"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.
15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.".

Sipas evidencës së paraqitur më datën 03.09.2019 nga përgjegjësi i njësive administrative për taksat vendore dhe drejtoresha e shërbimeve, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Berat dhe në Njësitë Administrative në vartësi Otllak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik, na u paraqit një pasqyrë me 24 subjekte që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, nga kërkesa e bërë nga ana jonë na u vunë në dispozicion vetëm 3 dosje nga drejtoria e shërbimit dhe protokoll-arkivit, ku u verifikuan për pagesat për dhënien dhe

përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante. Tarifa është 5,000,000 (pesë milionë) lekë për subjektet që ushtrojnë aktivitetin me vendndodhje në territorin në administrim të Bashkisë Tiranë dhe 2,000,000 (dy milion) lekë për bashkitë e tjera, të përcaktuara në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*", **i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; gërma "b" dhe pika 9.**

Auditimi u krye për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Berat, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujori i vitit 2019.

Në lidhje me auditimin e kryer, mbi legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, **u konstatua se:**

Nga Bashkia Berat për vitin 2018-2019 janë pajisur me licenca/autorizime të reja subjekti "E." shpk me nipt J72603156E më datën 12.11.2018 ku është arkëtuar tarifa 1.000.000 lekë dhe subjekti "T." shpk me nipt K42526065P është paisur me licenca/autorizim më datën 18.01.2019 dhe po atë datë është bërë arkëtimi i shumës 1.000.000 lekë, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Në vijim paraqiten subjektet sipas vendndodhjes ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të biznesit dhe nipti përkatës, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë të Bashkisë Berat sipas aneksit nr.1

Aneksi nr.1 Pasqyra e subjekteve periudha e viteve 2017-2018 dhe 9 mujori 2019 .

Nr	Emri Shoqërisë	NIPTI	Vendndodhja
1	L.	L23026001T	Lagj; Barrikade
2	E. SH.P.K	J72603156E	Lagj; Kushtrim
3	T. SH.P.K	K42526065P	Rr.Santa Lucia
4	S.	J62904029O	Dyshnik
5	A.	L32204031E	Lapardha 1
6	B.	L42928001K	Lapardha 1
7	H.	L33004001C	Rruga nacionale
8	I.	K32513111D	Morave
9	G.	K66801001T	Uznovë
10	G.	K66801001T	Lagj Barikadë
11	C.	K93213001M	Bilce
12	E.	K82906001S	Velabisht
13	K.	K83328001U	Bilce
14	P.	L43226001E	Velabisht
15	K.	L53023001H	Velabisht
16	O.	J63423463I	Dyshnik
17	K.	J61813529P	Orizaj
18	A.	J68612113I	Lagj; Cenollarët
19	O.	L91706037M	Lagj; Muzakaj
20	G.	L73308004N	Morav-Otllak
21	U.	L02702001I	Lapardha
22	L.Sha	K13527201D	Lagj; Çlirim
23	M. Ç.	L82702003J	Lagj;Donika Kastrioti
24	A. H.	K83431001P	Lagj;Uznovë

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas aneksit nr.1/1

Aneksi nr.1/1 Pasqyra përmbledhëse e subjekteve që nuk ka likuiduar tarifën e licencimit/autorizimit

Nr	Emri Shoqërisë	NIPTI	Vendndodhja	Detyrimi	Arsyeja	Arkëtuar	Diferenca lekë
1	S.	J62904029O	Dyshnik	1.000.000	Punon pa autorizim 1.4.19	-	**1.000.000**
2	H.	L33004001C	Lapardha	1.000.000	Punon pa autorizim 18.7.14	-	**1.000.000**
3	B.	L42928001K	Lapardha	1.000.000	Punon pa autorizim 29.5.15	-	**1.000.000**
4	L.	L23026001T	Berat	1.000.000	Punon pa autorizim 2.6.19	-	**1.000.000**
5	A.	L32204031E	Lapardha	1.000.000	Punon pa autorizim 26.4.18	-	**1.000.000**
6	I.	K32513111D	Morave	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
7	G.	K66801001T	Uznovë	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
8	G.	K66801001T	Berat	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
9	C.	K93213001M	Bilce	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
10	K.	K83328001U	Bilce	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
11	O. Shpk	J63423463I	Dyshnik	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
12	A.	J68612113I	Berat	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
13	O.	L91706037M	Berat	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
14	G.	L73308004N	Otllak	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
15	E.	K82906001S	Velabisht	1.000.000	Punon pa autorizim	-	**1.000.000**
16	U.	L02702001I	Lapardha	100.000	Punon pa autorizim	-	**100.000**
17	M. Ç.	L82702003J	Berat	100.000	Punon pa autorizim	-	**100.000**
18	A. H.	K83431001P	Berat	100.000	Punon pa autorizim	-	**100.000**
Totali							**15,300,000**

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Këshilli i Bashkisë ka nxjerr vendimi nr.3, datë 20.01.2016 për disa ndryshime për licencimin në tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, ku ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë Veterinarisë dhe Kadastrës. Nga Kryetari i Bashkisë është nxjerrë urdhër i brendshëm nr. 691, datë 11.10.2016 e cila është ndryshuar me urdhrin nr. 5179 prot, datë 14.08.2018 për ngritjen e komisionit për zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Gjithashtu është nxjerrë vendimi i këshillit bashkiak nr.37, datë 26.02.2019 për licencat për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre për tarifat dhe ku përcaktohet për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Emergjencave Civile, Shërbimeve dhe Pronave, Drejtoria e Taksave dhe Tregjeve, ky vendim i shtrin efektet juridike nga data 01.01.2019. Edhe pse ushtrojnë aktivitet në këtë bashki nuk është ndjekur dhe zbatuar ky urdhër dhe vendim për të aplikuar dhe likuiduar tarifën e liçensimit për tregtimin me pakicë të karburanteve nga ky komision dhe drejtorit përkatëse, në shkelje të VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9.

II. PROCEDURA PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNG-SHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTE DHE LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË 1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve,

për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga: b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.
a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto;
c) Certifikatën e përdorimit të objektit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit;
ç) Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës; dh) Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin;
e) Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës; ë) Regjistrimin e markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave; f) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore; g) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore.
3. Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore. Personi juridik, që kërkon të pajiset me këtë licencë, duhet të paraqesë, në njësitë e qeverisjes vendore, dokumentet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "ç" e "dh", të pikës 2, të këtij kreu, si dhe certifikatën e kalibrimit të enëve dhe të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit.
4. Organet që kanë përgjegjësi për dhënien e licencave, sipas këtij kreu, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.
VKM nr.344, dt. 19.4.2017 kapitulli II, pika 1; germa "b", të trajtuara në aneksin nr.1/1, kjo ka sjell **dëm ekonomik në të ardhura të munguara e të pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Berat, në vlerën 15,300,000 lekë.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar neni 35.
2)VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.
3)VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9.
VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9.
"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Vlera prej 15,300,000 lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim të tarifave të autorizimeve / licencave, për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të konsiderohet si dëm ekonomik në të ardhura të munguara e të pa planifikuar për Buxhetin e Bashkisë Berat.

Pika B/4. *"Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;*

1. Nga KLSH është konstatuar se në pikën B/4, nga krijimi i të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Berat për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave, për periudhën e viteve, 2017,2018 dhe 9 mujori i vitit 2019

Situata:	Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.606/1 prot, datë 26.08.2019 nga ana e Bashkisë Berat, nuk është arkëtuar shuma 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë,
Kriteri:	-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9.
Impakti:	-Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.
Shkaku:	Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse dhe në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e bashkisë.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	Bashkia Berat të marri masa të menjëhershme që të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9.

1-Komente dhe sqarime të subjektit: *paraqitur me shkresën me nr. 4977/23, datë 10.10.2019 nga ana e z. F. Rr..*

*Në Vendimin e Këshillit Bashkiak **me nr. 3 date 20.01.2016** për disa ndryshime në vendimin nr. 57 datë 28.12.2015 "Për Autorizimin/Lincensimin në tregtimin të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Veterinaris. Kjo drejtori është e rregjistruar në drejtorinë ë Tatimeve Dega Berat në datën **03.02.2016 me nr nipti L62603131V** dhe emërimet e para si pozicioni i Drejtuesit të Drejtorisë dhe punonjësit mbështetës janë rregjistruar në datën 16.02.2016 (bashkalidhur dokumentat te printuara nga sistemi i tatimeve). Pra Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 3 datë 20.01.2016 ka dalë me

herët se Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Veterinaris të rregjistrohej në Drejtorinë ë Tatimeve Dega Berat

* Në zyrën e arkiv protokollit të Bashkisë Berat janë tërhequr fotokopje të librit të protokollit të vitit 2016 si dhe fotokopje të librit të dorëzimit në postë te materialeve dhe nuk është asnjë material ose vendimi nr 3 datë 20.01.2016 , për njohje dhe zbatim Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Veterinaris (bashkalidhur dokumente të fotokopjuara nga arkiva e Bashiksë Berat)

* Nuk jam njoftuar dhe as kam patur dijeni për vendimin nr 3 të Këshillit Bashkiak datë 20/01/2016 pasi në regjistrin e prot, të Drejtorisë së Bujqësisë Administrimit Pyjeve Ujërave & Shërbimit Veterinar nuk ka të protokolluar shkresë në të cilin të vërtetohet që është depozituar për zbatim vendimi nr 3 i Këshillit Bashkiak datë 20/01/2016. (regjistri i protokollit fillon në datë 09/03/2016

Në zyrën e arkivës së kësaj drejtorie është krijuar libri i parë i protokollit i cili fillon me numër rendor nr .1 dhe datë 09.03.20196 dhe nuk rezulton që vendimi nr 3 datë 20.01.2016 të ketë ardhur për dijeni dhe zbatim (bashkalidhur dokumente të fotokopjuara nga arkiva e drejtorisë).

2- ***Komente dhe sqarime të subjektit:*** *paraqitur me shkresën me nr. 4977/16, datë 09.10.2019 nga ana e z. Ermal Dollani ku ngre të njëjtat pretendime për mos njoftimin e këtij vendimit këshillit bashkiak nr.3 datë 20.01.2016në mënyrë shkresore, këto të bashkëlidhur me dokumentacionin e observuar në drejtim të KLSH-së.*

3- ***Komente dhe sqarime të subjektit:*** *Paraqitur me shkresën me nr.4977/19, 4977/20, 4997/22, datë 10,11-10.2019 nga ana e znj.N. K., S. Dh., Ç. B., L. A., R. F.,E. N.,D. S. e H. M. pretendojnëse komisioni "Për zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngëshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim për konsumatorët fundor, të ngritura me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.3 dhe 691 kanë patur si detyrë zbatimin e procedurës për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngëshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim për konsumatorët fundor, bazuar në VKM nr.970, datë 2.12.2015 i ndryshuar. Komisjoni nuk ka përgjegjësi për subjektet e palicencuara që tregëtojnë karburante tek konsumatorët fundorë, për shkak se nuk kanë qenë objekt i punës sonë. Ky komision shqyrtonte vetëm kërkesat e paraqitura nga subjektet juridike. Përsa i përket VKB nr.37, datë 26.02.2019 nuk kemi njoftim për këtë drejtori DECSHP.*

4- ***Komente dhe sqarime të subjektit:*** *Paraqitur me shkresën nr. 4977/1, 4977/2, 4977/3, 4977/4, 4977/5, 4977/6, 4977/7, 4977/8, 4977/9, 4977/10, 4977/11, 4977/12, 4977/13, 4977/14, 4977/15, 4977/17, 4977/18, 4977/21,datë 9,10-10.2019 nga ana e S. T., E. Ç., E. P., K. Sh., T. E., S. V., V. Z., G. Xh., R. F., G. Q., S. R., Xh. M., O. L., Z. Z., B. T., M. H., L. M. e H. A. pretendojnë se d*etyrat dhe funksionet janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të drejtorisë. Kjo detyrë nuk është e përcaktuar në funksionet e kësaj drejtorie në këtë rregullore. Pra nuk është detyra jonë funksionale për mbledhjen dhe administrimin e kësaj taksë.

Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.37 datë 26.02.2019 Për disa ndryshime në Vendimin Këshillit Bashkiak nr.57 datë 28.12.2015 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat", i ndryshuar, drejtoria e taksave dhe tarifave nuk është njojtur dhe nuk kemi marrë dijeni për këtë vendim, por jemi njohur me anë të akt konstatimit tuaj.

<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:</u> *-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga personat e mësipërm, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim* ***se vlera 15,300,000 lekë qëndron*** *dhe duhet të mblidhet e të arkëtohet nga ana e bashkisë****,*** *ndërsa marrin në konsideratë pretendimet e tyre në lidhje me përgjegjësin e detyrave funksional në bazë të argumenteve e dokumentacionit të paraqitur, e cila do të trajtohen dhe reflektohen në projektraport.*

<u>Situata:</u>	*Në Bashkinë Berat për vitin 2017 ka funksionuar Drejtoria e Tatim Taksave, ku janë miratuar në organikë 15 punonjës në bazë të vendimit nr. 890, datë 23.12.2016, për vitin 2018 në bazë të vendimit nr.855, datë 30.11.2017 ky sektor është emëruar në drejtori me 1 Drejtor i Drejtorisë së Taksave e Tarifave, 1 në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit dhe 3specialist për kontrollin në terren dhe 17 specialist dhe agjent të taksave e tarifave në njësitë administrative, për vitin 2019 në bazë të vendimit nr.925, datë 26.11.2018 kjo drejtori ka funksionuar me 1 Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave, 8 specialist të taksave nga këta 1 është përgjegjës i sektorit dhe 12 specialist të taksave për njësit administrative, nga këta 1 është përgjegjës i sektorit. Për vitin 2019 Drejtoria e të Ardhurave përbëhet nga 21 punonjës. Aktualisht kjo drejtori funksionon pa drejtor të taksave dhe tarifave nga data 20.08.2019. Pasqyra e realizimit të të ardhurave për vitin 2017 në total është realizuar 86,4% ose 57,530 mijë lekë më pakë. Për vitin 2018 realizimi i të ardhurave ka qenë 66% ose 170,825 mijë lekë. Për të dyja vitet së bashku kemi mos realizime më pakë 228,355mijë lekë. *Për vitin 2018 janë me mosrealizim: 1) Taksat mbi ndërtesat dhe tabelat, është për arsye se ndryshoi Ligji 106/2017 datë 30.11.2017, i cili e ka filluar efektin nga data 1 prill 2018. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave e kishte planifikuar të ardhurat me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshime. 2.Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin është agjent Drejtoria Rajonale Tatimore Berat 3.Taksa mbi tokën bujqësore është me mos realizim për arsye se:Falja e detyrimeve të prapambetura për vitet 2003-2010, ndikojë negativisht për realizimin e taksës së tokës, sepse baza e mbledhjes së taksës ishte llogaritur mbi debitorët të cilët u falën detyrimet. 4. Taksa e truallit është me mos realizim pasi planifikimi i vitit 2018 nuk është realisht pasi edhe pse në 2017 nuk është realizuar, është bërë planifikim me rritje plani. 5.Tarifat vendore (ndriçim, gjelbërim, pastrim) një efekt në mos realizim ndikon mbyllja e biznesve si pezullimi i tyre. *Për vitin 2019 (nëntë mujori). Niveli i ulët i arkëtimeve për taksën e tokës është nga migrimi i familjeve bujqësore drejt qëndrave urbane, dhe nuk ka adresa të sakta të vendbanimit të tyre.

	Në lidhje me realizimin e planit të të ardhurave për taksën e tokës, taksën e ndërtesës dhe taksën e truallit, pritet të rriten arkëtimet për periudhën Shtator –Tetor –Nëntor –Dhjetor 2019 pasi edhe të ardhurat e familjeve bujësore janë në këtë periudhë. Nga të dhënat e marra nga inspektorët e njësive administrative Otllak, Velabisht, Sinjë,dhe Roshnik për periudhën shtator 2019 të ardhurat nga taksa e tokës, ndërtesës, truallit janë në vlerën 893,364 lekë, gjithashtu për muajin tetor kemi një rritje të arkëtimeve për këto taksa në vlerën 2,270,589 lekë. Të ardhurat nga taksa e hapësirës publike nga subjektet që shfrytëzojnë hapësirën publike, për 6 mujorin e dytë, ka pritshmëri të rritet pasi pagesa për këtë taksë nga subjektet kryhet në këtë periudhë. Për sa i përket tarifave vendore, (ndricim, gjelbërim, pastrim) këto tarifa pritet të kenë realizim pasi kjo është një tarifë që mblidhet nga ujësjellësi për Bashkinë Berat. *Më datën 30.09.2019 Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në shkallë bashkie Berat janë në shumën **prej 267,055,110** lekë, e cila përfaqëson:* *-563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh,në vlerën 68,838,416 lekë* *-10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë* *-Për taksën e ndërtimit,tarifat e pastrimit në vlerën **135,403,069 lekë**, nga të cila:* *- rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Berat.* *- 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,* *-700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastruktrurë për vlerën 26,225,134 lekë.* *Nga ana e 4 Njësive administrativë të Bashksië Berat , Otllak, Velabisht, Sinjë,dhe Roshnik sipas programit të auditimit, administratorët e Njësive Administrative, edhe pse nuk e kanë në kopetencë kanë nxjerë njoftim vlerësimet tatimore ndaj subjekteve Juridike dhe fizike. <u>Në kundërshtim me:</u> **a.** ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ”*Për sistemin e taksave vendore*”, neni 4-Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika **2**, <u>ku parashikohet se</u>**:** Zyra e taksave të bashkisë apo komunës vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin,nr. 9920, datë 19.5.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **b**. ligjin,nr. 9920, datë 19.5.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3, kupërcaktohet se: Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël. Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga drejtoria rajonale tatimore. ***Për mos ndjekjen e procedurave ligjore dhe nënligjore për arkëtimin e vlerës debitorëve më datën 30.09.2019 në shumën 267,055,110 lekë, ngarkohen me***

	përgjegjësi ish punonjësit dhe punonjësit e Drejtorisë Taksave dhe njëisve administrative si më poshtë:: **I.Bashkia Berat** **Z. R. F.** me detyrë ish/Drejtor i të Ardhurave nga periudha 30.07.2018-20.08.2019 **Znj. N. Ç.** me detyrë ish/Drejtor i të Ardhurave nga periudha 13.09.2016-29.06.2018 **Z. F. B.** me detyrë ish/ agjent taksash dhe administrator lagje nr.2 nga periudha 2014-05.08.2019 **Znj. K. K.** me detyrë ish/ agjent taksash nga periudha 2014-23.01.2019 **Znj.A. F.** me detyrë ish/ agjent taksash nga periudha 2014-11.03.2019 **Z. S. R.** me detyrë ish/specialist i të ardhurave nga periudha 2015-01.01.2019 **Z. I. B.** me detyrë ish/specialist i taksës nga periudha 19.11.2018-11.03.2019 **Z.S. V.** me detyrë specialist i taksave për rregjistrim nga 2017 e në vazhdim **Znj. E. P.** me detyrë inspektore terreni nga viti 2017 e në vazhdim **Z.E. Ç.** me detyrë inspektore terreni nga viti 2017 e në vazhdim **Z.T. E.** me detyrë specialist i taksës së ndërtesës nga 19.4.2017 e në vazhdim **Z.G. XH.** me detyrë specialist i taksës nga viti 2017 e në vazhdim **Z.H. L.** me detyrë agjent parkimi nga periudha 09.01.2018 e në vazhdim **Z. K. SH.** me detyrë agjent parkimi nga periudha 30.08.2018 e në vazhdim **Z.L. M.** me detyrë përgjegjës sektori për njësit administrative nga periudha 2017 e në vazhdim II. **Njësia Administrative Otllak** **Z.L. E.** me detyrë administrator nga periudha 2016- 02.08.2019 **Znj. A. P.** me detyrë ish/ specialist taksave nga periudha 11.07.2018-25.10.2018 **Z.G. Q.** me detyrë specialist i taksës 11.03.2019 e në vazhdim **Z.Z. Z.** me detyrë specialist i taksës para 2017 e në vazhdimësi **III.Njësia Administrative Velabisht** **Z.M. A.** me detyrë administrator nga periudha 2017-31.07.2019 **Z. Sh. H.** me detyrë administrator nga periudha 31.07.2019 e në vazhdimësi **Znj.M. H.** me detyrë specialist i taksës para 2017 e në vazhdimësi **Z.B. T.** me detyrë specialist i taksës nga periudha 01.01.2017 e në vazhdim **IV.Njësia Administrative Sinjë** **Z. M. H.** me detyrë ish/ specialist taksave nga periudha 01.01.2017-14.05.2018 **Z.Xh. M.** me detyrë specialist i taksës para 2017 e në vazhdimësi **Z.O. L.** me detyrë specialist i taksës nga periudha 15.05.2018 e në vazhdim **V.Njësia Administrative Roshnik** **Z.A. SH.** me detyrë administrator nga periudha 20.01.2016-05.08.2019 **Z.H. A.** me detyrë specialist i taksës para 2017 e në vazhdimësi
Kriteri:	Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ”*Për sistemin e taksave vendore*”, neni 4-Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 2; neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3; *Neni 114-Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit, pika 1;*
Impakti:	Menaxhimi i të ardhurave është jashtë kontrollit.
Shkaku:	Mos njohja e kuadrit ligjorë nga peronat përgjegjës..

Rëndësia:	**E lartë**.
Rekomandimi:	- Drejtoria e të Ardhurave Vendore **Bashkia Berat**, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën ***267,055,110*** **lekë**. Bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të **ndiqen rrugët e mëposhtme:** **a)** Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar *Nuk është vendosur masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet: *"..... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij*". *Nga ana e inspektorëve të Njësisë Administrative Otllak, Velabisht, Sinjë, dhe Roshnik nuk është vepruar sipas ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 2. *.....Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore*. *Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjitn 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet : " *Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit*".

1-Komente dhe sqarime të subjektit: *paraqitur me shkresën me nr. 5805/7, datë 22.11.2019 nga ana e z. T. E..*
Përsa i përket pozicionit tim të punës si agjent për taksat dhe tarifat vendore për familjarë në lagjen nr.2 në periudhën 18.04.2017-21.05.2018 periudhë të cilën kam punuar në atë pozicion ,kam nisur njoftim detyrimi disa here te debitorët familjarë me nr 4846 prot date 31.10.2017 gjithësej 100(njëqind) njoftime dhe njoftim detyrimi te debitorët familjarë me nr 5122 datë 14.11.2017 gjithësej 338 (treqind e tridhjetë e tetë) dhe kam kryer bllokime llogarie bankare

me nr prot 1156 date 01.03.2018 gjithësej 37 (tridhjetë e shtatë) ,pra kam zbatuar të gjitha proçedurat ligjore dhe nënligjore.

<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:</u> *-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se për periudhën në pozicionin si agjent për taksat dhe tarifat vendore për familjarë, pretendimet tuaja nuk merren në konsiderat, pasi nuk janë të argumentuara dhe nuk janë ndjekur të gjitha etapat e mbledhjes së borxhit tatimor në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

<u>2-Komente dhe sqarime të subjektit:</u> *paraqitur me shkresën me nr. 5805/8, datë 22.11.2019 nga ana e z. G. Xh.*

a- *Përsa i takon ndjekjes së procedurave ligjore dhe nënligjore për arkëtimin e vlerës së debitoreve, janë ndjekur procedurat e mëposhtme, në zbatim të nenit 90, të ligjit 9920"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1.Bllokimi i llogarive Bankare. si dhe në zbatim të nenit 91,të ligjit 9920"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"Pika2. Barra Siguruse dhe barra Hipotekore.*

<u>Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:</u> *-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk merren në konsiderat, pasi nuk janë të argumentuara dhe nuk janë ndjekur të gjitha etapat e mbledhjes së borxhit tatimor në neni. 93 ligji 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*

<u>3-Komente dhe sqarime të subjektit:</u> *paraqitur me shkresën me nr. 5805/9, datë 22.11.2019 nga ana e z. Xh. M..*

Në lidhje me përgjegjësinë time, përgjegjësi e cituar në këtë aktkonstatim nr 7 datë 15.11.2019 sqaroj se emërimi kam filluar punë si Specialist për Arkëtimet e Taksave dhe Tarifave në Njësine Administrative Sinjë duke filluar nga data 09.05.2016 deri më vazhdim .

Gjatë kësaj periudhe kam kryer detyrat e mia si Specialist për Arkëtimet e Taksave dhe Tarifave në Njësinë Administrative Sinjë te përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat.

Gjatë kësaj periudhe për mbledhjen e taksave dhe tarifave të familjeve debitore dhe të bizneseve debitoreve për vitet 2011-2017 janë kryer njoftim detyrimet për familjet debitorë si më poshtë:

Nr prot 35, 35/ 1-35/89 dt.23.01.2017 gjithsej 89 njoftime ; prot 36 -36/57 dt 25.01.2017 gjithsej 57 njoftime ; prot ; prot 160 -160/20 dt18.02.2017 gjithsej 21 njoftime , prot 495-495/11 dt 08.11.2017 gjithsej 12 njoftime, prot 500-500/58 dt 09.11.2017 gjithsej 59 njoftime, prot 536-536/32 dt 01.12.2019 gjithsej 33 njoftime, prot 553-553/72 dt11.12.2017 gjithsej 73 .

Noftim detyrimet për bizneset për vitin 2017

Prot 281 -283 dt 15.05.2017 gjithsej 3 njoftime ; prot. 293 – 293/4 dt 22.05.2017 gjithsej 5 njoftime ; prot 294/5 dt 22.05.2017 gjiyhsej 1 njotim ; prot 295/6 -295/7 dt 22.05.2017 gjiyhsej 2 njoftime ; 297-297/11 dt 25.05.2017 gjithsej 12 njoftime; prot 357-357/7 dt 19.07.2017 gjithsej 8 njoftime ; prot 363-365 , 365/1-365/2 dt 24.07.2017 gjithsej 5 njoftime ; prot 372 dt 31.07.2017 gjithsej 1 njoftim .

Për vitin 2018 janë kryer njoftim detyrimet për familjet si më poshtë :

Prot 263 -263/44 dt 31.05.2018 gjithsej 45 njoftime ; 315-315/19 dt 20.07.2018 gjithsej 20 njoftime ; 318-318/34 dt 23.07.2018 gjithsej 35 njoftime ; 349-349/101 dt 28.08.2015 gjithsej 102 njoftime ; 364-364/28 dt 14.09.2018 gjithsej 29 njoftime ; 380-380/40 dt 24.09.2018 gjithsej 41 njoftime ; 385/3-385/74 dt 04.10.2018 gjithsej 71 njoftime ;390-390/41 dt 03.10.2018 gjithsej 42 njofime .
Njoftim detyrimet për bizneset për vitin 2018 :
Prot 140-150 dt 13.02.2018 gjithsej 36 njoftime , prot 177-183 dt 06.04.2018 gjithsej 6 njoftime ; prot 188-192 dt 11.04.2018 gjithsej 5 njoftime ; prot 193-197 dt 13.04.2018 gjithsej 5 njoftime , prot 198-200 dt 13.04.2018 gjithsej 3 njoftime ; prot 203-206 dt 17.04.2018 gjithsej 4 njoftime; prot 244-253 dt 24.05.2018 gjithsej 8 njoftime.
Për periudhën 2011-2018 janë kryer bllokimi i nr të llogarive bankare për familjet si dhe bizneset debitore si vijon:
Urdhër bllokimi nr 4013 dt 14.09.2017 për familjet debitore gjithsej 96 familje urdhër bllokimi nr 4866 dt 31.10.2017 per bizneset debitore gjithsej 7 dhe urdher bllokimi per familjet debitore nr 5754 dt 14.12.2017 gjithsej 68 familje .
Për periudhen 2017-2018 janë vendosur barrë hipotekore dhe siguruese si më poshtë:
Barrë Siguruese Nr.187 prot dt 21.02.2017 gjithsej 14 biznese.
Barrë Hipotekore Nr.188 prot dt 21.02.2017 gjitjsej 14 biznese.
Barrë Siguruese Nr.209 prot 06.03.2017 gjithsej 1 biznes.
Barrë Hipotekore Nr. 542 prot dt 04.12.2017 gjithsej 6 biznese.
Barrë Siguruese Nr.543 prot dt 04.12.2017 gjithsej 7 biznese.
Barrë Hipotekore Nr.550 prot dt 06.12.2017 gjithsej 1 biznes.
Për vitin 2019 janë kryer njoftim detyrimet për familjet debitorë me nr 103/1-103/39 dt 19.04.2019 prot, gjithsej 39 njoftime dhe nr 141 -141/20 dt 30.05.2019 gjithsej 21 copë
Për vitin 2019 është kryer bllokimi i llogarive të subjekteve debitore me urdhër nr 5105 dt 07.10.2019 për 8 subjekte .
Për periudhën deri në fund të vitit ushtrimor jemi në punë e sipër për arkëtimin e të ardhurave nga familjet dhe bizneset edhe pse dihet se ka shume vështirësi pasi është zone e varfër dhe e thyer dhe ka shumë familje janë larguara nga fshati .

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH: *-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja nuk merren në konsiderat, pasi nuk janë të argumentuara dhe nuk janë ndjekur të gjitha etapat e mbledhjes së borxhit tatimor në neni. 93 ligji 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*

4-Komente dhe sqarime të subjektit:
Paraqitur me shkresën me nr. 5805/5, datë 22.11.2019 nga ana e z. V. Z.. Detyra ime në Drejtorinë e të Ardhurave për periudhën e viteve 2017-2018 dhe 9 mujori i vitit 2019 është Inspektorë mbledhës pagese për tregjet.

Qëndrimi i Audituesit Shtetëror të KLSH:
-Në lidhje me komentet dhe dokumentet e paraqitura nga ana juaj, audituesit e KLSH-së dalin në përfundim se pretendimet tuaja merren në konsiderat, pasi mbi bazën e Rregullores së Brendshme të miratuar me Urdhër nr. 444, datë 14.04.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë" për vitin 2017 si edhe Rregullores së Brendshme të miratuar me shkresës nr. 721, datë 07.02.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë" për vitin 2018 e 2019.

5-Komente dhe sqarime të subjektit: *paraqitur me shkresën me nr. 5805/6, datë 22.11.2019 nga ana e z. M. H..*
Gjatë kësaj periudhe kam kryer detyrat e mia si Agjent për Arkëtimet e Taksave dhe Tarifave në Njësinë Administrative Sinjë te përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Berat.
Gjatë kësaj periudhe për mbledhjen e taksave dhe tarifave të familjeve debitore dhe të bizneseve debitoreve për vitet 2011-2017 janë kryer njoftim detyrimet për familjet debitorë si më poshtë:
Nr prot 35, 35/ 1-35/89 dt.23.01.2017 gjithsej 89 njoftime ; prot 36 -36/57 dt 25.01.2017 gjithsej 57 njoftime ; prot ; prot 160 -160/20 dt18.02.2017 gjithsej 21 njoftime , prot 495-495/11 dt 08.11.2017 gjithsej 12 njoftime, prot 500-500/58 dt 09.11.2017 gjithsej 59 njoftime, prot 536-536/32 dt 01.12.2019 gjithsej 33 njoftime, prot 553-553/72 dt11.12.2017 gjithsej 73 .
Noftim detyrimet për bizneset për vitin 2017
Prot 281 -283 dt 15.05.2017 gjithsej 3 njoftime ; prot. 293 – 293/4 dt 22.05.2017 gjithsej 5 njoftime ; prot 294/5 dt 22.05.2017 gjiyhsej 1 njotim ; prot 295/6 -295/7 dt 22.05.2017 gjiyhsej 2 njoftime ; 297-297/11 dt 25.05.2017 gjithsej 12 njoftime; prot 357-357/7 dt 19.07.2017 gjithsej 8 njoftime ; prot 363-365 , 365/1-365/2 dt 24.07.2017 gjithsej 5 njoftime ; prot 372 dt 31.07.2017 gjithsej 1 njoftim .
Për vitin 2018 janë kryer njoftim detyrimet për familjet si më poshtë :
Prot 263 -263/44 dt 31.05.2018 gjithsej 45 njoftime ; 315-315/19 dt 20.07.2018 gjithsej 20 njoftime ; 318-318/34 dt 23.07.2018 gjithsej 35 njoftime ; 349-349/101 dt 28.08.2015 gjithsej 102 njoftime ; 364-364/28 dt 14.09.2018 gjithsej 29 njoftime ; 380-380/40 dt 24.09.2018 gjithsej 41 njoftime ; 385/3-385/74 dt 04.10.2018 gjithsej 71 njoftime ;390-390/41 dt 03.10.2018 gjithsej 42 njofime .
Njoftim detyrimet për bizneset për vitin 2018 :
Prot 140-150 dt 13.02.2018 gjithsej 36 njoftime , prot 177-183 dt 06.04.2018 gjithsej 6 njoftime ; prot 188-192 dt 11.04.2018 gjithsej 5 njoftime ; prot 193-197 dt 13.04.2018 gjithsej 5 njoftime , prot 198-200 dt 13.04.2018 gjithsej 3 njoftime ; prot 203-206 dt 17.04.2018 gjithsej 4 njoftime; prot 244-253 dt 24.05.2018 gjithsej 8 njoftime.
Për periudhën 2011-2018 janë kryer bllokimi i nr llogarive bankare për familjet si dhe bizneset debitore si vijon:
Urdhër bllokimi nr 4013 dt 14.09.2017 për familjet debitore gjithsej 96 familje urdhër bllokimi nr 4866 dt 31.10.2017 për bizneset debitorë gjithsej 7 dhe urdhër bllokimi për familjet debitore nr 5754 dt 14.12.2017 gjithsej 68 familje .
Për periudhen 2017-2018 janë vendosur barrë hipotekore dhe siguruese si më poshtë:
Barrë Siguruese Nr.187 prot dt 21.02.2017 gjithsej 14 biznese.
Barrë Hipotekore Nr.188 prot dt 21.02.2017 gjitjsej 14 biznese.
Barrë Siguruese Nr.209 prot 06.03.2017 gjithsej 1 biznes.
Barrë Hipotekore Nr. 542 prot dt 04.12.2017 gjithsej 6 biznese.
Barrë Siguruese Nr.543 prot dt 04.12.2017 gjithsej 7 biznese.
Barrë Hipotekore Nr.550 prot dt 06.12.2017 gjithsej 1 biznes.

Nga auditimi u konstatua se financa nuk ka aplikuar veprimet për të regjistruar në kontabilitet, fillimisht fondet (korrente dhe kapitale) te akorduara nga buxheti dhe me pas te regjistroje përdorimin apo mos përdorimin e tyre nëpërmjet llogarisë kalkulative 476 e cila po te aplikohej dhe analitike sipas programeve buxhetore do te siguronte evidencë te sakte në cdo moment mbi ndjekjen jo vetëm te përdorimit por dhe te sigurimit te fondeve, sipas kërkesave të pikës 15 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" gjithashtu evidentohet mospërputhje me kërkesat e udhëzimit sa më sipër edhe në drejtim të njohjes së detyrimeve dhe të ardhurave në momentin e lindjes së tyre pasi nga financa evidentimi dhe regjistrimi kanë ndodhur në momentin e dorëzimit të faturës dhe jo aktit kur lind detyrimi.

D. /1,2,3, 5

Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".

1.1- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

-Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, ku konstatuan shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar.

-Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 30.9.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

-Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 30.9.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017-30.6.2019, konstatohet se janë kryer gjithsej **64** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej **1,147,489,964 lekë** dhe vlerë kontrate të lidhur prej **1,065,715,325 lekë**, me një diferencë prej 81,774,638 lekë ose mesatare ulje prej rreth 7%.

-Për vitin 2017, janë zhvilluar gjithsej 27 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 488,919,731 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 453,458,311 lekë me diferencë nga FL në vlerën **35,461,420 lekë**, nga të cilat 13 procedura të llojit tender i hapur, 10 procedura të llojit kërkesë për propozim dhe 4 procedura me negocim pa shpallje paraprake.

-Për vitin 2018, janë zhvilluar gjithsej 27 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 249,636,491 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 221,410,495 lekë me diferencë nga FL në vlerën **28,225,996 lekë**, nga të cilat 7 procedura të llojit tender i hapur, 20 procedura të llojit kërkesë për propozim dhe nuk ka procedura me negocim pa shpallje paraprake.

-Për 9 mujorin e viti 2019, janë zhvilluar gjithsej 10 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 408,933,742 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 390,846,520 lekë me diferencë nga FL në vlerën **18,087,222 lekë**, nga të cilat 5 procedura të llojit tender i hapur, 5 procedura të llojit kërkesë për propozim dhe nuk ka procedura me negocim pa shpallje paraprake.

Të dhëna mbi procedurat e prokurimit	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	TOTALI
Prokurime gjithsej……	27	27	10	64
Vlera totale e fondit limit te prokuruar	488,919,731	249,636,491	408,933,742	1,147,489,964
Procedura të hapura……	13	7	5	26
Procedura kërkesë për propozim……	10	20	5	34
Me negocim pa shpalle……	4	0	0	4
Marrin pjesë Operatorë ekonomikë……	111	129	43	283
S`kualifikuar Operatorë ekonomikë……	49	53	22	124
Vlera e ofertave të fituara……	453,458,311	222,093,833	390,846,520	1,066,398,664
Diferenca nga fondi limit……	35,461,420	27,542,658	18,087,222	81,091,300
Procedura të audituara…….	20	14	6	40
Vlera e audituar……	460,143,132	218,657,666	394,170,389	1,072,971,187
% e audituar	94%	88%	96%	

Në totalin e procedurave të planifikuara për periudhën 01.01.2019 – 30.9.2019, konstatohet se nga AK janë zhvilluar gjithsej 5 procedura deri në 30.09.2019 të cilat janë anulluar nga AK, me fondin limit në shumën 68,611,900 lekë pa tvsh dhe fondin e fituar në shumën 27,869,991 lekë pa tvsh. Pas shpalljes së fituesit nga ana e KVO-së dhe përfundimit të procedurës së ankimimit, AK nuk ka vazhduar më tej me fazën e lidhjes së kontratës siç është parashikuar në LPP por ka vendosur anullimin e procedurave të prokurimit.

Për këto procedura bazuar në Urdhërin e Kryetarit me nr. 589 protokolluar me nr. 4224 prot., datë 14.08.2019 është urdhëruar anullimi i tyre për shkak të mungesës së fondeve dhe situatës problematike që shqaf 6-mujori i dytë i vitit 2019 duke u nisur nga MEMO me nr. 4154 prot., datë 08.08.2019 e Drejtorisë së Financave në lidhje me situatën financiare të Bashkisë Berat. Nga ana e AK është hatuar për çdo procedurë Formulari Nr. 3 dhe pasqyruar në SEP anullimi i procedurave të sipërcituara. Nga ana e OE të shpallur fitues deri në momentin e mbajtjes së Akt-Verifikimit nuk është bërë asnjë ankesë pranë AK apo gjykatës për anullimin e procedurës.

Procedurat e anulluara me të dhënat si më poshtë:

Nr	Objekti prokuruar	Fondi limit pa TVSH në leke	Oferta fituese	Arsyeja e anulimit
1	Rikonstruksion i Rrugëve dhe Qendres në Fshatin Bilçë, Njësia Administrative Velabisht" Bashkia Berat ”	12,447,248	”F. ” SHPK me Vlerë 8,521,341 lekë	Mungesë likujditeti
2	Mirembajtje per Projektin “Shqiperia Dixhitale”	7,182,000	”A.” SHPK me Vlerë 7,170,000 lekë	Mungesë likujditeti
3	Blerje Mjeti per transport personash me aftesi te kufizuar 8+1 vende per nevojat e Qendres Rezidenciale “ Lira” Bashkia Berat”	1,491,000	”A.” SHPK me Vlerë 1,470,000 lekë	Mungesë likujditeti
4	“Rikonstruksion i rruges Shyqyri Lakra, segmenti i rruges "Abedin Qafoku " deri te rruga "Riza Nebati”	14,656,202	”M.” SHPK me Vlerë 10,708,650 lekë	Mungesë likujditeti
5	“Rehabilitim I Skemes Ujitese Mbreshtan”,Bashkia Berat	32,835,450	KVO ka skualifikuar gjithë OE	Mungesë likujditeti
Procedurat e vitit 2019		**68,611,900**		

<u>Problematika të përgjithshme të evidentuara në procedurat e prokurimit:</u>

- Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet e mbajtura nga NJHDT dhe KVO nuk janë protokolluar, veprim në mospërputhje me nenin 18, “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”**.**

-Pjesa më e madhe e dosjeve të audituara rezultuan se nuk ishin të inventarizuar dhe të numëruara, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36.

-Në dosjet e tenderit rezultoj se:

- mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),
- mungon Proçes Verbali i pezullimit të porcedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,

Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :”... Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës.

-Në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ky procesverbal i vihet në dispozicionpersonit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

1.2-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore

Për aktivitetin e vitit 2017.

Për aktivitetin e vitit 2017, nga Bashkia Berat janë kryer gjithsej **27** procedura prokurime me vlera të larta, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

në mijë lekë

EMËRTIMI	VLERA	Në % ndaj fondit
Fondet prokuruar gjithsej		
Nga të cilat		
- Në fushën e ndërtimit	*309,769*	*63%*
-Në fushën e blerje mallrave	*42,061*	*9%*
-Në fushën e shërbimeve	*137,090*	*28%*
Financim nga Buxheti i shtetit	**249,897**	*51%*
Financime nga Bashkia	**239,023**	*49%*

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se 49% e financime janë nga të ardhurat e Bashkisë Berat dhe 51 % janë me destinacionit (grande të kushtëzuara), nga Buxheti i Shtetit.

Për aktivitetin e vitit 2018

Për aktivitetin e periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018, nga Bashkia Berat janë kryer gjithsej **27** procedura prokurime me vlera të larta, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

EMËRTIMI	VLERA	Në % ndaj fondit
Fondet prokuruar gjithsej		
Nga të cilat		
- Në fushën e ndërtimit	*214,416,812*	*86%*
-Në fushën e blerje mallrave	*25,817,814*	*10%*
-Në fushën e shërbimeve	*9,402,298*	*4%*
Financim nga Buxheti i shtetit		
Financime nga Bashkia	**249,636,924**	

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se të gjitha financimet janë nga të ardhurat e Bashkisë Berat.

Për aktivitetin 01.01.2019 – 30.9.2019

Për aktivitetin e periudhën 01.01.2019 – 30.09.2019, nga Bashkia Berat janë kryer gjithsej **10** procedura prokurime me vlera të larta, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

EMËRTIMI	VLERA	Në % ndaj fondit
Fondet prokuruar gjithsej		
Nga të cilat		
- Në fushën e ndërtimit	*69,900,593*	*17%*
-Në fushën e blerje mallrave	*15,805,174*	*4%*
-Në fushën e shërbimeve	*323,227,975*	*79%*
Financim nga Buxheti i shtetit		
Financime nga Bashkia	**408,933,742**	

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se të gjitha financimet janë nga të ardhurat e Bashkisë Berat.

D/1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Për aktivitetin e vitit 2017

Nga **27** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 488,919,731 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **20** procedura me vlerë kontrate prej 513,903 mijë lekë, ose 94% e totalit të kontratave, ku **6** procedura ose rreth 30% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **6,233,383 lekë**.

I. Titulli gjetjes: Në **6** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 01.01.2017 – 31.12.217**.**

1. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* "Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit "Tomorri" në bulevardin Republika "

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit "Tomorri" në bulevardin Republika "		
1.Urdhër Prokurimi nr.16, datë 28.02.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit të kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.I. G.(Jurist) 2.E. N. (Arkitekt) 3.E. S. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr 17 date 28 .02.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 72,480,695 lekë	**6.Oferta fituese**: " Z." shpk Vlera 70,247,274 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,233,521 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 01.04.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 5 OE b)S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: **Po**	**12. Përgjigje ankesës nga AK** **Po**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: Jo**
		Dt lidhjes kontratës: 10.05.2017 **Afati kontratës: 200 ditë**

Situata:

-Kriteret e vendosura nga NHDT nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e sa më shumë subjekteve pasi janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se OE "Z.", nuk plotëson një nga kriteret e vendosura në DST ndërkohë oferta e paraqitur nga OE B. duhet të konsiderohej e vlefshme , konkretisht:

- Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga OE për pikën 6 "skeleri suvatimi" 2000m2 nuk plotësohen pasi në sisitemin elektronik ndodhen fatura tatimore me nr serial 37935311 datë 03.08.2007 ku janë të përshkruara 1800 m2 skeleri dhe fatura tatimore me nr. Serial 41054904 datë 15.12.2008 ku janë të përshkruara 73 palë "skela hekuri". Pra siç dhe mund të vihet re OE nuk i përmbush përcaktimet e veçanta të vendosura në DST.

Kriteri:	Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), nenet 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 **"**Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të këshillit të ministrave," për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.
Impakti:	Shpallja fitues e shoqërisë "Z." me mangësi në plotësimin e kritereve, dhe skualifikimi i OE me oferta më të leverdishme, dhe mos anulimi i procedurës ose mos vlerësimi i kritereve kryesore "çmim i leverdishëm", midis operatorëve me mangësi, janë veprime në kundërshtim me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe **në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 2,921,953 lekë** si diferencë ndërmjet ofertës së skualifikuar dhe asaj së shpallur fituese.
Shkaku:	Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.
Rëndësia:	**I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.16 datë 28.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. I. G.(Jurist), z. E. N., (Arkitekt), znj. E. S. (Ekonomist).

Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 72,480,695 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.

Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Preventivi i punimeve është hartuar nga subjekti "N." ku në dosjen e tenderit nuk ndodhet asnjë dokument që të përcaktoj përse ky subjekt është ngarkuar apo kontraktuar për hartimin e preventivit dhe relacionin teknik.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i kritereve të veçanta të kualifikimit të DST konstatohet se AK ka bërë ndryshime në DST sipas Shtojcës së hedhur në sistemin elektronik të APP-së më datë 09.03.2017, "Shtojca" mban si ***datë 04.11.2016***, çka nuk përkon me datën e hedhjes në sistem, ku ndër të tjera janë shtuar si më poshtë:

1. *Operatori duhet të ketë:*

   ISO 9001:2008 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise "

   OHSAS 18001:2007 mbi "Shendetin dhe sigurimin ne pune "

   ISO 14001:2004 mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit "

Në këtë kriter shtohen pikat si më poshtë:

ISO 39001:2012 "Certifikon që sistemi i Menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor për kompaninë"

ISO 22000:2005 "Certifikon sigurinë ushqimore mbi punonjësit"

PAS 99:2012 "Certifikon që sistemi i Integruar i menaxhimit të kompanisë"

Të gjitha certifikatat e mësipërme të shoqërohen edhe me kontrollin periodik të tyre.

Certifikatë SA 8000 për përgjegjësin sociale.

2. *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 30 punonjës me certifikatë të lëshuar nga ISHT ose të lëshuar nga institucione ekuivalente, ku të përfshihen:*

Manovrator për makineritë e rënda, Elektricist dhe murator ose specialist për suvatimet shoqëruar me kontratë pune, leje manovrimi për manovratorët.

Ky kriter ndyshohet si me poshte:

Kompania duhet të ketë të paktën dy inxhinier të kualifikuar me ISO BS OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të sigurisë në kantier. Për të vërtetuar këtë, shoqëria duhet të paraqesi kontratë pune noteriale, Diplomë, CV.

3. *Në lidhje me makineritë të cilat duhet të ketë në dispozicion, në këtë kriter shtohet edhe* ***Makineri për prodhimin e pllakave dhe bordurave, për trotuare e shoqëruar me Kontratë blerje, skemën teknologjike të makinerisë, të jetë i pajisur me leje mjedisore nga QKL, vërtetim zhdoganimi si dhe certifikata ISO për prodhim elementesh si me poshtë:***

ISO 9001-2008 "Sistemi i menaxhimit te cilesise"

ISO 14001-2004 "Sistemi i menaxhimit te mjedisit

BS OHSAS 18001-2007 "Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune

PAS 99-2012 "Sistemi i integruar i menaxhimit"

ISO 39001-2012 "Sistemi i menaxhimit te sigurise rrugore

Gjithashtu të ketë të miratuar nga drejtoria e standarteve për prodhimet sipas standartit1339:03 që të vërtetohet kjo duhet fatura e blerjes nga drejtoria e standarteve

Shoqëria duhet të jetë e certifikuar me ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 39001 "Për instalimin e sistemeve për ndricim publik dhe instalim mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelberta.

Nga kriteret e mësipërme të vendosura nga NJP vihet re se disa prej tyre janë jo në përputhje me LPP, kjo pasi vendosja e tyre krijon mundësi diskriminimi për OE e tjerë prezent në treg për kryerjen e punimeve të përcaktuara nga AK dhe më konkretisht:

-ISO 22000:2005 "Certifikon sigurinë ushqimore mbi punonjësit", *kjo certifikatë lidhet me sigurinë ushqimore dhe bie ndesh me kërkesat e përcaktuara në VKM 914, datë 29.12.2014, pasi objekti i prokurimit nuk lidhet me këtë lloj dëshmie.*

-Makineri për prodhimin e pllakave dhe bordurave, për trotuare e shoqëruar me Kontratë blerje, skemën teknologjike të makinerisë, të jetë i pajisur me leje mjedisore nga QKL, vërtetim zhdoganimi si dhe certifikata ISO për prodhim elementesh, *ky kriter bie ndesh me kërkesat e LPP dhe VKM në funksion të këtij ligji pasi pengon të gjithë OE të cilët nuk disponojnë në pronësi makineri të prodhimit të pllakave të marrin pjesë në këtë procedurë. NJP duhet të mjaftohej edhe me ndonjë kontratë furnizimi nga ana e OE të pllakave dhe bordurave.*

-Kompania duhet të ketë të paktën dy inxhinier të kualifikuar me ISO BS OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të sigurisë në kantier. Për të vërtetuar këtë, shoqëria duhet të paraqesi kontratë pune noteriale, Diplomë, CV. *Ky kriter është i panevojshëm dhe pa bazë ligjore pasi kualifikimi i till jepet për shoqëritë dhe jo për punonjës.*

-Shoqëria duhet të jetë e certifikuar me ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 39001 "Për instalimin e sistemeve për ndricim publik dhe instalim mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelberta, ky kriter është i panevojshmë pasi në procedurën e prokurimit nuk janë parashikuar punime të tilla nga AK.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e sa më shumë subjekteve pasi janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor si miratuesi i kritereve.

Nga ana e OE "E." është plotësuar formulari i ankesës dhe dorëzuar ankesa protokolluar me nr. 1240 prot., datë 16.03.2017 ku paraqet kundërshtimet e tij në lidhje me disa nga kriteret e vendosura nga NJP. Me shkresën nr. 1240/1 prot., datë 20.03.2017 është kthyer përgjigje nga ana e AK ku nuk merret parasysh ankesa e OE pasi kërkesa është bërë jashtë afatit të përcaktuar në ligj.

Sipas nenit 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…"* nga ana e AK nuk është marë asnjë masë sipas përcaktimeve të bërë në ligj pasi mungon në dosjen e tenderit Urdhër pezullimi i procedurës, Urdhër për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave etj…

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve gjithashtu është në kundërshtim të nenit 63 të LPP. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht znj. I. G., z. E. N. dhe znj. E. S.i.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi AK.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. T. M., me detyrë zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V. K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 4 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE "A. P.", C., "E.", B.dhe "Z." Shpk i cili është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	Z.	70,247,274.62	Kualifikohet, Fitues
2	A.	ska	Skualifikohet
3	C.	ska	Skualifikohet
4	"E ."	36,231,704	Skualifikohet
5	B.	67,325,322	Skualifikohet

Janë s'kualifikuar ofertuesit:
1-" A." sh.p.k ka këto mangësi:

- I mungojne te gjitha dokumentat.

2-"C. " sh.p.k ka këto mangësi:

- I mungojne te gjitha dokumentat.

3-" B. " sh.p.k ka këto mangësi:

- Vlera e preventivit pjesor është e njëjtë me preventivn e plotë.
- Mungon ISO 22000:2005 si kriter i kërkuar në DST .
- Mungojnë të paktën dy inxhinier të kualifikuar me ISO BS OHSAS 18001 :2007 të pajisur me kontrat pune noteriale ,diplome cv sipas kriterit të kërkuar në DST .
- Mungon makineria për prodhimin e pllakave dhe bordurave ,për trotuare e shoqëruar me kontrat blerje ,skemën teknologjike të makinerisë ,të jetë i pajisur me leje mjedisore nga QKL ,vërtetim zhdoganimi si dhe certifikate ISO për prodhimin elementesh si më poshtë ISO 9001:2008 Sistemi i menaxhimit të cilësisë ,ISO 14001-2004 Sistemi i menaxhimit të mjedisit ,BS OHSAS 18001-2007 Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ,PAS 99-2012 Sistemi i integruar i menaxhimit ,ISO 39001 -2012 Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore .Gjithashtu të ketë të miratuar nga drejtoria e standarteve për prodhimet sipas standartit shen 1339:03 që të vërtetohet kjo duhet fatura e blerjes nga Drejtoria e standarteve.
- Shoqeria duhet te jete e certifikuar me ISO 9001 ,ISO 14001 dhe ISO 39001 Për instalimin e sistemeve për ndricim publik dhe instalim mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelberta sipas kritereve të kërkuara në DST.

4-" E. " sh.p.k ka keto mangesi:
Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm vlerën e preventivit pjesor dhe jo vlerën e preventivit të plotë .I mungojnë të gjitha dokumentat e kërkuara në DST.

OE të kualifikuar.
OE "Z." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:
Në DST është përcaktuar në kriteret e veçanta të prokurimit si më poshtë:

Nr.	Lloji i Makinerive	Sasia
1	Pompe suvatimi	1 cope

2	Mjete transporti veteshkarkues min.15 ton	1cope
3	Motobetionere	2 cope
4	Kamjocine	2 cope
5	Depozita uji kapacitet 5 000 litra	2 cope
6	Skeleri Suvatimi	2000m²

Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga OE për pikën 6 "skeleri suvatimi" 2000m2 nuk plotësohen pasi në sisitemin elektronik ndodhen fatura tatimore me nr serial 37935311 datë 03.08.2007 ku janë të përshkruara 1800 m2 skeleri dhe fatura tatimore me nr. Serial 41054904 datë 15.12.2008 ku janë të përshkruara 73 palë "skela hekuri". Pra siç dhe mund të vihet re OE nuk i përmbush përcaktimet e veçanta të vendosura në DST.

Bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në zbatim të tij sipas të cilit thuhet se *"... autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit...."* oferta duhet të konsiderohej e pavlefshme dhe oferta e OE duhej skualifikohej.

Në lidhje me ofertën ekonomike të paraqitur nga OE B., KVO duhet ta konsideronte të vlefshme dhe ta shpallte fituese bazuar në konstatimet e bëra mësipër në përcaktimin e kritereve të veçanta.

Shpallja fitues e shoqërisë "Z." me mangësi në plotësimin e kritereve, dhe skualifikimi i OE me oferta më të leverdishme, dhe mos anulimi i procedurës ose mos vlerësimi i kritereve kryesore "çmim i leverdishëm", midis operatorëve me mangësi, janë veprime në kundërshtim me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe në paligjshmëri të përdorimit të fondeve në vlerën 2,921,953 lekë si diferencë ndërmjet ofertës së skualifikuar dhe asaj së shpallur fituese.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. T. M., me detyrë ish-zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V. K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/4, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
-Preventivi i punimeve është hartuar nga subjekti "N." ku në dosjen e tenderit nuk ndodhet asnjë dokument që të përcaktoj përse ky subjekt është ngarkuar apo kontraktuar për hartimin e preventivit dhe relacionin teknik
Lidhur me këtë pretendim ju sqarojmë se preventivat e hartuara nga N. sjell pranë Bashkisë Berat janë në formën e dhurimit.
- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Procesverbali i hartimit të dokumentave të tenderit është një dokument që bëhet pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk i vihet në dispozicion OE dhe mosargumentimi i kërkesave të veçanta nuk bie ndesh me parimet kryesore të ligjit 9643.

-Nga kriteret e vendosura nga NJP vihet re se disa prej tyre janë jo në përputhje me LPP, kjo pasi vendosja e tyre krijon mundësi diskriminimi për OE e tjerë prezent në treg për kryerjen e punimeve të përcaktuara nga AK:
Makineri për prodhimin e pllakave dhe bordurave, për trotuare e shoqëruar me Kontratë blerje, skemën teknologjike të makinerisë.... Për shkak se dimensionet pllakave janë të ndryshme dhe sasia e tyre është e madhe 2456 m2 dhe ka vështirësi të madhe gjetje në treg, eksperiencë kjo nga objektet e mëparshme si rehabilitimi i Bulevardit Republika.
Kompania duhet të ketë të paktën dy inxhinier të kualifikuar me ISO BS OHSAS 18001:2007 për sistemin e menaxhimit të sigurisë në kantier... Kuptimi i vendosjes së këtij kriteri është që inxhinierët e shoqërisë të kenë kryer kursin pranë institucionit të ngarkuar me ligj për tu pajisur shoqëria me iso sipas kriterit mësipërm.
Në lidhje me cerifikimet ISO është bërë një lapsus pasi në DST nuk ekzistojnë 3 ISO të ndryshme me të njëjtin emërtim dhe asnjë prej ISO-ve të përmendura nuk i përshtaten përshkrimit bashkëlidhur. Në lidhje me kriterin e vendosur nga ana e NJP që shoqëria të jetë pajisur me ISO 39001 ju sqarojmë se objekti ndodhet në të dy krahët e rrugës e cila të çon tek stadiumi i ri, zonë kjo e populluar dhe me aktivitete biznesi. Objekti është me gjatësi rreth 500m dhe furnizimi është i detyrueshëm të bëhet nga rruga kryesore, në këto kushte duhen marë masa për funksionimin normal të bizneseve gjatë periudhës së kryerjes së punimeve, lëvizjeve të banorëve etj.
Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/5, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
Ne DST është përcaktuar në kriteret e vecanta të prokurimit:
Skeleri suvatimi 2000 m²
Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga OE për Skeleri suvatimi 2000 m² nuk plotësohen pasi ne sistemin elektronik ndodhen fatura tatimore me nr serial 37935311 datë 03.08.2017 ku janë të përshkruara 1800 m² skeleri fatuara tatimore me nr. Serial 41054904 date 15.12.2008 ku janë të përshkruara 73 pale skela hekuri .
Ju sqarojmë se ne si KVO kemi pranuar edhe 73 pale skela hekuri duke i llogaritur në m².
Kemi pranuar 1 skele përafërsisht 3 m² .
73 pale skela hekuri x 3 m² =219 m2 .Bazuar në këtë llogaritje kemi pranuar skeleri suvatimi 2000 m² si kriter i kërkuar ne DST .
Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kualifikimin e OE "Z." grupi i KLSH pasi analizojë arsyetimin e paraqitur arrin në konkluzionin se pretendimi i paraqitur nga KVO qëndron në lidhje me këtë OE por i qëndrojmë faktit se oferta më e leverdishme e paraqitur ishte ajo e OE "B."*. **Pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë.**

2. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* Rikonstruksioni i Stadiumit ”Tomorri” ne lagjen ”30 Vjetori” Berat

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i Stadiumit ”Tomorri” ne lagjen ”30 Vjetori” Berat		
1.Urdhër Prokurimi nr. 6, datë 14.02.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** “Procedure e Hapur”	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.I. G.(Jurist) 2.E. N. (Arkitekt) 3.E. S. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr 7 date 14.02.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 44 401 000 lekë	**6.Oferta fituese**: “ C. “ shpk, "P. " shpk Vlera 41 215 358	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 3 185 642 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 20.03.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Po	**12. Përgjigje ankesës nga AK** **Po**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: Jo**
		Dt lidhjes kontratës: 24.07.2017 **Afati kontratës: 60 ditë**

Situata:

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se BOE “C.” & “P.nuk plotësojnë disa nga kriteret e vendosura në DST, konkretisht:

- Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga BOE nuk është evidentuar asnjë përvojë e kryer nga BOE nga kontratat e paraqitura që të vërtetoj eksperiencat e mëparshme. Sipas Deklaratës nr. 499 Rep. Nr 130 Kol datë 16.03.2017, për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive është përcaktuar se OE “C.” do të kryej 67.04% të punimeve me më konkretisht zërat e punimeve nr: 1, 2, 3, 7, 8 dhe 9 ndërsa OE “P.” do të realizoj gjithë zërat e tjerë sipas preventivit.

Nga auditimi i kontratave dhe i preventivave përkatës të punimeve, të dorëzuar nfa OE, nuk është evidentuar asnjë zë punimesh i ngjashëm me zërat të cilat janë marë përsipër të kryen nga OE “C.”.

Kriteri:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*” pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “*Parimet e përzgjedhjes*” germa (a), (b) dhe (c), nenet 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe me nenet 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 **“**Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Impakti:

Bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në zbatim të tij sipas të cilit thuhet se “... autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit....” oferta duhet të konsiderohej e pavlefshme dhe oferta e OE duhej skualifikohej dhe tenderi duhet të anullohej.

Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.

<u>Rëndësia:</u> **I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.6 datë 14.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. I. G.(Jurist), z. E. N., (Arkitekt), znj. E. S. (Ekonomist).

Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 44,401,000 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.

Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Preventivi i punimeve dhe projekti janë hartuar nga subjekti "A." ku në dosjen e tenderit nuk ndodhet asnjë dokument që të përcaktoj përse ky subjekt është ngarkuar apo kontraktuar për hartimin e preventivit dhe relacionin teknik.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicionpersonit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i kritereve të veçanta të kualifikimit të DST konstatohet se AK ka bërë ndryshime në DST sipas Shtojcës së hedhur në sistemin elektronik të APP-së më datë 22.02.2017, ku ndër të tjera janë shtuar si më poshtë:

Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese licensen profesionale per ekzekutimin e puneve me kategorite perkatese:

NP1-A, NP2-B, NP5-B, NS10-B, NP12-B, NS18-A

Shtojca është hedhur në bazë të ankesave të bëra nga disa OE në lidhje me kriteret e vendosura nga AK sipas përcaktimeve të NJP. Në dosjen e tenderit vihet re:

-mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),

-mungon Proçes Verbali i pezullimit të procedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,

Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve gjithashtu është në kundërshtim të nenit 63 të LPP. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht znj. I. G., z. E. N. dhe znj. E. S.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me Urdhër nr 7 date 14.02.2017 e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. T. M., me detyrë zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V.K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO. KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 2 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE "SH.", B.dhe BOE "C." & "P." Shpk i cili është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	C.	41,215,358	Kualifikohet, Fitues
2	Sh.	ska	Skualifikohet
3	B.	36,808,208	Skualifikohet, tërhequr nga tenderi

Janë s'kualifikuar ofertuesit:

1-" Sh. " sh.p.k ka këto mangësi:

- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2-" B." sh.p.k pasi:

- OE me shkresën e paraqitur me Nr. 91 Prot datë 21.03.2017, protokolluar në Bashkinë Berat me shkresën nr. 1323 prot., datë 21.03.2017, subjekti tërhiqet nga kjo procedurë prokurimi me arsyetimin *"... nuk kemi më interes për këtë objekt"*.

OE të kualifikuar.

BOE "C." & "P." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:

Në DST është përcaktuar në kriteret e veçanta të prokurimit si më poshtë:

- *Pervoje e suksesshme ne ekzekutimin e te pakten:*

-Pune te ngjashme të së njëjtës natyrë,per nje kontrate te vetme në një vlerë prej 50 % te vleres qe prokurohet : 22.200.500 (njezete e dy milion e dyqind mije e peseqind) lekë pa T.V.SH, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; ose
-Punë të ngjashme ku vlera totale e punës së tre viteve të fundit është një vlerë 88.802.000 (tetedhjete e tete milion e teteqind e dy mije) leke pa TVSH;
Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.
Per te vertetuar pervojen e meparshme te paraqiten kontrate, deklarata sipas shtojces nr 8, e shoqeruar me aktkolaudimin dhe situacionet perfundimtare.

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten vertetime ku te shenohet vlera, koha dhe natyra e punese se bere e shoqeruar me fatura tatimore.

Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga BOE nuk është evidentuar asnjë përvojë e kryer nga BOE nga kontratat e paraqitura që të vërtetoj eksperiencat e mëparshme. Sipas Deklaratës nr. 499 Rep. Nr 130 Kol datë 16.03.2017, për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive është përcaktuar se OE "CAUSHI" do të kryej 67.04% të punimeve me më konkretisht zërat e punimeve nr: 1, 2, 3, 7, 8 dhe 9 ndërsa OE "P." do të realizoj gjithë zërat e tjerë sipas preventivit. Nga të dhënat e paraqitura në sistemin elektronik të APP OE "C." ka paraqitur si punë të ngjashme 3 kontrata si më poshtë:

1. *Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit të ngrohjes në shkollën e mesme "Sinan Tafaj", Bashkia Tiranë, vlera e kontratës 27,672,440 lekë me TVSH.*
2. *Ndërtim i ujësjellësit lagje Lugu i Dardhës, Bashkia Berat, vlera e kontratës 148,532,344 lekë.*
3. *Rikualifikimi urban i bllokut 92/1, Njësia Bashkiake Nr. 4, Bashkia Tiranë, Vlera e kontratës 151,389,012 lekë.*

Nga auditimi i këtyre kontratave dhe i preventivave përkatës të punimeve nuk është evidentuar asnjë zë punimesh i ngjashëm me zërat të cilat janë marë përsipër të kryen nga OE "C." dhe më konkretisht:

PREVENTIVI I PUNIMEVE				
OBJEKTI: "RIKONSTRUKSIONI I STADIUMIT TOMORI NE LAGJEN 30 VJETORI-BERAT"				
Nr.	**Nr. Analize**	**PERSHKRIMI I PUNIMEVE**	**Njesi**	**Sasia**
B. PUNIME NE SHTRESAT E FUSHES TE FUTBOLLIT				
1	Anal.2	Shtrese tapeti me bar artificial	m2	8150
2	Anal.3(244)	Shtrese me kokrriza gome + rere	kg	2433
3	An-6	FV gjeotekstil 165/m2	m2	8150
7	Anal. 4	Shine pvc per fiksimin e tapetit ne skaje	ml	340
8	Anal. 5	Fashe per realizimin e ngjitjes se fleteve te tapetit	ml	2296
9	Anal. 6	Material ngjites per fiksimin e tapetit	litra	100

Si rrjedhojë konstatohet se OE nuk i përmbush përcaktimet e veçanta të vendosura në DST.

Bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në zbatim të tij sipas të cilit thuhet se *"... autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit...."* oferta duhet të konsiderohej e pavlefshme dhe oferta e OE duhej skualifikohej dhe tenderi duhet të anullohej.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. T. M., me detyrë zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V. K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Komente dhe sqarime*:*

Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/3, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

-*Preventivi i punimeve dhe projekti janë hartuar nga subjekti "A." ku në dosjen e tenderit nuk ndodhet asnjë dokument që të përcaktoj përse ky subjekt është ngarkuar apo kontraktuar për hartimin e preventivit dhe relacionin teknik*

Lidhur me këtë pretendim ju sqarojmë se preventivat e hartuara nga A. sjell pranë Bashkisë Berat janë në formën e dhurimit.
- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Procesverbali i hartimit të dokumentave të tenderit është një dokument që bëhet pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk i vihet në dispozicion OE dhe mosargumentimi i kërkesave të veçanta nuk bie ndesh me parimet kryesore të ligjit 9643.
- Në dosjen e tenderit vihet re:
**mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),*
**mungon Proçes Verbali i pezullimit të procedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE*
Në lidhje me këtë faktot sqarojmë se me ardhjen e formularit të ankesës nga OE titullari në formular vendoste dhe personat përgjegjës që të ishin përgjegjës për shqyrtimin e ankesës dhe kthimin e përgjigjes. Në rastin konkret kërkesat ishin për DT dhe referuar vkm 914 datë 29.12.2014 neni 78 gërma a, në rast se ankimimi lidhet me dokumentet e tenderit titullari mund të ngarkoj shqyrtimin e ankesës KVO. AK mbështëtur në ankesat e OE rishikoi kriteret e kualifikimit të përcaktuar në DST.
-Nga kriteret e vendosura nga NJP vihet re se disa prej tyre janë jo në përputhje me LPP, kjo pasi vendosja e tyre krijon mundësi diskriminimi për OE e tjerë prezent në treg për kryerjen e punimeve të përcaktuara nga AK:
Janë sqaruar nga ana e NJP pikat e licensës së shoqërisë të vendosura si kritere në DST.
Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte gjithashtu argumentimi i kritereve duhet të ishte bërë gjatë fazës së hartimit të DT si një detyrim që buron nga LPP dhe VKM në zbatim të tij. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/5, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
Nga auditimi i Dokumentave të paraqitura nga BOE nuk është evidentuar asnjë përvojë e kryer nga BOE nga kontratat e paraqitura që të vërtetojë eksperiencat e mëparshme. Sipas Deklaratës nr. 499 Rep. Nr 130 Kol datë 16.03.2017, për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive është përcaktuar se OE "C." do të kryej 67.04% të punimeve me më konkretisht zërat e tjerë sipas prevenitvit. Nga të dhjënat e paraqitura në sistemin elektronik të APP OE "C." ka paraqitur si punë të ngashme 3 kontrata si më poshtë:
1. Rehabilitim i pjesshëm dh instalim i sistemit të ngrohjes në shkollën e mesme "Sinan Tafaj", Bashkia Tiranë, vlera e kotratës 27,672,440 leke me TVSH.
2. Ndërtimi I ujësjellësit lagje Lugu I Dardhës, Bashkia Berat, vlera e kontratës 148,532,344 lekë.
3. Rikualifikimi urban i bllokut 92/1, Njësia Bashkiake Nr. 4, Bashkia Tiranë, Vlera e kontratës 151,389,012 lekë.
Nga audimi I këtyre kontratave dhe i preventivave përkatës të punimeve nuk është evidentuar asnjë zë punimesh I ngjashëm me zërat të cilat janë marë përsipër të kryen nga OE "C."
Për sa më sipër ju sqarojmë se :
-Për sa i përket pretendimit se Shoqëria Ç.
shpk ka marrë përsipër të kryejë ato punime për të cilat pretendohet se preventivat e punëve te ngjashme nuk kanë zëra te ngjashëm me punimet e marra përsipër për këtë procedure, ju bëjmë

me dije se ashtu si ne fakt cilësohet punë "e ngjashme" do të thotë punë të përafërta dhe jo identike. Rikualifikimi urban i bllokut 92/1, Njësia Bashkiake Nr. 4, Bashkia Tiranë që është paraqitur si punë e ngjashme ka në objekt shtresat, ashtu si dhe fusha ka në objekt shtresat, pra për realizimin e tyre nevojiten të njëjtat mjete Fadrome, Rul etj .Po ashtu për kryerjen e këtyre punimeve të këtij objekti nevojitet e njëjta kategori license .

Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditmit mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "C." sqarojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.*

3. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* Rikonstruksioni i Muzeut Historik Sinje

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i Muzeut Historik Sinje		
1.Urdhër Prokurimi nr. 67, datë 30.11.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kërkesë për propozim"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.A. S.(Jurist) 2.E. N. (Arkitekt) 3.M. Xh. (Ekonomiste)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr 68 date 30.11.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,446,818.82 lekë	**6.Oferta fituese**: "P." shpk Vlera 7,634,330	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 187,511 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 26.12.2017	**9.Burimi Financimit**: Të ardhura të Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 9 OE b)S'kualifikuar 7 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Po	**12. Përgjigje ankesës nga AK** **Po**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: Po** **Vendimi nr. 54/1 datë 16.01.2018** **Vendimi nr. 220/2018 datë 17.04.2018**
		Dt lidhjes kontratës: 13.06.2018 **Afati kontratës: 120 ditë**

Situata:

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se skualifikimi i OE nuk është i saktë dhe më, konkretisht:

Në lidhje me skualifikimin e OE "C." arsyetimi i përdorur nga KVO për hartimin e kontratave jo në përputhje me kodin civil dhe kodin e punës nuk qëndron pasi OE ka dorëzuar kontratë pune të lidhur pranë noterit dhe nuk konstatohen element jo konform kodit të punës.

Në lidhje me pagën e deklaruar për ing. M. S. sqarojmë se listëpagesat janë dokumenta të administratës tatimore dhe janë këto instanca kompetente për kontrollin e dhe monitorimin e pagave sipas dispozitave të tyre ligjore. Kriteret e vendosura nga Ak shërbejnë për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualfikimet e nevojshme dhe kapacitetet organizative, pajisjet mjetet etj. Në këtë kuptim për AK është e rëndësishme të provohet zotërimi i kapaciteteve nga OE në përputhje me përcaktimet e bëra në DST. Bazuar mbi këto konstatime nuk merret parasysh vendimet e mara nga KVO.

I njëjti arsyetim vlen dhe për ofertën e paraqitur nga OE " SH." ku vlerësimi i KVO ka parashtruar si kritere të paplotësuara hartimin e kontratave dhe

mospërputhjen e pagës së deklaruar në kontratë me atë në listpagesë.

Kriteri:	KM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Impakti:	Dokumentacioni i paraqitur nga OE "C." shpk ka kushte më të favorshme se sa OE "P.", çka nuk është konstatuar nga KVO, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues ofertën me vlerë më të lartë. Vlerësohet shpenzim **jo me efektivitet dhe eficencë** i shkaktuar nga shpallja fituese e ofertës së OE "P." shpk vlera **prej 1,677,352 lekë**.
Shkaku:	Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.
Rëndësia:	**I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.67 datë 30.11.2017, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. A. S.(Jurist), z. E. N., (Arkitekt), znj. M. Xh.(Ekonomist).
Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 8,446,819 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.
Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.
Preventivi i punimeve dhe projekti janë hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Berat.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. S.o, z. E. N. dhe znj. M. Xh.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me Urdhër nr 68 date 30.11.2017 e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. T.M., z.A. H., dhe z. A. Dh..
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave, ndërsa mungon në dosjen e procedurës së prokurimit procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim kjo me neni 66, *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, *pika 3* të VKM 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku shprehimisht thuhet:

❖ *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Nga ana e OE "P." është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 40 Prot., datë 05.01.2018 pranë Bashkisë Berat, mbi vlerësimin e ofertës ekonomike të paraqitur nga ky OE nga ana e KVO, ku ka parashtruar argumentat e tij. Bashkia Berat me shkresën nr. 40/1 datë 11.01.2017(viti duhet të jetë 2018 por në dosje ndodhet kjo shkresë) i ka kthyer përgjigje OE ku ka pranuar të gjitha pikat e paraqitura në ankesë.
Në dosjen e tenderit rezultoj se:
-mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),
-mungon Proçes Verbali i pezullimit të porcedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,
Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi AK.

Me formularin e ankesës protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr. 238 prot, datë 16.01.2018 është bërë ankesë pranë KPP nga OE "P.", KPP me vendimin nr. 54/1 datë 16.01.2018 ka vendosur të kalojë për shqyrtim ankesën e OE tek AK sidhe mbasi të jëtë shqyrtuar ankesa nga ky i fundit të dërgohet pranë KPP informacion i hollësishëm mbi këtë procedurë.
Ak në informacinon e nisur KPP me shkresën nr. 282/1 datë 23.01.2018 në përgjigjen e saj, pasi ka shqyrtuar ankesën dhe vënë në dieni për Vendimin e KPP-së, ka përfshirë në raportin përmbledhës të dhëna të reja mbi arsyet e skualifikimit të OE "P.".
Me formularin e ankesës protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr. 924 prot, datë 19.02.2018 është bërë ankesë pranë KPP nga ana e OE "S." për kualifikimin e OE "P." me arsyetimin se në dokumentat e dorëzuar ka mangësi.
Me vendimin nr. 415/1 Prot., datë 06.03.2018 KPP ka vendosur të kaloj për shqyrtim ankesën e OE pranë AK sidhe mbasi të jëtë shqyrtuar ankesa nga ky i fundit të dërgohet pranë KPP informacion i hollësishëm mbi këtë procedurë.
Ak në përgjigje të vendimit të KPP ka dërguar dokumnetacionin pranë KPP në lidhje me vedndimet e mara.
Me vendimin nr 2163 prot., datë 19.04.2018 KPP ka vendosur "Të mos pranoj ankesën e OE "S."…"
Gjatë gjthë procesit të kryer nga ana e AK, nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen e tenderit, grupi i auditimit ka konstatuar se mungojnë Procesverbalet e ngritjes së KSHA, Procesverbalet e KSHA sidhe Procesverbali i pezullimit të procedurës, kërkesa këto bazuar në LPP.

-Nga vlerësimi sidhe pas Vendimeve të KPP-së, rezulton se janë s'kualifikuar 7 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 2 operator, OE "S."dhe OE "P." i cili është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	P.	7,634,330	Kualifikohet, Fitues
2	S.	8,060,561	Kualifikohet
3	Sh.	6,340,923	Skualifikohet
4	F.	ska	Skualifikohet
5	S.	6,310,250	Skualifikohet
6	SH.	6,529,649	Skualifikohet
7	N.	6,158,331	Skualifikohet
8	C .	5,956,978	Skualifikohet
9	E.	5,735,061	Skualifikohet

Janë s'kualifikuar ofertuesit:

1-" Sh." sh.p.k ka këto mangësi:

- ISO 9001:2008 është e paapdejtuar kërkohet ISO 9001:2015
- Ing. S. T. mungon në lispagesën e muajit Janar, Shkurt.

2-" F. " sh.p.k pasi:

- Nuk ka paraqitur asnjë dokument

3-" S. " sh.p.k pasi:

- Listpagesat nuk janë konfirmuar nga administrata tatimore

4-" SH." sh.p.k pasi:

- Kontratat e ing nuk janë konform ligjit 7961 dt. 12.07.1995
- Ing H. Sh.është jashtë standarteve të kërkuara nga kodi i punës dhe kodi civil
- Ing Elektrik A. M., paga në kontratë është 40,000 lekë në bordero figuron 22,000 lekë

5-" NGRACAN 1934 " sh.p.k pasi:

- Mungon polica e sigurimit për kamionin AA557HN
- Mungon CV për arkitekt Gj. T.
- Mungon dokumentacioni për ing. Mjedisi,
- Për OE K.mungon diploma për ark. E. B.

6-" C. " sh.p.k pasi:

- Kontratat e inxhinierëve nuk janë konform kodit të punës dhe në përputhje me ligjin 7961 datë 12.07.1995
- Ing. E. C. është jashtë standarteve të kërkuara nga kodi i punës dhe kodi civil
- Ing. Elektrik M. S., paga në kontratë është 50,000 lekë, në bordero figuron 25,000 lekë.

7-" E. " sh.p.k pasi:

- Mungon dokumentacioni për kamionin vetëshkarkues me targë AA397LZ
- Drejtuesi teknik A. H. mungon në listëpagesën e muajit prill 2017
- Drejtuesi teknik M. T. mungon në listëpagesat e muajit shkurt, mars, maj, qershor, korrik, gusht, shtator 2017
- Drejtuesi teknik A.H., M. T. dhe V.Sh. mungon në listëpagesën e muajit shkurt 2017

Nga auditimi i ofertave ekonomike të skualifikuara nga KVO konstatohet se:
Në lidhje me skualifikimin e OE "C." arsyetimi i përdorur nga KVO për hartimin e kontratave jo në përputhje me kodin civil dhe kodin e punës nuk qëndron pasi OE ka dorëzuar kontratë pune të lidhur pranë noterit dhe nuk konstatohen element jo konform kodit të punës.

Në lidhje me pagën e deklaruar për ing. M. S. sqarojmë se listëpagesat janë dokumenta të administratës tatimore dhe janë këto instanca kompetente për kontrollin e dhe monitorimin e pagave sipas dispozitave të tyre ligjore. Kriteret e vendosura nga Ak shërbejnë për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualfikimet e nevojshme dhe kapacitetet organizative, pajisjet mjetet etj. Në këtë kuptim për AK është e rëndësishme të provohet zotërimi i kapaciteteve nga OE në përputhje me përcaktimet e bëra në DST. Bazuar mbi këto konstatime nuk merret parasysh vendimet e mara nga KVO.
I njëjti arsyetim vlen dhe për ofertën e paraqitur nga OE " SH." ku vlerësimi i KVO ka parashtruar si kritere të paplotësuara hartimin e kontratave dhe mospërputhjen e pagës së deklaruar në kontratë me atë në listpagesë.

Pra, dokumentacioni i paraqitur nga OE "C." shpk ka kushte më të favorshme se sa OE "P.", çka nuk është konstatuar nga KVO, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues ofertën me vlerë më të lartë. Vlerësohet shpenzim jo me efektivitet dhe eficencë i shkaktuar nga shpallja fituese e ofertës së OE "P." shpk vlera prej 1,677,352 lekë.
Veprimet dhe mosveprimet sa trajtuar më sipër, janë veprime në kundërshtim me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të KVO sipas të dhënave të tenderit në tabelën më sipër të cilat nuk kanë bërë të mundur sigurimin e efektivitetit, eficencës dhe ekonomicitetit të përdorimit të fondeve publike në shumën prej 1,677,352 lekë.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. T. M., me detyrë zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe z. A. Dh., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Komente dhe sqarime:
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/6, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
-KVO shqyrton ofertat sipas kriterve të vendosura ne DST në perputhje me nenin 46, të LPP-së ku parashikohet se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." dhe ne rastin konkret kvo ka pare te arsyshme per te kualifikuar S.
Theksojme se edhe pas vendimit te marre nga ana jone KPP si organi me I larte per kontrollin dhe shpalljen e fituesit ne kete procedure pas ankesese se bere nga operatori ekonomik P. ka kontrolluar dokumentacionin teknik dhe ka shpallur fitues operatorin ekonomik P.. KPP vendimi Nr. 2136 Prot , datë 19.04.2018.
Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditmit mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "P." sqarojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.*

4. Auditim i prokurimit publik me objekt: "Blerje karburanti per Bashkine Berat dhe per drejtorite vartese"

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ""Blerje karburanti per Bashkine Berat dhe per drejtorite vartese"		
1.Urdhër Prokurimi nr.14, datë 24.02.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit të kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.I. G.(Jurist) 2.E. N. (Arkitekt) 3.E. S. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr 15date 24.02.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 13,190,550 lekë	**6.Oferta fituese**: "P." SHPK Vlera 13,127,576	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 62 974 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 06.02.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 4 OE b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: **Po**	**12. Përgjigje ankesës nga AK** **Po**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP: Jo**
		Dt lidhjes kontratës: 28.04.2017 **Afati kontratës: 12 muaj**

Situata:

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se OE P.nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga NJHDT, konkretisht:

Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga OE është paraqitur kontrata e furnizimit e lidhur me Bashkinë Berat për vitin 2016 por mungojnë tek dokumentet e ngarkuar në SPE si vërtetimi për realizimin e kontratës ashtu edhe faturat tatimore të lëshuara nga OE.

OE në ekstraktin e QKR ka të deklaruar si Adresë kryesore dhe të vetme të atë periudhë të ushtrimit të aktivitetit :

Berat,Velabisht, Fshati Velabisht, rruga kryesore, go~ine nje kateshe nr.16, zona kadastrale nr.3722, me numer pasurie : 1/10.

Duket qartë se adresa e ushtrimit të aktivitetit nuk është në përputhje me kërkesat e DST ku është përcaktuar qartë se OE duhet të ketë pikë furnizimi me vendndodhje në qytetin e Beratit.

Si rrjedhojë konstatohet se OE nuk i përmbush përcaktimet e veçanta të vendosura në DST.

Kriteri:

VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Impakti:

Kualifikimi i OE "P." nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, dhe KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, ose midis operatorëve pjesëmarrës me mangësi në plotësimin e kritereve të vlerësonte kriterin kryesorë "*çmimi më i leverdishëm*", për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve në vlerën **1,445,678 lekë**

Shkaku:

Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.

Rëndësia: **I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.14 datë 24.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. I. G.(Juriste), z. E. N., (Inxhinier), znj. E. S. (Ekonomiste). Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 13,190,550 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.
Fondi limit është llogaritur nga komisioni i ngritur me Urdhërin e Kryetarit nr 281, datë 22.02.2017 ku në përbërje të tij kanë qenë znj. B. Sh. (Kryetare), M. Ll. (Anëtare) dhe B. K. (Anëtare). Bazuar në Proces Verbalin mbi llogaritjen e fondit limit, metoda e ndjekur është testimi i tregut dhe mbështetur mbi nevojat e dërguara me shkresë nga sicila ndërmarje varësie për sasitë e karburantit të nevojshme për vitin 2017 është përcaktuar vlera prej 13,190,550 lekë.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht znj. I. G., z. E. N. dhe znj. E. S.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me Urdhër nr 15 date 24.02.2017 e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. T. M., z.A. H., dhe znj. V. K.
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave, ndërsa mungon në dosjen e procedurës së prokurimit procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim kjo me neni 66, *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 3* të VKM 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku shprehimisht thuhet:
❖ *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*
Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Nga ana e OE "A." sh.a. është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 1737 Prot., datë 13.04.2017 pranë Bashkisë Berat, mbi vlerësimin e ofertës ekonomike të paraqitur nga ky OE nga ana e KVO, ku ka parashtruar argumentat e tij. Bashkia Berat me shkresën nr. 1737/1 datë 14.04.2017 i ka kthyer përgjigje OE ku nuk është pranuar ankesa e OE me argumentin se shoqëria nuk disponon aktin teknik të lëshuar nga PMNZH dhe poolicën e e sigurimit të lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në RSh.
Në dosjen e tenderit rezultoj se:
-mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),

-mungon Proçes Verbali i pezullimit të porcedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,
Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi AK.

-Nga vlerësimi i KVO-së sipas raportit përmbledhës, rezulton se janë s'kualifikuar 3 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator i cili është shpallur fitues.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	P.	13,127,576	Kualifikohet, Fitues
2	E.	12,556,762	Skualifikohet
3	A.	11,681,898	Skualifikohet
4	K.	13,455,173	Skualifikohet

Janë s'kualifikuar ofertuesit:
1-" E. " sh.p.k ka këto mangësi:

- Ekstrakti tregtar është jashtë afatit të kërkuar në DST
- Mungon sigurimi ofertës
- Mungon kopje vërtetuar e bilanceve të viteve 2013-2015
- Mungon certifikatë e gjendjes financiare
- OE nuk ka një pikë furnizimi me vendodhje në BR
- Mungon Leje për tregtim karburanti të lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore
- etj

2-" S.& "A." " sh.p.k pasi:

- A&T i mungon police sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve

3-" K. " sh.p.k pasi:

- Oferta është më e lartë se fondi limit i përcaktuar

OE të kualifikuar.
OE "P." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:
Në DST është përcaktuar në kriteret e veçanta të prokurimit përveç të tjerave edhe si më poshtë:

1.Pervoje e suksesshme ne ekzekutimin e te pakten:

-Pune te ngjashme të së njëjtës natyrë,per nje kontrate te vetme në një vlerë prej 40% te vleres qe prokurohet : 5,276,220(pese milion e dyqind e shtatedhjet e gjashte mije e dyqind e njezet) lekë pa T.V.SH, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit; ose

Per te vertetuar pervojen e meparshme te paraqiten vertetime te leshuara nga nje ent publik ose/dhe fatura tatimore te shitjes ku te shenohen datat,shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

2. Operatori ekonomik, të ketë minimumi 1 (nje) pike furnizimi me vendndodhje ne qytetin e Beratit, të pasqyruara këto në Ekstraktin e shoqërisë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit

Nga auditimi i dokumentave të paraqitura nga OE është paraqitur kontrata e furnizimit e lidhur me Bashkinë Berat për vitin 2016 por mungojnë tek dokumentet e ngarkuar në SPE si vërtetimi për realizimin e kontratës ashtu edhe faturat tatimore të lëshuara nga OE.

OE në ekstraktin e QKR ka të deklaruar si Adresë kryesore dhe të vetme të atë periudhë të ushtrimit të aktivitetit :

Berat,Velabisht, Fshati Velabisht, rruga kryesore, go~ine nje kateshe nr.16, zona kadastrale nr.3722, me numer pasurie : 1/10.

Duket qartë se adresa e ushtrimit të aktivitetit nuk është në përputhje me kërkesat e DST ku është përcaktuar qartë se OE duhet të ketë pikë furnizimi me vendndodhje në qytetin e Beratit.

Si rrjedhojë konstatohet se OE nuk i përmbush përcaktimet e veçanta të vendosura në DST.

Bazuar në nenin 53 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar në zbatim të tij sipas të cilit thuhet se *"... autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentat e tenderit...."* oferta duhet të konsiderohej e pavlefshme dhe oferta e OE duhej skualifikohej dhe tenderi duhet të anullohej.

Veprimet dhe mosveprimet, sa trajtuar më sipër, janë objekt i veprimtarisë së anëtarëve të KVO sipas të dhënave të tenderit në tabelën më sipër të cilat nuk kanë bërë të mundur sigurimin e efektivitetit, eficencës dhe ekonomicitetit të përdorimit të fondeve publike në shumën prej **1,445,678 lekë** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. T.M., me detyrë zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V. K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/2, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Procesverbali i hartimit të dokumentave të tenderit është një dokument që bëhet pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk i vihet në dispozicion OE dhe mosargumentimi i kërkesave të veçanta nuk bie ndesh me parimet kryesore të ligjit 9643. Argumentimi ose jo i kritereve të veçanta për kualifikim nuk sjell pasoja ose ndryshime në procedurën e prokurimit pra as nuk favorizon dhe as nuk diskriminon asnjë nga OE.
Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/5, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

1.Përvoje e suksesshme në ekzekutimit e te paktën :
Punë të ngjashme të së njëjtës natyrë,për një kontratë të vetme në një vlere prej 40 % të vlerës që prokurohet: 5,276,220 (pesë million e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet) lekë pa TVSH të realizuar gjatë tre viteve te fundit të aktivitetit të operatorit ; ose
Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku te shënohen datat ,shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuar.
Për sa me sipër ju sqarojmë se operatori ekonomik ka paraqitur vetëm kontratën e furnizimit të lidhur me Bashkinë Berat për vitin 2016 pasi në DST është shkruar fjala ose Për të vërtetuar përvojen e mëparshme të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat ,shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuar. KVO shqyrton ofertat sipas kriterve të vendosura ne DST .
2.Operatori ekonomik ,të ketë minimumi 1 (një pikë)furnizimi me vendodhjen në qytetin e Beratit ,të pasqyruara keto në Ekstraktin e shoqërise të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit
OE në ekstraktin e QKR ka deklaruar si adresë kryesore dhe të vetme në atë periudhe të ushtrimit të aktivitetit :
Berat,Velabisht ,Fshati Velabisht ,rruge kryesore ,godinë njëkateshe nr.16 ,zona kadastrale nr.3722,me numër pasurie 34/10.
Ju sqarojmë se kvo duke u mbështetur dhe në ligjin Nr.115/2014 dt 31.07.2014 Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, fshati Velabisht është njësi administrative pjesë e qytetit të Beratit dhe kjo pikë karburanti ndodhet në një distance shumë të afërt me qendrën e qytetit duke arsyetur kualifikues këtë kriter.
Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditmit mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "P." sqarojmë se argumenti i paraqitur nga ana e KVO në lidhje me adresën e deklaruar nga OE dhe distanca me qendrën e qytetit merren në konsideratë ndërsa për pasaktësitë e tjera të konstatuara nga grupi i auditimit nuk janë paraqitur argumente ligjore justifikues.*
Pretendimi juaj merret pjesërisht në konsideratë.

5. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* "Blerje materialesh elektrike" Berat

Sipas kërkesës së:Ndërmarrjes së Shërbimeve Publik

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje materialesh elektrike" Berat Sipas kërkesës së: Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike		
1.Urdhër Prokurimi nr.38, datë 20.04.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kërkesë për propozime	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit të kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.E. N. (Arkitekt) 2.E. S.(Ekonomiste) 3.I. G.(Juriste)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.39 datë 20.04.2017 1.T. M. , kryetar 2.A. H. anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,636,342 lekë	**6.Oferta fituese**: "K." SHPK Vlera 1,570,000 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 66,342 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 04.05.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 6 OE b)S'kualifikuar 1OE, c) Kualifikuar 5 OE
11.Ankimime AK: jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP jo**
		Dt lidhjes kontratës: 29.05.2017 **Afati kontratës: deri në përfundim të mallit**

Situata:

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se OE K.i cili është shpallur fitues nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për furnizimin me mallra sipas përcaktimeve të bëra për të cilën nuk është mbajtur sigurimi i kontratës dhe më konkretisht:

Kontrata e lidhur mban nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 midis Bashkisë Berat të përfaqësuar nga Kryetari i bashkisë z. P. . vlerë 1,884,000 lekë.

Me shkresën nr. 15 prot. datë 07.06.2017 nga ana e OE ”K.është dorëzuar një kërkesë ku thuhet “...OE kërkon të tërhiqet nga tenderi me objekt Blerje Materiale Elektrike për ndërmarrjen e shërbimeve publike për arsye pasi nuk janë të përcaktuara sipas manualit për këto arsye kërkoj tërheqjen nga tenderi...”

Kriteri:

Neni 24, VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, dhe nenit 13, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Impakti:

Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24, Sigurimi i kontratës, nga ana e Bashkisë Berat nuk është mbajtur sigurimi i kontratës, siç është përcaktuar në kontratën nr. 2517 prot., datë 29.05.2017 pika 32.2 ku thuhet se : “shuma e sigurimit të kontratës 188,400 lekë duhet ti paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Shuma prej ***188,400 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë*** pasi duhej të sekuestrohej sigurimi i kontratës nga enti ku është bërë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor për mosveprime të tyre bazuar në LPP.

Shkaku: Mosmbajtja e sigurimit të kontratës për procedurat e parealizuara nga ana e OE.

Rëndësia: **I lartë**

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Ka dalë urdhri i prokurimit nr.38, datë 20.04.2017 i kryetarit të bashkisë z. P. S.. Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 1,636,342 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.

Preventivi dhe kërkesa për sasitë janë hartuar nga Ndërmarja e Shërbimeve Publike të Bashkisë Berat.

Dosja e procedurës së prokurimit është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, bazuar në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Zhvillimi i Procedurës:

Nga auditimi në elektronik dhe dokumenteve faktik të procedurës së prokurimit sa më sipër rezultoi se në tender kanë marrë pjesë 6 operator ekonomik, KVO ka kryer vlerësimet si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomik pjesmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	"KON."	1,570,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*
2	MU.	1,571,050	*Kualifikuar*
3	D.	1,598,000	*Kualifikuar*
4	A.	1,617,900	*Kualifikuar*
5	A.	1,629,450	*Kualifikuar*

6	"D.	1,585,700	S'kualifikuar *për arsyet e mëposhtëme*: -Mungon vërtetimi i lëshaur nga Bashkia ose njësitë administrative për shkyerjen e taksave vendore për vitin 2016

-Me Proces-Verbalin nr. ska datë 04.05.2017 është bërë pranimi i ofertave ku kanë rezultuar si më sipër paraqitur. Mungon Proces-Verbalin i vlerësimit të ofertave, nga ana e KVO është mbajtur vetëm Proces-Verbali mbi llogaritjen e ofertës anomalisht të ulët nga ku ka rezultuar se të gjitha ofertat e paraqitura ishin të rregullta. Me shkresën nr. ska prot., datë 17.05.2017 është mbajtur Raporti Përmbledhës dhe po në atë datë me shkresën nr. ska prot., është plotësuar formulari i fituesit i cili shpall OE "K." fitues të procedurës ***"Blerje materialesh elektrike"*** me vlerë të ofertës 1,570,000 lekë. Nuk ka patur ankesa nga OE e tjerë që kanë marë pjesë në procedurën elektronike.
Kontrata e lidhur mban nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 midis Bashkisë Berat të përfaqësuar nga Kryetari i bashkisë z. P. S. dhe administratori i shoqërisë "K." z. Gj. Zh. me vlerë 1,884,000 lekë.
Me shkresën nr. 15 prot. datë 07.06.2017 nga ana e OE "KON." është dorëzuar një kërkesë ku thuhet "...*OE kërkon të tërhiqet nga tenderi me objekt Blerje Materiale Elektrike për ndërmarrjen e shërbimeve publike për arsye pasi nuk janë të përcaktuara sipas manualit për këto arsye kërkoj tërheqjen nga tenderi*..."

Gjithashtu nga ana e AK është dërguar shkresa me nr. 3226 prot., datë 17.07.2017 pranë APP-së ku është vënë në djeni për mospërmbushjen e detyrimit kontraktual nga ana e OE "K." për sjelljen e mallrave të tenderuar. Bashkia Berat i ka kërkuar APP-së të marri masat përkatëse në lidhje me këtë OE. App-ja deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk ka marë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LPP për përjashtim nga procedurat e prokurimit shoqërinë "K." bazuar:

a.Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar" konkretisht: - nenit 13- Agjencia e Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për*
- pika 3ç – mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit
b.Në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës konkretisht:
-Pika 2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç tënenit 13 tëLPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj , përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24, Sigurimi i kontratës, nga ana e Bashkisë Berat nuk është mbajtur sigurimi i kontratës, siç është përcaktuar në kontratën nr. 2517 prot., datë 29.05.2017 pika 32.2 ku thuhet se : "shuma e sigurimit të kontratës 188,400 lekë duhet ti paguhet AK si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Shuma prej 188,400 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë pasi duhej të sekuestrohej sigurimi i kontratës nga enti ku është bërë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor për mosveprime të tyre bazuar në LPP.

Komente dhe sqarime: Nga subjekti Bashkia Berat për këtë procedurë nuk janë paraqitur kundërshtime.

6.Auditim i prokurimit publik me objekt*:* "Ndërtim ujësjellsi fshatit Qereshnik, Njësia administrative Otllak Berat"

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "NDERTIM UJSJELLSI FSHATIT QERESHNIK, NJESIA ADMINISTRATIVE OTLLAK BERAT"		
1.Urdhër Prokurimi nr.51, datë 27.07.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** Tender i hapur	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.E. N. (Arkitekt) 2.F. K.(Jurist) 3.M. Xh.(Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.56 datë 04.09.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H. anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 37 373 332.8lekë	**6.Oferta fituese**: "31 000 701" B.Sh.p.k & C. "shpk	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 6 272 631.8 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 03.11.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise /	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 4OE b)S'kualifikuar 1OE, c) Kualifikuar 3OE
11.Ankimime AK: po Nr.3553 prot date 11.08.2017 AK: po Nr.3566 prot date 14.08.2017	**12. Përgjigje ankesës nga AK** nr Nr.3553/1 prot date 14.08.2017 Nr.3566/1 prot date 16.08.2017	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP jo**
		Dt lidhjes kontratës: 06.10.2017 **Afati kontratës: 354 ditë**

Situata:

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se BOE "B.& C." nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga NJHDT, konkretisht:

Në kriteret e vendosura në DST është përcaktuar në llojin e makinerive dhe pajisjeve ndër të tjerave dhe :

- Fadrome copë 2
- Autobot Uji copë 2

Për kërkesën e parë nga dokumentat e paraqitura në BOE konstatohet se OE CAUSHI ka paraqitur për Fadrome mjetin me targë ACMT 60 me kontratë qeraje me nr. 1313 Rep., nr. 213/1 Kol datë 01.04.2016, në dokumentat e paraqitura Polica e sigurimit të mjetit është e palexueshme.

OE Boshnjaku B. ka paraqitur dokumentat për Fadrome vetëm akt cdoganimin e mjetit ndërkohë *makineria e mësipërme rezuton e paregjistruara dhe e pashoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikes së Shqipërisë ,Neni 113.*

Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike,

2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit.

4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

Në lidhje me kërkesat e AK për Autobot Uji copë 2 nga ana e BOE janë paraqitur tek deklarata e disponibilitetit të mjeteve shtojca 9, përkatësisht nga OE C. Kamion me

	targe TR9224K me kontratë qeraje dhe nga OE Boshnjaku B. Kamioni me targë AA984DA në pronësi. Të dy këto mjete nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar në DST pasi janë kamiona dhe jo autobot uji siç kërkohet.
Kriteri:	VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Impakti:	BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "B." shpk & "C." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar
Shkaku:	Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.
Rëndësia:	**I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.51 datë 27.07.2017, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. E. N., (Inxhinier), znj. F. K.(Jurist) dhe znj. M. Xh.(Ekonomiste).

Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 37,373,332.8 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.

Fondi limit dhe projekti është llogaritur dhe hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe kontrollit të Territorit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. E. N., znj. F. K. dhe znj. M. Xh..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me Urdhër nr 52 date 27.07.2017 e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. T. M., z.A. H., dhe znj. V. K..

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave, ndërsa mungon në dosjen e procedurës së prokurimit procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, në kundërshtim kjo me neni 66,

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, *pika 3* të VKM 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku shprehimisht thuhet:

❖ *Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

Nga ana e OE "S." sh.a. është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 3553 Prot., datë 11.08.2017 pranë Bashkisë Berat, mbi disa nga kriteret e vendosura nga AK në DST.
Bashkia Berat me shkresën nr. 3553/1 datë 14.08.2017 i ka kthyer përgjigje OE ku disa nga kërkesat e OE janë marë parasysh nga ana e AK.
Nga ana e OE "P." sh.a. është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 3566 Prot., datë 14.08.2017 pranë Bashkisë Berat, mbi disa nga kriteret e vendosura nga AK në DST.
Bashkia Berat me shkresën nr. 3566/1 datë 16.08.2017 i ka kthyer përgjigje OE ku disa nga kërkesat e OE janë marë parasysh nga ana e AK. Janë pasqyruar në SEP shtojcat përkatëse me ndryshimet e bëra në DST nga AK duke u nisur nga ankesat e bëra nga OE.
Në dosjen e tenderit rezultoj se:
-mungojnë Proçes Verbalet për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),
-mungojnë Proçes Verbalet e pezullimit të procedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,
Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi AK.

-Nga vlerësimi i KVO-së sipas raportit përmbledhës, rezulton se është s'kualifikuar 1 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 3 operatorë nga të cilët është shpallur fitues BOE B.Sh.p.k & C."shpk i cili është shpallur fitues dhe është lidhur kontrata me nr. 4398 prot., datë 06.10.2017.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	B.& C.	31,000,701	Kualifikohet, Fitues
2	S.	34,319,831	Kualifikohet
3	T.	37,200,668	Kualifikohet
4	A.	ska	Skualifikohet

OE A.është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument në SEP.

BOE "B.& C." shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:
Në kriteret e vendosura në DST është përcaktuar në llojin e makinerive dhe pajisjeve ndër të tjerave dhe :

- Fadrome copë 2
- Autobot Uji copë 2

Për kërkesën e parë nga dokumentat e paraqitura në BOE konstatohet se OE C. ka paraqitur për Fadrome mjetin me targë ACMT 60 me kontratë qeraje me nr. 1313 Rep., nr. 213/1 Kol datë 01.04.2016, në dokumentat e paraqitura Polica e sigurimit të mjetit është e palexueshme.
OE B.ka paraqitur dokumentat për Fadrome vetëm akt cdoganimin e mjetit ndërkohë *makineria e mësipërme rezuton e paregjistruara dhe e pashoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik, dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikes së Shqipërië*
Neni 113
Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike,
2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit.
4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

Në lidhje me kërkesat e AK për Autobot Uji copë 2 nga ana e BOE janë paraqitur tek deklarata e disponibilitetit të mjeteve shtojca 9, përkatësisht nga OE C. Kamion me targe TR9224K me kontratë qeraje dhe nga OE B.Kamioni me targë AA984DA në pronësi. Të dy këto mjete nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar në DST pasi janë kamiona dhe jo autobot uji siç kërkohet.
Pra BOE nuk plotëson numrin e makinerive të kërkuara nga AK.

Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "B." shpk & "C." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:
- neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, germa (ç), ku thuhet :

"*Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*

- neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, ku thuhet:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.

- nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3:

"3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. T.M., me detyrë ish zv.Kryetare, z.A. H., me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V.K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/1, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot.,

datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Procesverbali i hartimit të dokumentave të tenderit është një dokument që bëhet pjesë e dosjes së tenderit dhe nuk i vihet në dispozicion OE dhe mosargumentimi i kërkesave të veçanta nuk bie ndesh me parimet kryesore të ligjit 9643. Argumentimi ose jo i kritereve të veçanta për kualifikim nuk sjell pasoja ose ndryshime në procedurën e prokurimit pra as nuk favorizon dhe as nuk diskriminon asnjë nga OE.
-Të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim të vendosura në këtë procedurë janë të dokumentuara në procesverbalin e hartimit të dokumnetave të tenderit dhe janë vendosur në përputhje me objektin e prokurimit.
Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/5, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 8 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5808 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
Në kriteret e vendosura në DST është përcaktuar në llojin e makinerive dhe pajisjeve ndër të tjerave dhe :
-Fadromë copë 2
-Autobot Uji copë 2
Për kërkesën e parë nga dokumentat e paraqitura në BOE konstatohet se OE Ç. ka paraqitur për Fadromë mjetin me targë ACMT 60 me kontratë qeraje me nr. 1313 Rep., nr. 213/1 Kol datë 01.04.2016, në dokumentat e paraqitura Policia e sigurimit të mjetit është e palexueshme.
OE B. ka paraqitur dokumentat për Fadromë vetëm akt çdoganimin e mjetit ndërkohë makineria e mësipërme rezulton e paregjistruara dhe e pashoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe policë sigurimi në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.
Në lidhje me kërkesat e AK për Autobot Uji copë 2 nga ana e BOE janë paraqitur tek deklaratat e disponibilitetit të mjeteve shtojca 9, përkatësisht nga OE C. Kamion me targe TR9224K me kontratë qeraje dhe nga OE B. Kamioni me targë AA984DA në pronësi. Të dy këto mjete nuk plotësojnë kriteret e përcaktuar ne DST pasi janë kamiona dhe jo autobot uji siç kërkohet.
Ju sqarojmë se :
-Në lidhje me pretendimin se Fadroma e paraqitur nga operatori Ekonomik Ç. Shpk policia e sigurimit është e palexueshme, ju bëjmë me dije se pavarësisht se Policia e sigurimit të mjetit është e mjegullt lexohet me sy të lirë lloji i mjetit ACMT60 dhe dallohet shumë qartë periudha e sigurimit të mjetit i cili është i vlefshëm deri në 19/10/2017 , pra brenda afatit të zhvillimit të procedurës.
-Shoqëria B.shpk ka paraqitur gjithashtu 2 mjete të tipit fadrome ku për mjetin tip fadrome Cat 318 me nr shasie 8AL00525 përveç akt zhdoganimit është e shoqëruar me kontratë shitblerje. Duke qenë se është mjet që tërhiqet, nuk ka nevojë për leje qarkullimi , dhe targa e njohjes është e qartë në aktin e shitblerjes, ashtu dhe në fletën e zhdoganimit bashkëngjitur. Për më tepër kjo shoqëri ka paraqitur mjetin tjetër tip Fadrome Caterpillar tipi 428 CT me nr shasie 2CR01353 të shoqëruar me faturë tatimore blerje dhe me dokumentat e nevojshme për makineritë që nuk

janë të regjistruara në regjistrat publike, pasi edhe kjo makineri nga kjo shoqëri është deklaruar si makineri që tërhiqet.
Përveç këtyre shoqëritë kanë paraqitur mjete të tipit grejder i cili shërben gjithashtu si fadrome dhe e bën punën në mënyre akoma më efikase. Pra shoqëritë kane paraqitur më shumë makineri sesa janë kërkuar, dhe ne e kemi arsyetuar kualifikues këtë kriter.
Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditmit mbi kualifikimin e padrejtë të BOE sqarojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte.* ***Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë***.

Për aktivitetin e vitit 2018

Nga **27** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 249,636,491 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **14** procedura me vlerë kontrate prej 218,657 mijë lekë, ose 87% e totalit të kontratave, ku **7** procedura ose 50% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar

1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Blerje fadrome për Drejtorinë e Shërbimeve Publike".***

Situata:

Me kërkesën nr. 15/1 prot., datë 12.0.2018 të Drejtorit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Berat ka nxjerr urdhrin e Prokurimit nr. 1, datë 31.01.2018 për blerje fadrome për ndërmarrjen e shërbimeve publike. Njesia e Prokurimit përbëhet nga z. F. D. (inxhinier), E. T. (juriste) dhe A. Zh. (Ekonomiste). Është mbajtur proces verbali për përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në testimet e tregut, dhe është firmosur nga NJP.
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Dokumentet e tenderit kanë ndryshuar, dhe janë paraqitur me shtojcën e firmosur nga NJP.

KVO është ngritur me urdhrin nr. 74, datë 31.01.2018 dhe përbëhet nga zj. T. M. (kryetare), A. H. dhe A. Dh. (anëtarë).
Në këtë tender ka marrë pjesë vetëm 1 OE, konkretisht "P." shpk, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertë në vlerën 8,208,333 lekë, ose 125,000 lekë më e ulët se fondi limit.
Në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur, rezulton se ky OE, nuk përmbush të gjitha kriteret, dhe konkretisht atë në lidhje me Certifikatën ISO 14001:2004, e cila rezulton të jetë e papërkthyer.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto

kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "P." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T.M., z. A. H. dhe znj. A. Dh..**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Mesme.**

1.Urdhër Prokurimi nr.1, datë 31.01.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** Tender i Hapur	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.F. D. (ingt) 2.E. T. (Jurist) 3.A. Zh.(Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.56 datë 04.09.2017 1.T. M. , kryetar 2..A. H. anëtar 3.A. Dh. , anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8 333 333 lekë	**6.Oferta fituese**: "8 208 333 P.	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 125 000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 05.03.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1OE
11.Ankimime AK: jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **07.05.2018**	**15. Afati i kontratës:** **10 ditë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "P." shpk	8,208,333	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/1 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP A.Zh., E. T.dhe F. D..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje me shkeljen e konstatuar nga KLSH për mos argumentimin e kërkesave për kualifikim të hartuara nga NJHDT, NJP sqaron se referuar ligjit për LPP, dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pika 2 e nenit 61, ka mbajtur procesverbalin e datës 01.02.2018 ku ka argumentuar kërkesat për kualifikim në përputhje me nenin e cituar.
2.Në lidhje me kërkesën për Certifikatën BS ISO 39001:2012 "Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor", NJP sqaron se në DST është kërkuar mirëmbajtja e mjetit si garanci për një vit, dhe vendosja e këtij kriteri është argumentuar duke u referuar përmbajtjes së kësaj ISO-je e cila ka në përmbajtjen e saj mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve industriale....etj çka është në përputhje me objektin e prokuruar.
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga NJP, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë se NJP nuk ka Hartuar kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mos bashkëlidhur procesverbalin në të cilin të argumentohen të gjitha arsyet e vendosjes së të gjitha kritereve.
2.Pranohet pika e 2-të e observacionit në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO BS 39001:2012.

Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura në lidhje me certifikatën ISO, ndërsa për pjesën tjetër nuk kanë paraqitur prova dhe argumente.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T.M.a, A. H. dhe A. Dh.. Në lidhje me gjetjen, KVO sqaron se OE plotëson të gjitha kriteret, me përjashtim të certifikatës ISO 14001:2004 e cila është ngarkuar në sistem 2 herë, një në gjuhën angleze, ndërsa e dyta ne pjesën e fundit, emërtimin te koka e ka në gjuhën shqipe.*
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, kërkohet që "**nëse gjuha e përdorur është gjuha shqipe,** atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar të gjuhës shqipe". Ky OE nuk e plotëson kushtin e mësipërm për dokumentin ISO 14001:2004.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

*2.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Berat dhe Drejtorive vartëse".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 8, datë 10.04.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. E. Ç. (inxhinier), G. A. (juriste) dhe I. A. (Ekonomiste). Është mbajtur proces verbali për përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në testimet e tregut, dhe është firmosur nga NJP.

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 9, datë 10.04.2018 dhe përbëhet nga znj. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe A.Dh. (anëtarë).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët është kualifikuar OE "G.me ofertë **13,25,943 lekë,** ose sa vlera e fondit limit.
Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
1.Certifikata e mbrojtjes nga zjarri, është totalisht e palexueshme.



2.Në DST kërkohet që *Subjekti ofertues duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet (autobot) për furnizimin me karburant. Për këtë duhet të paraqesë leje qarkullimi për automjetin në pronësi, ose kontratë qiraje me akt noterial dhe leje qarkullimi e pronarit të mjetit, në rastin e qiramarrjeve, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, certifikatën për transportin e lëndëve të rrezikshme.*

-Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se OE, ka paraqitur për mjetin autobot, kontratë qiraje me shoqërinë ”G.” sha për mjetin me Targa AA850DG. Ky mjet ka Certifikatën e Kontrollit Teknik të mjeteve të skaduar që me 16 Janar 2018, ndërsa siguracioni i detyrueshëm i mjeteve rezulton i skaduar që me 17 Prill 2018. Siç konstatohet, te dy këto dokumente janë jashtë afatit të vlefshmërisë së tyre në momentin e dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST.

3.Në DST, kërkohet *Autorizim për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor, sipas Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 ”Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.*

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE ka paraqitur Autorizimin e lëshuar nga Bashkia Shkodër, dhe jo nga Bashkia Berat siç është detyrimi i vendosur nga NJP në DST.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “G.” shpk dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia: **E Mesme.**

1.Urdhër Prokurimi nr. 8 datë 10.04.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2 E. C. (Inxhinier) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.3/1 datë 12.02.2018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3. A.Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 13 251 876 lekë	**6.Oferta fituese**: " G." SHPK Vlera 13 251 876 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 12.03.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **30.05.2018**	**15. Afati i kontratës** **Deri në mbarimin e sasisë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "K." shpk	13,631,561	S`kualifikuar
2	OE "E." shpk	14,439,266	S`kualifikuar
3	OE "A." shpk	13,461,891	S`kualifikuar
4	OE–"Gega Center GKG" shpk	13,251,943	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., A. H.dhe A. Dh.. Në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH, KVO sqaron se OE plotëson kriterin e certifikatës për mbrojtjen nga zjarri e cila është lehtësisht e lexueshme.*

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se në SPE, linku i parë është për certifikatën e mbrojtjes nga zjarri, dhe nuk ka asnjë dokument tjetër të ngjashëm. Ky dokument, rezulton totalisht i palexueshëm.*
Bashkëlidhur linku në SPE dhe dokumenti që mund të lexohet nga KVO.





Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi argumenti dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është provon pretendimin e tyre.

3.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e transportit".***

Situata:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 7, datë 26.03.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. E. Ç. (inxhinier), E. T. (juriste) dhe I. A. (Ekonomiste). Është mbajtur proces verbali për përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në testimet e tregut, dhe është firmosur nga NJP.
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 6, datë 26.03.2018 dhe përbëhet nga znj. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe A. Dh.(anëtarë).
Në këtë tender, ka marrë pjesë vetëm 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "P." me ofertë në vlerën **6,000,000 lekë,** ose 390,833 lekë më ulët se sa fondi limit.
1.Në lidhje me vlerësimin e kryer nga KVO, rezulton se OE fitues ka mangësi, pasi nuk përmbush njërën nga pikat për kapacitetin teknik, dhe konkretisht kërkesën sipas të cilës OE duhet *Të ketë kompjuter diagnostifikues të regjistruar*

në QKR.
-OE nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë disponimin e këtij kompjuteri sipas kërkesës së NJP në DST.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "P." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe znj. V. K..**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Mesme.**

1.Urdhër Prokurimi nr.7, datë 26.03.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kërkesë për propozime	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.E.C. (ingt) 2.E. T.(Jurist) 3.I. A.(Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.56 datë 04.09.2017 1.T. M., kryetar 2.A. H. anëtar 3.A. Dh. , anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6 390 833 lekë	**6.Oferta fituese**: "6 000 000 P.	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 390 833 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 16.04.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1OE
11.Ankimime AK: jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **08.05.2018**	**15. Afati i kontratës:** **12 muaj**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE "P." shpk	6,000,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T.M., A. H. dhe A. Dh.o. Në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH për mos paraqitjen e kompjuterit diagnostikues të regjistruar në QKR, KVO sqaron se është gjykuar që OE me regjistrimin në QKB, ka tregtimin e të gjitha llojeve të kompjuterëve pa kufizim. Ky kriter është përfshirë në tregtimin e kompjuterëve.*

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se në DST është kërkuar ekzaktësisht që OE të disponojnë kompjuter diagnosifikues të regjistruar në QKR. Kjo kërkesë nuk është përmbushur nga OE, pasi rezulton se nuk është paraqitur asnjë dokument provues që ky OE posedon një kompjuter sipas kërkesës së DST.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

*4.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Restaurim i mureve të Kalasë Berat".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 11, datë 26.04.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga znj. V. K. (inxhiniere), I. A. (ekonomiste) dhe G.B. (juriste).
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 11/1, datë 26.04.2018 dhe përbëhet nga zj. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe A. Dh. (anëtarë).
Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 5 OE, janë kualifikuar 2 dhe s'kualifikuar 3 të tjerët. Është shpallur fituese ofertë e OE "M." shpk me vlerë 6,826,124 lekë, ose 850,543 lekë me e ulët se fondi limit. Oferta me e ulët në këtë procedurë është ajo e OE "C." shpk me vlerë 6,311,555 lekë, ose 514,569 lekë me e ulët se oferta fituese.
"Në lidhje me klasifikimin e bërë nga KVO, OE "J." shpk ka paraqitur ankesë në bashkinë Berat me nr. 446 prot., datë 16.05.018, protokolluar me nr. 3657 prot, datë 16.05.2018. Në lidhje me ankesën e saj, ky OE pretendon se s'kualifikimi i bërë nga KVO e Autoritetit Kontraktor , Bashkia Berat, është i padrejtë dhe i pabazuar në ligj. Ky OE pretendon se 5 shkaqet e s'kualifikimit nuk qëndrojnë.
-Në lidhje me pikat e ankesës, Autoriteti Kontraktor ka kthyer përgjigje OE me shkresën me nr. 3657/1, datë 21.05.2018, në të cilën ka rrëzuar të gjitha pretendimet e palës ankuese si të pambështetura në ligj. Kjo shkresë mban firmën e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor.
Në lidhje me trajtimin e kësaj ankese, dhe mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ngritjen e Komisionit për Shqyrtimi e Ankesave, mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.
Nga kontrolli i dokumentacionit të ofertës fituese, rezulton se OE "M." shpk nuk përmbush të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht:
1.KVO, ka kualifikuar OE M.shpk në mospërmbushje të pikës "b" pika 1 të

kritereve të vecanta *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

-Ky OE, ka paraqitur vërtetimin e OSHEE me datë 05.05.2018, ndërkohë në datën e hapjes së tenderit është maturuar fatura e muajit Prill, e cila rezulton e papaguar nga ky OE. Rezulton se për të njëjtën arsye, është konsideruar shkak për s'kualifikim OE "C." shpk në të njëjtin tender, pasi nuk ka paguar faturën e muajit Prill, edhe pse ajo ishte e maturuar në momentin e hapjes së ofertave.

Siç konstastohet, KVO ka vepruar me dy standarde në të njëjtin tender.

2.Në DST, kërkohet që OE të disponojnë ndër të tjera për zbatimin e kësaj kontrate *2 kamionçina me kapacitet mbajtës 1-1.5 Ton.*

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE nuk e plotëson këtë kriter. Për mjetin kamionçinë me kapacitet 1-1.5 Ton, mjeti me targa SR5513B rezulton nga leja e qarkullimit me kapacitet mbajtës 0.85 Ton, ose 150 kg me pak se sa kapaciteti i kërkuar.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "M." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **514,569 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr.11, datë 26.04.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B.j (Jurist) 2.G. S. (Inxhiniere) 3.I.A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.11/1 datë 26.04.2018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7 676 667 lekë	**6.Oferta fituese**: "M." SHPK Vlera 6 826 124 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 850 543 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 07.05.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 5 OE

		b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Po **JOGI SHPK** Nr 3657 Dat:16.05.2018	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ka **JOGI SHPK** Nr 3657/1/1 Date:21.05.2018	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** SKA
	14. Data e lidhjes së kontratës: **12.06.2018**	**15. Afati i kontratës** **2 muaj**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "J."shpk	6,752,550	S`kualifikuar
2	OE"C." shpk	6,311,555	S`kualifikuar
3	OE "Sh." shpk	0	S'kualifikuar
4	OE–"L." shpk	7,600,635	Kualifikuar.
5	OE "M." shpk	6,826,124	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/4 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP G. B. dhe V. K..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje me kriteret e vendosura nga NJHDT, e cila është firmosur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, është hartuar relacioni teknik me argumentimet përkatëse për kërkesat për kualifikim firmosur.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Pranohet observacioni juaj në lidhje me pikat e mësipërme.*

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T.M., A. H. dhe A.Dh. KVO ka paraqitur observacionet si më poshtë:*
1.Në lidhje me faturën e maturuar të energjisë të papaguar nga OE ekonomik, KVO shprehet se OE M.shpk e ka paraqitur me datë 05.05.2018, ndërsa OE C.me 20.04.2018, duke paraqitur edhe shlyrjen deri me këtë datë, duke mos paraqitur shlyerjen për gjithë muajin Prill por vetëm 20 ditë të këtij muaji.
2.Në lidhje me mjetin vetëshkarkues me kapacitet 5-10 Ton, KVO sqaron se mjeti me Targa AA736CU del nga certifikata e pronësisë si mjet kamion vetëshkarkues, dhe nga fotot shihet që mund të bëjë shkarkimin me vinxh; ndërsa për kamionçinën me targa SR5513B me kapacitet mbajtës 1-1.5 Ton, KVO sqaron se ky mjet ka kapacitet mbajtës 1.665 Ton pra i plotëson kushtet sipas tyre.
3. Në lidhje me shpenzimin në kundërshtim me parimin e 3E-ve në vlerën 514,569 lekë, KVO sqaron se se s'kualifikimi i Operatorëve të tjerë ka qenë i drejtë, dhe njëkohësisht ka kualifikuar me të drejtë OE fitues, ç'ka nuk ka sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E-të në vlerën 514,569 lekë.
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me argumentin e mos pagesës së maturuar të energjisë, ku faturën e OE M.s shpk e ka konsideruar të rregullt dhe atë të OE C. të parregullt, rezulton se KVO nuk ka kryer një vlerësim të drejtë, pasi në thelb asnjëri nga OE nuk e ka paguar faturën e muajit Prill. OE M. shpk, ka paraqitur vërtetimin e datës 03.05.2018 i cili në përshkrim sqaron se detyrimet janë 0 lekë, pa përfshirë faturën koherente Prill 2018, pra rezulton se nuk është paguar fatura koherente, ndërkohë që OE C.shpk, ka paraqitur vërtetimin me datë 20.04.2018, në përshkrimin e të cilin thuhet që ky OE ka 0 detyrime, duke përfshirë faturën e muajit Mars. Pra nga sa shihet më sipër, të dy OE nuk e kanë paguar faturën e muajit Prill, dhe KVO ka bërë vlerësime të ndryshme për të njëjtën situatë.



OSHEE

Nr 1613 Prot. Fier, me 20 / 04 / 2018

VËRTETIM DEBIE
PËR OPERATORËT EKONOMIKË PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, PËR PERSONAT JURIDIKË TË INTERESUAR PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT E HAPURA, SI DHE PËR PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË TË INTERESUAR PËR PROCEDURAT QË LIDHEN ME ZBATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, LIDHUR ME NDËRTIMET E REJA

Bazuar në deklarimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Zi [redacted] vërtetojmë se kërkuesi "[redacted]" nga verifikimet e kryera [redacted] Faturimit, për kontraten[me[redacted]014295 , titullar i të cilës eshte Zyra Kolombo , rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën: 18. 04. 2018, duke përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2018.

Vërtetimi leshohet me kërkesën e "[redacted] SHPK" në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 379, datë 11.[redacted] "Për disa shtesa në Vendimin Nr.1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkese.

[redacted]



OSHEE

Nr 529 Prot. Gjirokaster, me 03 / 05 / 2018

VËRTETIM DEBIE
PËR OPERATORËT EKONOMIKË PËR PJESËMARRJE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK, PËR PERSONAT JURIDIKË TË INTERESUAR PËR MARRJEN E LEJEVE MINERARE NË ZONAT E HAPURA, SI DHE PËR PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË TË INTERESUAR PËR PROCEDURAT QË LIDHEN ME ZBATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, LIDHUR ME NDËRTIMET E REJA

Bazuar [redacted] deklarimet e deklaruesit (përfaqësuesit ligjor) Z[redacted] vërtetojmë se kërkuesi M[redacted] SHPK ,nga verifikimet e kryera [redacted] e Faturimit për kontraten/kontratat(mekod) GJOA01005102970 7,titullar i së cilës/cilave është Malo Mane ,rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 03/05/2018,ga përfshirë faturën koherente Prill 2018.

Vërtetimi lëshohet me kërkesën e [redacted] SHPK, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 379, datë 11.06.2014 [redacted] shtesa në Vendimin Nr.1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe jo më vonë se pesë ditë nga data e depozitimit të kësaj kërkese.

[redacted] OSHEE, sh.a.
Prokuroli
Drejtor Drejtoria Rajonale Gjirokaster
Operatori I Shperndarjes se Energjise Elektrike

2.Në lidhje me mjetin kamion vetëshkarkues me kapacitet 5-10 Ton, pranohet observacioni juaj, ndërsa për mjetin kamioçinë me Targa SR5513B, audituesit sqarojnë se ky mjet ka kapacitet mbajtës 0.85 Ton, pra poshtë atij të kërkuar në DST e cila duhet 1-1.5 Ton. Pretendimi i KVO se ky mjet ka kapacitet mbajtës 1.665 Ton nuk qëndron, pasi sipas lejes së qarkullimit, ky mjet është i certifikuar që pesha neto e tij plus ngarkesë të jetë 1.665 Ton, që edhe në këtë rast sërish di ishte jashtë kritereve të kërkuara të cilat duhet të jenë nga 1 deri në 1.5 Ton.
3.Në lidhje me kundërshtimin për vlerën e 3E-ve, audituesit sqarojnë se kjo vlerë ka ardhur si rezultat i kualifikimit të

padrejtë të OE M.shpk, i cili nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe njëkohësisht nuk ishte oferta me e favorshme, ndërkohë që për mangësi të vogla janë s'kualifikuar oferta më të favorshme ç'ka ka sjellë shpenzime në kundërshtim me 3E-të në vlerën 514,569 lekë.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

*5.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Mirëmbajtje kanale ujitëse dhe kulluese".***

Situata:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 16 datë 30.04.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. L. S. (inxhinier), I. A.(ekonomiste) dhe G. B. (jurist).

DT janë hartuar me procesverbal. DST nuk janë firmosur nga gjithë NJHDT, veprim në kundërshtim me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Nuk ka procesverbal për arsyen e mos firmosjes së DST nga njëri prej anëtarëve të saj.
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Dokumentet e tenderit janë ndryshuar nëpërmjet shtojcës së hedhur në SPE. Sipas trajtimit të NJP ndryshimet e bëra në kritere kanë ardhur si rezultat i një ankese, mgjth në dosjen e tenderit nuk ka asnjë ankesë në raport me kriteret e vendosura. Dokumenti fizik i shtojcës në dosje është pa firmën e anëtarëve të NJP dhe pa firmën e Titullarit të AK-së për miratimin e ndryshimeve.
-Nga vlerësimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme dhe diskriminuese në raport me volumet e punimeve.
1.Në DST kërkohet që *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjësish të siguruar, për periudhën , Janar 2017- Mars 2018.*
-Kjo kërkesë është diskriminuese dhe e paargumentuar, pasi ky numër është i lartë në raport me volumet e punimeve, dhe kjo pengon pjesëmarrjen e operatorëve tjerë.
2.Në DST kërkohet sipas grafikut 6 manovratorë, një numër shumë i lartë, i cili është në mospërputhje edhe me numrin e makinerive të rënda për të cilat janë kërkuar 2.
Këto kritere, përveçse nuk janë të argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin*

publik". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **z. G.B., z. L. S. dhe znj. I. A..**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 17 datë 30.04.2018, është ngritur KVO e cila përbëhet nga z. T. M. (kryetare), A. H. dhe A. Dh. (anëtar).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, s'kualifikuar 2 dhe kualifikuar 1 OE, konkretisht "S." shpk me ofertë 2,965,565 lekë i cili është shpallur fitues. Oferta e këtij OE është 836,102 lekë më e ulët se sa fondi limit. Dy ofertat e s'kualifikuara janë më të favorshme në aspektin ekonomik pasi janë rreth 300,000 mijë lek më të ulta se sa oferta e shpallur fituese. Arsyet e s'kualifikimit në të dyja rastet është mungesa e certifikatës ISO BSEN 13331-1:2002 mbi" Sistemet për veshjen e kanaleve".
-Nga dokumentacioni i paraqitur nga OE fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:
1.Për karpentierin P. K., rezulton se ka paraqitur dëshminë e kualifikimit jashtë afateve, pasi rezulton e skaduar që në Tetor 2017.
2.Inxhinieri Hidtroteknik N. K., ka paraqitur diplomën e panoterizuar.
3.Inxhinieri i ndërtimit A. S., ka paraqitur licencën dhe diplomën të panoterizuar, si dhe nuk rezulton në listpagesë për vitin e fundit siç kërkohet.
4.Në DST, është kërkuar për makineritë në dispozicion, të paraqiten edhe fotot e tyre.
-Nga kontrolli rezulton se për eskavatorin me zinxhirë, nuk janë paraqitur fotot sipas kërkesës në DST.
5.Nuk plotëson kriteret për 6 manovratorë, pasi vetëm njëri prej tyre z. T. Xh. ka dokumentacionin e rregullt. Manvoratorët e tjerë kanë këto mangës: L. Xh. ka paraqitur dëshminë e aftësisë profesionale të panoterizuar, P. Gj., B. Z., F. M. dhe O. B. nuk kanë paraqitur dëshmi kualifikimi për drejtimin e mjeteve të rënda por vetëm kontata punë, ndërsa për manovratorin B.Z. nuk është paraqitur kontrata e punës.
6.OE, nuk plotëson gjithashtu kushtin për numrin e 55 punonjësve për zbatimin e kësaj kontrate, pasi në listëpagesën e paraqitur, rezultojnë të punësuar 48 punonjës nga 55 të kërkuar në DST.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorin ekonomik "S." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia: **I Lartë.**
Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **359,087 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr. 16 datë 30.04.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2.L. S. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.17 datë 30.04.02018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3. A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3 801 667 lekë	**6.Oferta fituese**: "S." SHPK Vlera 2 965 565 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 836 102 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 14.05.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **18.06.2018**	**15. Afati i kontratës** **1 muaj**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"Al."shpk	2,606,478	S`kualifikuar ".
2	OE "F." shpk	2,634,000	S`kualifikuar
3	OE "S." shpk	2,965,565	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/2 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP G. B. dhe L. S..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje me fondin limit, NJP argumenton se vlera e fondit limit, merret vlera e llogaritur nga preventivuesi e parashikuar për projektin.
2.Në lidhje me arsyen e mosfirmosjes së DST nga gjithë anëtarët e NJP, sqarohet se njëri prej punonjësve nuk ka qenë i punësuar në bashki, por në ndërmarrjen e ujësjellësit, dhe si inxhinier i jashtëm, nuk jam njoftuar për shkak të një lapsusi për të firmosur dokumentet.
3.Në lidhje me vlerësimin e kërkesave si të papërshtatshme dhe diskriminuese, NJP sqaron se kërkesat kanë qenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit në tender.
4.Në lidhje me numrin mesatar prej 55 punonjësish për periudhën Janar 2017-Mars 2018, NJP sqaron se ky numër ka dal përllogaritja e volumeve me normat orare të marra nga manuali i vitit 2015.
5.Në lidhje me kërkesën për 6 manovratorë, NJP sqaron se janë kërkuar 2 mjete transporti, 1 fadromë, 1 ekskavator dhe 3 saldatriçe, dhe ndaj kërkohet ky numër manovratorësh.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me observacionet e mësipërme, audituesit sqarojnë se në pikën e dytë të observacionit, është detyrim sipas nenit 61, pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, firmosja e DT nga gjithë anëtarët e njësisë. Argumenti se kam qenë i jashtëm nuk qëndron, pasi supozohet që anëtari i njësisë së prokurimit ka qenë pjesë e grupit deri në përfundim të procesit të hartimit, i cili konkludohet me firmosjen e këtij dokumenti.
2.Në lidhje me pretendimin se kërkesat nuk janë të papërshtatshme dhe diskriminuese, pasi ato janë të barabarta për të gjitha pjesëmarrësit në tender, audituesit sqarojnë se sipas nenit 23, pika 2 të LPP, kërkohet që "Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për

konkurrencën e hapur në prokurimin publik". *Pretendimi se kërkesat janë të njëjta për gjithë ofertuesit nuk qëndron, pasi pikërisht disa kërkesa jo në përputhje me volumet e punës, dhe njëkohësisht të paargumentuar me procesverbal sipas detyrimeve të nenit 61, pika 2 të VKM-së së mësipërme, e bëjnë të pabarabartë konkurrimin ndërmjet ofertuesve.*
3.Në lidhje numrin mesatar të kërkuar prej 55 punonjësish për periudhën Janar 2017-Mars 2018, audituesit sqarojnë se në respektim të nenit 61, pika 2 të VKM-së së mësipërme, AK duhet të argumentojë me procesverbal vendosjen e çdo kriteri të veçantë.
4.Në lidhje me numrin e manovratorëve, audituesit sqarojnë se pretendimi i i NJP nuk qëndron, pasi është kërkuar 1 saldator, dhe nuk ka specifikuar në DST nëpërmjet procesverbalit për argumentimin e dokumenteve të tenderit arsyet dhe shpërndarjen e 6 manovratorëve, veprim ky në kundërshtim me nenin 61, pika 2 të VKM-së së cituar më sipër.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., A.H.dhe A.o Dh.. Në lidhje me shkeljet e konstatuara, KVO ka paraqitur observacionet si më poshtë:*
1.Në lidhje me karpentierin P.K., KVO sqaron se dëshmia e kualifikimit e cila është jashtë afateve, nuk e bën të pakualifikueshëm, pasi ai thjesht nuk ka bërë ripërsëritjen e certifikatës.
2.Në lidhje me inxhinierin hidroteknik N. K. i cili ka paraqitur diplomën të panoterizuar, KVO sqaron se dokumentet i dorëzohen noterit i cili i noterizon me vulë lidhëse të gjitha bashkë, ku ndër to është edhe diploma.
3.Në lidhje me inxhinierin e ndërtimit A.S., i cili ka paraqitur diplomën dhe licencën të panoterizuar, KVO sqaron se dokumentet i dorëzohen noterit i cili i noterizon me vulë lidhëse të gjitha bashkë, ku ndër to është edhe diploma dhe licenca.
4.Në lidhje me Ing Mjedisi E. A.e cila ka paraqitur në CV-në e saj se nga viti 2014 e në vijim punon në CEZ-shpërndarje, KVO sqaron se në CV-në e saj kur është nënshkruar kontrata para noterit, nuk mund të pasqyronte punën që do të kryente pas lidhjes së kontratës.
5.Në lidhje me makineritë në dispozicion dhe fotot e tyre, KVO sqaron se për fadromën dhe ekskavatorin me zinxhirë për të cilat nuk janë paraqitur fotot, bashkëlidhur ka paraqitur foto të fadromës të marrë nga sistemi.
6.Në lidhje me numrin mesatar të punonjësve për muajt Janar 2017 – Mars 2018 ku kërkohen mesatarisht 55 punonjës, KVO shprehet se ky OE e plotëson këtë kriter duke pasur mesatarisht 58.6 punonjës për këtë periudhë dhe nuk kundërshtim argumentin e audituesve që ky OE ka 48 punonjës në momentin e hyrjes në tender.
7. KVO në përfundim kundërshton argumentin e audituesve, të cilët kanë konkluduar se është kualifikuar OE S. shpk i cili nuk plotëson të gjitha kriteret. Sipas KVO ky OE i plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me karpentierin P. K., i cili e ka dëshminë e kualifikimit jashtë afateve, audituesit sqarojnë se vlefshmëria e afateve të çdo dokumenti ka rëndësinë e vet në çdo marrëdhënie. E njëjta gjë vlen si për dokumentacionin e makinerive, kontratave etj, të cilat kërkohen që të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Prandaj lëshuesi i asaj dëshmie ka vendosur edhe afatin e vlefshmërisë së saj duke përcaktuar edhe datën përkatëse.
2/3. Në lidhje me inxhinierin hidroteknik N. K. për diplomë të panoterizuar si dhe inxhinierin e ndërtimit A. S. për licencë dhe diplomë të panoterizuar, audituesit sqarojnë se në DST kërkohet ekzaktësisht që të gjitha dokumentet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në SPE, dokumentet e cituara më sipër, nuk kanë asnjë vulë e cila të provojë se ky dokumentacion është i noterizuar.
4.Në lidhje me inxhinieren e mjedisit E. A., audituesit pranojnë observacionin, mgjth është detyrim e punonjësit rifreskimi i CV-së, pasi rezulton me kontratë pune pranë kësaj shoqërie, ndërkohë ne CV-në e saj nuk rezulton e punësuar aty.
5.Në lidhje me numrin mesatar të punonjësve të kërkuar 55 për periudhën Janar 2017 – Mars 2018, audituesit sqarojnë se për zbatimin e kësaj kontrate, NJP ka krijuar një grafik për shpërndarjen e punimeve, sipas të cilit kërkohen ekzaktësisht 55 punonjës ndërkohë OE 7 muajt e fundit duke përfshirë edhe muajin në të cilin zhvillohet tenderi, ka një numër prej mesatarisht 48 punonjësish, çka është e pamjaftueshme për zbatimin e kësaj kontrate sipas kërkesës së DST.
6.Në lidhje me pretendimin se kualifikimi i OE S. shpk ka qenë i rregullt posi plotësonte të gjitha kushtet, audituesit sqarojnë se për arsyet e paraqitura në qëndrimin e audituesve në lidhje me observacionin e paraqitur, ky OE nuk plotësonte kushtet për t'u kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

*6.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikonstruksion i repartit të pediatrisë në spitalin e Beratit".***

Situata: Me urdhër nr. 12, datë 27.04.2018 të Kryetarit të Bashkisë, është përcaktuar Njësia e Prokurimit (NJP), e përbërë nga Z. G.B. (Jurist), V. K. (Inxhiniere), I. A. (Ekonomiste).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Në vlerësimin e kritereve të vendosura, rezulton vendosja e kritereve të paargumentuara, dhe konkretisht kërkesa e pikës 2.4 e DST e cila kërkon që *Ofertuesi duhet te përcaktoj me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai/ajo do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt dhe nuk janë të angazhuar në kontratat të tjera.*

Kjo kërkesë vjen në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".*

Siç rezulton, vlera e fondit limit për këtë tender është **12,452,107 lekë,** dhe në këto kushte, kërkesa për drejtuesin e punimeve me kohë të plotë në objekt është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me volumet e punës.

Ky kriter përveçse nuk është i argumentuara, është në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **z. G. B., znj. V. K. dhe znj. I. A.**

Me urdhër nr. 12/1, datë 27.04.2018 të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Ofertave (KVO), e përbërë nga znj. T. M. (kryetare), A. H.dhe A. Dh. (anëtar).

Në këtë tender, kanë marrë pjesë 6 OE, janë kualifikuar 4 OE dhe janë s'kualifikuar 2 të tjerë. Nga të kualifikuarit, fitues është shpallur oferta e BOE "B." & "Sh." shpk me vlerë 9,638,841 ose 2,813,266 lekë me e ulët se fondi limit. Nga oferta e s'kualifikuara, oferta ekonomike e OE "C." shpk është me e ulta me vlerë 9,458,245, ose 180,596 lekë më e ulët se oferta fituese.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE fitues, rezulton se ato nuk përmbushin të gjitha kriteret e vendosura nga NJP në DST, dhe konkretisht:

1.Nga aktmarrëveshja mes palëve për ndarjen e punimeve, OE "B." merr përsipër kryerjen e 89.45 % të punimeve dhe diferenca ose 10.55 % do kryhet nga OE "Sh." shpk.

Sipas pikës 2 për kriteret e veçanta në DST, kërkohet që OE të kenë në stafin e tyre për zbatimin e kësaj kontrate specialistë *elektrist 2, mekanik 1, hidraulik 2, murator 5, bojaxhi 2 dhe ekspert zjarrfikës 1.*

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE i cili merr përsipër kryerjen në masën 89.45 % të punimeve, ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 murator nga 4 të kërkuar, dhe nuk ka paraqitur asnjë elektricist, hidraulik, mekanik apo bojaxhi, pavarësisht se nga ana e këtij OE do kryheshin punime të këtyre kategorive. Mos plotësimi i këtyre kushteve përbën shkak për s'kualifikimin e këtij OE nga gara për këtë tender.

2.BOE, nuk përmbush kërkesën e vendosur në DST për autobotin e ujit mbi 10 Ton, kjo pasi mjetet e paraqitura rezultojnë me mangësi. Mjeti i paraqitur nga OE "B." shpk me targa AA387PA, i marrë me kontratë qiraje nga J., ka kapacitet mbajtës sipas lejes së qarkullimit 6.78 Ton, ose 3.22 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar në DST. Mjetet e paraqitura nga OE "Sh." shpk, me Targa ADR202 dhe ABR004, të marra me kontratë qiraje nga subjekti "I." sha, rezultojnë mjete për transport mallrash të rrezikshme dhe jo për transportin e ujit. Kjo paraqitet edhe nga fotot, të cilat paraqesin mjetet me kode për transport mallrash të rrezikshme si dhe certifikatat me përmbajtje për transport lëndësh të rrezikshme.

Sa më sipër, ky BOE nuk e plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë "B." shpk dhe "Sh." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **180,596 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr. 12 datë 30.04.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2V. K. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.12/1 datë 30.04.02018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3. A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 12 452 107,9 lekë	**6.Oferta fituese**: " B.SHPK Vlera 9 638 841 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2 813 266.9 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 01.06.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 6 OE b)S'kualifikuar 2 OE,

		c) Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **18.07.2018**	**15. Afati i kontratës** **2 muaj**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"C."shpk	9,458,245	S`kualifikuar
2	OE"S." shpk	10,656,016	S`kualifikuar
3	OE "C." shpk	11,144,086	Kualifikuar.
4	OE–"S." shpk	11,005,114	Kualifikuar.
5	OE "T." shpk	12,071,100	Kualifikuar.
6	OE "B.." shpk	9,638,841	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/5 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP G. B.j dhe V. K..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje me argumentimin me procesverbal të kërkesave për kualifikim, NJP sqaron se është mbajtur ky procesverbal i cili është miratuar nga titullari i AK-së, bashkëlidhur këtij observacioni.
2.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.4, në të cilën kërkohet të përcaktohet me anë të një deklarate drejtuesi teknik i punimeve i cili duhet të jetë i pranishëm gjate gjithë kohës ku kryhen punimet, NJP e konsideron një lapsus pasi në procesverbalin mbi HDT të datës 27.04.2018 dhe në relacionin teknik të hartuar, ky kriter nuk është vendosur.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Pronohet pika 1 e observacionit.
2.Në lidhje me pikën e 2-të të observacionit tuaj, audituesit sqarojnë se kërkesa e mësipërme u është drejtuar operatorëve ekonomikë nëpërmjet SPE, dhe NJP ka pasur gjitha mundësitë që nëpërmjet një shtojce për modifikimin e dokumenteve të tenderit, të bënte modifikimin e këtij lapsusi në sistem. Ky kriter, mund të përbëjë shkak për trajtim jo të barabartë mes operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 23, pika 2 të LPP.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur në lidhje me pikën 2.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T.M., A.H. dhe A.o Dh.. Në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH për mungesën e specialistëve nga OE B.i cili ka marrë përsipër 89.45% të punimeve, KVO sqaron se ky është një kriter teknik dhe BOE i plotëson së bashku.*

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se sipas nenit 74, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përcaktohet qartë që "*Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato **teknike** duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

7.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Asfaltim dhe shtrim rrugësh me beton, mirëmbajtje me çakull dhe tombino e mure mbajtëse në njësitë administrative dhe lagjet e qytetit".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 22 datë 28.05.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. G. B.(jurist), I. A. (ekonomiste) dhe M. B. (arkitekt). Nuk ka procesverbal për përllogaritjen e fondit limit.

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur një procesverbal nga inxhinieri i NJP ku sqaron kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar

Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK-së janë paraqitur dy ankesa nga OE "Eni" shpk dhe "Salillari" shpk. Ankesa e subjektit "E." shpk është protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 4094, datë 08.06.2018. OE ankohet për numrin e teknikëve të mesëm, ku nga 5 të kërkuar të modifikohet në 2; ankohet për numrin e manovratorëve, ku nga 15 të kërkuar të modifikohet në 6; ankohet për numrin e makinerive ku kërkon që numri i tyre të modifikohet dhe të jenë më të pakta në numër se sa numri i referuar në DST. Gjithashtu, ky OE kërkon gjithashtu, që duke marrë parasysh zërat e punimeve në preventiv, të shtohet në DST kritere të reja që kanë të bëjnë fabrikë betoni dhe impiant inertesh me QKL, lejet e mjedisit, si dhe kërkon që për fabrikën e betonit, të paraqesë disa lloje certifikatash cilësie.

-Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e nën/kryetarit të Bashkisë, me porosi në mungesë të Kryetarit që mban nr. 4094/1 prot., datë 14.06.2018. Në përgjigje, AK shprehet se pranon modifikimin e të gjitha pikave të paraqitura nga ky OE për zbatimin e kësaj kontrate. Mgjth, pavarësisht gjitha ndryshimeve të kërkuara nga ky OE, sërish rezulton se nuk ka paraqitur ofertë.

-Ankuesi tjetër "S." shpk, ka paraqitur pretendimet e tij me shkresën nr. 307 prot., datë 08.06.2018, protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 4124, datë 11.06.2018. Ky OE kërkon heqjen e kriterit për certifikatat ISO SSH EN ISO 1452:1:2009 "Sistemet e tubacioneve plastike për drenazhim.....", si dhe certifikatën UNI – EN – ISO 9001:2008 në fushat e aplikimit kodi EA 16, Projektim, prodhim, transport dhe hedhje betoni në vepër; kërkon të specifikohet se çfarë specialiteti duhet të kenë 5 teknikët e mesëm të kërkuar; kërkon të modifikohet numri i inxhinierëve pasi numri i kërkuar është i ekzagjeruar; kërkon modifikimin e numrit të disa prej mjeteve të kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, duke i konsideruar të tepërta dhe jo në përpjesëtim me natyrën e objektit që tenderohet.

-Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e nën/kryetarit të Bashkisë, me porosi në mungesë të Kryetarit që mban nr. 4094/1 prot., datë 14.06.2018. Në përgjigje, AK nuk pranon pikën e parë për heqjen e certifikatave; në lidhje me pikën e dytë, sqaron specialitetin e teknikut të mesëm; në lidhje me pikën e 3 dhe të 4 të ankesës, AK refuzon modifikimin e këtyre pikave duke i konsideruar të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate.

-Gjithashtu, në dosje ndodhet edhe argumentimi që bën APP, e cila nga monitorimi që i ka bërë procedurës së prokurimit në SPE, ka konstatuar disa kritere jo në përputhje me volumet dhe natyrën e punës, kritere të paraqitura gabim në formulim etj për të cilat rekomandon edhe ndryshimet përkatëse. Nga kontrolli i bërë ndryshimeve që kanë pësuar dokumentet e tenderit, vërehet se nuk janë marrë parasysh konstatimet e APP.

Në lidhje me trajtimin e këtyre ankesave, dhe mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ngritjen e Komisionit për Shqyrtimi e Ankesave, mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

-Në lidhje me vlerësimin e kritereve të vendosura nga NJP në DST, u

konstatuan mangësi në lidhje me kërkesën për disponimin e mjeteve për zbatimin e kësaj kontrate. NJP krahas dokumentacionit të kërkuar, nuk ka kërkuar për mjetet në dispozicion, Certifikatën e Transportit për Vete, për të Tretë dhe me Qira, kërkesë kjo e përcaktuar nga ligji me nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, neni 39, 41, 45.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 23 datë 31.05.2018, është ngritur KVO e cila përbëhet nga z. T. M. (kryetare), A. H. dhe V. K.(anëtar). Mungon procesverbali i hapjes së ofertave, si dhe mungon raporti përmbledhës në dosje.
Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, të cilët janë kualifikuar dhe është shpallur fitues BOE "B." shpk dhe "Sh." shpk me ofertë në vlerën **50,557,548 lekë,** ose 10,666,993 lekë më e ulët se sa fondi limit.
Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se BOE i kualifikuar dhe shpallur fitues, nuk përmbush të gjitha kriteret për t'u kualifikuar dhe konkretisht:
1.Në shtojcën për dokumentet e tenderit, është kërkuar që OE duhet të ketë për zbatimin e kësaj kontrate si më poshtë:

Fabrikë Betoni me QKL 1 cope (Pronësi ose me qira)
Impiant Inertesh me QKL 1 cope (Pronësi ose me qira)
Linje prodhimi elemente Betoni,
Pllaka Bordura me QKL 1 cope (Pronësi ose me qira)
Për sa më sipër duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë apo marrjes me qira, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si me poshtë:

- *QKL – Leje Mjedisi, të tipit C Kodi: III.1.A "Linjë prodhimi elemente Betoni, Pllaka Bordura".*
- *QKL - Leje Mjedisi Kodi: III.1.B. për "Impiant Betoni dhe Inertesh"*

Planvendosje, certifikatë pronësie ose kontrate qiraje mbi sipërfaqen e vendosjes së impiantit të prodhimit te asfaltit.

- *Për fabrikën e prodhimit përpunim të elementeve betonit pllakë dhe bordurë duhet të paraqesë kontratë blerje ose me qira, skemën teknologjike të makinerisë, të jetë i pajisur me leje mjedisore nga QKL, vërtetim zhdoganimi, si dhe certifikuar për cilësinë sipas standardit*

ISO 9001;2015 mbi " Sistemin e menaxhimit të cilësisë" e vlefshme
OHSAS 18001;2007 mbi " Shëndetin dhe sigurimin në punë" e vlefshme
ISO 14001:2004 mbi "Sistemet e menaxhimit të ambientit" e vlefshme
ISO 39001;2012 mbi "Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor" e vlefshme

- *Për fabrikën e betonit, prodhimin e produkteve të betonit dhe inerte duhet:*
  - *Te paraqesë planvendosjen për impiante të betonit dhe inerteve*
  - *Monitorim mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit*

Duhet të paraqesë raport testimet për materialet ndërtimore si më poshtë:

- *Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000*
- *Raport Testim të Materialeve Inerte Rërë e Larë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000*
- *Raport Testim nga Impianti i Prodhimit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1: 2000. S SH EN 12390-3: 2000 për mostrën e betonit.*
- *Raport Testim nga Impianti i Prodhimit Ujit për Beton, Metoda e Testimit S SH EN 1008: 2002.*
- *Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform*

S SH ISO/EN 17025:2006
Raporti testimeve duhet të jetë të paktën 3 muajt e fundit bazuar në ligjin Nr. 9290 datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit"

- *Çdo ofertues do të paraqesë PLAN – ORGANIZIMIN e punimeve në objekt në format të shoqëruar dhe me një relacion shpjegues dhe legjendë, ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-administrative dhe elementet e tjerë që kërkon një plan organizimi i mirëfilltë.*
- *Çdo ofertues do të paraqesë PLANIN E SIGURISË NË KANTIER*

Për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 datë 06.11.2003.

-Në lidhje me kërkesën e mësipërme, rezulton se BOE nuk e përmbush këtë kriter.

-OE "B.", ka paraqitur disa kontrata për fabrika betoni dhe inertesh por asnjëra prej tyre nuk përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara sa më sipër.

1.Fabrikë Betoni Shoqëria B. shpk me kontratë qiraje nr. 3198 rep, 1922 kol, datë 06.09.2014. Mungon skema teknologjike e makinerisë dhe nuk ka paraqitur vërtetim zhdoganimi. Mungojnë certifikatat ISO 9001:2015, OHSAS 18001:2007, ISO 14001:2004 skaduar që me 17.06.2017, ISO 39001:2012. Nuk ka paraqitur monitorimin mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve për 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet sipas kërkesës së paraqitur ne DST.

2.Impiant Inertesh, S.shpk, kontratë nr. 1336 rep, 326 kol, datë 17.06.2017. Nuk ka paraqitur QKL – leje mjedisore Kodi: III.1.B "impiant betoni dhe inertesh. Mungon skema teknologjike e makinerisë dhe nuk ka paraqitur vërtetim zhdoganimi. Certifikatat kërkohet 9001:20015, subjekti e ka paraqitur ISO 9001:2008, OHSAS 18001:2007 dhe ISO 14001:2004 të skaduara që me 17.06.2017. Nuk ka paraqitur monitorimin mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve për 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet sipas kërkesës se paraqitur në DST.

3.Shoqëria A., kontratë nr. 2582 rep, 1496 Kol, datë 22.07.2014 për furnizim me asfaltbeton. Nuk ka paraqitur asnjë prej certifikatave ISO të kërkuara në DST. Mungon monitorimi mjedisor i 6 muajve të fundit dhe raport testimet për materialet.

-OE "Sh." shpk, ka paraqitur disa kontrata për fabrika betoni dhe inertesh por asnjëra prej tyre nuk përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara sa më sipër.

1.Fabrike betoni, "F."shpk, kontrate nr. 625 rep, 167 Kol, datë 03.04.2017. Mungojnë certifikatat ISO. Mungon monitorimi mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet ndërtimore.

2.Fabrike betoni "G.". Mungojnë certifikatat ISO. Mungon monitorimi mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet ndërtimore.

3.Fabrike asfalto betoni "Sh.", kontratë nr. 1205 rep, 602 Kol, datë 27.02.2015. Ka ISO 9001:2008, ndërkohë që kërkohet ISO 9001:2015, certifikata OHSAS 18001:2007 është jashtë vlefshmërisë nga 12 shkurt 2017 ndërkohë që tenderi zhvillohet në Korrik 2018. Mungon monitorimi mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet ndërtimore.

4.Furnizim me Inerte "V.", kontratë 436 rep, 172 kol, datë 16.03.2016. Mungojnë ISOT e kërkuara. mungon monitorimi mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për

materialet ndërtimore.
5.Furnizim me inerte "B." shpk, kontratë me nr. 365 Rep, 243 Kol, datë 26.11.2013. Mungojnë certifikatat ISO. Mungon leja e tipit C Kodi:III.1.A. Mungon monitorimi mjedisor për impiantin e betonit dhe inerteve 6 mujorin e fundit. Mungojnë raport testimet për materialet ndërtimore.

Siç konstatohet, të gjitha kontratat e lidhura me fabrikat për prodhim betoni dhe inertersh, nuk plotësojnë kushtet siç janë kërkuar nga NJP.

2.Në DST, kërkohet disponimi i mjetit *Autobitumatriçe.*

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE "B.", ka paraqitur mjetin me Targa AA512OB, i cili rezulton të jetë mjet i modifikuar kamion + bitumatriçe. Nga certifikata e pronësisë së mjetit paraqitet kamion vetëshkarkues. Ky mjet nuk plotëson kushtet teknike, si dhe nuk disponon certifikatat e transportit për lëndë të rrezikshme.

3.Në DST kërkohen 6 manovratorë për zbatimin e kësaj kontrate.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE "B." shpk, ka paraqitur dokumentacion vetëm për 2 manovratorë. Duke qenë se ky OE, ka marrë përsipër 50% të kryerjes së punimeve, është detyrim i tyre që të ketë të paktën 3 manovratorë për zbatimin e kësaj kontrate.

4.Në DST kërkohet që OE të disponojnë Certifikata UNI-EN-ISO 9001:2008 e vlefshme ne fushat e aplikimit kodi EA 16 për *Projektim, prodhim, transport dhe hedhje betoni ne vepër.*

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se asnjëri nga OE fitues nuk e disponon certifikatën e mësipërme.

5.Në DST kërkohet nga OE disponimi i 5 mjeteve tip kamionë me kapacitet mbajtës minimumi 15 Ton

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ky BOE nuk e përmbush plotësisht këtë kriter sipas kërkesave eksplicite te DST. OE "B." shpk, ka paraqitur 7 kamionë, nga të cilët vetëm njëri prej tyre plotëson kushtet. Kamionët tjerë kanë këto mangësi:

a)Kamioni me Targa AA749KR, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti P. H., ka kapacitet mbajtës 9 Ton, ose 6 ton poshtë kapacitetit të kërkuar. Ky mjet ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve si dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve, jashtë afateve të vlefshmërisë pasi kanë skaduar që në Nëntor të vitit 2017.

b)Mjeti me Targa AA933NF, rezulton nga leja e qarkullimit me kapacitet mbajtës 5.7 Ton, ose 9.3 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar; mjeti me Targa FR3839C ka kapacitet mbajtës 2.3 ton, mjeti AA467PE ka kapacitet mbajtës 3.1 Ton.

c)Mjeti me Targa AA780AJ, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti K. Xh., ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve si dhe certifikatën e kontrolli teknik të mjeteve të skaduar që në Maj të vitit 2017.

d)Mjeti me Targa AA391KK, në pronësi të subjektit, ka kapacitet mbajtës 8.6 Ton, ose 6.4 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar, si dhe ka siguracionin e detyrueshëm te mjeteve si dhe certifikatën e kontrolli teknik jashtë afateve të vlefshmërisë pasi kanë skaduar në Prill të vitit 2018, ndërkohë tenderi zhvillohet në Korrik 2018.

-Edhe operatori tjetër ekonomik, "Sh." shpk ka mangësi në raport me kamionët me kapacitet mbajtës mbi 15 Ton. Ky OE ka paraqitur 6 kamion,

nga të cilët vetëm 2 përmbushin kriteret e vendosura në DST. 4 mjetet tjera kanë këto mangësi:

a)Mjeti me Targa AA928DM, marrë me kontratë qiraje nga subjekti "H." shpk, ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve të skaduar në Qërshor 2018, ndërkohë tenderi zhvillohet në Korrik 2018.

b)Mjeti me Targa AA078IL, marrë me kontratë qiraje nga subjekti "J., ka kapacitet mbajtës 4.1 Ton; mjeti me Targa AA719EB, marrë me kontratë qiraje nga subjekti B. M., ka kapacitet mbajëts 13 Ton (2 ton poshtë kapacitetit), si dhe mjeti me Targa AA347KE në pronësi të subjektit, ka kapacitet mbajtës 2 Ton.

-**Nga kontrolli i mjeteve të mësipërme,** rezulton se ky BOE nuk e përmbush kriterin për mjetet kamionë me kapacitet mbajtës mbi 15 Ton.

Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "B." shpk & "Sh." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A.H. dhe znj. V. K..**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ligji 8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, neni 41.

Udhëzimi nr. 15 datë 24.07.2007 i Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë më transportin rrugore", neni 39, 41, 45.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

1.Urdhër Prokurimi nr.22, datë 28.05.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2.M. B.(Arkitekt) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.23 datë 31.05.2018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) **61 224 541.3** lekë	**6.Oferta fituese**: "B." SHPK & "Sh." SHPK Vlera **50 557 548** lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** **10 666 993**.lekë
8. Data e hapjes së tenderit:04.06.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Po **Salillari SHPK**. Nr 4124	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ka **Salillari SHPK**. Nr 4124/1 Dat:14.06.2018	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** **SKA**

Dat:11.06.2018 **Eni SHPK.** Nr 4094 Dat:08.06.2018	**Eni SHPK.** Nr 4094/1 Dat:14.06.2018	
	14. Data e lidhjes së kontratës: **24.08.2018**	**15. Afati i kontratës** **91 ditë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "Z." shpk	61,091,817	Kualifikuar.
2	OE "B." shpk	50,557,548	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 5809/7 prot., datë 23.08.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., V. K. dhe A. H.*. Në lidhje me fabrikat e betonit KVO argumenton:

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e betonit B.Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.A, dhe nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-3652-06-2012, Kodi: III.1.B, akt miratimi leje mjedisore, nr. 5161/11 Prot., nr 685 identifikues, vendimi nr 19 I K.SH.K, datë 25.06.2012, e cila është e fushës së përcaktuar por klasifikim më i lartë se kategoria III.1.A. Kodi III.1.A, është plotësuar edhe nga subjekti Sinani & Lici Shpk. është paraqitur certifikata e pronësisë së fabrikës nr 255129, datë 04.04.2013, harta treguese datë 28.01.2013. Për sa i përket certifikatave ISO, janë paraqitur ISO të shoqërisë "B." Shpk. Është paraqitur fotografi e impiantit.*

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e betonit S.Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.B, kjo nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-2498-11-2011, Kodi: III.1.A, akt miratimi leje mjedisore, nr. 681 Prot., nr 36 identifikues, vendimi nr 11 I K.SH.K, date 12.11.2011. Kodi III.1.B, është plotësuar edhe nga subjekti Beton E-G Fier Shpk. Është paraqitur certifikata e pronësisë së fabrikës datë 04.09.2007, harta treguese datë 03.09.2007. ISO 9001: 2008, datë 12.02.2016, ISO 18001: 2007, datë 18.06.2014, ISO 14001:2004, datë 18.06.2014, ISO 39001:2012, datë 16.02.2016, janë paraqitur edhe iso të shoqërisë "B." Shpk. Është paraqitur fotografi e impiantit.*

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e asfaltobetonit A.. Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.A, kjo nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-1754-01-2016, Kodi: III.1.B, akt miratimi leje mjedisore, nr. 240 Prot., nr 2021 identifikues, vendimi nr 62 I K.SH.K, date 13.01.2016, e cila është e fushës së përcaktuar por klasifikim më i lartë se kategoria III.1.A.*

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e betonit F. Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.A, kjo nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-3775-09-2016/2, Kodi: III.1.B, akt miratimi leje mjedisore, nr. 6738 Prot., nr identifikimit 2404, vendimi nr 33, date 14.10.2016, e cila është e fushës së përcaktuar por klasifikim me I lartë se kategoria III.1.A. Për sa i përket certifikatave ISO, janë paraqitur ISO të shoqërisë "Sh." shpk.*

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e betonit G. Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.A, kjo nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-5570-05-2013, Kodi: III.1.B, akt miratimi leje mjedisore, nr. 249 Prot., nr identifikimit 1241, vendimi nr 12 I KSHK, date 07.06.2013, e cila është e fushës së përcaktuar por klasifikim me i lartë se kategoria III.1.A. Për sa i përket certifikatave ISO, janë paraqitur ISO te shoqërisë "Sh." Shpk.*

- *Për sa i përket argumentit se për fabrikën e asfaltobetonit Sh.Shpk, nuk ka paraqitur leje mjedisore, Kodi: III.1.A, kjo nuk qëndron, pasi është paraqitur leje mjedisore, nr PN-8981-01-2015, Kodi: III.1.B, akt miratimi leje mjedisore, nr. 147 Prot., nr identifikimit 1762, vendimi nr 01 I KSHK, date 09.01.2015, e cila është e fushës së përcaktuar por klasifikim me i lartë se kategoria III.1.A. Për sa i përket certifikatave ISO, janë paraqitur ISO të shoqërisë "Sh." Shpk.*

- *Për sa i përket argumentit se për nyjen e inerteve nga V.Shpk, për sa i përket certifikatave ISO, janë paraqitur ISO të shoqërisë "Sh." Shpk. Në dokumentet e tenderit është certifikatë nr. Serial 9/17, datë 09.09.2016.*

- *Për sa i përket argumentit se për nyjën e inerteve nga Brahaj Shpk, kjo pikë është plotësuar edhe nga kontrata e nënshkruar me V.Shpk.*

2. Në lidhje me mjetin autobitumatriçe i cili është i modifikuar kamion + bitumatriçe, KVO sqaron se mjeti me targa AA512OB është pranuar nga KVO të paraqitur nga operatori ekonomik B. si mjet i nevojshëm për kryerjen e procesit të punës me dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve të vendosura në DST por në këto kritere nuk është kërkuar certifikata e transportit për lëndë të rrezikshme.

3. Në lidhje me mos përmbushjen e numrit të manovratorëve nga OE B., KVO sqaron se shoqëria B.shpk ka paraqitur

2 manovratore , kur ka marrë përsipër të kryejë 50% të punimeve , ju bëjmë me dije se numri i manovratorëve varet nga zërat të cilët ka marrë përsipër shoqëria B.shpk , për punime që është i nevojshëm monovratori duke marrë parasysh edhe faktin që ky tender është bashkim operatorësh edhe me subjektin Sh. shpk.

4. Në lidhje me mungesën e certifikatës UNI-EN-ISO 9001:2008 e vlefshme në fushat e aplikimit kodi EA 16 për Projektim, prodhim, transport dhe hedhje betoni ne vepër, KVO sqaron se operatorët ekonomik B.Shpk dhe Ç. Shpk kanë paraqitur Certifikatën ekuivalente ISO 9001;2015 të vlefshme .(Bashkangjitur kjo certifikate).

5. Në lidhje me mos plotësimin e kushteve për kamionët me kapacitet mbi 15 Ton nga OE B., KVO sqaron operatori ekonomik B.shpk ka paraqitur kamionë me dokumentacionin e plotë sipas kritereve të kërkuara në DST .Për më tepër kanë paraqitur edhe këta kamion : Kamionin me targa AA221BG me kapacitet mbajtës 18 ton, Kamioni me targa AA 922 GA me kapacitet mbajtës 18 ton , Kamioni me targa AA835EU me kapacitet mbajtës mbi 18 ton , Kamioni me targa AA984DA me kapacitet mbajtës mbi 18 ton, Kamioni me targa AA 933 NF me kapacitet mbajtës 7.5 deri ne 18 ton. Së bashku me operatorin Sh. shpk plotësojnë numrin e kërkuar sipas kritereve të kërkuara në DST .

(Bashkangjitur ju përcjellim certifikatat e pronësisë së bashku me Certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore)

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*

1 - Në lidhje me fabrikat e betonit dhe impiantet e inerteve të paraqitura nga BOE, asnjëra prej tyre nuk plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DST. "B."shpk nuk ka certifikatat ISO të paraqitura në Projekt Raport, dhe pretendimi i KVO se ato i disponon OE B.nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi.

- Impiant Inertesh "S." shpk nuk plotëson kriteret e kërkuara. Në lidhje me ISOT e paraqitura ato kanë mangësi të paraqitura në Projekt Raport dhe pretendimi i KVO se ato i disponon OE B.nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi. Në lidhje me lejen mjedisore, në DST kërkohet me kodin III.1B, ndërkohë subjekti e posedon lejen me kodin III.1.A.

- Në lidhje me fabrikën e betonit "A." Shpk, pranohet argumenti për lejen mjedisore, por KVO nuk ka paraqitur kundërshtime për mangësitë e tjera të këtij furnitori.

- Në lidhje me fabrikën e betonit "F." Shpk, pranohet argumenti për lejen mjedisore, por në lidhje me mungesën e certifikatave ISO pretendimi i KVO se ato i disponon OE Sh. shpk nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi.

- Në lidhje me fabrikën e betonit të "G." shpk, pranohet argumenti për lejen mjedisore, por në lidhje me mungesën e certifikatave ISO pretendimi i KVO se ato i disponon OE Sh. shpk nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi.

- Në lidhje me fabrikën e betonit të "Sh." shpk, pranohet argumenti për lejen mjedisore, por në lidhje me mungesën e certifikatave ISO pretendimi i KVO se ato i disponon OE Sh. shpk nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi.

- Në lidhje me nyjën e inerteve të "V." shpk, për mungesën e certifikatave ISO pretendimi i KVO se ato i disponon OE Sh. shpk nuk qëndron pasi certifikatat kërkohet që të disponohen nga furnizuesi.

-Gjithashtu, KVO nuk ka paraqitur kundërshtime për pjesën tjetër të mangësive të paraqitura në Projekt Raport për fabrikat dhe nyjet e mësipërme.

2. Në lidhje me mjetin autobitumatriçe, sqarojmë se në DST kërkohet të disponohet ekzaktësisht mjeti autobitumatriçe, ndërkohë nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se mjeti me targa AA512OB është kamion vetëshkarkues, të cilit i është montuar bitumatriçe, pra ky mjet nuk disponon dokumentacionin e kërkuar për autobitumatriçe siç kërkohet nga NJP në DST.

3. Në lidhje me mos përmbushjen e numrit të manovratorëve nga OE "B." shpk, audituesit sqarojnë se ky OE nuk e përmbush këtë kriter pasi duke marrë parasysh pjesëmarrjen në punime e cila është 50%, si dhe duke patur parasysh numrin e madh te mjeteve të kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, është detyrim i vet OE që të plotësojë kriteret në përputhje me pjesëmarrjen në punime.

*4. Në lidhje me disponimin e certifikatës UNI-EN-ISO 9001:2008 e vlefshme në fushat e aplikimit kodi **EA 16** për projektim, prodhim, transport dhe hedhje betoni në vepër, audituesit sqarojnë se certifikata e paraqitur nga OE Boshnjaku B është EN-ISO 9001:2015, ndërkohë që në DST kërkohet ekzaktësisht UNI-EN-ISO 9001:2008 bashkëlidhur kodin e aplikimit **EA 16.***

5. Në lidhje me mos plotësimin e kritereve për kamionët mbi 15 Ton nga OE "B."shpk, audituesit sqarojnë se, pretendimi i KVO nuk qëndron pasi kamionët me Targa AA221BG, AA922GA, AA835EU me kapacitet mbi 18 Ton, janë klasifikuar si të rregullt në lidhje me kërkesën e DST për 5 kamionë me kapacitet mbi 18 Ton, ndërkohë që OE tjetër "Sh."shpk ka paraqitur 2 kamionë mbi 18 Ton, dhe në këtu kushte është plotësuar kriteri vetëm për kamionët mbi 18 T. Sa i përket, mjetit tjetër me targa AA933NF sipas të cilit KVO pretendon se është me kapacitet mbajtës nga 7.5 deri në 18 Ton, audituesit sqarojnë se ky mjet del nga leja e qarkullimit me kapacitet 5.7 Ton, pra është poshtë kapacitetit të kërkuar mbi 15 Ton.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionet e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

*8.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikonstruksion i fasadave në lagjen Murat Çelebiu".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 13, datë 27.04.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. G. B. (jurist), G. S. (inxhinier) dhe I. A. (ekonomiste). Nuk ka procesverbal për përllogaritjen e fondit limit.

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Për dokumentet e tenderit, është paraqitur ankesë në AK nga subjekti "S." shpk me nr. 221 prot., datë 02.05.2018, protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 2416, datë 04.05.2018. Nëpërmjet kësaj shkrese, OE kërkon ndryshimin e disa kritereve.

-Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e Titullarit me nr. 2416/1 prot., datë 07.05.2018. Në përgjigje, AK ka pranuar heqjen e kriterit për certifikatën përfundimtare të marrjes në dorëzim, si dhe ka ndryshuar kriterin në lidhje me mjetet dyje kërkuar që dokumentacioni i tyre të jetë i vlefshëm në datën e zhvillimit të tenderit.

Këto ndryshime janë pasqyruar në shtojcën e vendosur në SPE nga NJP.

Pas ndryshimeve në sistem të kritereve, sërish OE "S.i" shpk, ka paraqitur ankesë në AK me shkresën nr. 243 prot., datë 14.05.2018, protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 3650, datë 16.05.2018. Në ankesë e tij, ky OE shprehet se AK ka vendosur në kriteret e tenderit, nëpërmjet shtojcës së hedhur në SPE, këto kritere:

a. Operatorët ekonomikë duhet të kenë në listën e drejtuesve teknik pjesë e licencës së shoqërisë 1 Ing. Ndërtimi, profil ndërtime civile, i pajisur me licencë kategoria L1 M-N për testimin e materialeve.

b. Operatori ekonomik duhet të ketë 1 Ing. Ndërtimi të diplomuar me master profesional në planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore, i pajisur me certifikatë trajnimi për sigurinë dhe mbrojtjen dhe mbrojtjen e shëndetit në punë i cili duhet të jetë në listpagesat e shoqërisë.

- Në lidhje me këto dy kritere, OE ankohet se:

a/1. Kriteri i parë, është i panevojshëm, i tepërt dhe diskriminues, pasi për testimin e materialeve të ndërtimit ekzistojnë laboratorë të akredituar dhe të certifikuar për të cilën nuk është aspak e nevojshme që drejtuesi teknik të jetë i licencuar për këto lloj testimesh.

b/1. Kriteri i dytë është i tepërt dhe i panevojshëm, pasi për sigurinë në kantier referuar ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", është e qartë se siguria dhe shëndeti në punë kryhet nga persona të

kualifikuar ose të trajnuar, dhe jo domosdoshmërisht këta persona duhet të jenë të diplomuar në fushën e inxhinierisë. Ligji i mësipërm, nuk përcakton që personi i certifikuar duhet të jenë patjetër një inxhinier ndërtimi, dhe aq me tepër ***Ing. Ndërtimi i diplomuar me master profesional në planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore !!!***

Ky OE kërkon ndryshimin e korrigjimi i këtyre kritereve.

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e Titullarit me nr. 3650/ prot., datë 17.05.2018. Në përgjigje, AK sqaron se kriteret qëndrojnë dhe nuk duhet të ndryshohen pasi janë në përputhje me llojin e punës së prokuruar.

Në lidhje me trajtimin e kësaj ankese, dhe mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ngritjen e Komisionit për Shqyrtimi e Ankesave, mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

-Në vlerësim të kritereve të vendosura, u konstatuan kritere diskriminuese dhe të ekzagjeruar.

1.Në shtojcën e DT, nga NJP janë shtuar disa kritere dhe ndër të tjera janë shtuar edhe këto kritere:

- *Operatorët ekonomik duhet të kenë në listën e drejtuesve teknik pjesë e licencës së shoqërisë 1 Ing. Ndërtimi, profile ndërtime civile, i pajisur me licencë kategoria L1 M-N për testimin e materialeve.*
- *Operatori ekonomik duhet të ketë 1 Ing. Ndërtimi të diplomuar me master profesional në planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore, i pajisur me certifikatë trajnimi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, i cili duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë.*

-Kërkesat e mësipërme janë diskriminuese dhe të paargumentuara. Kërkesat për drejtuesin teknik inxhinieri ndërtimi, i pajisur me licencë kategoria L1 M-N për testimin e materialeve, është diskriminuese, pasi ka laboratorë të posaçëm të akredituar për testimin e materialeve, nëse kërkohet testimi i tyre, dhe kërkesa që të jetë pjesë e stafit drejtues nuk ofron kushte të barabarta për operatorët ekonomikë që kërkojnë të marrin pjesë në tendera.

-Gjithashtu, kërkesa që eksperti për sigurinë dhe shëndetin në punë, duhet të jetë inxhinier ndërtimi me master profesional në planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore, është diskriminuese dhe e ekzagjeruar. Objekti i punës është rikonstruksion fasadash, dhe për sigurinë në punë mjafton që të ketë persona të kualifikuar në këtë drejtim. Kërkesa eksplicite që duhet të jetë ***Ing. Ndërtimi i diplomuar me master profesional në planifikim transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore,*** nuk është kriter që rrit konkurrencën dhe të ofrojë kushte të barabarta për operatorët ekonomikë në këtë tender.

Këto kritere përveçse janë të paargumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 10/1, datë

17.04.2018 dhe përbëhet nga z. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe A. Dh. (anëtarë).
Në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertë 5 OE, janë s'kualifikuar 4 OE, dhe është kualifikuar BOE "S." & "M." shpk me ofertë **37,024,857 lekë,** ose 564,327 lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e ulët është e OE "C." shpk me vlerë **28,202,068,** ose 8,822,789 lekë më e ulët se sa oferta fituese.
Nga shqyrtimi i ofertës fituese u konstatuan këto mangësi në dokumentacion:
1.BOE kanë nënshkruar marrëveshje sipas së cilës 65% të punimeve do kryhen nga "M." shpk dhe 35% nga "S." shpk, dhe punimet do kryhen për çdo zë nga të dy OE. Rezulton se OE "S." shpk, duke marrë përsipër kryerjen e çdo punimi në masën 35%, rezulton se nuk disponon te gjithë stafin e nevojshëm sipas kërkesave të DST, kjo pasi ka paraqitur vetëm 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 specialist ndërtimi si staf te kualifikuar, ndërkohë që sipas kërkesave të DST kërkohen edhe 3 lloje tjerë inxhinierësh, 1 mjek, 3 manovratorë dhe shoferë të mjeteve të rënda, elektricist. Në mungesë te këtij stafi KVO duhej ta s'kualifikonte pasi nuk përmbush kriteret për mbulimin e punimeve për çdo zë në masën 35% te aktmarrëveshjes se lidhur.
2.OE "S." shpk, nuk disponon kategorinë NP12-A në licencën e shoqërisë, të kërkuar nga NJP në DST.
3.OE "S." shpk, disponon vetëm 1 certifikatë ISO, dhe konkretisht ISO 14001:2015, ndërkohë në DST kërkohen edhe 4 ISO të tjera shtesë, për të cilat ky OE nuk i ka paraqitur.
Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "M." shpk & "S.shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe znj. A. Dh..**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ligji 8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, neni 41.
Udhëzimi nr. 15 datë 24.07.2007 i Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave , autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë më transportin rrugore", neni 39, 41, 45.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **8,822,789 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr.13, datë 27.04.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B.j (Jurist) 2.G. S. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.10/1 datë 17.04.2018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 37 589 184.50 lekë	**6.Oferta fituese**: "S." SHPK "M." SHPK Vlera 37 024 857 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 564 327.5 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 05.06.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 12 OE b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 9 OE
11.Ankimime AK: Po **Salillari SHPK** Nr 3650 Dat:16.05.2018	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ka **Salillari SHPK** Nr 4725/1 Date:20.07.2018	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** SKA
	14. Data e kontratës: **31.07.2018**	**15. Afati i kontratës:** **8 muaj**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "L." shpk	35,706,312	S`kualifikuar
2	OE "C." shpk	28,202,068	S`kualifikuar
3	OE "L." sha	34,482,400	S`kualifikuar
4	OE–"B." shpk	33,128,582	S`kualifikuar
5	OE-"S." shpk	37,024,857	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/10 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP G. S. dhe G. B..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier elektrik dhe 1 inxhinier mekanik, NJP sqaron se pjesa e investimit përfshin shumë objekte në lartësi të madhe ku përfshihet ngritja e skelave dhe makinerive të ndryshme për transportin, përgatitjen dhe ngritjen e materialeve në kantier dhe për këtë arsye është menduar nevoja e 1 inxhinieri mekanik dhe 1 inxhinieri elektrik.
2.Në lidhje me kërkesën për certifikatën BS-ISO 39001:2012 "Mbi menaxhimin e trafikut mbi sigurinë rrugore", NJP sqaron se rruga në të cilën janë objektet që do të suvatohet është e vetmja rrugë kryesore hyrëse në Berat, dhe duke parë këtë trafik në këtë segment, është e nevojshme kërkesa për një certifikatë të tillë.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Pranohen dy pikat e observacionit të mësipërm.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., A.H.dhe A.o Dh. Në lidhje me konstatimet e audituesve të KLSH, KVO sqaron:*
1.Në lidhje me mos plotësimin e numrit të inxhinierëve, KVO sqaron se OE "S." shpk ka paraqitur 1 inxhinier, pra e plotëson numrin në raport me pjesëmarrjen në punime prej 35%.
2.Në lidhje me mosplotësimin e kërkesave për licencat profesionale të shoqërisë, KVO sqaron se OE "S." shpk, plotëson 1 nga 4 pikat, pra e plotëson kushtin në raport me përqindjen.
3.Në lidhje me mos plotësimin e kërkesave për certifikatat ISO, KVO sqaron se ky është kriter teknik, dhe plotësohet në grup bashkë me operatorët e tjerë ekonomikë.

4.Në lidhje me shpenzimet në kundërshtim me parimin e 3E-ve, KVO sqaron se kualifikimi i BOE fitues është i rregullt dhe nuk ka shpenzime në kundërshtim me 3E-të.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitur nga KVO, audituesit sqarojnë se, OE "S."shpk, ka marrë përsipër kryerjen e punimeve për çdo zë të preventivit, dhe në këto kushte ai duhet të plotësojë kriteret për çdo zë. Kualifikimi i këtij OE, është në shkelje të ligjit me nr. 9643 të LPP, nenit 46 dhe 53 pika 3, VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 74, pika 3.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

9.Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Blerje materiale ndërtimi për drejtorinë e shërbimeve publike".***

Situata:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 2, datë 31.01.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. G. S. (inxhinier), M. Ç. (juriste) dhe I.A. (Ekonomiste). Është mbajtur proces verbali për përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në testimet e tregut, dhe është firmosur nga NJP.
DT janë hartuar me procesverbal. DST nuk janë firmosur nga NJHDT, në kundërshtim me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 76, datë 31.01.2018 dhe përbëhet nga znj. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe z. A. Dh. (anëtarë).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 8 OE, janë kualifikuar 3 OE, dhe është shpallur fituese oferta e OE "E." shpk me vlerë **2,926,400 lekë,** ose 248,720 lekë më e ulët se sa fondi limit. Kjo ofertë rezulton se është edhe oferta më e ulët ndër gjithë operatorët pjesëmarrës.
Në lidhje me vlerësimin e dokumenteve të operatorit fitues, rezultoi se ai është kualifikuar dhe shpallur fitues duke mos përmbushur të gjitha dokumentet e kërkuara nga NJP në DST dhe konkretisht:
1.Në pikën 2.3 të kritereve për Kapacitetin Teknik të operatorëve ofertues, kërkohet që OE të disponojnë *Mjete transporti vetëshkarkues minimumi 28 Ton (2 copë).*
-Në lidhje me këtë kërkesë, rezulton se OE fitues ka paraqitur 2 kamionë të marrë me kontratë qiraje nga subjekti "D." shpk. Kamionët me Targa AA036RF dhe AA037RF, rezultojnë sipas lejes së qarkullimit që të jenë me kapacitet mbajtës 25.6 Ton, ose 2.4 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar nga NJP në DST.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "E." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.

9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuarPër veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe znj. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **8,822,789 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr.2, datë 31.01.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. S. (inxhinier) 2.M. Ç. (Jurist) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.76 datë: 31.012018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 3,175,120 lekë	**6.Oferta fituese**: "E." shpk Vlera 2,926,400 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 248,720 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 26.02.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 8 OE b)S'kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP**
	14. Data e kontratës: **27.03.2018**	**15. Afati i kontratës:** **Deri në mbarimin e sasisë.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"M."shpk	3,043,995	S`kualifikuar
2	OE"D." shpk	3,104,300	S`kualifikuar
3	OE "M." shpk	3,000,000	S`kualifikuar
4	OE–"R." shpk	2,997,900	S'kualifikuar
5	D.B.	2,931,800	S'kualifikuar
6	OE "A." shpk	2,988,200	Kualifikuar.
7	OE "S." shpk	2,941,800	Kualifikuar
8	OE "E." shpk	2,926,400	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., A.H. dhe A.Dh.. Në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH për 2 kamionët me kapacitet poshtë atij të kërkuar, KVO sqaron se mjetet janë vlerësuar se mund të përmbushin kontratën dhe është vlerësuar oferta më e ulët.*

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se, sipas nenit 46 të LPP, pika 1/b, "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese", b/aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës, *si dhe nenit 53 pika 3 të LPP i cili përcakton* se Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.
Siç konstatohet, ky OE nuk e plotëson kriterin për 2 mjetet kamionë me kapacitet mbajtës mbi 28 Ton. KVO nëse e vlerësonte se kjo shkelje është devijim i vogël që nuk cenon kushtet dhe kërkesat e kontratës, duhej ti referohej nenit 53 pika 4 të LPP, dhe të konstatonte devijimin në lidhje me kapacitetin e mjeteve.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

10.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Rikonstruksion pjesor i palestrës së gjimnastikës Berat".***

Situata:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 20 datë 18.05.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. G. S. (inxhinier), I. A. (ekonomiste) dhe G. B. (jurist). Nuk ka procesverbal për përllogaritjen e fondit limit.
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
-Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK-së është paraqitur një ankesë nga OE "M." shpk, protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 3858 prot., datë 25.05.2018. OE ankohet për kërkesën për inxhinier hidroteknik në licencën e shoqërisë, duke e konsideruar kriter të tepërt që kufizon pjesëmarrjen në tender të ofertuesve të cilët janë të aftë të kryejnë këto punime. Nëse AK e konsideron të nevojshme inxhinierin hidroteknik, atëherë të kërkohet me kontratë pune dhe jo të jetë pjesë e licencës së shoqërisë.
-Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e Titullarit me nr. 3858/1 prot., datë 28.05.2018. Në përgjigje, AK shprehet se nuk pranon ankesën e kësaj shoqërie pasi preventivi ka zëra të kësaj natyre të cilët kërkojnë prezencën e këtij inxhinieri për zbatimin e kësaj kontrate.
Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 21 datë 18.05.2018, është ngritur KVO e cila përbëhet nga z. T. M.(kryetare), A. H. dhe A. Dh. (anëtar).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 13 OE. KVO ka kualifikuar 10 OE dhe s'kualifikuar 3 të tjerë. KVO ka rekomanduar shpalljen fituese të BOE "P.shpk dhe "M." shpk, me ofertë në vlerën 4,915,205 lekë, e cila është edhe oferta më e ulët në këtë tender.
Nga vlerësimi i dokumentacionit të ofertës fituese, rezultuan këto mangësi:
Në ndarjen e punimeve, OE "P." shpk merr përsipër 90.26 % të punimeve, ndërsa OE "M." shpk 9.74 %. Sipas pikës 2.3 *Për kapacitetin Teknik,* kërkohet disponimi i disa mjeteve si më poshtë:

1. Mjete Transporti vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës mbi 10 ton – 1 copë
2. Kamiançinë - 2 copë
3. Kamion me vinç - 1 copë
4. Autobot uji - 1 copë

-Nga verifikimi, rezulton se OE " P." shpk ka paraqitur dokumentacion për disponimin e 2 mjeteve 1 kamiançinë dhe 1 autovinxh, ndërsa OE "M." shpk 1 autobot uji, 1 kamion mbi 10 Ton dhe 1 kamiançinë. Duke parë përqindjen e pjesëmarrjes në punime, është detyrë dhe përgjegjësi e OE "P." shpk disponimi i këtyre mjeteve, duke parë edhe zërat e punimeve, ndërkohë duke paraqitur dokumentacion për vetëm për 2 mjete, ky OE nuk përmbush kriterin për tu kualifikuar.
-Gjithashtu, rezulton se mjeti autovinxh me Targa AA945DJ, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti E. M., nuk ka siguracionin e detyrueshëm të mjetit dhe certifikatën e kontrollit teknik, të cilat kërkohen nga NJP në DST.
Për makineritë duhet te paraqiten (Leje qarkullimi, certif e kontrollit teknik , polica e sigurimit te mjeteve.
Sa më sipër, ky BOE nuk e plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë "P." shpk dhe "M." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia: **I Lartë.**

1.Urdhër Prokurimi nr.20, datë 18.05.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2.G. S. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.21 datë : 18.05.2018 1.T.M., kryetar 2.A. H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7 076 527.82 lekë	**6.Oferta fituese**: "P." SHPK "M." SHPK Vlera 4 915 205 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2 161 322.82 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 11.06.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 13 OE b)S'kualifikuar3 OE, c) Kualifikuar 10 OE
11.Ankimime AK: Po MENI SHPK Nr 3858 Dat:25.05.2018	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ka MENI SHPK Nr 3858/1 Dat:28.05.2018	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** SKA
	14. Data e kontratës: **18.07.2018**	**15. Afati i kontratës:** **90 ditë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"A."shpk	6,223,159	S`kualifikuar
2	OE"B ." shpk	5,712,064	S`kualifikuar
3	OE "E." shpk	5,611,610	S`kualifikuar
4	OE–"B.." shpk	6,935,765	Kualifikuar.
5	OE "C." shpk	5,579,157	Kualifikuar.
6	OE "C." shpk	5,718,012	Kualifikuar.
7	OE "S." shpk	2,941,800	Kualifikuar
8	OE "F." shpk	6,351,330	Kualifikuar.
9	OE "L." shpk	6,412,221	Kualifikuar.
10	OE "N." shpk	6,052,670	Kualifikuar.
11	OE "S." shpk	5,564,685	Kualifikuar.
12	OE "T." shpk	6,493,206	Kualifikuar.
13	OE "P." shpk	4,915,205	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., A.H. dhe A. Dh.. Në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH për mos disponimin e mjeteve të kërkuara nga OE "P."shpk i cili ka marrë përsipër 90.26% të punimeve, si dhe për mjetin me Targa AA945DJ i cili nuk ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve si dhe certifikatën e kontrollit teknik, KVO sqaron se ky është kriter teknik dhe BOE e plotësojnë së bashku.*

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionin e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se sipas nenit 74, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përcaktohet qartë që "Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato **teknike** duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. OE "Pesë Vëllezërit" shpk nuk plotëson **kapacitetet teknike** për zbatimin e kësaj kontrate, në raport me 90.26% të pjesëmarrjes në punime.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionin e paraqitur, pasi nuk kanë paraqitur argument dhe dokumentacion të nevojshëm për të provuar pretendimin e tyre.

*11.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikonstruksion i çerdhes Uznovë".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 32, datë 21.06.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. J. H. (inxhiniere), I. A. (ekonomiste) dhe

G. B. (jurist). Nuk ka procesverbal për përllogaritjen e fondit limit.
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 33, datë 21.06.2018 dhe përbëhet nga z. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe A. Dh. (anëtarë).
Në këtë tender kanë marrë 12 OE, janë kualifikuar 9 OE dhe s'kualifikuar 3 të tjerë. KVO ka shpallur fituese ofertën e OE "B." shpk, me ofertë **5,101,460 lekë,** e cila është oferta më e ulët ndër të kualifikuara dhe është 1,975,067 lekë më e ulët se fondi limit. Vlerësimi i kryet nga KVO për këtë ofertë është i drejtë.
Ofertat më të ulëta në këtë tender janë ato të OE "C." shpk e cila është **5,056,846,** ose 44,614 lekë më e ulët se oferta fituese, si dhe oferta e paraqitur nga OE "S." shpk me vlerë **4,491,070 lekë,** ose 610,390 lekë.
Për vlerësimin e ofertave të bëra nga KVO, është paraqitur ankesë në AK nga subjekti "C." shpk protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 4725, datë 17.07.2018. Ky OE është s'kualifikuar me argumentin e vetëm se disa prej inxhinierëve rezultojnë me paga të ndryshme të deklaruara në kontratë, në raport me listpagesat e paraqitura. Për këtë shkak, OE ankues, nëpërmjet shkresës së paraqitur, kërkon ndryshimin e vendimit të KVO-së dhe shpalljen fitues si ofertë më e ulët në raport me OE fitues në këtë procedurë prokurimi, pasi argumenti i s'kualifikimit është i padrejtë. Sipas tij, kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, organizative, makineritë, pajisjet, reputacionin, përvojën etj. Për AK-në është e rëndësishme që OE të kenë paraqitur dokumentacionin për stafin sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, kontratat e paraqitura nga shoqëria jonë, rezultojnë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik". Subjektit i është kthyer përgjigje që mban vetëm firmën e Titullarit me nr. 4725/1 prot., datë 20.07.2018. Në përgjigje, AK sqaron se qëndron argumenti i s'kualifikimit të këtij OE dhe për këtë arsye nuk pranohet ankesa e tij.
Në lidhje me trajtimin e kësaj ankese, dhe mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ngritjen e Komisionit për Shqyrtimi e Ankesave, mban përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.
-Në lidhje me ankesën e OE "C." shpk, grupi i auditimit vlerëson se nuk qëndron arsyeja e s'kualifikimit.
Mospërputhja mes pagës në kontratë dhe listpagesës, nuk mund të përbëjë shkak për s'kualifikim. Për raste të ngjashme dhe pikërisht pranë këtij Autoriteti Kontraktor, KPP ka mbajtur qëndrimin se *formularët e pagave (listpagesat) janë të*

strukturuara nga administrata tatimore dhe janë këto instanca të cilët janë kompetente për kontrollin dhe monitorimin e pagave dhe formularëve të pagesave, si dhe respektim nga ana e subjekteve tatimore të këtyre dispozitave ligjore.
*Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, personelin e nevojshëm, në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. (**Vendimi i K.P.P nr. 220/2018).***

Siç konstatohet, në raste të ngjashme brenda të njëjtin AK, KPP ka arsyetuar se mospërputhja mes pagës në kontratë dhe asaj në listëpagesë, nuk mund të përbëjë shkak për s'kualifikim. Në këto kushte, KVO duhej të kualifikonte OE "C." shpk dhe të shpallej fituese e kësaj procedure prokurimi si oferta me vlerë më të ulët.

KVO, duke mos kualifikuar dhe shpallur fitues OE "C." shpk, ka vepruar në kundërshtim me nenin 53, të ligjit me nr. 9643 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili përcakton se *AK.... vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **44,614 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr.32, datë 21.06.2018	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B.(Jurist) 2.J. H. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.33 datë 21.06.2018 1.T. M., kryetar 2.A.H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7 076 527,82 lekë	**6.Oferta fituese**: "B." SHPK Vlera 5 101 460 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1 975 067.82 lekë

8. Data e hapjes së tenderit: 09.07.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 12 OE b)S'kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 9 OE
11.Ankimime AK: Po Colombo SHPK Nr 4725 Dat:17.07.2018	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ka Colombo SHPK Nr 4725/1 Date:20.07.2018	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** SKA
	14. Data e kontratës: **30.08.2018**	**15. Afati i kontratës:** **120 ditë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "M." shpk	5,541,894	S`kualifikuar
2	OE "C." shpk	5,056,846	S`kualifikuar
3	OE "S." shpk	4,491,070	S`kualifikuar
4	OE–"B." shpk	5,325,342	Kualifikuar.
5	OE "F." shpk	5,179,541	Kualifikuar
6	OE "F." shpk	5,122,498	Kualifikuar
7	OE "H." shpk	5,661,961	Kualifikuar
8	OE-"S." shpk	5,540,274	Kualifikuar
9	OE-"Sh." shpk	5,341,782	Kualifikuar
10	OE-"Sh." shpk	5,796,272	Kualifikuar
11	OE-"T." shpk	5,845,948	Kualifikuar
12	OE-"B." shpk	5,101,460	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/3 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP G.B. dhe J. H..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:
1.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier mjedisi, e cila është konsideruar e paargumentuar dhe e ekzagjeruar, NJP sqaron se inxhinieri i mjedisi është kërkuar duke ju referuar ligjit me nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, i ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009. Duke pasur zëra prishjesh dhe transportim mbetjesh të ngurta, është parë e arsyeshme disponimi i 1 inxhinieri mjedisi, kjo edhe për faktin se objekti ka qenë jo funksional prej vitesh dhe do bëhej në funksion të grup moshave 0-3 vjeç.
***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Pranohet observacioni juaj në lidhje me pikën e mësipërme.*

*12.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Mirëmbajtje ujësjellës, rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Kostren 1 dhe veprës së marrjes".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 40, datë 21.06.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. F. T. (inxhinier), I. A. (ekonomiste) dhe G. B. (jurist).
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Nga verifikimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme dhe jo në përputhje me llojin dhe volumet e punimeve.
1.Kërkesa për Certifikatën ISO 39001:2012 mbi "Sistemin i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor" e vlefshme, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën e punës. Ky tender zhvillohet për mirëmbajtje dhe rikonstruksion ujësjellësi, dhe kërkesa për Certifikatë ISO për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor është jashtë objektit të prokurimit.
2.Në DST kërkohet që *Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt*

të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, nuk është i angazhuar në marrëdhënie pune në subjekte të tjera publike apo private dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

- Kjo kërkesë vjen në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".*

Siç rezulton, vlera e fondit limit për këtë tender është **4,166,587 lekë,** dhe në këto kushte, kërkesa për drejtuesin e punimeve me kohë të plotë në objekt është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me vlerën e punimeve.

3.Në DST, kërkohet që OE duhet të ketë në stafin e shoqërisë *6 manovratorë.*

-Ky numër manovratorësh, është shumë i madh dhe i ekzagjëruar në raport me volumet e punës. Kjo vjen edhe në mospërputhje me numrin e makinerive të rënda që kërkohen, pasi kërkohet 1 fadromë dhe 1 eskavator, dhe nuk mund të kërkohen 6 manovratorë për zbatimin e kësaj kontrate.

Këto kritere përveçse nuk janë i argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **z. G. B., z. F. T. dhe znj. I. A.**

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 33, datë 21.06.2018 dhe përbëhet nga z. T. M. (kryetare), z. A. H. dhe V. K. (anëtarë).

Në këtë praktikë prokurimi kanë paraqitur ofertë 2 OE, dhe është kualifikuar 1 OE, konkretisht "Z." shpk me ofertë në vlerën 4,134,612 lekë, ose 31,975 lekë më e ulët se fondi limit. Oferta me e ulët në këtë tender është ajo e OE "Sh." shpk me vlerë 3,675,824 lekë, ose 458,788 lekë me e ulët se oferta fituese.

Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit fitues, u konstatuan se ajo nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST për t'u kualifikuar dhe shpallur fitues, dhe konkretisht:

1.Inxhinieri topograf N. Z., ka paraqitur diplomën e panoterizuar, në shkelje të kritereve të vendosura në DST.

2.Për 6 manovratorët e kërkuar, rezulton se 5 manovratorë nuk kanë paraqitur kontratat e punës të kërkuara në DST (F. S., D. S., Y. Z., K. S., A. Z.), ndërsa për 1 manovrator, Xh.P., dëshmia për drejtimin e mjeteve të rënda është e paqartë dhe e panoterizuar.

3.Vërtetimi i OSHEE është i muajit Qershor, dhe paraqet pagesat e shoqërisë deri në muajin Maj 2018, ndërkohë hedhja e dokumentit në SPE është me 14 Korrik 2018 dhe OE nuk pa kryer pagesën e maturuar të muajit Qershor 2018.

4.Mjekët e paraqitur, kanë mangësi në dokumentacion, pasi mjeku E. M. ka paraqitur kontratën e punës, diplomën dhe licencën të panoterizuar, ndërsa mjeku I. M. ka paraqitur diplomën të panoterizuar. Këto janë në kundërshtim kriteret e vendosura në DST.

5.Inxhinieri mekanik G. S., s'ka paraqitur librezën e punës, në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST.

6.Në DST ndër të tjera janë kërkuar disa makineri për zbatimin e kësaj kontrate:

1.Kamiona vetshkarkues mbi 18 – 2 copë

2. Kamioncina nga 3,5-7.5 ton - 1 copë

3. Miniskrep deri ne 2,8 ton - 1 copë
4. Prerëse bari - 1 copë

-Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se mjetet kamionë vetëshkarkues mbi 18 Ton, nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST pasi asnjëri prej tyre nuk është mbi 18 Ton. Mjeti me Targa AA538FT ka kapacitet mbajtës 17.1 Ton, ose 900 kg poshtë kapacitetit të kërkuar, ndërsa mjeti kamion me targa AA338OP, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti L. M., ka kapacitet mbajtës 17 Ton, ose 1 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar në DST.

-Kamionçina me targa AA97PT, ka kapacitet mbajtës 2.3Ton, ose 1.2 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar në DST.

-Nuk ka paraqitur miniskrepin deri 2.8 Ton.

-Nuk ka paraqitur faturë për disponimin e prerëses së barit.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "Z." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe znj. V. K.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **458,788 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr. 40 datë 05.07.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese me Propozim	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G. B. (Jurist) 2 F. T.(Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.49 datë 31.07.2018 1.T. M., kryetar 2.A. H., anëtar 3. V. K., anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 4 166 587.96 lekë	**6.Oferta fituese**: " Z." SHPK Vlera 4 134 612.64 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 31 975.32** lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 16.07.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo**

	14. Data e kontratës: **07.08.2018**	**15. Afati i kontratës:** **60 ditë**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"Sh."shpk	3,675,824	S`kualifikuar
2	OE "Z." shpk	4,134,612	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/6 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP F. T. dhe G. B.j.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje procesverbalin për hartimin e dokumenteve te tenderit, NJP sqaron se është mbajtur ky procesverbal, bashkëlidhur observacionit.
2.Në lidhje me certifikatën ISO 39001:2012 "Për menaxhimin e sigurisë në sistemin rrugor", NJP sqaron se kjo certifikatë është vendosur pasi është e nevojshme. Rruga për të vajtur në objekt kalon nëpër disa fshatarë të cilët kanë popullsi të lartë, dhe gjatësia e ndërtimit të linjës është L=6,873 m.
3.Në lidhje me kërkesën sipas të cilës kandidati ofertues duhet të përcaktojë nëpërmjet një deklarate drejtuesin teknik të punimeve i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, NJP sqaron se ky kriter është vendosur pasi objekti është zona malore dhe shumë larg nga qendra e banuar e Beratit, ka shtrirje të madhe në terren dhe problematika të ndryshme.
4.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier ndërtimi, dhe 1 inxhinier mekanik, NJP sqaron se inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për punime ndërtimore (puseta, bazamento betoni, për mbikalimet, rikonstruksion i veprës së marrjes), ndërsa inxhinieri mekanik për të mbajtur makineritë në gatishmëri, makineritë gërmuese dhe për realizuar kalimin në tiranta.
5.Në lidhje me kërkesën për 6 manovratorë, NJP sqaron se në DST kërkohen 6 mjete dhe në këto kushte kërkohen 6 manovratorë.
***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga NJP, audituesit sqarojnë se:*
1.Pranohet pika 1 e observacionit në lidhje me procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit.
2.Në lidhje me kërkesën për certifikatën ISO 39001:2012, audituesit sqarojnë se kjo kërkesë është e ekzagjeruar, dhe jo në përputhje me volumet e punës. Edhe në procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk është sqaruar arsyeja e vendosjes së këtij kriteri, por vetëm është dhënë një përcaktim i përgjithshëm se çfarë natyre ka kjo certifikatë. Natyra e punës është mirëmbajtje ujësjellësi, dhe rikonstruksion i linjës dhe veprës së marrjes, dhe kërkesat për këtë certifikatë dalin jashtë objektit të punës.
3.Në lidhje me kërkesën për drejtuesin teknik i cili nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, audituesit sqarojnë se një kërkesë e tillë nuk argumentuar në procesverbalin për HDT, dhe gjithashtu është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".*
4.Pranohet observacioni për 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier mekanik.
5.Në lidhje me numrin e manovratorëve, audituesit sqarojnë se në DST kërkohen 6 manovratorë me dëshmi për mjetet e rënda, ndërkohë që mjetet e kërkuara në DST nuk klasifikohen të gjitha të tilla, pasi shoferët e kamionëve dhe kamionçinave nuk u kërkohen dëshmi të klasifikuara për mjetet e rënda, por vetëm licencat e drejtimit me kategoritë përkatëse.

Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura. Për pjesën tjetër të observacioneve nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 589/1 prot., datë 23.08.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., V. K. dhe A.H..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:

1.Në lidhje me inxhinierin topograf N. Z. i cili ka paraqitur diplomën të panoterizuar, KVO sqaron se në DST kërkohet që drejtuesi teknik të figurojë në licencën e shoqërisë dhe në listpagesa.
2.Në lidhje me 6 manovratorët e kërkuar, ku për 5 prej tyre nuk është paraqitur kontrata e punës, KVO sqaron se në DST kërkohet vetëm dëshmi e aftësisë profesionale si dhe të figurojnë në listpagesa.
3.Në lidhje me mos pagesën e maturuar të energjisë për muajin Qershor 2018, KVO sqaron se shqyrton ofertat sipas kritereve të vendosura në DST dhe operatori ekonomik ka paraqitur ne sistem një vërtetim ku ka 0 detyrim të prapambetur deri në datën 18.06.2019 ku tregon që nuk është debitor ndaj OSHEE.
4.Në lidhje me mjekët E. M., i cili ka paraqitur kontratë pune, diplomë dhe licencë të panoterizuar, si dhe mjeku I.M. i cili ka paraqitur diplomë të panoterizuar, KVO referuar Udhëzimin nr. 8, datë 22.05.2015 "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik të APP", shprehet se përpara lidhjes së kontratës NJP i kërkon të paraqesë OE fitues dokumentacionin origjinal ose kopje të noterizuar. Për sa i përket pretendimeve, lidhur me diplomën e panoterizuar procesi i dorëzimit të dokumenteve prej operatorëve ekonomikë në S.P.E. lidhet me konvertimin e tyre nga hard copy në informacion dixhital (elektronik), informacion ky tashmë i aksesueshëm vetëm nëpërmjet kompjuterit dhe për të cilin nuk ka më kuptim gjykimi i origjinalitetit dhe askush nuk mund të gjykojë nëse një dokument në format elektronik është kopje apo original. Për më tepër që operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit ku marrin pjesë, dorëzojnë deklarata mbi përgjegjësinë që ata mbajnë për dokumentacionin që paraqesin. KPP vendimi Nr. 13/20165, datë 11.03.2016.

5.Në lidhje me inxhinierin mekanik G. S. i cili s'ka paraqitur librezën e punës, KVO sqaron se libreza e punës nuk ka asnjë funksion tjetër vetëm dublikon faktin që ing mekanik apo çdo punonjës tjetër është në marrëdhënie pune me këtë shoqëri. Mjafton fakti që punonjësit e kërkuar të jenë në listëpagesat e shoqërisë dhe është e vërtetuar ligjërisht marrëdhënia juridike e punësimit të tyre.
6.Në lidhje me mjetet vetëshkarkuese mbi 18 Ton, KVO sqaron se mjetet AA538FT si dhe AA338OP sipas certifikatës së kontrollit teknik janë mbi 18 Ton; për kamionçinën me kapacitet nga 3.5 deri 7.5 Ton, KVO sqaron se mjeti me targa AA971PT ka kapacitetit e kërkuar sipas certifikatës së kontrolli teknik; për miniskrepin me kapacitet deri 2.8 Ton, KVO sqaron se OE ka paraqitur mini eskavatorin me faturë tatimore nr serie 03290811 dhe deklaratë doganore, të cilin KVO e ka konsideruar të rregullt pasi kryen të njëjtin proces pune; në lidhje me faturën për prerësen e barit, KVO sqaron është paraqitur me faturën tatimore me numër serie 37123400 me zërin korrëse bari.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1 - Në lidhje me inxhinierin topograf me diplomë të panoterizuar, audituesit sqarojnë se kërkohet ekzaktësisht në paragrafin e fundit të paraqitur me ***bold*** *nga NJP në DST që të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Mos paraqitja e tyre konsiderohet kusht për s'kualifikim.*
2.Pranohet observacioni juaj në lidhje me manovratorët.
3.Në lidhje me mos pagesën e maturuar të energjisë për muajin Qershor 2018, audituesit sqarojnë se argumenti i KVO nuk qëndron, pasi dokumentet janë hedhur në sistem në datë 14 Korrik 2018, ndërkohë që faturat e muajit Qershor janë të maturuara. Në raste të ngjashme, KVO ka s'kualifikuar OE të tjerë, pikërisht për mos pagesën e maturuar të energjisë (siç është rasti i OE C. shpk në tenderin Restaurim i mureve të kalasë). Edhe në DST kërkohet ekzaktësisht në pikën ***b*** *të Kritereve të Veçanta që OE duhet të paraqesin* ***Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.***
4.Në lidhje me mangësitë në dokumentacionin e mjekëve, audituesit sqarojnë se në DST kërkohet ekzaktësisht në paragrafin e fundit të paraqitur me ***bold*** *nga NJP që të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Mos paraqitja e tyre konsiderohet kusht për s'kualifikim.*
5.Në lidhje me inxhinierin mekanik G. S. i cili nuk ka paraqitur librezën e punës, audituesit sqarojnë se kjo është kërkesë e përcaktuar qartë në DST, dhe KVO nëse e konsideronte kërkesë që nuk cenon zbatimin e kontratës, duhej ta konstatonte dhe vlerësonte vetë devijimet e vogla sipas nenit 53, pika 4 të LPP.
6.Në lidhje me mangësitë e paraqitura të mjeteve, audituesit sqarojnë se për mjetet kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbi 18 Ton, dy mjetet e paraqitura me targa AA538FT dhe AA338OP, janë sipas lejes së qarkullimit poshtë kapacitetit të kërkuar në DST. Mjetet nuk llogariten mbi bazën e peshës neto që kanë, por mbi bazën e kapacitetit mbajtës; gjithashtu, e njëjta vlen edhe për mjetin kamionçinë me targa AA971PT e cila është poshtë kapacitetit të kërkuar nga 3.5 deri 7.5 Ton. Ky mjet del nga leja e qarkullimit me kapacitet 2.3 Ton, çka e bën të pa kualifikueshëm për këtë tender; në lidhje me miniskrepin deri 2.8 Ton, audituesit sqarojnë se edhe mjeti minieskavator i paraqitur nuk plotëson kushtet, pasi NJP ka specifikuar edhe peshën deri 2.8 Ton për miniskrepin, dhe asnjë mjet i paraqitur nga OE, nuk plotëson kriteret e vendosura në DST.
7.Pranohet observacioni në lidhje me prerësen e barit.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionet e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

13.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Sistemi i kondicionimit për godinën e Bashkisë Berat".***

Situata: Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Berat me nr. 54, datë 31.07.2018, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga z. M. H. (inxhinier), I. A. (ekonomiste) dhe G. B. (jurist). Nuk ka procesverbal për përllogaritjen e fondit limit, por vetëm një preventiv i përgatitur nga projektues R. K. – subjekti iMEPS.
DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në vlerësimin e kritereve të vendosura, rezultuan kritere të ekzagjeruara, të paargumentuara dhe diskriminuese të vendosura nga NJP dhe konkretisht:
1.Në DST kërkohet që OE ofertues, të kenë pjesë të stafit ndër të tjera edhe 1 inxhinier mjedisi, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier mekanik.
-Këto kërkesa janë të ekzagjeruara dhe diskriminuese, pasi objekti i prokurimit është

kondicionimi i godinës së Bashkisë Berat, në të cilin zërat në preventiv për ndërtimin, mjedisi dhe aq më pak mekanik nuk ekzistojnë. Ky kriter zvogëlon mundësinë e OE që operojnë në fushën e kondicionimit për të paraqitur ofertat e tyre.
2.Në pikën 2 të DST kërkohet që *Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në listën e shoqërisë si më sipër, dhe të* ***deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ... si dhe të ketë licencë Restaurimi Kategoria A.***
-Kriteri i mësipërm është i ekzagjeruar dhe diskriminues. Së pari, kërkesa për drejtuesin teknik që të jetë me kohë të plotë në objekt, është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".* Ky tender ka fond limit vlerën **18,333,332 lekë,** ose 11,666,668 lekë poshtë vlerës, për të kërkuar drejtuesin teknik në dispozicion gjatë gjithë zbatimin të kontratës. Gjithashtu, kërkesa që drejtuesi teknik të jetë i pajisur me licencë Restaurimi Kategoria A, është kriter diskriminues dhe i paargumentuar, pasi objekti i Bashkisë Berat nuk ka asnjë vlerë të veçantë arkitekturore që mbrohet me ligj të veçantë, për të kërkuar Licencën e mësipërme e cila kërkohet për *Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë arkitekturore.*
3.Në DST kërkohet që OE të kenë në stafin e tyre një *Arkitekt Restaurator, i cili duhet të ketë licencë për restaurime te tipit A, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.....*
-Edhe ky kriter, në vazhdim të argumentit të mësipërm, është diskriminues dhe i ekzagjeruar, pasi objekti i Bashkisë Berat nuk ka asnjë vlerë të veçantë arkitekturore që mbrohet me ligj të veçantë, për të kërkuar Licencën e mësipërme e cila kërkohet për *Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë arkitekturore.*
Ky kriter nuk ofron cilësi të veçanta në lidhje me objektin e prokurimit, por përkundrazi pamundëson operatorët ekonomikë për të paraqitur ofertat e tyre për këtë tender.
4.Në DST kërkohet që OE duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën – "CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi", të lëshuar nga institucionet e autorizuara për lëshimin e tyre.
-Kjo kërkesë është diskriminuese dhe e paargumentuar, pasi punimet e kondicionimit nuk kanë impakt në zonën e mbrojtur, ndërkohë që vet objekti i Bashkisë Berat nuk ka status të veçantë mbrojtjeje të lëshuar nga Autoritetet Kompetente.
5.Në DST kërkohet disponimi i disa certifikatave ISO, si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori për sistemet e kondicionimit dhe certifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit/distributorit të autorizuar.
Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015**
Shoqëria duhet të paraqesë Certifikate **ISO 14001-2015**
Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007**
Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012**
Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 50001:2011**
Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 3834-2:2005**
Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO SA 8000:2014**
-Kërkesa për disponimin e këtyre certifikata është e ekzagjeruar dhe e paargumentuar. Kjo kërkesë pamundëson operatorë të tjerë ekonomikë për të paraqitur ofertat e tyre për këtë tender.

Këto kritere, përveçse nuk janë të argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **z. G.B., z. M. H. dhe znj. I. A.**

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 6, datë 26.03.2018 dhe përbëhet nga znj. T.M.(kryetare), z. A. H.dhe A.Dh.(anëtarë).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "L." shpk me ofertë në vlerën **17,964,893 lekë,** ose 368,439 lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta e paraqitur nga operatori tjetër ekonomik i s'kualifikuar është 16,671,500, ose 1,293,393 lekë më e ulët se oferta fituese.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:
1.Nuk përmbush piken 2.3 të kapacitetit teknik për punë të ngjashme. Rezulton se punët e paraqitura, asnjëra prej tyre nuk përmbush kërkesat e pikës *a)* qe vlera e punimeve te jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur gjatë 3 viteve të fundit. Në kushtet kur fondi limit është 18,3 milion leke, gjysma e kësaj vlere është 9,15 mln leke. Ky operator nuk ka paraqitur asnjë pune te ngjashme ku zëri në preventiv për punime të kësaj natyre të ketë vlerën e kërkuar.
2. Gjithashtu, OE është në mos përmbushje të pikës *b)* për punët e ngjashme ku vlera monetare për 3 vitet e fundit të marra së bashku të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit. Rezulton se ky OE nuk përmbush as këtë pikë pasi vlera e punëve të ngjashme sipas kontratave të lidhura dhe zërit që kanë në preventiv punimet e kësaj natyre, rezulton të jetë 22,1 milion leke nga 36,6 milion që është dyfishi që kërkohet sipas kërkesës se DST. Punët e ngjashme të paraqitura ku janë kryer punime kondicionimit, janë kontratat e lidhura për zyrat e ADISE-s ne Kavaje, Gjirokastër, Fier, Shijak, dhe rikonstruksioni i bashkisë Berat.
3.OE fitues, nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinierin mekanik të kërkuar në DST.
4.Në DST kërkohet që Arkitekti Restaurator me licencë të tipit A të lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, duhet të figurojë në listëpagesa për periudhën Janar 2017 – Qershor 2018.
-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se Arkitekti Restaurator me licencë të tipit A, Jorgo Xuhano, nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë për muajin Janar 2017, sipas kërkesës së DST.
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "L." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. T. M., z. A. H. dhe z. A. Dh.**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **I Lartë.**

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,293,393 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

1.Urdhër Prokurimi nr.54, datë 31.07.2018	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit të kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.G.B. (Jurist) 2.M. H. (Inxhiniere) 3.I. A. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.55 datë 31.07.2018 1.T. M., kryetar 2.A.H., anëtar 3.A. Dh., anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur"		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 18 333 332 lekë	**6.Oferta fituese**: "L." SHPK Vlera 17 964 893 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 368 439 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 31.08.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Ska	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Ska	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** SKA
	14. Data e kontratës: 29.10.2018	**15. Afati i kontratës: 4 javë**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	BOE"M."shpk, "B.." Shpk & "A." shpk	16,671,500	S`kualifikuar
2	OE "L." shpk	17,964,893	Kualifikuar dhe shpallur fitues.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/8 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtari e NJP G.B. dhe M.H..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, NJP argumenton:

1.Në lidhje procesverbalin për hartimin e dokumenteve te tenderit, NJP sqaron se është mbajtur ky procesverbal nga specialisti i fushës, anëtar i NJP, dhe i është dërguar titullarit të AK-së për miratim. (Bashkëlidhur relacion teknik për kriteret i firmosur nga anëtari Marjus Heqimaj

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga NJP, audituesit sqarojnë se:*

1.Pranohet pika 1 e observacionit në lidhje me procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit, i paraqitur si relacion teknik nga anëtari i NJP Marjus Heqimaj, por mungon nga ana e NJP argumentimi i vendosjes së kritereve tjera për këtë tender siç është kërkesa për drejtues teknik i paangazhuar në kontrata tjera, veprim ky në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".*, *si dhe njëkohësisht ky drejtues të ketë edhe licencë Restaurimi Kategoria të tipit A. Nuk argumentohen dhe janë të ekzagjeruara kërkesat për Arkitektin Restaurator me licencë të Tipit A, pasi objekti nuk është objekt i klasifikuar për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturore; kërkesa për licencën CZ për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi, është e ekzagjeruar pasi objekti i Bashkisë Berat nuk ka asnjë status të veçantë mbrojtjeje, dhe zërat në preventiv janë vetëm për objektin e Bashkisë Berat, dhe për asnjë objekt tjetër që mund të ketë status të veçantë mbrojtjeje.*

Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura. Për pjesën tjetër të observacioneve nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 5809/9 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e KVO T. M., V.K. dhe A. H..* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:

1.Në lidhje me mosplotësimin e pikës për punët e ngjashme, KVO sqaron se "kur ka bërë vlerësimin si punë të ngjashme ka marrë

parasysh faktin që janë punë civile dhe ka parë në brendësi zërat e preventivit të cilat nuk janë punë civile por montim pajisjesh. I vetmi zë punimi në preventiv qe është punë civile është hapja e tavanit për vendosjen e aparaturave të kondicionerëve. Prandaj KVO I është referuar vlerës totale të preventivit për punët e ngjashme të paraqitura dhe jo vlerës së zërave të veçantë në preventiv."

2.Në lidhje me mospërmbushjen e pikës për punë të ngjashme ku vlera monetare të 3 viteve të fundit e marrë së bashku të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, KVO sqaron se vlerat e paraqitura në dokumentacion janë "Rikonstruksioni Bashkisë" në shumën 78 335 865.62 lekë, "Rikonstruksioni I muzeut" me vlerë 12 361 460.82 Kavajë 11 866 436.71 lekë. Vlera totale është **102 563 736.15** lekë OE nuk ka paraqitur dokumentacionin për inxhinierin mekanik të kërkuar në DST.

3.Në lidhje me mos paraqitjen e dokumentacionit që provon disponimin e inxhinierit mekanik, KVO sqaron se OE ka të punësuar inxhinierin që ka licencë për montimin e kondicionereve kjo e vërtetuar me kontratë pune dhe pagesën e kontributit të sigurimeve Shoqërore.

4.Në lidhje me arkitektin restaurator i cili nuk figuron në listë pagesën e muajit janar, KVO sqaron se sipas gjykimit të tyre, inxhinieri është pjesë e listë pagesës për gjithë periudhën e kërkuar nga DST, dhe mos figurimi në muajin janar nuk mund të jetë arsye për s'kualifikim të OE.

5.Në lidhje me shpenzimet në kundërshtim me parimin e 3E-ve, KVO sqaron se s'kualifikimi i operatorëve tjerë ka qenë i drejtë, dhe fituesi është shpallur duke plotësuar të gjitha kushtet., ndaj sipas mendimit të tyre nuk kemi shpenzime në kundërshtim me 3E-të.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*

1.Në lidhje me pikën 1 dhe 2 të observacionit, audituesit sqarojnë se OE fitues, nuk e plotëson kriterin e vendosura nga NJP në DST, pasi në rastin e parë nuk ka asnjë punë të ngjashme të vetme, vlera e të cilit të jetë sa 50% e fondit limit, ndërkohë në rastin e pikës 2, vlera e punimeve të kryera nga ky OE nuk plotësohet që shuma e gjitha punimeve të jetë sa dyfishi i fondit limit. Pretendimi i KVO nuk qëndron, pasi punët e paraqitura në observacion për të cilat vlera totale është ***102,563,736 lekë,*** *janë punime ku fondi limit i tyre nuk është zë në preventiv vetëm për punime të natyrës së punës së prokuruar sa më sipër, por janë punime të përgjithshme rikonstruksioni godinash, dhe zërat që duhet të mbulonin pjesën e kondicionimit, në total nuk janë sa dyfishi i fondit limit. Neni 53, pika 3 e LPP përcakton qartë se AK vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

2.Në lidhje me mungesën e inxhinierit mekanik, audituesit sqarojnë se kërkesat e DST janë të qarta që kërkohet një inxhinier mekanik, ndërkohë nga kontrolli i dokumentacionit në SPE, mungon një inxhinier i tillë, dhe sipas nenit 53 pika 3 të cituar më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE.

3.Në lidhje me mungesën në listë pagesën e muajit Janar për inxhinierin restaurator, audituesit sqarojnë se edhe ky kriter nuk është përmbushur nga OE, dhe sipas nenit 53, pika 3 të cituar më sipër, nuk duhet të kishte kualifikuar.

Në lidhje me pretendimet e KVO, se ne mendojmë se nuk mund të jetë arsye për s'kualifikim, audituesit sqarojnë se KVO ka mbajtur qëndrim në çdo tender ku shkeljet sado të vogla, janë konsideruar arsye për s'kualifikim për operatorët e tjerë. Gjithashtu, neni 53, pika 4 e LPP, i jep të drejtë AK-së të shpalli një ofertë të vlefshme edhe për devijimet e vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera. KVO duhet ti referohet dispozitës së mësipërme, në rast se gjykon se një OE ndodhet në kushtet kur mund të kualifikohet edhe pse ka devijime të vogla.

5.Sa u pasqyrua më sipër, rezulton se OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe në këto kushte, shpenzimet e kryera janë në kundërshtim me parimin e 3E-ve, pasi oferta e operatorit tjetër ekonomik, është dukshëm më e favorshme se sa oferta e kualifikuar dhe shpallur fituese.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionet e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur asnjë dokument dhe argument për të provuar pretendimet e tyre.

Për aktivitetin e vitit 2019

Nga **10** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate të lidhur 468.623.804 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **6** procedura me vlerë kontrate prej 451,444 mijë lekë, ose 95% e totalit të kontratave, ku **3** procedura ose rreth 50% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve të prokuruar në vlerën **1,452,546 lekë**.

II.	**Titulli gjetjes:** Në **3** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 01.01.2019 – 30.09.2019**.**

1. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* "Ndertim rrjeti KUZ ne fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik :

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndertim rrjeti KUZ ne fshatin Lapardha 1, Lapardha 2 dhe fshatin Drobonik		
1.Urdhër Prokurimi nr.05, datë 25.01.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Tender i hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit:(ing G. S. TOP A. J. Ing V. Z. Ing D. S. Ing V. K.,hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.F. K. (Jurist) 2.F. T. (Inxhinier) 3.A. Zh. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.6 datë 25.01.2019 1.A. S. kryetar 2.E. M. anëtar 3.G. G. anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 31.666.634 (tridhjete e njemilion e gjashteqind e gjashtedhjete e gjashtemije e gjashteqind e tridhjete e kater) leke pa tvsh fondi i plote	**6.Oferta fituese**: BOE "M." SHPK dhe E. shpk ME Vlere **24 056 360** lekë pa tvsh.	**7.Diferenca me fondin limit** 7 610 274 leke **(pa tvsh).**
8. Data e hapjes së tenderit: 04.03.2019	**9.Burimi Financimit**: Buxheti Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: **4**OE b)S'kualifikuar **2** OE, c) Kualifikuar **2**OE
11.Ankimime Ankese me date 20.03.2019	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Me date 26.03.2019	**13.Përgjigje** **Ankesës nga APP apo KPP jo**
		Dt lidhjes kontratës: 14.05.2019 **Afati kontratës: 4 muaj**

-Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se kriteret e vendosura nga NJHDT nuk janë në përputhje me natyrën e punimeve, konkretisht:
Nga verifikimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme dhe jo në përputhje me llojin dhe volumet e punimeve.

2.3 ***Per Kapacitetin teknik:***

Për të provuar përvojëne mëparshme, operatori ekonomik duhet te kete :

1. *Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene ne* ***licencen e shoqerise*** *dhe ne listpagesa drejtues teknik te punesuar te vertetuar me kontrate pune te vlefshme te noterizuara, diplome,CV, te domosdoshem per kryerjen e punimeve si:*

Situata:

Ing Ndertimi 1
Ing. Hidroteknik 1
Ing. Mjedisi 2
Ing. Topograf 2
Ing. Mekanik 1

Kjo kërkesë është e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën e punimeve. Në preventiv nuk ka punime të natyrës së veçantë të cilat kërkojnë domosdoshmërisht një numër prej 2 ing. Mjedisi apo 2 ing. Topograf, kur mund të mjaftonte nga një inxhinier, për të cilët të kërkohet prezenca e këtyre inxhinierëve në kantier. Ky kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me vlerën dhe natyrën e punimeve.

Kriteri:	VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Impakti:	Këto kritere përveçse nuk janë të argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. F. K., z. F. T., znj. A. Zh..
Shkaku:	Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.
Rëndësia:	**I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.5 datë 25.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. F. K. (Jurist), z. F. T., (Inxhinier), znj. A. Zh.(Ekonomist).
Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 31.666.634 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.
Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.
Nga verifikimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme dhe jo në përputhje me llojin dhe volumet e punimeve.

2.3	***Per Kapacitetin teknik:***
Për të provuar përvojëne mëparshme, operatori ekonomik duhet te kete :	
2.	*Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene ne* ***licencen e shoqerise*** *dhe ne listpagesa drejtues teknik te punesuar te vertetuar me kontrate pune te vlefshme te noterizuara, diplome,CV, te domosdoshem per kryerjen e punimeve si:*
Ing Ndertimi	*1*
Ing. Hidroteknik	*1*
Ing. Mjedisi	*2*
Ing. Topograf	*2*
Ing. Mekanik	*1*

Kjo kërkesë është e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën e punimeve. Në preventiv nuk ka punime të natyrës së veçantë të cilat kërkojnë domosdoshmërisht një numër prej 2 ing. Mjedisi apo 2 ing. Topograf, kur mund të mjaftonte nga një inxhinier, për të cilët të kërkohet prezenca e këtyre inxhinierëve në kantier. Ky kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me vlerën dhe natyrën e punimeve.

Këto kritere përveçse nuk janë të argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur*

***në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. F. K., z. F. T., znj. A. Zh.**

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër nr. 06 datë 25.01.2019 të Kryetarit të Bashkisë Berat është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. A. S., me detyrë zv.Kryetare, z. E. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO dhe z. G. G., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.
Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 4 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 2 operator.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	M.	24,056,360	Kualifikohet, Fitues
2	B.SH.P.K	26,450,767	Kualifikohet
3	Sh.	19,918,270	Skualifikohet
4	Z.	28,078,216	Skualifikohet

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se në përgjithësi qëndrojnë mangësitë e konstatuara për operatorët ekonomikë të skualifikuar:

Janë s'kualifikuar ofertuesit:

1-" Sh." sh.p.k ka këto mangësi:

- I mungon tekniku i mesem topograf
- 2 manovrator të Glavenices janë pa dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik
- Jo të pestë manovratorët e shëndëllisë nuk kanë dëshmi kualifikimi profesional
- 2 teknikët e ndërtimit nuk kanë certifikatat përkatëse
- Mungojnë 2 pompat e ujit
- Kamioncina AA034XL ka mospërputhje dokumnetash shoqëruese
- Nuk ruhet raporti i makinerive sipas përqindjes së kontratës.

2-" Z. " sh.p.k ka këto mangësi:

- 3 prej manovratorëve nuk kanë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.
- 1 nga punonjësit, B.I. nuk ka kontratë pune
- Teknikët e ndërtimit, N.B. dhe Y.Z. nuk kanë certifikate aftësie profesionale
- Topografi G. A. nuk ka certifikatë aftësimi profesional
- Mjeku E. M. nuk figuron në listpagesë
- 1 Eskavator me goma mungon
- 1 minieskavator mungon etj

OE Shëndelli ka paraqitur formularin e ankesës protokolluar me nr. 1533 prot., datë 20.03.2019 ku ka paraqitur observacionet e tij lidhur me arsyet e skualifikimit. Me shkresën nr. 1533/1 prot., datë 26.03.2019 është kthyer përgjigje nga ana e AK ku nuk është marë parasysh ankesa e OE. Nga ana e OE nuk është paraqitur ankesë pranë KPP në lidhje me këtë procedurë.

Veprimet e mara nga AK për kthimin e përgjigjes nuk janë bërë bazuar në L**igjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar,** dhe me konkretisht:

Sipas nenit 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…"* nga ana e AK nuk është marë asnjë masë sipas përcaktimeve të bërë në ligj pasi mungon në dosjen e tenderit Urdhër pezullimi i procedurës, Urdhër për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave etj…

Më datë 09.04.2019 është bërë njoftimi i ofertuesit fitues, më datë 14.05.2019 është lidhur kontrata me nr. 2047/1 prot.
Vlerësojmë se vlerësimi i KVO-së gjatë shqyrtimit të ofertave ka qënë në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komente dhe sqarime*:*
Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5793/2, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 5 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5793 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:
- *Në lidhje me kriterin për kapacitet teknik të kërkuar në DST konkretisht Ing Mjedisi 2 dhe Ing Topograf 2 sqarohet se objekti i investimit është i ndarë në dy Njësi Administrative të ndryshme të cilat ndodhen në pozicion gjeografik shumë larg njeri tjetrit. Afati i punimeve për ndërtimin e rrjetit KUZ në të dy fshatrat është në të njëjtën kohë dhe volumin më të madh e zënë punime mjedisore dhe topografike ku janë të përfshira dhe 3 vepra pastrimi përkatësisht 2 në Lapardha dhe 1 një Drobonik që lidhne me mbrojtjen e mjedisit. Drejtuesit teknik të mësipërm nuk janë kërkuar të jenë prezent gjatë gjithë kohës por duke qënë se investimi bëhej njëkohësisht në të dy fshatrat për të mos penguar vazhdimin punës.*

Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte kjo pasi fakti që nuk kërkohet të jenë prezent në objekt nuk përbën kusht të nevojshëm për të pasur nga dy inxhinier kur mund të mjaftoheshin edhe me nga një të tillë. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

2. Auditim i prokurimit publik me objekt*:* "Menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Berat 2019-2024 (Shërbim i pastrimit) "

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "**Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta urbane te Bashkise Berat 2019-2024(Sherbim i pastrimit)"**		
1.Urdhër Prokurimi nr.1 datë 17.01.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** 'Tender i hapur mbi kufirin e larte monetar"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit dhe percaktimit, te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.F. A.i (Jurist) 2.D. S. (Inxhiniere) 3.A. Zh. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 2 datë 17 .01.2019 1.A. S. kryetar 2.V. K. anëtar 3.G. B. anëtar
5.Fondi Limit : 298.615.566, leke pa tvsh	**6.Oferta fituese**: "A.shpk me vlere: 298,355,185 pa tvsh	**7.Diferenca me fondin limit : 260 381 leke pa tvsh**

8. Data e hapjes së tenderit: 11.03.2019	**9.Burimi Financimit**: Vete financim	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime **Date:24.01.2019nr.507 prot** **28.02.2018nr.1155prot** **07.03.2019nr.1311prot**	**12. Përgjigje ankesës nga AK** **28.01.2018 nr.508/1 prot** **Date: 08.03.2019**	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** **jo**
		Dt lidhjes kontratës: 25.04.2019 **Afati kontratës: 5 vite**

Situata: -Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se OE "A." nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga NJHDT, konkretisht:
Mungon vërtetimi i realizimit të kontratës me notën 10 ose shumë mirë.
Mungon stafi teknik në listëpagesë për të gjithë periudhëne kërkuar sipas DST

Kriteri: VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Impakti: OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorin ekonomik "A." dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anulluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Shkaku: Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.

Rëndësia: **I lartë**

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër nr.01 datë 17.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. F. A. (Juriste), znj. D. S., (Inxhiniere), znj. A. Zh. (Ekonomist).

Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 298,615,566 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".

Fondi limit është përcaktuar bazuar në Urdhërin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr. 173 datë 05.03.2018 ku është ngritur grupi i punës "Për studimin e kostove të pastrimit dhe llogaritjen e menaxhimin e integruar të mbetjeve të Bashkisë Berat", në përbërjet të cilit kanë qenë 21 persona me funksione të ndryshme pranë Bashkisë Berat. Në përllogaritjen e fondit limit veç analizës së zëra të shërbimeve është përcaktuar dhe investime që do të kryen nga ana e operatorit fitues dhe përkatësisht vitin e parë do të blihen 200 kazane dhe kostoja totale e

shërbimit do të jetë 76,052,536 lekë me TVSH, vitin e dytë do të blihen 100 kazane dhe kostoja totale e shërbimit do të jetë 71,852,536 lekë me TVSH, vitin e tretë dhe të katërt do të blihen 60 kazane dhe kostoja totale e shërbimit do të jetë 70,088,536 lekë me TVSH dhe për vitin e pastë do të blihen 58 kazane dhe kostoja totale e shërbimit do të jetë 70,172,536 lekë me TVSH.
Mungon nga NJHDT procedura e ndjekur për përcaktimin e çmimit për njësi të çdo kazani.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre.
Nga ana e AK është bërë edhe publikimi i tenderit pranë gazetës Financial Time më datë 21.01.2019 në faqen 18 të saj.

- Në Dst është kërkuar :

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese te konfirmuara për shërbimet e kryera; b)vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; vlersuar me noten 10 (dhjete) ose e shprehur me fjalen " shume mire", me sukses,plotesisht, ne perputhje me kushtet e kontrates etj.

Kriteri i vendosur nga NJHDT për notën 10 është i pabazuar, i paargumentuar dhe ekzagjerues, ky kriter është **në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*".**
Me shkresën nr 507 prot., datë 24.01.2019 është plotësuar formulari i ankesës nga ana e OE A.dhe është bërë ankesë në lidhje me kriteret e vendosura nga Ak. Me shkresën nr. 507/1 prot., datë 28.01.2019 është kthyer përgjigje nga ana e AK, është hartuar Shtojca për ndryshimet në DT dhe është ngarkuar në SEP.
Me shkresën nr 1155 prot., datë 28.02.2019 sidhe shkresën nr. 1311 prot., datë 07.03.2019 është bërë kërkesë për sqarim nga ana e subjektit S.dhe me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 08.03.2019 është kthyer përgjigje nga ana e AK.
Në dosjen e tenderit rezultoj se:
-mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),
-mungon Proçes Verbali i pezullimit të porcedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,
Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*

Në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Ky procesverbal i vihet në dispozicionpersonit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve gjithashtu është në kundërshtim të nenit 61 të LPP. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht znj. F. A., znj. D. S.i, znj. A. Zh.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. A. S. me detyrë zv Kryetare, z. G. B., me detyrë Specialist së Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj.V. K., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se nuk ka operatorë ekonomik të s'kualifikuar dhe është kualifikuar 1 operator, OE "A." Shpk i cili është shpallur fitues me ofertë ekonomike në vlerën 298,355,185 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 260,381 lekë. Është lidhur kontrata me nr. 2241 prot., datë 25.04.2019 me vlerë totale të kontratës në shumën 358,026,222 lekë me TVSH midis Bashkisë Berat dhe OE "A.".

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:

- Në DST është përcaktuar në kriteret e veçanta, kapaciteti teknik pika 1 si më poshtë:

  3.Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

  - *Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore perkatese te konfirmuara për shërbimet e kryera; b)vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; vlersuar me noten 10 (dhjete) ose e shprehur me fjalen " shume mire", me sukses,plotesisht, ne perputhje me kushtet e kontrates etj.*

OE ka paraqitur kontratat e lidhur me 2 Bashki dhe më konkretisht kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë dhe atë të lidhur me Bashkinë Berat (për vitet 2014-2018). Nuk ka në asnjë nga dokumentet e ngarkuara në sistem vërtetimi i realizimit i vlerësuar me notë apo i shprehur me fjalën "shumë mirë" për të gjitha kontratat e paraqitura.

- Në DST dhe Shtojcën përkatëse për ndryshime, pika 2.1 dhe 3 e kapaciteteve teknik është kërkuar:

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën janar 2018 – Janar 2019 për punonjësit si më poshtë:

- *1 (një) Inxhinier Mjedisi/ kimist/agronom për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune*

Operatorët ekonomike duhet të kenë të punësuar 1 ekspert për ndikimin në mjedis per të cilin të paraqesë, diplome, dëshminë përkatëse dhe i cili duhet të figurojnë në listepagesat e operatorëve per periudhën janar 2018 – Janar 2019

1.Është kërkuar "1 (një) Inxhinier Mjedisi/ kimist/agronom për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune", i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën janar 2018 – Janar 2019 , subjekti ka paraqitur deklaratën e tij ku në stafin teknik ka deklaruar znj. E. D. si inxhiniere mjedisi e cila do të mari pjesë në procedurën që do të zhvillohet. Nga kontrolli i listpagesave rezulton se znj. E. D. nuk figuron në muajt

Janar-Prill të vitit 2018, kjo sjell mospërmbushje të kritereve të vendosura në DST. Gjithashtu në deklaratën e paraqitur nga shoqëria për këtë procedurë prokurimi është caktuar si Drejtues teknik z. V. Z. i cili do të angazhohet me kohë të plotë. Nga kontrolli i listëpagesave figuron se z ky person nuk është i siguruar me kohë të plotë pranë kësaj shoqërie por figuron mesatarisht me 13 ditë pune në muaj, kjo tregon se personi në fjalë nuk jep garanci për punë të vazhdueshme çka është kusht i domosdoshëm për zhvillmin e shërbimit.

2.Është kërkuar "Operatorët ekonomike duhet të kenë të punësuar 1 ekspert për ndikimin në mjedis per të cilin të paraqesë, diplome, dëshminë përkatëse dhe i cili duhet të figurojnë në listepagesat e operatorëve per periudhën janar 2018 – Janar 2019.", shoqëria ka paraqitur në sistem Certifikatën e z.B. D. si ekspert për ndikimin në mjedis dhe kontratën e lidhur me këtë person. Në librezën e paraqitur figuron se ky person është larguar nga puna në datë 25.05.2018 me dëshirë nga shoqëria. Rrjedhimisht ky person nuk figuron as në lispagesat e shoqërisë dhe nuk përmbush kërkesat e vënë nga njësia e hartimit të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, ky OE nuk i plotësontë gjitha kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar operatorin ekonomik "A." dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anulluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika nr.1, gërma (ç), ku thuhet :

"Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm (ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"

- neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, ku thuhet:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret …, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.

- nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3:

"3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: znj. A. S. në cilësinë e kryetares së KVO, z. G. B. dhe zj.V. K., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Komente dhe sqarime*:*

Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5793/3, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 5 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5793 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

-Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me: a) situacionet dhe faturat tatimore përkatëse te konfirmuara për shërbimet e kryera; b)vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e

përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar; vlerësuar me notën 10 (dhjete) ose e shprehur me fjalën " shume mire", me sukses, plotësisht, ne përputhje me kushtet e kontratës etj. Pas koordinimit me APP na sygjerojnë që me qëllim shmangien e problematikave që mund të krojohen në plotësimin e kriterit nga OE apo në vlerësimin e përmbushjes së kriterit nga KVO, duke marë shkas se vlerësimet nga entet publike mund të kenë formate apo përshkrime të cilat jo domosdoshmërisht përmbajnë përcaktimet e sipërcituara nga AK, rekomandojmë që AK të pranojë dhe forma të tjera të vlerësimit, sipas email të APP-së.

Sqarim i grupit të auditimit: Për sa sqaruar në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. Theksojmë faktin se në komunikimin elektronik të zhvilluara me APP është gjithashtu e përcaktuar nga ana e kësaj të fundit shprehimisht: "... APP rekomandon AK të rivlerësojë nevojën për vendosjne e specifikave në fjalë dhe në rast se argumenton nevojën, të përdorë vlerësimin me pikë të ofertës ekonomike më të favorshme duke përfshirë në kriter edhe specifikën e pikës 1. AK nuk duhet të anullojë procedurën por mund të bëj ndryshime përmes hartimit të një shtojce". Mos përcaktimi në shtojcë i ndryshimit të këtij kriteri nuk rrit konkurencën dhe nuk jep mundësi operatorëve të tjerë në treg të marin pjesë në këtë procedurë, veprime të cilat janë në kundërshtim me parimet e LPP.

Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.

<u>Komente dhe sqarime</u>*:*

Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5793/4, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 5 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5793 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

Në lidhje me kriterin e veçantë pika 1 ku kërkohet Vërtetimin e Iëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kesaj kontratë, ku të jetë e përcaktuar kohezjatja e shërbimit,vlera e shërbimit të realizuar ,vlerësuar me notën 10 ose e shprehur me fjal "shume mirë". Ju sqarojmë se:

Operatori ekonomik A.ishte operatori që mbulonte shërbimin e pastrimit në qytetin e Beratit për 5 vitet e fundit deri në momentin e lidhjes së kontratës së tenderit me objekt menaxhim I integruar I mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Berat 2019-2024"

Kvo gjatë kohës se shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dispononte informacionin qe nga ana e Bashkisë Berat ishte dhënë një formular vlerësimi në të cilin shprehej "punët janë kryer konform kontratës së lidhur dhe është vlerësuar me shumë mirë"

Kualifikimi i këtij operatori me ofertë e suksesshme është bërë:

Së pari duke u nisur nga fakti që ishte i vetmi operator pjesëmarrës në tender dhe pavarësisht se nuk kishte ngarkuar në sistem formularin e vlerësimit si punë të ngjashme kishte paraqitur.

kontratën me Bashkinë Berat dhe dijenisë nga kvo se operatori ekonomik ishte vlerësuar "shumë mirë", nga AK.

Së dyti institucioni do të kishte kosto negative duke qënë se ky është tender ndërkombëtar dhe në bazë të ligjit 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" I ndryshuar , neni 38 pika 2 Njoftimet për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, botohen në Buletinin e

Njoftimeve Publike dhe në të paktën një gazetë me shpërndarje në Europë institucioni do të duhej të paguante përsëri për të bërë të mundur zbatimin e ligjit duke bëre publikimin në gazetë me shpërndarje në Europë.

Në lidhje me pikën 2.1 dhe 3 të DST ju sqarojmë se:

1.Për periudhën Janar 2018 deri ne Prill 2018 e plotëson z.B. D.

Për periudhën Prill 2018 Janar 2019 e plotëson znj.E. D. bashkangjitur po ju dërgojmë kopje te kontratës së punës dhe dhe dëshmisë përkatëse.

2. Në lidhje me pikën 2 për sa i përket Drejtuesit teknik z.V. Z. referuar kontratës së punës Nr.165 rep dhe Nr 64/1 kol date 07.03.2019 e lidhur midis punëdhënësit shoqëria Ante grup shpk dhe punëmarrësit V. Z. neni 3 citohet: koha normale e punës do te jete 40 ore ne javë. Periudha ditore e punës do te jetë 8 orë dhe ajo javore pesë ditë, nga e hëna deri të premten. Ditët e shtunë dhe e dielë do te jetë pushim javor.(bashkangjitur kopje e kontratës së punës). **Sqarim i grupit të auditimit:** *Për sa paraqitur në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kualifikimin e padrejtë të OE sqarojmë se asnjë nga argumentet nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte. Lidhur me pretendimin e parë nuk është argument që velrësimi i ofertës ekonomike mund të bëhet nga ana e KVO-së mbi bazën e djenisë që mund të ketë KVO por duhet bërë mbi bazën e fakteve dhe dokumentave të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik. Përsa i përket pretendimit të dytë në lidhje me Ing. E. D. dhe ing. V. Z. nga ana juaj janë paraqitur vetëm kontratat e punës të lidhura të cilat nuk shërbejnë si provë për të vërtetuar faktin se personi është i punësuar apo jo pranë shoqërisë, kjo gjë vërtetohet nëpërmjet listpagesave të deklaruara pranë organeve tatimore në periudha përkatëse për të cilat nuk është evidentuar nga grupi i auditimit emri i znj. E. D. në periudhën Janar-Prill 2018 ndërsa për z. V. Z. rezultojnë deklarime jo me kohë të plotë.* ***Pretendimet tuaja nuk merret në konsideratë.***

3. **Auditim i prokurimit publik me objekt:**"Ujesjellesi fshati Mbreshtan,njesia administrative Sinje **:**

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ujesjellesi fshati Mbreshtan,njesia administrative Sinj.		
1.Urdhër Prokurimi nr.09, datë 04.02.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Tender i hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit:(ing F. T., E. Ll.,L. S.,S. Dh.,A. Dh. dhe D. S., hartimit dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.F. K. (Jurist) 2.E. Ll. (Inxhinier) 3.A. Zh. (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.10 datë 04.02.2019 1.A. S. kryetar 2.E. M. anëtar 3.A. Sh. zvendesuar me Z.A. Dh. anëtar
5.Fondi Limit (pa tvsh) 31.065.619,00	**6.Oferta fituese**: F. shpk me vlere **21 956 747** lekë pa tvsh.	**7.Diferenca me fondin limit** **9 108 872** leke **(pa tvsh).**
8. Data e hapjes së tenderit: 01.04.2019	**9.Burimi Financimit**: Buxheti Bashkisë	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: **9** OE b)S'kualifikuar **5** OE, c) Kualifikuar **4** OE
11.Ankimime Ankese me date 22.02.2019 dhe 26.02.2019 Ankes ne sistemkundrejt vendimit te KVO date 21.04.2019	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Me date: 26.03.2019 28.02.2019 Kthim pergjigja me date 26.04.2019	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP** **Jo**
		Dt lidhjes kontratës: 23.05.2019 **Afati kontratës: 4 muaj**

Situata: -Nga të dhënat e dosjes dhe të sistemit APP, konstatohet se OE "F." nuk plotëson disa nga kriteret e vendosura nga NJHDT, konkretisht:

Nga dokumentacioni i paraqitur në SEP rezulton se munojnë certifikata : BS PAS 99 : 2015, BS ISO 39001:2012 dhe ISO 1452-1:2009.

Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura nga OE rezulton se mungojnë foto për pajisjet e deklaruara dhe është ngarkuar në SEP vetëm faturat eqë vërtetojnë disponibilitetin e pajisjeve apo kontrata e qerave dhe më konkretisht mungojnë fotot për : pompë uji copë 1, aparate saldimi tubash polietileni copë 2, motogenerator copë 1, prerëse asfalti copë 1, depozitë uji copë 1, betoniere copë 2 dhe vibrator copë 1. Ndërkohë për mjete e tjera e vëna në dispozicion janë paraqitur dhe fotot përkatëse.

Kriteri: VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të KM, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, dhe nenit 53, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Impakti: Kualifikimi i OE "F." nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST, dhe KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, ose midis operatorëve pjesëmarrës me mangësi në plotësimin e kritereve të vlerësonte kriterin kryesorë "*çmimi më i leverdishëm*", për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve në vlerën **1,452,546 lekë**

Shkaku: Nga mos vlerësim i drejtë i kritereve kualifikues sipas DST, dhe në përputhje me dispozitat e ligjit te LPP.

Rëndësia: **I lartë**

Me urdhër nr.9 datë 04.02.2019, të Kryetarit të Bashkisë Berat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga znj. F. K. (Jurist), z. E. Ll., (Inxhinier), znj. A. Zh. (Ekonomist).
Në urdhër është përcaktuar fondi limit në vlerën 31,065,619 lekë pa TVSH, përbërja e njësisë së prokurimit dhe lloji i procedurës së prokurimit.
Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të preventivit konstatohet se çmimi i përcaktuar nga AK përputhet me çmimin sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin 2015, sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve gjithashtu është në kundërshtim

të nenit 61 të LPP. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht znj. F. A., z. E. Ll., znj. A. Zh.

Në lidhje me kriteret e vendosura nga ana e OE I.C. është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 1037 prot., datë 22.02.2019 gjithashtu dhe nga OE S. është paraqitur formulari i ankesës protokolluar me nr. 1103 prot., datë 26.02.2019. Nga ana e AK është kthyer përgjigje të dy OE dhe më kontretisht për OE I. me nr. 1037/1 prot., datë 26.02.2019 ku është marë parasysh vetëm një pjesë e ankesës ndërsa për OE S. është kthyer përgjighe sipas shkresës nr. 1103/1 prot., datë 28.02.2019 ku janë marë parasysh kërkesat e OE. Pas këtyre veprimeve nga ana e AK është hartuar dhe ngarkuar në SEP shtojca me ndryshimet përkatëse në DST.

Në dosjen e tenderit rezultoj se:
-mungon Proçes Verbali për ngritjen e KSHA (komisioni i shqyrtimit të ankesave),
-mungon Proçes Verbali i pezullimit të porcedurës deri në shqyrtimin e ankesave të OE,
Veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP ku citohet se :"... *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës…*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi AK.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër nr. 06 datë 25.01.2019 të Kryetarit të Bashkisë Berat është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga znj. A. S., me detyrë zv.Kryetare, z. E. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO dhe z. A. Dh., me detyrë Specialiste në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO i cili ka zëvendësuar z. A. Sh. i caktuar më parë si anëtar i KVO.
KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.
Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.
Nga vlerësimi rezulton se janë s'kualifikuar 5 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 4 operator.
Kualifikimet dhe s'kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s'kualifikuar
1	F.	21,956,747	Kualifikohet, Fitues
2	S.	22,306,492	Kualifikohet
3	M.	25,458,372	Kualifikohet
4	V.	27,122,768	Kualifikohet
5	Sh.	21,796,708	Skualifikohet
6	K.	20,504,201	Skualifikohet
7	D.	27,443,633	Skualifikohet
8	C.	24,433,000	Skualifikohet
9	B.	25,805,506	Skualifikohet

Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentacionin kualifikues të paraqitur në formatin elektronik u konstatua se në përgjithësi qëndrojnë mangësitë e konstatuara për operatorët ekonomikë të skualifikuar:

Janë s'kualifikuar ofertuesit:
1-" Sh. " sh.p.k ka këto mangësi:

- Mjeti SR2857B i paraqitur si autobot uji nga fotoja duket që është mjet për hedjen e prajmerit në vazhdim të shtesave të asfaltit
- Aparati i saldimit të tubave polietileni sic eshte paraqitur ne for është i papërshtatshëm për punën që do kryet pasi seksioni i tubave që duhet të ngjiten është i përmasave Ø30-90.

2-“ K. “ sh.p.k ka këto mangësi, mungon:

- 1 kamioncinë
- 1 mjettransporti vetëshkarkues min 8 ton
- Minieskavatori, i njëjti mjet është ngarkuar në dy skedar të ndryshëm njëherë si eskavator dhe në skedarin tjetër si minieskavator, KVO e ka vlerësuaer si eskavator
- Dokumentacioni i eskavatorit me goma si leje qarkullimi sgs polica e sigurimit
- Bilanci i vitit 2015, 2016 për K. dhe C., të dy kanë filluar aktivitet në vitin 2017 dhe 2018
- Xhiro e vitit 2015, 2016 për K. dhe C. të dy kanë filluar aktivitet në vitin 2017 dhe 2018
- Lispagesa për periushën janar 2018-shtator 2018

3-“ D.“ sh.p.k ka këto mangësi ne mjetet e mëposhtëme:

- AA770AN fotokopjet e dokumentave nuk shihet qartë vula e noterit
- Autobot uji gjithë dokumnetacioni është fotokopje
- Kamioni AA351OE gjithë dokumnetacioni është fotokopje
- Eskavatori me goma AGMT 74 gjithë dokumentacioni është fotokopje etj

4-“ C.“ sh.p.k ka këto mangësi:

- Mungon eskavatori me goma. Mjeti VL 7985 C i ngarkuar në skedare si eskavator me goma është vlerësuar nga KVO si fadromë. Mjeti AFMT31 i ngakuar në skedare si fadromë është minieskavator. Mjeti case 13358 i narkuar në skedare si fadromë nuk ka asnjë dokumentacion, nuk ka foto, është paraqitur një vërtetim doganor i datës 10.02.2005 nga i cili nuk mund të vlerësohet lloji i mjetit dhe me këto nuk mudn të klasifikohet si fadromë apo si eskavator
- Inxhiniere mjedisi znj. G. Z. i gjithë dokumentacioni është i panjehsuar me origjinalin

5-“ B. “ sh.p.k ka këto mangësi:

- Mjeti AA978 AM nuk është paraqitur në foto dhe nuk ka policë sigurimi, mjeti AA651 DY nuk është paraqitur me foto, mjeti AA601NP nuk është paraqitur me foto. Mjetet e mara me qera nga shoqëria K.nuk janë paraqitur me foto

Më datë 14.05.2019 është bërë njoftimi i ofertuesit fitues, më datë 23.05.2019 është lidhur kontrata me nr. 2775/1 prot me OE F. me vlerë 26,348,096 lekë me TVSH.

<u>Komente dhe sqarime</u>*:*

Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/1, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 5 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5793 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e NJP për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

- Vihet re se, në te gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha kriteret e veçanta për kualifikim të vendosura në këtë procedurë janë të dokumentuara në procesverbalin e hartimit të dokumentave të tenderit dhe janë vendosur në përputhje me

objektin e prokurimit nga z. E. Ll. të cilat nuk janë gjetur në dosjen e prokurimit. Bashkëlidhur janë paraqitur kopje të kritereve teknike të mbajtura personalisht nga z. E. Ll.

Sqarim i grupit të auditimit: *Për sa paraqitur në lidhje me mangësi e konstatuara nga grupi i auditimit mbi kriteret e vendosura nga NJHDT vlerësojmë se e dokumentat e paraqitur nga z.Llupi nuk mund të merren në konsideratë pasi nuk janë pjesë së dosjes së prokurimit (të painventarizuara) dhe mbi të gjitha janë personale siç dhe shpreheni në kundërshtimet tuaja. Asnjë nga argumentet që paraqisni nuk janë ligjore dhe të mbështetura në fakte dhe për rrjedhojë* ***pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.***

Komente dhe sqarime*:*

Në kundërshtimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat me shkresën nr. 5808/5, datë 22.11.2019 lidhur me Akt Konstatimin nr. 5 protokolluar pranë Bashkisë Berat me nr.5793 prot., datë 15.11.2019, është bërë sqarim nga ana e KVO-së për mangësitë te konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, si vijon:

Certifikata BS PAS 99:2015 e kërkuar si kriter nga Njësia e Prokurimit është vënë gabimisht viti 2015 pasi për këtë certifikatë e fundit është e vitit 2012. Të gjithë operatorët pjesëmarrës kanë paraqitur çertifikatë BS PAS 99:2012 Sisteme të Menaxhimit të Integruar". Gjithashtu dhe operatori ekonomik F. sh.p.k ka paraqitur këtë çertifikatë. Ndërsa për BS ISO 39001 :20 12" Sistemet e Menaxhimit të sigurisë të trafikut rrugor(RTS) nga OE 'F. sh.p. k e ka të ngarkuar ne SEP.

ISO 1452-1 :2009 Për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldim" nga OE F. sh.p.k është paraqitur çertifikata ISO 3834-2:2006. Çertifikata nr. 001-3834/19 Çertifikon që Sistemi 1 Menaxhimit Të cilësisë për saldim me shkrirje të materialeve metalike.

2. Më date 12 Prill 2019 Kryetarja e KVO-së znj.A. S. ka bërë kërkesa në SEP 4 OE si "B.93" sh.p.k, ' K. ' sh.p.k,' M.s" sh.p.k dhe F. sh.p.k që të paraqesin me foto dokumentacionin e kërkuar pasi nuk ishin ngarkuar në SEP fotot gjithashtu për të qartësuar e saktësuar mjetet e kërkuara.

Për OE F. sh.p. k janë kërkuar këto mjete si më poshtë:

A. Foto të mjetit Autobot uji AA203NT me pamje ballore e anësore për tu bërë e dukshme dhe targa e mjetit

B. Foto të aparatit të saldimit për iubat e polietileni

C. foto të vibratorit të ngjeshjes së shtresave të dheut.

Kryetarja e KVO-së ka vënë në dijeni dhe dy anëtarët e Komisionit me anë të një email i ku kërkohet informacioni. Bashkëlidhur me foto dhe emaili date 12 Prill 2019 ora 11:23. Afati që i është lënë OU është sipas afateve ligjore të parashikuara në LPP.

Më datë 15.04.2019 është dërguar në adresë të Kryetares se Kvo-së në SEP përgjigja e operatorit. Gjithashtu është dërguar dhe në mënyrë zyrtare më datë 15.04.2019 me nr.2024 prot. të Bashkisë Berat ku marrim dokumentacionin për mjetet të shoqëruara me fotot përkatëse. Bazuar mbi këtë informacion KVO rivlerëson dokumentin justifikues të OE duke mbajtur një procesverbal dhe kualifikon në sistem OE F. sh.p.k. Bashkëlidhur kopja e dokumentacionit të OE dhe procesverbali i KVO.

Ndërsa për mjetet e tjera st pompë uji copë 1, motogjenerator copë 1, depozitë uji copë 1, betoniere copë 2, prerëse asfalti copë l të gjitha mjetet e mësipërme janë paraqitur me foto dhe me fatura tatimore të Blerjes.

Sqarim i grupit të auditimit: *: Për sa sqaroni në lidhje me argumentimin e dokumentacioni të paraqitur dhe të kërkuar nga KVO , grupi i KLSH pasi analizojë dokumentet e paraqitura arrin në konkluzionin se pretendimet e paraqitura nga subjekti Bashkia Berat (anëtarët e KVO-së), argumentojë veprimet e tyre.* ***Pretendimi qëndron dhe merret në konsideratë****.*

D/4

I. "Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 3080 prot datë 04.07.2017	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 14,983,653 lekë **OE fitues "B." SHPK**		**16.Likuiduar ------**	
17- Situacioni Përfundimtar dt 04.09.2017 **-Vlera me tvsh 17,983,653 lekë** **-Vlera pa tvsh 12,486,378 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 20 ditë, Zbatuar 20 ditë. Fillimi punimeve: 28.07.2017 Perfundimi punimeve : 16.08.2017		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "H." SHPK	Licenca MK 2018/13	Kontrata pa nr prot, datë 26.07.2017		
21. Kolaudatori i punimeve N. M.	Licenca MK 0992/2	Kontrata nr. 4129/1 prot., datë 11.06.2018		
22.Akt Kolaudimi Datë 21.06.2018	**23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim** dt 18.09.2018			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **211,888 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve OE "B." SHPK, për zërat e punimeve 1.4 dhe 1.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve "Shtresë betoni C 7/10 për kunetë" dhe "Skarifikim shtresë asfalti ekzistues makineri", për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit Nr. 3080 prot datë 04.07.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr prot, datë 26.07.2017. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nr. 4129/1 prot.,

	datë 11.06.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I ulët.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 211,888 lekë pa tvsh nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 3080 prot datë 04.07.2017 me objekt *"Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 12, datë 15.11.2019.

Vlera prej 211,888, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Berat. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. F. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. N. M. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

II. "*Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës*", Bashkia Berat

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 5893 prot datë 28.10.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 48,850,889 lekë **BOE fitues "Sh." SHPK & "B." SHPK & "J." SHPK**		**16.Likuiduar ------**	
17- Situacioni Përfundimtar dt 04.09.2017 **-Vlera me tvsh 17,983,653 lekë** **-Vlera pa tvsh 12,486,378 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 45 ditë, Zbatuar 132 ditë. Fillimi punimeve: 28.10.2016 Perfundimi punimeve : 10.03.2017		**19. Zgjatja e kontratës** PV i shtyrjes së afatit, miratuar nga AK, datë 09.12.2016, 42 ditë, deri 22.01.2017+ Amend. Nr. 1, datë 09.12.2016. Amend. nr. 2, datë 20.02.2017, 38 ditë, deri 01.03.2017. Amend. nr. 3, datë 01.03.2017, 10 ditë, deri 10.03.2017.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N." SHPK	Licenca MK 1846/3	Kontrata pa nr prot, datë 26.10.2016		
21. Kolaudatori i punimeve D. shpk	Licenca MK 1676/6	Kontrata pa nr prot, datë 26.03.2018		
22.Akt Kolaudimi Datë 08.05.2018	**23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim** dt 03.08.2018			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **464,600 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve OE "B." SHPK, për zërat e punimeve II.8 dhe IV.8+IV.16.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve "Shtresë betoni kornize" dhe "Elektroda tokëz + Shtylla ndriç 3.5 m", për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit Nr. 5893 prot datë 28.10.2016. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa nr prot, datë 26.10.2016. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, pa nr prot, datë 26.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 464,600 lekë pa tvsh nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 me objekt *"Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 13, datë 15.11.2019.

Vlera prej 464,600, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Berat. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E.N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. V. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

III. "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 4826 prot datë 12.08.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 312,462,933 lekë **BOE fitues "G." SHPK & "B." SHPK**		**16.Likuiduar ------**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 312,462,933 lekë** **-Vlera pa tvsh 260,385,778 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 150 ditë, Zbatuar 132 ditë. Fillimi punimeve: 06.09.2016 Perfundimi punimeve : 02.06.2017		**19. Zgjatja e kontratës** Amend. Nr. 1, datë 25.04.2017, 80 ditë deri në 25.04.2017. Amend. nr. 2, datë 25.04.2017, 40 ditë, deri 04.06.2017.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N." SHPK	Licenca MK 1846/3	Kontrata me nr 5070 prot, datë 05.09.2016		
21. Kolaudatori i punimeve N. M.	Licenca MK 0992/2	Kontrata pa nr prot, datë 05.03.2018		
22.Akt Kolaudimi Datë 08.05.2018	**23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim** dt 03.08.2018			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **4,616,180 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve BOE "G." SHPK & "B." SHPK, për zërat e punimeve të rrugës "Stadiumi i vjetër-Stadiumi i Ri" I.2+I.3, II.3+II.4, III.3, III.4+III.10, V.3-V.6, V.9 dhe zërat e punës të rrugës së stadiumit I.1+I.2 dhe II.3+II.4.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve të rrugës "Stadiumi i vjetër-Stadiumi i Ri": "Gërmim dheu ekskavator me goma, kanale<2m+Transport", "Shtresë binderi t=6cm + shtresë asfaltobetoni t=4cm" dhe "FV pllaka guri gëlqeror t=6 cm, çmimi", si dhe nga "Rruga e Stadiumit" në zërat "Gërmim dheu ekskavator me goma, kanale<2m+Transport" dhe "Shtresë binderi t=6cm + shtresë asfaltobetoni t=4cm", për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe

	faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit Nr. 4826 prot datë 12.08.2016. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr 5070 prot, datë 05.09.2016. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, pa nr prot, datë 05.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,616,180** lekë pa tvsh nga BOE "G." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4826 prot datë 12.08.2016 me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

III.1 Është bërë gjithashtu auditimi i objektit "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho"" Bashkia Berat

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat				
14.Lidhja e kontratës Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 46,412,975 lekë **BOE fitues " "B." SHPK & "G." SHPK**		**16.Likuiduar ------**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 46,182,575 lekë** **-Vlera pa tvsh 38,485,479 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 121 ditë. Fillimi punimeve: 03.01.2018 Perfundimi punimeve : 04.05.2018		**19. Zgjatja e kontratës** PV datë 08.01.2018, Amend. Nr 1, datë 28.02.2018, 30 ditë deri në 04.05.2017.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N." SHPK	Licenca MK 1846/3	Kontrata pa datë		
21. Kolaudatori i punimeve D. shpk	Licenca MK 1676/6	Kontrata pa nr 1156/1 prot, datë 28.02.2019		
22.Akt Kolaudimi Datë 20.03.2019	**23.Akt i marrjes së përkohshme në dorëzim** dt 06.05.2019			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,866,540 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve BOE "G." SHPK & "B." SHPK, për zërat e punimeve të rrugës "Stadiumi i vjetër-Stadiumi i Ri" III.4+III.7 dhe VI.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve të rrugës "Stadiumi i vjetër-Stadiumi i Ri": "FV pllaka guri gëlqeror t=6 cm, çmimi" dhe "FV shtylla 9.8 m krahë tek", për pasojë vlerat e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve;
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, me nr 1156/1 prot, datë 28.02.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,866,540** lekë pa tvsh nga BOE "G." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 4826 prot datë 12.08.2016 me objekt *"Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Sa më sipër, është trajtuar me detaje në aktkonstatimin nr. 14, datë 15.11.2019.

Në mënyrë të përmbledhur, për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 6,482,720 lekë pa tvsh sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera dhe të pajustifikuara, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore Berat. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E.N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës (bazë + shtesë) së sipërmarrjes;
2. Znj. N. M., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara në kontratën bazë;
3. Z. V. T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara në kontratën shtesë.

Për sa sipër, është paraqitur observacioni i ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve ing. E. N., me nr. 153 prot, datë 21.11.2019, protokolluar në KLSH me nr. 606/2 prot, datë 25.11.2019, në të cilin citohet:

1. Zëri 1.2 Gërmim dheu eskavator me goma kanale gjerësi deri 2m, toke zak, kat III, me shkarkim ne mjet.

Sipas grupit të auditimit volumi 1254 m^3, i librezuar dhe i situacionuar është marrë në zërin 1.1. Në të vërtetë ndarja e dy zërave është kryer për të bërë diferencim, pasi gërmimet në siperfaqe janë realizuar me krahë, duke mos kërkuar ndryshim çmimi por vetem specifikim. Arsyeja e realizimit me krahë ka qenë për shkak të vazhdimit të përdorimit të pjesës kaluese të rrugës për një periudhe disa javore, duke mbajtur perkohesisht te paprekura nenshtresat ekzistuese, diktuar kjo edhe nga përqendrimi vende-vende i materialeve të papërshtatshëm në trupin e rrugës (prezencë e madhe argjile). Duke qenë se në rrugën "Stadiumi i ri-stadiumi i vëjter" ka një përqëndrim mjaft të madh të bizneseve dhe lokaleve të shërbimit (sidomos në pjesën jugperëndimore), pjesa më e madhe e gërmimeve sipërfaqesore janë realizuar me krahë, pasi lidhjet e lokaleve me shkarkimet e KUZ dhe KUB, si dhe tubacionet e furnizimit me ujë të këtyre ambienteve kanë qenë mjaft të shpeshta, sporadike dhe te padokumentuara, ndaj gërmimi fillimisht duhej bërë duke monitoruar hap pas hapi zbulimin e këtyre lidhjeve dhe marrjen e masave per disiplinimin e tyre, për të vazhduar më pas me gërmimet masive me makineri.

Për këtë aesye është vendosur volumi prej 1254m^3, i librezuar dhe situacionuar .

2. Zëri II.3+II.4- shtrese binderi t=6cm dhe shtrese asfaltobetoni t=4cm-

Diferencat e volumeve në shtresën asfaltike binder plus tapet në të vërtetë nuk janë, pasi është bërë një lapsus në pasqyrimin e librezës së masave: duke qenë se kjo sasi e zërave shtresë binderi t=6cm dhe shtresë asfaltobetoni t=4cm ishte parashikuar të hidhej një gjatesi prej 10m në kryqezimin e rruges "Stadiumi i ri –Stadiumi ivjeter", me rrugën "Santa Lucia" (rruga në krahun perëndimor të stadiumit të vjetër)

Ndërkohe këto sasi punimesh janë realizuar në degëzimet mbrapa stadiumit, çka do të reflektojë në ndryshimet në librezën e masave.

3. Në lidhje me diferencat e volumeve Zeri III.4 + III.10 "F.v. pllaka guri gelqeror t=6cm" , mendojmë që konstatimi i grupit të auditimit pjesërisht duhet korrigjuar, për arsye se:

- është e vërtetë që një pjesë e pllakave të trotuarit në terren janë me trashësi 4 cm nga 6 cm që figuron si zë në preventiv dhe kjo më tepër në ato pjesë të sipërfaqes së trotuareve ku kuota e trotuarit ka qenë e diktuar nga kuota e hyrjeve të pallateve (kryesisht bëhet fjalë per pllakat e trotuarëve të vendosura në juglindje të rrugës "Stadiumi i ri –Stadiumi i vjeter, etj) dhe për pasojë dhe vendosja e pllakave është bërë duke u nisur nga kjo logjikë, pra matjet e bëra në atë pjesë të trotuarit nuk përfaqesojne trashësin për të gjitha pllakat e vendosura në trotuare.

Duke marre diferencën e çmimeve prej (5900-4720) lekë/m2 = 1180 lek dhe duke e trajtuar këtë me një pjesë prej rreth 25 % te sipërfaqes së trotuareve, do të marrim :

Diferenca ne vlere: 25 %* 4066.5m2 * 1180 lek = 1 199 617 ,5 leke

• Nisur nga fakti qe objekti është ende në periudhë garancie, për pjesët e trotuarit që vihen re vendosje pllakash me trashesi 4cm, keto te padiktuara nga kuota e hyrjes se banesave, sipermarresi do të bëjë riparimin dhe zëvendësimin e pllakave, duke njoftuar autoritetin kontraktor .

4.Zëri III.3 Shtrese betoni per fiksim bordure

Sipas gjykimit te grupit te auditimit siperfaqja e betonimit duhet te jete 0.025m^2 per ml (0.25x0.1)dhe jo 0.055 sic eshte librezuar.Nderkohe gjate punes ne objekt, e diktuar nga sipërfaqja faktike në të cilën kjo shtresë mbeshtetej shkonte në trashesine 10 deri 15 cm. Duke marre nje trashesi mesatare prej 12 cm (nisur nga logjika me sipër), si dhe gjerësinë e shtresës 35 cm (10 cm nga të dyja krahët e bordurës), si dhe duke marrë në konsideratë veshjet anësore për fiksimin e bordurës si në figuren në vijim, del në total një seksion

S= 0.35m*0.12m+ 0.22m*0.1m=0.057m3/ml

Për një gjatësi totale të shtresës së betonit nën bordurën (15 x 35) cm prej 1900 ml, kemi

V1= 1900ml * 0.057 m3/ml = 104.5 m3

Përveå kësaj, janë edhe bordurat e pemëve me një gjatësi totale prej 460 ml, me seksion

S= 0.2 ml (nga 7cm ne te dyja krahet e bordures) * 0.1ml =0.02 m3/ml, cka sjell

V2= 0.02m3/ml * 460 =9.2m3

Ne total ,

V= V1+ V2=113.7m3

Pra pretendimi i grupit te auditimit lidhur me këtë zë pune nuk qëndron.

5. Zëri V.3 Mure butobetoni C12/15 per muret e kanalit. Zeri i pergjigjet mureve te kanalit te shkarkimit.

Grupi i auditimit shprehet qe gjatesia totale e kanalit eshte 820ml pra 105ml me pak sesa vlera e situacionuar dhe librezuar.Saktesojme ketu qe gjatesia reale e kanalit,me kerkesen e investitorit eshte rritur qysh ne momentin e fillimit te punes.

Nëpërmjet matjeve e cilat jane lehtesisht te verifikueshme edhe ne terren dhe ne planimetri, gjatesia e kanalit, e parë sipas segmenteve është si me poshtë:

• 117ml nga pika e shkarkimit ne Lumin"Osum" deri tek fillimi i lulishtes
• 188 ml nga fillimi i lulishtes deri tek fillimi i objektit pra ekstremi verior i Stadiumit te Vjeter
• 552 ml nga ekstremi verio i Stadiumi i Vjeter deri tek lidhja me rrjetin ekzistues perpara Stadiumit te Ri , pra aksi kryesor
• Jane shtuar me kerkesen e investitorit, 68ml pergjate rruges "FAN NOLI" , te cilat fillojne ne kryqezimin e kesaj rruge me rrugen "Antiparea" dhe shkarojne ne afersi te ekstremit lindor te stadiumit të vjeter, kerkese e bere kjo për shkak të permbytjeve te vazhdueshme qe kishte zona ne veriperendim te rruges , ne pjesen midis kesaj rruge dhe rruges "Antipatrea" , per shkak te ujrave te larta qe vinin nga kodra ne verilidje te rruges

Ne total gjatesia e kanalit eshte 925ml.Kjo jep per pasoje qe volumi i zerit V.3 "Mure butobetoni C12/15 per muret e kanalit" , te jete

• 925ml * 0.5ml *1.8ml *2(krahe)=1665m3-muret anesore
• 925ml * 0.5ml *2ml =925m3 -bazamenti

Total : 2590m3

6. Zeri 1.1+1.2 Germim dheu me eskavator me goma 0.35-0.4m3 kanale <2m,toke e zakonshme.kat III,me shkarkim ne mjet+Transport dheu auto.

Grupi i auditimit pretendon qe volumi ne piketat 480-500 dhe 500-520 eshte marre dy here,nje here ne grupin e punimeve qe i takojne "Rruga Stadium i Vjeter-Stadium i Ri" dhe nje here grupin e punimeve qe i takojne" Rruga Stadiumi"....

.... Volumi ne fjale nuk eshte marre dy here por eshte ndare ne dy poligone qe bashke japin

siperfaqen totale qe i perket kesaj progresive. Ndarja ne libreze masash eshte bere vetem per thjeshtim veprimi duke marre parasysh natyren komplekse te objektit si poligon i tipit shumkendesh.

7.Zeri II.3+II.4 Shtrese binderi t=6cm +shtrese asfaltobetoni t=4cm.
Grupi i auditimit pretendon qe volumi ne piketat 480-500 dhe 500-520 eshte marre dy here,nje here ne grupin e punimeve qe i takojne "Rruga Stadium i Vjeter-Stadium i Ri" dhe nje here grupin e punimeve qe i takojne" Rruga Stadiumi". Per shkak te vete formes poligonale te zones volumet jane dhene ne siperfaqe perfundimtare, pra nuk jane pare si figura gjeomentike , siperfaqja e te cilave logaritet gjatesi shumezuar per gjeresi.
....Volumi ne fjale nuk eshte marre dy here por eshte ndare ne dy poligone qe bashke japin siperfaqen totale qe i perket kesaj progresive. Ndarja ne libreze masash eshte bere vetem per thjeshtim veprimi duke marre parasysh natyren komplekse te objektit si poligon me shum elemente.
Pra volumi total i germimit per zerin: 4 Shtrese binderi t=6cm +shtrese asfaltobetoni t=4cm, ashtu sic paraqitet ne libreze masash eshte 3990.4m2 dhe jo 3422.7m2 saç eshte shifra e vendosur nga grupi i auditimit , e cila edhe ne kete rast nuk qendron.
8. Zëri VI.5 F.V shtylla 9.8m krahe tek ,komplet me aksesore.furnizues ndricimi,sinjalizim LED. Grupi i Auditimit pretendon qe jane vendosur 10 cope me pak nga 67 ndricues ne total.
Fakt eshte qe ne preventivin e rishikuar paraqiten 67 shtylla ne segmentin Stadiumi i ri-Stadiumi i vjeter , nderkohe qe jane instaluar 57 shtylla, pasi keshtu u vendos nga specialistet e entit te ndricimit te qytetit.
Si pasoje e po kesaj rishperndarje te bere nga ky ent , ne rrugen "Stadiumi" jane vendosur 22 shtylla (cka ne preventivin e rishikuar jane paraqitur 17 cope).
Po si pasoje e kesaj rishperndarjeje , ne rrugen "Koli Vesho" jane vendosur 6 shtylla (cka ne preventivin e rishikuar jane paraqitur 4 cope).
Pra , te paraqitura ne preventivin e rishikuar jane 88 shtylla dhe te instaluara sipas shperndarjes se siperpermendur jane 57+22+6=85 shtylla; 3 shtylla, me kerkesen e po ketij enti jane te magazinuara , ne dispozicion te entit ndricimit te qyetit , ne pritje te nje pozicionimi tjeter ne ate zone.
Pra , konstaimi i grupit te auditimit lidhur me këte ze punimesh nuk qqndron.

Qëndrim i grupit ta auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit shtesë bashkëlidhur observacionit dhe ballafaqimit të kryer në datën 24.12.2019 në zyrat e KLSH-së:
1. Përsa observohet për zërin I.2+I.3. "Gërmim dheu ekskavator me goma, kanale<2m+Transport", sqarojmë që pastrimi me krahë (profilimi i terrenit), sipas specifikimeve teknike, është i përfshirë në çmimin e gërmimit, për pasojë, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Përsa observohet për zërin II.3+II.4- "Shtrese binderi t=6cm dhe shtrese asfaltobetoni t=4cm", diferencat e volumeve ne shtresen asfaltike binder plus tapet në të vërtetë janë, pasi nga ana e grupit të auditimit është bërë verifikimi në terren dhe në dosje nuk administrohet ndonjë dokument ku të jetë miratuar ndryshimi i pretenduar në observacion, për pasojë, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

3. Përsa observohet për zërin "F.v. pllaka guri gelqeror t=6cm", diferenca në trashësinë e pllakave të vendosura të trotuare me trashësinë e specifikuar në projektpreventiv, në të dy kontratat, qëndron, pasi nga ana e grupit të auditimit është bërë verifikimi në terren, për pasojë, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4. Përsa observohet për zërin "Shtresë betoni për fiksim bordure", grupi i auditimit, pasi shqyrtoi argumentet e paraqitur në observacion, i merr në konsideratë dhe u reflektua në vlerën e dëmit ekonomik.

5. Përsa observohet për zërat "Mure butobetoni C12/15 per muret e kanalit", "Breza b/a monolit C16/20", "Shtresë betoni C12/15 për shtresën e kanalit", "Struktura monolite betoni C20/25" dhe "Mbushje me zhavorr", pas shqyrtimit të observacionit, nga grupi i auditimit, nisur nga kërkesa e investitorit për rritje të gjatësisë së kanalit (e paraqitur me procesverbalin e datës 24.11.2016, miratuar nga titullari i Entit prokurues), ky argument merret në konsideratë dhe u reflektua në vlerën e dëmit ekonomik.

6. Përsa observohet për zërat 1.1+1.2 "Germim dheu me eskavator me goma 0.35-0.4m3 kanale <2m,toke e zakonshme.kat III,me shkarkim ne mjet"+ "Transport dheu auto", pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit ka bërë rillogaritjen e sipërfaqes së gërmimit, e cila është situacionuar 225 m^2 më e madhe së ajo e paraqitur në observacion, që e konvertuar në volum është 90 m^3 më tepër, volum ky i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi. Përsa sipër, ky argument merret pjesërisht në konsideratë dhe u reflektua në vlerën e dëmit ekonomik.

7. Përsa observohet për zërat "Shtrese binderi t=6cm" + "shtrese asfaltobetoni t=4cm", pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit ka bërë rillogaritjen e sipërfaqes së gërmimit, e cila është situacionuar 290 m^2 më e madhe së ajo e paraqitur në observacion, volum ky i përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi. Përsa sipër, ky argument merret pjesërisht në në konsideratë dhe u reflektua në vlerën e dëmit ekonomik.

8. Përsa observohet për zërin "F.V shtylla 9.8 m krahë tek, komplet me aksesore, furnizues ndricimi, sinjalizim LED", nga ana e grupit të kolaudimit, merret në konsideratë diferenca e paraqitur në observacion (3 shtylla), pasi bashkëlidhur observacionit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë që 3 shtylla janë të magazinuara, në mënyrë që të konkludohet "*...konstatimi i grupit të auditimit lidhur me këtë zë punimesh nuk qëndron*". Përsa sipër, ky argument merret pjesërisht në konsideratë dhe u reflektua në vlerën e dëmit ekonomik.

1. Objekti i prokurimit: "Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re" Bashkia Berat.

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan likuidime të pakryera në vlerën 583,470 lekë pa TVSH, për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK, përfaqësuar nga OE "L." SHPK, për zërat e punimeve: "Prishje suvatime tavani"; "Suvatim solete"; "Lyrje me bojë hidroplastike Importi cilësi e I-rë"; sipas kontratës me Nr. 2538 Prot, Datë 13.04.2016 me vlerë 78,347,107 lekë me TVSH.

Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: Ka patur likudime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: "Prishje suvatime tavani"; "Suvatim solete"; "Lyrje me bojë hidroplastike Importi cilësi e I-rë". Nga verifikimi në terren i punimeve

	të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të preventivuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 583,470 lekë pa TVSH.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me Nr. 2789 Prot, Datë 05.12.2016.
Impakti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 583,470 lekë pa TVSH nga Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016 me objekt "Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re", Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Vlera prej 583,470 *lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt sipas volumeve të preventivit të ripunuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Berat.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. N., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së punimeve civile.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të subjektit të audituar, Bashkisë Berat, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" në observacionin e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve me nr. prot. 154, datë 21.11.2019 (protokolluar në KLSH me nr. 606 prot, datë 02.12.2019) është trajtuar si vijon:

A. Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Mbikëqyrësi i punimeve nuk pranon problematikat e konstatuara për zërat e punimeve

- Zëri 1(An-1) "Prishje suvatime tavani" dhe zëri "suvatim solete tavani", me argumentin se tavanet tek salla e hyrjes në katin përdhe dhe në kati e parë nuk janë mbyllur me gips për të ruajtur vlerat arkitektonike të objektit.

- Zëri 2 (An-2) "Prishje suvatime muresh të brendshme", me argumentin se nga fotot e bëra gjatë realizimit të punimeve është paraqitur qartë se në të gjitha katet e objektit është bërë prishja e suvatimit te muret e brendshme deri në lartësinë e tavanit ekzistues.

- Zëri 2 (2.310 "Suvatime muresh të brendshme", me argumentin se nga fotot e bëra gjatë realizimit të punimeve është paraqitur qartë se në të gjitha katet e objektit është bërë prishja e suvatimit te muret e brendshme deri në lartësinë e tavanit ekzistues.

- Zëri 3 (2.404/1 "Lyrje me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë", me argumentin se ky zë punimi është realizuar për sipërfaqen 8,203.4 m^2.

B. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

- Lidhur me pretendimin për zërin 1(An-1) "Prishje suvatime tavani" dhe zëri "suvatim solete tavani", grupi i auditimit sqaron se; në vlerën e dëmit nuk është përfshirë sipërfaqja e tavaneve tek salla e hyrjes në katin përdhe dhe në kati e parë dhe se nga fotot e paraqitura në observacion duket shumë qartë se tavanet nuk janë prishur, prandaj argumentimi i bërë nga ana juaj nuk merret në konsideratë.

-Lidhur me pretendimin për zërin e punimit 2 (An-2) "Prishje suvatime muresh të brendshme", sqarojmë se; ky zë punimi është zë i maskuar por nga fotot e paraqitura në observacion, prishja e suvatimit te muret e brendshme është kryer deri në lartësinë e tavani ekzistues, por jo në tavan. Argumentimi i bërë nga ana Juaj merret në konsideratë dhe zbritet vlera prej 100,000 lekë si dëm ekonomik.

-Lidhur me pretendimin për zërin e punimit 2 (2.310) "Suvatime muresh të brendshme", sqarojmë se; ky zë punimi është zë i maskuar por nga fotot e paraqitura në observacion, prishja e suvatimit te muret e brendshme dhe suvatimi i tyre, është kryer deri në lartësinë e tavani ekzistue. Argumentimi i bërë nga ana Juaj merret në konsideratë dhe zbritet vlera prej 216,800 lekë si dëm ekonomik.

- Lidhur me pretendimin për zërin e punimit 3 (2.404/1 "Lyrje me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë", merret pjesërisht në konsideratë, duke pranuar si volum pune të kryer 7,803.4 m2, pra duke shtuar sipërfaqen prej 400 m2 sipërfaqe e mureve të brendshme të cilat janë kryer deri në lartësinë e tavanit. sa më sipër, grupi i auditimit konsideron punë të kryer 7,775 m2 * 341 lekë, ndërsa punë të pa kryer sipërfaqen 428.4 m2 * 341 lekë = 146,084 lekë me efekt dëm ekonomik për zërin lyrje me bojë.

Si përfundim mbas shqyrtimit të observacioneve të paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve,

lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 583,470 lekë pa TVSH. Grupi i auditimi zbret si dëm ekonomik vlerën prej 452,918 lekë pa TVSH për zërat e punimeve: Zëri 2(An-2) Prishje suvatime muresh të brendshme, Zëri 2(2.310) Suvatime muresh të brendshme dhe Zëri 2(2.404/1) Lyrje me bojë hiroplastike importi cilësi e i-rë, bazuar në argumentimin dhe fotografitë e paraqitura për zërat e punimeve të maskuara.

Paraqitja e dëmit ekonomik.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 1(An-1)	Prishje suvatime tavani	m^2	250	428.5	428.5	-	428.5	107,125
Zëri 1(2.300)	Suvatim solete	m^2	770	428.5	428.5	-	428,.5	329,945
Zëri 3(2.404/1)	Lyrje me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë.	m^2	341	8,203.4	8,203.4	7,775	428.4	146,400
	Totali në lekë pa TVSH							583,470

2. Objekti i prokurimit: "<u>Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë</u>" Bashkia Berat.

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit, u konstatuan likuidime të pakryera në vlerën 1,015,500 lekë pa TVSH, për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë", Bashkia Berat, nga zbatuesi i punimeve Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "T." SHPK & "B." SHPK, për zërat e punimeve: "F.V kaseta llamarine xingat"; "Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60 cm; "Shtresë jastek gome me t=3 cm", sipas kontratës me Nr. 3082 Prot, Datë 28.07.2017 me vlerë 52,263,124 lekë me TVSH.

Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur likudime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: "F.V kaseta llamarine xingat"; "Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm; "Shtresë jastek gome me t=3 cm". Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 1,015,500 lekë pa TVSH.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit pa Nr. Prot, Datë 28.07.2018.

Impakti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Berat.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Berat, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,015,500 lekë pa TVSH nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "T." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3082 prot, datë 28.07.2017 me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë", Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për sa më sipër mosrealizimi i zërave të punimeve për zërat e punimeve: "F.V kaseta llamarine xingat"; "Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm; "Shtresë jastek gome me t=3 cm" sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike në shumën 1,015,500 lekë pa TVSH, do të konsiderohet dëm ekonomik deri në riparimin e plote të tyre brenda periudhës së garancisë së defekteve. Sipërmarrësi i punimeve Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "T." SHPK & "B." SHPK, duhet të vërtetojë pranë Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat, realizimin e plotë të këtyre zërave punimesh dhe realizimi të bëhet në periudhën e garancisë së punimeve.

Vlera prej 1,015,500 *lekë pa TVSH, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Berat.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. N., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes së punimeve të ndërtimit.

3. Objekti i prokurimit: "<u>Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat</u>".

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me objekt "Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat" rezultoi:

<u>Kontrata e sipërmarrjes dhe mbikëqyrjes së punimeve dhe e kolaudimit të investimit:</u>

- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me Nr. 6490 Prot, datë 29.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, përfaqësuar nga Kryetari Z. P. S. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK përfaqësuar nga Z. F. SH., me licencë profesionale NZ. 5621/15, datë 19.01.2016 dhe NIPT K71820009I. Vlera e kontratës është 21,557,871.6 lekë me TVSH vlera e plotë dhe 7,834,862 lekë me TVSh vlera pjesore per vitin 2018. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore është parashikuar brenda 4 javë vlera e plotë dhe 2 javë vlera pjesore nga data nenshkrimit e kontratës së superviziorit. Periudha e garancisë së difekteve është 2 vjet. *Konstaohet se Kryetari i Bashkisë nuk ka caktuar Drejtuesin e projektit si përsoni përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor, veprim ky në kundërshtim me kontratën nr. Prot. 6490, datë 29.10.2018 si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.*

- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 7183 prot, datë 07.12.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat, përfaqësuar nga Z. Petrit Sinaj dhe kontraktorin "M." SHPK, përfaqësuar nga Ing. T. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1811/7 dhe NIPT L01422017O. Vlera e kontratës 559,562 lekë me TVSH.

- Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me shoqërinë "D." SHPK, përfaqësuar nga Ing. V. T., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1676/7.

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "I." sh.p.k "I. në vitin 2018, me NUIS L71927011N, Tiranë.

- Për zbatimin e projektit të zbatimit me objekt "Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat" Kryetari i Bashkisë Z. P. S., ka nxjerrë vendimin nr. 884, datë 07.11.2018 për miratimin e deklaratës së mësipërme për kryerje punimesh me afat 4 javë për punimet: (- instalime të impiantit të kondicionimit (veshje pajisjesh, hapje dhe mbyllje tavani për vendosjen e kondicionerëve) dhe - instalime të impiantit të aspirimit).

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet për "Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat", sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 28.12.2018 dhe kanë përfunduar me datë 14.01.2019, ose brenda afatit kontraktual pas miratimit me 10 ditë shtyrje afatit të përfundimit të punimeve të kontratës.

- Në datën 31.12.2018 sipërmarrësi i punimeve i është drejtuar mbikëqyrësit "M." sh.p.k dhe i ka kërkuar shtyrje të afatit të punimeve, për shkak të mos lirimit të plotë të sheshit të ndërtimit. Mbikëqyrësi i punimeve i është drejtuar Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat për këtë kërkesë dhe në vijim, ka miratuar shtyrjen e afatit të punimeve, dhe data e miratuar për përfundimin e punimeve është caktuar data 14.01.2019.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore dhe përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve " Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat".				
14.Lidhja e kontratës Nr. 6490 Prot datë 29.10.2018	15.Vlera e kontratës 21,557,871 lekë me tvsh OE fitues "L." SHPK		16.Likuiduar: - sit nr.1 me vlerë 7,830,374.40 lekë me TVSH. - Situacioni përfundimtar me vlerë 13,722,800 lekë me TVSH	
Situacioni Përfundimtar -21,553,175 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 4 javë sipas kontratës Fillimi punimeve: 28.12.2019 Perfundimi punimeve : 14.01.2019		19. Zgjatja e kontratës S'ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve	Licenca Nr: MK. 1811	Kontrata nr. 7183 prot, datë 07.12.2018		

Ing. T..				
21. Kolaudatori i punimeve Ing. V. T.	Licenca Nr: 1676/7	Kontrata pa nr. prot., datë _____		
22.Akt Kolaudimi Datë 05.03.2019, nr. 1233 prot.	23.Akt i marrjes në dorëzim është në proces.			

Tipologjia e impiantit të kondicionimit është në përputhje me kërkesat e projektuesit dhe është sipas tipologjisë. Impianti ajër-gaz është në përputhje me kriteret e projektit dhe specifikimet teknike.

- Impianti ajër-gaz frigoriferik përbëhet nga dy sisteme, sistemi i ajrit dhe sistemi i gazit R410A. Pajisjet e jashtme HEAT PUMP dhe pajisjet e mbrendshme VRF si dhe impiantet e aspirimit (Aspiratore, rekupatore dhe grila alumini kundër shiut), janë realizuar nëpërputhje me projektin. Punimet ndërtimore për instalimin e pajisjeve si: konstruksionet metalike për instalimin e pajisjeve të jashtme është realizuar konforme projektit të zbatimit. Pajisjet rezultojnë sipas specifikimeve teknike dhe projektit.

Nga testimi dhe prova në ngarkesë e sistemit, ka rezultuar se sistemi është funksional, brenda parametrave dhe standarteve të përcaktuara në projekt dhe specifikimeve teknike.

Grupi i auditimit të KLSH-së, pas kontrollit në fakt të zbatimit të punimeve, mendon se kontrata me objekt "Sistemi i kondicionimit për Bashkinë Berat" është zbatuar në përputhje të plotë me projektin e zbatimit, specifikimet teknike, me preventivin dhe se cilësia e punimeve është e mirë dhe në përputhje me Kushtet Teknike të Zbatimit.

U konstatua se vendosja në planimetritë e godinës së bashkisë Berat (kati perdhe; kati I; Kati II dhe kati i III) e pajisjeve të brendshme në sasinë 68 copë të rakordohet me faktin në objekt.

Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në dosje dhe nga auditimi i realizimit të punimeve të ndërtimit në objekt, rezulton se:

- Pajisjet nuk janë montuar sipas projektit fillestar, por sipas projektit të azhurnuar. Arsyet e ndryshimeve të pozicionit të pajisjeve janë argumentuar në relacionin e ndryshimeve.
- Me datë 15.11.2019, sistemi ngohje ventilim u vu në punë, u kontrollua temperatura në ambjentet e brendshme dhe në ambjentin e jashtëm dhe pas 20 minutash u kontrollua temperatura e brendshme dhe kishte një ritje me 2^0 C.
- Në vijim të procesit, sistemi u vendos nën presion mbi 40 bar për 24 orë pa ndërprerje për testim për rrjedhje gazi dhe u konstatua se nuk ka rrjedhje gazi në sistem. Gjatë testit nuk u konstatuan zhurma të pazakonta.
- Për sa më sipër sistemi është plotësisht funksional, brenda parametrave dhe standarteve të përcaktuara në projekt dhe specifikimeve teknike.

Rekomandojë që palët: AK Bashkia Berat në cilësinë e investitorit; sipërmarrësi i punimeve shoqëria "L." sh.p.k, mbikëqyrësi dhe koladatori i punimeve, të marrin masa të menjëhershme për të kryer marrjen e përkohshme në dorëzim të investimit për bashkinë Berat.

E. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm.

1-Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimet nuk janë pranuar.

Situata: Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Berat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 1104/9 datë 14.05.2016, protokolluar në subjekt me shkresën nr. 3749/7 datë 17.05.2016. Bashkia Berat në zbatim të rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. prot.3749/9, datë 07.06.2016, duke respektuar afatin ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Kryetari i Bashkisë Berat është nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 355 datë 20.05.2016 në të cilin përcaktohen pesë hapat e organizimit të punës në zbatim të rekomandimeve të KLSH si dhe afati 6-mujor i raportimit mbi ecurinë e e realizimit të tyre. Është hartuar Plan veprimi, ku janë përcaktuar për çdo rekomandim personat përgjegjës dhe afati i për zbatimin dhe raportimin e realizimit të rekomandimeve.

Raporti Përfundimtar i auditimit të KLSh dhe rekomandimet e auditimit janë dërguar me shkresën e saj nr. 1104/9 datë 14.05.2016, afati 6-mujor për raportimin mbi ecurinë e realizimit të rekomandimeve nga Bashkia Berat pranë KLSH ka përkuar me programin e auditimit të KLSH për verifikimin e rekomandimeve të lëna për realizim të realizuar mbi bazë të programit të auditimit nr.1113, datë 04.11.2016.

a.Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat , janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, janë të pazbatuara 7 masa dhe janë pjesërisht të zbatuara 3 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 28 masa me vlerë 55,846,909 lekë, nga verifikimi rezultoi se deri më datë 30.09.2019, vlera debitore është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të tjerë", të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2018 (bilanci vjetor 2018) vlera prej 44,083,697 lekë.

Deri më datën 30.09.2017 është arkëtuar vlera prej 1,006,892 lekë.

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej 26,806,859 lekë nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 3 rekomandime në vlerën 81,785 lekë

-Në proces gjyqësor 10 rekomandime në vlerën 26,725,074 lekë

Nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 55,846,909 lekë,deri më datën 30.09.2019 paraqiten:

-Për 28 rekomandime janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe janë arkëtuar në 1,006,892 leke në 17 raste.

-Janë ngritur padi Gjyqësore ndaj Bashkisë dhe janë dhenë Vendime Gjykate të Shkallës së Parë dhe të formë së prere në favor të punonjësve dhe privatëve të ngarkuar me masa shpërblim dëmi në 65 raste në shumën 28,131,378 lekë.

-Nga punonjësit dhe privat të ngarkuar me masa shpërblim dëmi janë ngritur padi në Gjykatën Administrative Berat dhe janë në proces

gjyqësor në 25 raste në shumën 26,479,574 lekë.

c. Janë rekomanduar 13 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;

c.1-Për 5 punonjës për shkelej në fushën e prokurimeve është rekomanduar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi civil", nga verifikimi rezulton se 3 punonjësit kanë ndërprerë marëdheniet financiare me Bashkinë,dhe masa konsiderohet e realizuar ndërsa për 2 punonjës nuk është dhënë masë disiplinore me arsyetimin se për të njëjtën shkelje janë gjobitur nga APP me vendimin nr .72 datë 12.08.2016 me nga 100,000 lekë secili, kjo e argumentuar në nenin 60, pika 6, e ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil"i ndryshuar përcakton se: "Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore dhe Udhëzimin e Administratës Publike nr. 01, datë 02.04.2014" Për elementët kryesorë procedurialë dhe materiale të ecurisë dhe Shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, shkronja C- Seanca e shqyrtimit të çështjes në procedim, pika 12 faqe 15-19 paragrafi i parë ku përcaktohet se: Komisioni (Disiplinor), nuk mund të vendosë 2 masa disiplinore për të njjtën shkelje në procedim,ai vendos vetëm për 1 masë disiplinore të përcaktuar në shkronjën "b""c" "ç" të nenit 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

c.2-Nga 8 masa disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj"parashikuar në nenin 58 shkronja (b), janë zbatuar për 4 punonjës me nga 6,000 lekëe secili respektivisht: A. Sh., G. Xh. dhe T. M. është bërë ndalesë në pagë për periudhën Korrik 2016-Dhjetor 2016 . Për punonjësen O. H. është bërë ndalesë e plotë në pagë në muajin Gusht 2016. por me vlera minimale 1,000 lekë/muaj ose 6,000 lekë, nga deri 6 muaj me 1/3 e pagës mujore, 1 punonjës z. T. H. ka dalë në pension pleqërie, 1 punonjës është larguar, për 2 punonjës F. K. dhe V. Z., nuk është dhënë masë me arsyetimin se për të njëjtën shkelje janë gjobitur nga APP me vendimin nr.72 datë 12.08.2016 protokolluar në KLSH me nr.prot.1104/18 datë 16.08.2016

d. Kërkuar APP, 9 masa administrative, Për këtë rekomandim Agjencia e Prokurimit Publik, ka dërguar vendimi nr.72 datë 12.08.2016 protokolluar në KLSH me nr.prot.1104/18 datë 16.08.2016 në të cilin ka vendosur të dënojë me gjobë 9 punonjës në vlerën 900,000 lekë ku nga verifikimi rezultoi se nga 9 punonjës 3 persona nuk kanë paguar 300,000 lekë. Secili nga 100,000 leke, ndërsa 6 persona kanë paguar vlerën 140,000 lekë, duke mbetuar pa u paguar edhe vlera prej 760,000 lekë,

e.Masa administrativë për IMT bashkia Berat. Me shkresën nr.992/8 datë 28.02.2015 Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kërkuar kryetarit të Bashkisë Berat që nëpërmjet Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit strukture pranë bashkisë që të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryer në "Shoqërinë e Ujsjellës SHA Berat-Kucovë"të paraqitura në këtë shkresë dhe dokumentacionin bashkëlidhur për dënimin me gjobë dy mbikëqyrësve, nga verifikimi rezultoi se këto 2 masa janë në proces zbatimi.

Kriteri: Veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të

	ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" dhe shkresën nr. 1104/9 datë 14.05.2016 "Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Berat".
Impakti	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve sipas planit të veprimit.
Shkaku	Përgjegjësi e strukturave drejtues dhe e grupit të punës sipas urdhrit dhe planit të masave Nr. 3749/8 datë 07.06.2016 E lartë
Rëndësia:	
Rekomandimi:	Kryetari i Bashkisë Berat të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara dhe të rikërkuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën *Nr. 1104/9 prot datë 14.05.2016*.

(Gjerësisht problemet mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, janë trajtuar në akt-verifikimin nr. 2, datë 14.11.2019, dorëzuar me protokoll në Bashkinë BERAT)

F.

Në zbatim të pikës E të Programit të Auditimit me objekt *"Mbi verifikimin e ankesës së Protokolluar në KLSH me nr. 705, datë 22.06.2017,* ***për procedurën e prokurimit dhe zbatimin e punimeve të zhvilluar në vitin 2016,*** *për objektin: Rikonstruksion i rrugës Stadiumi i Vjetër-Stadiumi i Ri, rruga "Stadiumi", Rruga "Koli Vesho" dhe "Sheshi Para Stadiumit" me ofertë në vlerën* ***260,385,778 lekë pa tvsh, lidhur më datë 12.08.2016****)",* u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e zyrave të Bashkisë Berat, i një aktkonstatimi nga audituesit e KLSH-së z. Sh. H., G. H. dhe z. A. TH. (*Përgjegjës grupi*).

Objekti dhe përmbajtja e këtij akt verifikimi është si vijon:

-Me urdhrin nr. 10 prot, datë 30.03.2016, është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. A.s H. (kryetar), znj. H. D. dhe znj. F. K. (anëtarë).

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato".
Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.
Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e

bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit

Në lidhje me kriteret e vendosura nga NJP, rezulton se janë paraqitur disa ankesa drejtuar Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën me nr. 1897 prot, datë 08.04.2016, ka bërë ankesë OE "B." shpk.

1.Ky OE ankohet për kërkesën në *DST në lidhje me fabrikën e betonit 30 km larg objekti që prokurohet.*

2.Ky OE ankohet për numrin e punonjësve për zbatimin e kësaj kontrate (150 punonjës). OE pretendon se për zbatimin e kësaj kontrate mjaftojnë 75 punonjës.

3.OE ankohet për *Licencën Profesionale sipas modelit të kërkuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në Ministrinë e linjës "Kategoria" C, Punime restaurimi në monumentet e kulturës.* Sipas këtij OE, punimet janë të zakonshme dhe nuk ka asnjë monument kulture për të bërë.

OE kërkon modifikimin e këtyre kërkesave pasi janë në kundërshtim me nenin 1, 20, të ligjit me nr. 9643 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

-Në lidhje me trajtimin e kësaj ankese, është kthyer përgjigje subjektit nëpërmjet shkresës me nr. 2740/1, datë 13.04.2016, e cila mban firmën e nën/kryetarit të Bashkisë z. B. B., në mungesë të kryetarit. AK ka pranuar të modifikojë pikën 1 të ankesës duke hequr kriterin e fabrikës së betonit 30 km larg objektit, dhe nuk ka pranuar pikën 2 dhe 3 të saj duke i konsideruar të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate.

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Në vijim, rezulton se me shkresën e protokolluar në Bashkinë Berat me nr. 2835, datë 18.04.2016, ka paraqitur ankesë OE "E." shpk.

1.Ky OE kërkon që të hiqet kriteri i vendosur në shtojcë sipas të cilit *OE duhet të jetë pajisur me licencë për prodhim dhe tregtim të farave dhe fidanëve me kodin IIA lëshuar nga QKL.* Sipas këtij OE kjo kërkesë është e paargumentuar dhe jo në përputhje me LPP dhe VKM nr. 914.

-AK, i ka kthyer përgjigje OE me shkresën nr. 2835/1, datë 20.04.2016 duke pranuar kërkesën dhe hequr kriterin e mësipërm.

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Sërish pranë AK-së është paraqitur ankesë nga OE "B." shpk, protokolluar me shkresën nr. 861, datë 19.04.2016.

1.Ky OE, rikërkon të shihet sërish kriteri në lidhje me numrin 150 punonjës. Sipas OE, ky numër është i paargumentuar dhe i pabazuar në asnjë manual apo normë teknike.

2.OE, ankohet gjithashtu edhe për kriterin e vendosur sipas shtojcës së DST, ku kërkohet që *OE duhet të jetë pajisur me licencë për prodhim dhe tregtim të farave dhe fidanëve me kodin IIA lëshuar nga QKL.*

-AK, i ka kthyer përgjigje OE me shkresën nr. 2861/1, datë 21.04.2016. Në përgjigje, AK shprehet se nuk pranon pikën 1 të ankesës për numrin 150 punonjës duke e konsideruar të argumentuar për zbatimin e kësaj kontrate, ndërkohë që pranon pikën 2 të ankesës për heqjen e kriterit që *OE duhet të jetë pajisur me licencë për prodhim dhe tregtim të farave dhe fidanëve me kodin IIA lëshuar nga QKL.*

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Në vijim, pranë AK-së është paraqitur shkresë me nr. prot., datë 04.05.2016 ku OE "S." shpk bën kërkesë për sqarim. Në disa zëra punimesh, është vendosur M^3 në vend të M^2. OE, kërkon të sqarohet nga AK në lidhje me këtë pretendim.

-Me shkresën me nr. 3172/1, datë 10.05.2016 AK kthen përgjigje OE "S." shpk, ku modifikon gabimin duke e vendosur M^2.

Në lidhje me këtë ankesë, rezulton se Kryetari i AK-së nuk ka ngritur Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave, veprim ky në kundërshtim me nenin 78, pika 6 e kreut X "Shqyrtimi i Ankesave" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Sërish në lidhje me Dokumentet e Tenderit, është paraqitur ankesë nga OE "I." sh.a, protokolluar me nr. 2659, datë 07.04.2016

1.Ky OE, kërkon që kërkesa për mjekun i shoqërisë që të jetë i punësuar për të paktën vitin e fundit, të ndryshojë pasi e nevojshme është që OE të disponojë mjekun.

2.OE kërkon të sqarohet në lidhje me stafin e inxhinierëve, ku në fillim kërkohen një numër inxhinierësh që të figurojnë në licencën e shoqërisë, dhe njëkohësisht kërkon të njëjtën inxhinierë të jenë të punësuar për vitin e fundit në një paragraf tjetër të kërkesave në DST.

3.OE kërkon të sqarohet në lidhje me specialistët me IQT. Duke qënë se sot ky institucion nuk ekziston pasi quhet ISHTI, të saktësohet organi që i lëshon.

4.OE kërkon të modifikohet kriteri për fabrikën e asfaltit 30 km larg objektit duke e konsideruar kriter diskriminues.

-Në dosje mungon përgjiga e AK-së në lidhje me këtë ankesë.

Në përfundim të procesit, KVO ka kualifikuar BOE "G." shpk & "B." shpk me ofertë **260,385,778 lekë,** si dhe OE "B." shpk me ofertë në vlerën **278,798,143 lekë.** Në përfundim është shpallur fitues BOE "G." shpk & "B." shpk me ofertë **260,385,778 lekë,** ose **39,438,458 lekë** më e ulët se fondi limit.

Nga shqyrtimi i ofertave, ajo e OE "S." shpk me vlerë **215,850,057 lekë,** është oferta më e favorshme e cila është **83,974,179 lekë** më e ulët se sa fondi limit i prokuruar, ose **44,535,721 lekë** më e ulët se sa oferta fituese.

Në lidhje me kualifikimin e OE, pranë AK-së janë paraqitur ankesa nga OE.

Me shkresën me nr. 291 prot., datë 06.06.2016, ka paraqitur ankesë OE "S." shpk.

Ky OE ankohet në lidhje me arsyet e s'kualifikimit duke i konsideruar të padrejta.

1.Në lidhje me Inxhinierin Mekanik E. C., OE shprehet se ky person punon pranë kësaj shoqërie prej vitin 2012. AK nuk duhet të bazohet te kontrata e punës e datës 03.11.2015, pasi kjo është kontratë e rinovuar ndërkohë që ky punonjës rezulton në listpagesa.

2.Në lidhje me ing. Mjedisi M. K. S., OE shprehet se kjo punonjëse punon pranë kësaj kompanie prej vitit 2012, ndërkohë figuron edhe në listëpagesat e hedhura në SPE. Gjithashtu pranë kësaj shoqërie punon si ing. mjedisi edhe z. F. B.j i cili është pjesë e drejtuesve teknik në licencën e shoqërisë.

3.Në lidhje me arsyet e s'kualifikimit për mungesën e certifikatës të pronësisë si *Autobetoniere, Kamionçinë, mjet vetëshkarkues,* ky OE pretendon se nuk qëndron si argument pasi në asnjë moment nuk kërkohet nga NJP certifikata e pronësisë por akti i pronësisë, dhe ne si OE e vërtetojmë nëpërmjet lejes së qarkullimit, akt kolaudimit, policës së sigurimit, certifikatës së transportit të lëshuar nga Bashkia. Në këto kushte nuk qëndrojnë arsyet për s'kualifikim.

4.Në lidhje me mjetin *Fadromë,* OE shprehet se ka paraqitur 2 fadroma për të cilat disponon dokumente zhdoganimi dhe faturë tatimore shitje, të mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë e këtyre mjeteve. Duke qenë mjete kantiere, këto fadroma nuk qarkullojnë nëpër rrugë, dhe në këto kushte sipas ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, nuk është e nevojshme polica e sigurimit, certifikata e bashkisë etj.

Për sa më sipër, pretendimi i autoritetit kontraktor nuk qëndron dhe nuk mund të konsiderohet si kriter s'kualifikues.

-Në lidhje me këtë ankesë, është kthyer përgjigje nga AK me shkresën nr. 3765/1 prot, datë 13.06.2016.

-Në lidhje me pikën 1 është pranuar ankesa në lidhje me inxhinierin E. Ç.

-Në lidhje me pikën 2 është pranuar pjesërisht ankesa duke e konfirmuar se kjo punonjëse figuron në listëpagesa, ndërkohë duke marrë si shkak ankesën e BOE "G." shpk dhe "B." shpk, rezulton se kjo punonjëse figuron e punësuar në institucionin "Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit", Tiranë, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

3.Mos pranimin e ankesës në lidhje me certifikatën e pronësisë për 3 Autobetoniere, 2 kamionçina dhe 1 mjet vetëshkarkues pasi është kërkuar në mënyrë eksplicite në DST.

4.Mos pranimin e ankesës në lidhje me mjete fadromë për arsye se dokumentet e zhdoganimit dhe fatura tatimore e shitjes nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë mbi mjetet.

5.Gjithashtu, nuk ka paraqitur dokument nga Bashkia Durrës që vërteton shlyerjen e taksave vendore për periudhën 1 Janar – 5 Mars 2015.

-Në vijim, shoqëritë "G." shpk & "B." shpk kanë paraqitur një shkresë pranë AK-së, në lidhje me ankesën e OE "S." shpk.

Ky BOE, shprehet në shkresën e tyre se ky operatori ekonomik "S." shpk nuk përmbush kriteret për kualifikim, pasi nga informacioni që disponojnë, ky OE nuk ka shlyer të gjitha detyrimet për taksa vendore për vitin 2015, sipas kërkesës së DST, dhe konkretisht:

1.Nuk ka paguar detyrimet në Bashkinë Përrenjas, ku ka ushtruar aktivitetin me objekt "Ndërtim rruga Qukës – Qafë Plloçë, Loti I, për vitin 2015.

2.Nuk ka paguar detyrimet në Bashkinë Durrës, ku ka ushtruar aktivitet me objekt "Ndërtim rruga By Pass Plepa – Kavajë – Rrogozhinë, Plepa Durrës Tek Rreth Rrotullimi", për vitin 2015.

3.Nuk ka paguar detyrimet në Bashkinë Tiranë, ku ushtron aktivitet me objekt "Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (Segmenti Komuna e Parisit – Rruga e Kavajës), loti I-rë, si dhe punë të tjera për të cilat duhet të kishte paguara detyrimet për vitin 2015.

4.Ky BOE, në shkresën e tij, shprehet se në bazë të informacionit që disponon, njëri nga drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë, nuk figuron i punësuar për periudhën e kërkuar.

5.Ky BOE, në shkresën e tij, jep informacion se njëri nga drejtuesit teknik, me profesion inxhinier mjedisi nuk ka qenë i punësuar për periudhën e kërkuar. Gjithashtu, ky BOE informon se inxhiniere M. K., e punësuar pranë kësaj shoqërie, rezulton gjithashtu e punësuar në shtet dhe pikërisht pranë "Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit".

-Sa më sipër, ky BOE kërkon që të trajtohet ankesa e tyre.

1.Në lidhje me këtë ankesë, AK i ka kthyer përgjigje operatorëve të mësipërm, duke mos pranuar ankesën në lidhje me pagesën e taksave në Bashkinë Përrenjas dhe Tiranë për vitin 2015, por ka pranuar ankesën në lidhje me mos pagesën e këtyre taksave pranë Bashkisë Durrës.

2.Gjithashtu, në përgjigjen e tij, AK nuk ka pranuar ankesën për inxhinierin mekanik Eduard Çohadari, pasi figuron në listpagesat e depozituara në SPE, ndërkohë ka pranuar ankesën për inxhinieren M. K., pasi ajo rezulton e punësuar deri në datë 31.05.2016 në Institucionin "Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit", Tiranë.

Në vijim, pranë AK-së është paraqitur ankesa e radhës në lidhje me vlerësimin e kryer nga KVO, dhe konkretisht nga OE "B." shpk, i cili shprehet se arsyet për s'kualifikim nuk qëndrojnë.

1.Ky OE, argumenton se konstatimi i bërë nga KVO për administratorët e OE "B." shpk dhe"E." shpk, për të cilin pretendohet se u ka mbaruar afati i emërimit, nuk qëndron, pasi riemërimi i administratorëve është një proces rutinë, dhe këto dy shoqëri kanë qenë në proces, ndërkohë që edhe sistemi online i QKR, i nevojiten disa ditë për azhurnimin e të dhënave. Të dyja këto shoqëri janë me aksionarë të vetën 100%, dhe të njëjtët persona që janë administratorë, janë edhe pronarë dhe domosdoshmërisht nuk ka asnjë lloj ndryshimi përveç formaliteteve të cilat janë kryer.

2.OE ankohet në lidhje me arsyen e s'kualifikimit për mos paraqitjen e licencës nga OE "B." shpk. Ky OE argumenton se kjo arsye nuk qëndron pasi në dosjen e tenderit në fjalë, dokumentacioni i kërkuar sipas DST është në folderin me emërtim: STAFI DHE LICENCA B.; Licenca 03.11.2015, i cili është ngarkuar në datë 18.05.2016.

3.OE ankohet për arsyen e s'kualifikimit sipas të cilës operatorët ekonomikë nuk kanë të punësuar mjek sipas afatit të përcaktuar të tenderit për vitin 2015, dhe konkretisht OE "J." shpk e ka të punësuar me kontratë pune datë 14.05.2016 dje "B." shpk me datë 31.11.2015. Sipas OE, kjo arsye nuk qëndron dhe është e pabazuar në fakte, pasi vetë si AK e keni kërkuar duke e specifikuar *"të paktën për vitin e fundit",* por pa specifikuar se prej cilit muaj. OE sqarojnë se janë paraqitur kontrata të rregullta me mjekun e shoqërisë, kontrata noteriale dhe konform të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi. Gjithashtu, ky OE, kërkon që të verifikohet "fituesi", pasi edhe ai nuk e posedon mjekun e shoqërisë.

4.OE, ankohet në lidhje me arsyen e s'kualifikimit, sipër të cilës "B." shpk nuk ka paraqitur deklaratën e angazhimit të mjeteve si dhe shtojcat deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, deklaratë mbi konfliktin e interesit. Sipas këtij OE, kjo arsye nuk qëndron pasi në dosjen e tenderit në fjale, dokumentacioni i kërkuar është në folderin me emërtim: Shtojca Deklarata B., e cila është ngarkuar në sistem në datë 17.05.2016.

-Në lidhje me këtë ankesë, AK ka kthyer përgjigje OE me shkresën nr. 3855/ prot., datë 15.06.2016. Në përfundim të shqyrtimit AK ka vendosur:

1.Pranimin e ankesës në lidhje me riemërimin e administratorit të shoqërisë "E." shpk dhe "B." shpk.

2.Pranimin e ankesës në lidhje me ekzistencën e licencës së shoqërisë "B." shpk.

3.Mospranimin e ankesës në lidhje me mjekun e shoqërisë që duhet të ketë operatori ekonomik, për arsye se mjeku i "J." shpk është punësuar në datë 14.05.2016 si dhe mjeku i "B." shpk është punësuar në datë 30.11.2015, ndërsa 2 shoqëritë e tjera nuk kanë mjek.

4.Pranimin e ankesës në lidhje me paraqitjen e deklaratës së Paraqitjes së Mjeteve, si dhe shtojcat: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe Deklarata e Konfliktit të Interesit.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se BOE "B." shpk, "B." shpk, "E." shpk dhe "J." shpk nuk kanë paraqitur dokumentet e kërkuara në DST si më poshtë:

1.Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjetit Bobcat.

2.Fabrika e betonit ka leje nga QKL me kod III-1.A dhe jo III-1.B siç është kërkuar në shtojcën 10 të DST në SPE>

3.Dokumentet për një autobetoniere, ndërsa për tre autobetoniere të tjera nuk janë paraqitur lejet e qarkullimit.

-Me datë 16.06.2016, OE "S." shpk, ka paraqitur ankesë drejtuar KPP me nr. 317 prot.

Në ankesën drejtuar KPP, kundërshton arsyet e s'kualifikimit të shoqërisë "S." shpk si më poshtë:

1.Ing. M. K. figuron në listpagesat e shoqërisë nga viti 2012 e në vijim, por AK nuk ka pranuar ankesën me arsyetimin se *Ing. M. K. Sava figuron e punësuar deri në datë 31.05.2016 në Institucionin "Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Tiranë.*

Ky argument mbështetet në ankesën dhe pretendimet e BOE "G." shpk "B." shpk, kjo në shkelje të rregullave dhe parimit të konfidencialitetit të përcaktuar në ligjin për prokurimin publik.

OE, shpret çudinë se si AK bazohet në ankesa të depozituara nga operatorët e tjerë në lidhje me dosjen dhe dokumentacionin e shoqërisë "S." shpk, si dhe fakti se në ç'mënyrë është marrë dhe si ka dalë ky informacion për stafin e shoqërisë "S." shpk nga operatorët tjerë ekonomikë.

1.Në vijim, ky OE sqaron se ing. M. K. është e punësuar dhe e regjistruar pranë shoqërisë "S." shpk me profesion Ing. mjedisi, duke filluar nga data 08.10.2012 dhe në vazhdim e verifikueshme lehtësisht nga listëpagesat e paraqitura. Fakti se ajo është e punësuar diku tjetër në asnjë rast nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e shoqërisë në një procedurë tenderimi. Kjo inxhiniere ka filluar punë pranë Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Tiranë, me datë 09.04.2015, ndërkohë ky pozicion pune nuk rekrutohet me statusin e nëpunësit civil por me kod pune dhe si i tillë nuk lidhet me përcaktimet e vendosura në VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Gjithashtu, AK qëllimisht nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e paraqitur për inxhinierin e mjedisit z. F. B., i cili është drejtues teknik i shoqërisë për të cilin "S." shpk ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar.

2.AK ka refuzuar të pranojë kërkesën e shoqërisë në lidhje me mjetet e paraqitura si pjesë e ofertës. Sipas OE, është paraqitur i gjithë dokumentacionin e plotë që tregon se mjetet e kërkuara nga AK janë në pronësi të shoqërisë "S." shpk. Në ankesën drejtuar AK-së i kemi argumentuar se *akte pronësie* janë të gjitha dokumentet/aktet që tregojnë dhe japin të dhëna ose të adresojnë te pronari. Mbi disponimin e këtyre mjeteve, kemi paraqitur leje qarkullimi, kolaudim, taska, siguracion.

3.Në lidhje me fadromat, AK nuk ka pranuar dokumentacionin e shoqërisë "S." shpk, me arsyetimin se shoqëria ka vënë në dispozicion dy fadroma për të cilat ka paraqitur dokumente zhdoganimi dhe faturë tvsh-je, të cilat i konsideron të pamjaftueshme për të vërtetuar pronësinë mbi mjetin. Sipas OE, fadromat janë mjete për punime brenda kantierit dhe nuk janë mjete vetëlëvizëse të cilat mund të lëvizin në rrugë interurbane dhe referuar ligjit me nr. 937, datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vetëm mjetet që qarkullojnë në rrugë mund të pajisën me leje qarkullimi dhe dokumentacionin tjetër shoqërues. Duke qenë se këto mjete përdoren vetëm në kantier dhe lëvizja e tyre bëhet me rimorkiator, nuk kanë nevojë për dokumentacion tjetër. Kjo përforcohet edhe më shumë nga përgjigja e marrë nga "Shërbimi i Transportit Berat", i cili me shkresën nr. 2679/1 prot., datë 15.06.2016 ka kthyer përgjigje OE "S." shpk duke konfirmuar se *Mjetet që lëvizin brenda kantierit dhe nuk dalin në*

rrugë, nuk kanë nevojë për regjistrim..... Gjithashtu, nëse AK do të kishte dyshime për pronësinë e këtyre mjeteve, atëherë duhej që në zbatim të ligjit për prokurimi publik të kërkonte sqarime dhe jo të vendoste s'kualifikimin e OE duke vënë në dyshim dokumentacionin e paraqitur.

4.Në shkresën kthim përgjigje, datë 13.06.2016, AK nëpërmjet KSHA, ka shtuar si arsye s'kualifikimi mos paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e taksave vendore nga Bashkia Durrës për vitin 2015.

Një konstatim i tillë nuk qëndron pasi shoqëria "S." shpk ka ushtruar aktivitet për realizimin e objektit "Ndërtim rruga By Pass Plepa – Kavajë.....". Ky objekt ka përfunduar dhe është kolauduar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nisur nga ky fakt, në datë 05.03.2016 ka mbyllur adresën sekondare të ushtrimit të aktivitetit, nëpërmjet depozitimit të kërkesës së administratorit të saj datë 04.03.2016 pranë QKR-së. Prej muajit Mars 2016 kjo shoqëri nuk ushtron aktivitet në Bashkinë Durrës. AK, ka gabuar në konstatimin e saj pasi në DST kërkohet vërtetim *për vendet ku ushtron aktivitet sipas QKR-së,* dhe jo vërtetim *vërtetim për vendet ku ka ushtruar aktivitetin sipas QKR-së.* Në këtë rast konstatimi i AK-së do ishte i saktë dhe do përbënte arsye për s'kualifikim.

-Për të gjitha arsyet e mësipërme, OE e konsideron vendimin për s'kualifikim tërësisht të padrejtë dhe të paligjshëm, si dhe kërkon të rishikohet vendimi konform rregullave ligjore në fuqi dhe ti jepet shoqërisë "S." shpk e drejta e kualifikimit në këtë tender.

-Në lidhje me ankesën e mësipërme, KPP me vendimin nr. 1446/1, datë 17.06.2016, ka vendosur:

1.Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga OE "S." shpk.

2.Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga AK deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.

3.AK të dërgojë menjëherë pranë KPP informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme ku të jepen argumente në lidhje me pretendimet e OE "S." shpk, një CD me të gjitha materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse.

4.I gjithë dokumentacioni i kërkuar të paraqitet jo më vonë se 2 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi.

-Me shkresën nr. 4066/1 prot., datë 22.06.2016 të firmosur nga Titullari i AK-së, i është dërguar dokumentacioni i kërkuar KPP-së.

-Me shkresën nr. 605/1 prot., datë 10.08.2016, KPP dërgon pranë Bashkisë Berat vendimin me nr. 605/2016 në lidhje me ankesën e OE "S." shpk.

Në përfundim, KPP arsyeton se OE "S." shpk, nuk ka respektuar procedurën e ankimimit bazuar në legjislacion, pasi arsyet shtesë të vendosura nga AK për s'kualifikimin e këtij OE, nuk janë ankimuar pranë AK-së, por pranë KPP-së, duke mos shteruar fillimisht ankimimin pranë AK-së. KPP sqaron se në rastin konkret nuk mund të merret në shqyrtim ankesa e paraqitur, pasi një situatë e tillë mund të cojë në precedent që çdo OE të anashkalojë procesin e ankimimit pranë AK-ve si shkallë e parë, dhe të vinte direkt në KPP.

Më datë 11.08.2016, AK nëpërmjet Raportit Përmbledhës, ka paraqitur klasifikimin përfundimtar, ku ka klasifikuar BOE "G." & "B." shpk, si dhe "B." shpk. Fitues i kësaj procedure në përfundim është shpallur BOE "G." & "B." shpk me ofertë **260,385,778 lekë,** ose **39,438,458 lekë** më e ulët se fondi limit.

-Kjo procedurë është hetuar në mënyrë administrative nga APP.

APP gjatë hetimit të saj ka konstatuar:

1.AK nuk ka argumentuar dhe dokumentuar mënyrën përllogaritëse së fondit limit në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së, dhe konkretisht:

a) *Zërat mure betoni C12/15 për pusetat e kontrollit* dhe *Mure buto betoni C12/15 për muret e kanalit,* AK ka përdorur si çmim për njësi vlerën **9,651 lekë** duke përdorur referencën 2.112/2 të manualit teknik, ndërkohë që në manual çmimi për *zërin Mure buto betoni* është **9,375 lekë.** Ky zë punimesh përbën pothuajse **3%** të vlerës së punimeve.

b) Për zërin e punimeve *F.V tuba të brinjëzuar HDPE SN 8 d=500mm,* AK ka përdorur çmimin për njësi **6,564 lekë,** ndërkohë sipas manualit çmimi për këtë njësi është **6,075 lekë.** Ky zë përbën **1%** të vlerës së punimeve.

c) *Zërat F.V hekur betoni Φ 6-10 mm periodike* dhe *F.V hekur betoni Φ>12 mm periodik.* AK ka përdorur çmimin për njësi **143,168 lekë dhe 133,196 lekë,** shoqëruar me numrin e analizës 2.166, ndërkohë që në manual, ky numër ka çmimin për njësi **113,157 lekë,** dhe është çmim vetëm për zërin *F.V hekur betoni Φ 6-10 mm periodike.* Këta zëra punimesh përbëjnë **30% të vlerës** së preventivit.

d) Për zërin e punimeve *F.v siguresa modulare 3P, 380 V, 2A,* AK ka përdorur çmimin për njësi **4,272 lekë,** ndërkohë që në manual çmimi për këtë zë është **1,006 lekë.**

e) Për zërin e punimeve *F.V bordurë betoni p/fabrikat për pemë,* shoqërohet në preventiv me shënimin *an-3,* por AK nuk ka dokumentuar referencën e çmimit për njësi të përdorur për këtë zë punimi.

f) Zërat e punimeve *F.v zgara modulare 380V, 100A, 16KA* dhe *F.V llamba sinjalizimi modulare,* shoqërohen në preventiv me shënimin *am,* por nuk ka dokumentuar referencat e çmimeve për njësi, ndërkohë që gjëndet në 3 kapituj të preventivit.

Sa më sipër, sipas APP mban përgjegjësi hartuesi i preventivit **z. S. Dh.**

2.AK nuk ka argumentuar kriteret për kualifikim, të hartuara për procedurën e prokurimit. APP sqaron se, në nenin 61, pika 2, të VKM 914, datë 29.12.2014, parashikohet se *Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat përgjegjës.*

Sa më sipër, mban përgjegjësi NJP e përbërë nga z. **A. H., znj. F. K. dhe znj. H. D.**

3.Në pikën 2.2 të kritereve të veçanta, AK ka kërkuar që ofertuesi të paraqesin *"Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve 2012, 2013, 2014, të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse, dega e tatim taksave dhe të shoqëruara me raport të ekspertit kontabël.*

APP sqaron se, në bazë të nenit 46, pika 1, germa c, të LPP, parashikohet se: *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Në lidhje me gjendjen ekonomike e financiare: OE duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitete ekonomike dhe financiare..... për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.

Në nenin 18 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për Tatimin mbi të Ardhurat",* i ndryshuar, parashikohet, ndër të tjera, *se afati i fundit i paraqitjes pranë organeve tatimore të bilancit është data 31 Mars e vitit pasardhës.*

Në rastin konkret, pavarësisht se, sipas AK dokumentet janë hedhur në sistem në datë 01.04.2016, procedura e prokurimit në fjalë është zhvilluar me datë 23.05.2016, pra OE kanë pasur 23 ditë në dispozicion për të paraqitur dokumentacionin e plotë.

4.Pika 2.2a e kritereve të veçanta, kërkon që ofertuesi të ketë punësim mesatar prej 150 punonjësish për periudhën Janar 2013 – Shkurt 2016

APP, sqaron se në respektim të nenit 61, pika 2 të VKM, AK duhet të argumentojë me procesverbal vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim.

Gjithashtu, në shkresën drejtuar OE "B." shpk, AK ka përcaktuar numrin e punonjësve, si dhe ndarjen e tyre sipas profesioneve, duke specifikuar numrin e stafit drejtues etj, por nuk rezulton të jetë pasqyruar argumente mbi bazën e të cilave është bërë përcaktimi i numrit të punonjësve për secilin profesion.

5.Në DST, kërkohet licenca NS-6B, e cila është në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Sipas lidhjes 4 të kësaj VKM, germa B, e licencës në fjalë është për punime në vlerë **21-50 milion lekë,** ndërkohë në preventiv janë parashikuar **2,050,664 lekë.** Në rastin konkret duhej të kërkoj kategoria A e kësaj licence.

Sa më sipër, mbajë përgjegjësi anëtaret e NJP z. **A. H., znj. F. K. dhe znj. H. D.**

Në vijim, APP ka analizuar vlerësimin e kryer nga KVO në lidhje me kualifikimin dhe klasifikimin përfundimtar të OE. Në lidhje me kualifikimin e BOE *"G." shpk dhe "B." shpk.*

1.Në marrëveshjen mes palëve, "G." shpk merr përsipër 77% të punimeve, ndërkohë "B." shpk 23% të tyre. Rezulton se në marrëveshjen mes palëve nuk janë përcaktuar elementët konkretë, që do të realizojë secili prej tyre.

APP sqaron se, neni 74, pika 2 e VKM-së parashikon se: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi".*

Sa më sipër, kontrata e bashkëpunimit ndërmjet këtyre OE, konsiderohet e paplotë, dhe nuk i jep mundësi AK të vlerësojë drejt, dokumentacionin e paraqitur nga ky bashkim operatorësh.

2.Në pikën 2.2.a, AK ka kërkuar nga OE *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion, që nevojiten për zbatimin e kësaj kontrat, ku midis të tjerave ka kërkuar edhe:*

-Autovinxh 4 copë

-Autovinxh me kosh copë

-Autobot Uji 1 copë

-Autobitumatriçe 1 copë

a) APP sqaron se nga kontrolli, rezulton se OE "B." shpk ka paraqitur 3 Autobetonier, për të cilat provohen të rregullta me dokumentacion, ndërkohë OE "G.' shpk, nuk e ka provuar me dokumentacion të rregullt 4 Autobetonieret e paraqitura.

APP vëren se, dokumentacion i paraqitur për si provë nga AK, është dokumentacion i panoterizuar (i shkarkuar nga sistemi), në kundërshtim me shtojcën 10 të DST, sipas së cilës dokumentet e paraqitura nga ofertuesi duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Edhe udhëzimi nr. 8, datë 22.05.2015 përcakton se NJP i kërkon të paraqesë OE dokumentacionin origjinal ose fotokopje të noterizuar, i cili, verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes.

b)Në lidhje me mjetin autovinxh me kosh (1 cope), OE "B.", ka paraqitur mjetin me targa AA24IY, i marrë me kontratë qiraje nga z. L. K., i cili ka kontrollin teknik të vlefshëm deri me datë 18 Mars 2015, ndërsa siguracioni deri më 17 Mars 2015, ndërkohë procedura e prokurimit zhvillohet me datë 23.05.2016, pra janë jashtë afateve të vlefshmërisë.

Ndërkohë, OE "G." shpk, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues të mjetit në fjalë. Ky OE ka paraqitur mjetin autovinxh me targa TR7409S, e cila shoqërohet me lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë, policën e sigurimit dhe taksat vjetore, por nuk ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik të mjetit në fjalë.

Në lidhje me mjetet autovinxh me kosh me targa AA685DN dhe TR7409S, për të cilat AK pretenton se plotësojnë kushtet, APP sqaron se dokumentacioni i paraqitur është i panoterizuar (i shkarkuar nga sistemi), ndërkohë që kërkohen të jenë origjinale ose kopje të noterizuar.

c)BOE "G." shpk dhe "B" shpk, nuk kanë paraqitur dokumentacion për të provuar se kanë në dispozicion mjetet *1 Autobot Uji dhe 1 Autobitumatriçe.*

APP vëren se dokumentacioni i paraqitur për këto mjete është i panoterizuar (i shkarkuar nga sistemi), në kundërshtim me DST pasi kërkohet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

d)BOE nuk përmbush pikën 2.2.a të kritereve të veçanta, pasi OE "B." shpk nuk disponon certifikatën ISO 39001:2012 *"Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor".*

Kjo certifikatë disponohet nga OE "G." shpk, por duke qënë se janë punime rrugore, dhe të dy OE do kryejnë këto punime, është kërkesë që kjo certifikatë të disponohet nga të 2 OE.

Në përfundim, APP arrin në konkluzion se KVO ka kualifikuar BOE e mësipërm me gjithë mangësitë në marrëveshjen e bashkëpunimit, dhe mospërmbushjen e kritereve të cituara më sipër.

Sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO z. **Ç. B., z. E. V. dhe znj. V. K.**

APP, ka shqyrtuar edhe dokumentacionin e paraqitur nga BOE "B." shpk, "A." shpk, "A." shpk.

1.Në lidhje me certifikatën ISO 14001:2004 "Mbi sistemin e menaxhimit të ambientit, ISO 18001:2007 mbi "Shëndetin dhe sigurimin në punë", të paraqitura nga OE "A." shpk, janë në gjuhën angleze dhe të papërkthyera.

Në nenin 53, pika 3 të LPP, përcaktohet se: *AK, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

APP arrin në përfundim se KVO ka kualifikuar BOE e mësipërme në kundërshtim m;2e kërkesat e për kualifikim dhe nenin 53 të LPP.

Sa më sipër, mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO z. **Ç. B., z. E. V. dhe znj. V. K.**

Në përfundim, APP ka vendosur të dënojë me gjobë si më poshtë:

1.Z. S. Dh. me 200,000 lekë, si përson përgjegjës për mosdokumentimin e përllogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me nenin 28 të LPP.

2.Z. A. H., znj. F. K. dhe znj. H. D. në masën 200,000 lekë, në cilësinë e anëtarëve të NJP, si përsona përgjegjës për hartimin e kritereve në kundërshtim me nenin 46 të LPP.

3.Z. Ç. B., z. E. V. dhe znj. V. K. në masën 100,000 lekë, në cilësinë e anëtarëve të KVO, si persona përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në kukndërshtim me nenin 53 të LPP.

Vlerësimi i Audituesve Shtetëror të KLSH

Audituesit e KLSH, pasi shqyrtuan dokumentacionin e praktikës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i rrugës "Stadiumi i Vjetër – Stadiumi i Ri, rruga Stadiumi, rruga "Koli Vesho" dhe të sheshit para Stadiumit, Bashkia Berat", me fond limit* ***299,824,236 lekë pa tvsh konkluduan si më poshtë:***

-Oferta ekonomike e paraqitur nga OE "S." në tërësinë e saj përmban elementë të domosdoshëm për realizimin e kontratës. Arsyet e s'kualifikimit të paraqitura nga AK dhe fakti se KPP në vendimin e saj nuk ka gjykuar në themel ankesën e OE por është mjaftuar me faktin se ankesa e paraqitur procedurialisht nuk ka ndjekur kërkesat e LPP, pasi duhet të kishte kaluar paraprakisht pranë AK, në gjykimin tonë mosplotësimi i kritereve të OE "S." duhet të konsiderohej si devijim i vogël i parashikuar në nenin 53, pika 4 e LPP duke konsideruar faktin se mungesa ose mos saktësia e tyre nuk cenon thelbin e realizimit të kontratës dhe duhet të konsiderohej si ofertë ekonomike e vlefshme.

Duke kualifikuar BOE "G." shpk & "B." shpk me ofertë **260,385,778 lekë**, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **44,535,721 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE "S." shpk në vlerën **215,850,057 lekë**.

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 5806/1 prot., datë 22.11.2019 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Berat nga anëtarët e NJP dhe KVO S. Dh., Ç. B., V. K., E. V.dhe F. K.*Në lidhje me akt konstatimin e KLSH, këta punonjës argumentojnë:

Në lidhje me akt verifikimin nr 4 të mbajtur nga audituesit e KLSH dhe Projekt Raportit të Auditimit punonjësit e mësipërm sqarojnë se në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, është hetuar në mënyrë administrative nga APP. Ky institucion, me vendimin nr. 78, datë 20.10.2017 ka vendosur gjoba për anëtarët e NJP dhe KVO-së. Kundër këtij vendimi është ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuziqimin e vendimit të APP. Gjykata gjatë gjykimit ka ndarë çështjen në dy pjesë, ku ka veçuar punonjësin S. Dh.

Në përfundim të gjykimit, i cili është përfundimtar, gjykata ka vendosur: *1.Me vendimin nr. 312, datë 06.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka pranuar kërkesën e z. Sllavi Dhrami, duke shfuqizuar pjesërisht vendimin me nr. 78, datë 20.10.2017 të APP, pikën 1 të vendimit.*
2.Me vendimin nr. 505, datë 16.02.2018, Gjykata Administrative te Shkallës së Parë Tiranë, ka rrëzuar kërkesë padinë e palës paditëse si të pa bazuar në ligj dhe në prova.

Përsa i përket ankesës me nr. 705 prot., datë 22.07.2017, nga verifikimet e bëra nga grupi i auditimit, lidhur me pikat e kësaj ankese për moskkryerjen e disa zërave pune, apo kryerjen e punimeve me cilësi të dobët, rezulton si më poshtë:

1. Përsa i përket volumeve të pakryera "Punime gërmimi dhe prishje" nga ana e grupit të auditimit është konstatuar diferencë volumi në këtë zë pune, i cili pasohet me një vlerë dëmi ekonomik, që është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Përsa i përket volumeve të kryera jo sipas projektit për zërat "Shtresë çakulli t=20 cm" dhe "Shtresë stabilizanti t=15 cm", grupi i auditimit, nisur nga fakti që këto zëra pune janë punime të maskuara, ka kërkuar nga Bashkia Berat verifikimin e këtyre shtresave në një gropë testuese, të përcaktuar nga ana jonë, me përmasa 100 cm x 100 cm, në të cilën rezultoi se shtresat e mësipërme janë kryer sipas projektit.

3. Përsa i përket volumeve të kryera jo sipas projektit për zërat "Shtresë binderi t=6 cm" dhe "Shtresë asfaltobetoni t=4 cm", grupi i auditimit, nisur nga fakti që këto zëra pune janë punime të maskuara, ka kërkuar nga Bashkia Berat verifikimin e këtyre shtresave nga një laborator i certifikuar. Nga provat e bëra nga laboratori "N.", rezultoi se shtresat e binderit dhe asfaltobetonit, si dhe cilësitë fizike të tyre, janë sipas projektit. Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar diferencë volumi në këtë zë pune, i cili pasohet me një vlerë dëmi ekonomik, që është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Përsa i përket abuzimit me çmimin e blerjes dhe cilësinë e pllakave të gurit gëlqeror, grupi i auditimit nuk analizon çmimin e blerjes së materialeve, por nga ana tjetër ka konstatuar se pllakat e përdorura në shtrimin e trotuarëve nuk janë sipas projektit, qoftë nga pamja vizuale (nuk janë boçardim pikësor), qoftë edhe nga trashësia e kërkuar në projekt, pasi nga auditimi në fakt, u konstatua që trashësia është rreth 4 cm dhe jo 6 cm sipas projektit, e cila pasohet me një vlerë dëmi ekonomik, që është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

V. REKOMANDIMET

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Njësia Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, nuk ka audituar aktivitetin e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit dhe Policinë Bashkiake, në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik ", *(Trajtuar në faqet 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Berat, të parashikojë dhe ushtrojë një auditim për aktivitetin e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit dhe Policia Bashkiake ndër të tjerat edhe administrimi i dokumentacionit të blloqeve si letra me vlerë. Gjithashtu në mbylljen e raporteve finale të auditimit, të përcaktohen masa konkrete për personat përgjegjës për veprimet apo mosveprimet në përputhje me ligjin për të cilën është konstatuar shkelja.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Sipas Informacioneve të paraqitura nga IMTV, Bashkia Berat,rezulton se në total, për periudhën e viteve 01.01.2015 deri 30.09.2019 , për ndërtime të kundërligjshme /mos

zbatim të rregullave për kolaudimin dhe ndërtimet janë dënuar me Vendime për Dënim me gjobë 125 kundërvajtës, me vlerë totale 38,650,000 lekë,(të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare llogaria 468 më dt.31.12.2019) prej tyre deri më datën 01.11.2019, janë arkëtuar gjobat vetëm nga 17 subjekte në vlerën 2,200,000 lekë ose në masën 5.6%. Ndërkohë vetëm për 13 subjekte në vlerën 6,900,000 lekë janë kërkuar nga Gjykata e Shkallës së parë Berat, kthimi vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, por deri më datën 01.11.2019 janë kthyer në tituj ekzekutiv vetëm 4 vendime gjobe në vlerën 2,000,000 lekë, por edhe këto 4 vendime gjoba nuk janë ekzekutuar (arkëtuar), ndërsa për 6 vendime gjobe në vlerën 4,900,000 lekë, nuk është kthyer përgjigje nga Gjykata dhe nga IMTV Bashkia Berat nuk i është përsëritur kërkesa duke mbetur pezull dhe pa veprim

Pasqyrë përmbledhëse e Vendimeve të gjobave dhe arkëtimi për periudhën 01.01.2015 deri 30.09.2019, IMT Bashkia Berat

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga 122 gjoba të vendosura për vlerën 38,650,000 lekë, rreth 63 % të numrit të gjobave ose 55 gjoba x 500,000 lekë dhe 81.5% të vlerës prej 31,500,000 lekë e zënë gjobat minimale prej 500,000 lekë për secilin rast.

Pra më datën 01.11.2019 për **100 vendime gjobe** nuk është vepruar duke të mbetur të pa arkëtuara vit pas viti dhe shkaktuar mungesë të ardhurash në Bashkinë Berat. **në vlerën prej 28,400,000 lekë.** (Për vendimet e 100 gjobave në vlerën prej 28,400,000 lekë nuk janë llogaritur kamat vonesat në vlerën 60 % të shumës ose 17,040,000 lekë duke shkuar vlera **prej 45,440,000 lekë** (28,400,000+ 17,040,000)

Nga auditimi rezulton se për **100 vendime gjobe në vlerën prej 28,400,000** lekë, të vendosura për periudhën 4 vjeçare e 9 muaj respektivisht nga data 01.01.2015 deri 30.09.2019,prej tyre **31 vendime gjobe në vlerën 20,650,000 lekë,** të vendosura për **periudhën 2 vjeçare e 10 muaj**, nga data 01.01.2015 deri 31.10.2017 të cilave u ka kaluar afati 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar (pra nuk mund të vilen më) dhe asnjë nga ish kryeinspektorët e IMT pasardhës konkretisht **z.R. B. dhe z.L. S., Drejtoria Juridike Bashkia Berat** juristja e IMTV **znj. E. T.** dhe ish kryetari i Bashkisë Berat **z.P. S.,** nuk kanë ndërmarrë asnjë nga hapat ligjore/nënligjore edhe pse **u ka kaluar afasti 2 vjeçar i arkëtimit, pra janë parashkruar dhe nuk mund të vilen më.** *(Trajtuar në faqet 36-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, Bashkia Berat,bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH", të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 31 vendime gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura për periudhën 01.01.2015,deri më datën 31.10.2017, për shumën **20,650,000 lekë,** (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar).

Aneksi nr. 2 bashkëlidhur.

b.Njëherazi Bashkia Berat Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrin masa për kthimin në tituj ekzekutiv të 125 vendimeve të gjobave në vlerën **38,650,000 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60%, mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar). **Aneksi nr. 1.bashkëlidhur**

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat më datën 31.12.2018 sipas bilancit (llog. 486) paraqitet me fatura të prapambetura në shumën **39,836,177** lekë. Gjatë 9-mujorit 2019 ka likujduar fatura në shumën **34,807,895** lekë, mbetur pa likujduar fatura të palikujduara në shumën **5,028,282** lekë dhe vendime gjyësore në shumën ***9,061,735*** *lekë* .Vlerën më të lartë të detyrimeve e zënë shpenzimet për

energji të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, detyrim i vitit 2007 në shumën 9,294,942 lekë, detyrimet gjyqësore në shumën 5,470,961 leke, fatura nr. 7 datë 27.08.2018 e operatorit B., për objektin "Ndërtim i ujësjellësit Qereshnik" me shumën 4,155,960 lekë, fatura nr.86 datë 15.10.2018 e operatorit P. sh.p.k me objekt "Rikonstruksion i muzeut historik Sinjë" me shumën 2,612,283 lekë, si dhe fatura të tjera të përshkruara në pasqyrën më sipër. Sic shihet dhe nga pasqyra është likuiduar 87 % e detyrimeve të prapambetura të vitit 2018. *(Trajtuar në faqet 91-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Berat (Drejtoria e Financës), bazuar ne; Udhëzimin plotësues te Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*"dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njësitë e qeverisjes vendore''*.të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën prej 14,090,017, nga e cila vlera e faturave të palikujduara në shumën **5,028,282** lekë ***dhe vendime gjyqësore për shumën prej 9,061,735*** *lekë* **(Bashkëlidhur Aneksi nr.8 mbi gjendjen e faturave te palikujduara me datën 30.09.2019)**

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Bashkia Berat, nuk ka zbatuar VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen. Rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë me vlerë **26,225,134 lekë** ,e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Berat. *(Trajtuar në faqe 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Berat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **26,225,134 lekë.**

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga ana e 4 Njësive administrative të Bashkisë Berat, administratorët e Njësive administrative, edhe pse nuk e kanë në kompetence kanë nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore ndaj subjekteve Juridike dhe fizike. Në kundërshtim me:

a. ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", neni 4-Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika **2**, ku parashikohet se**:** Zyra e taksave të bashkisë apo komunës vendos e zbaton sanksione për shkelje të procedurave e të detyrimeve fiskale vendore, të përcaktuara në ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

b. ligjin, nr. 9920, datë 19.5.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,neni 70, E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor pika 3, ku përcaktohet se: Zyra tatimore e qeverisjes vendore ka të drejtë të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit, që klasifikohen si biznes i vogël. Për detyrimet tatimore, të lidhura me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, njoftimi i vlerësimit tatimor nxirret nga drejtoria rajonale tatimore. *(Trajtuar në faqen 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Berat në Rregulloren e Brendshme të përcaktojë për punonjësit e taksave të 4 Njësive Administrative se njoftim vlerësimet tatimore të nxiren vetëm nga Drejtoria e të

Ardhurave bashkia Berat dhe jo si deri tani të cilat janë nxjerrë jashtë kompetencave nga Administratori i Njësisë Administrative.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Berat dhe 4 Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore subjektet m*ë datën 30.09.2019 Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore në shkallë bashkie Berat janë në shumën* ***prej 267,055,110*** *lekë, e cila përfaqëson:*
-563 subjektet e biznesit të vogël e biznesit të madh,në vlerën 68,838,416 lekë
-10,503 familjarë janë debitorë për taksat e tokës në vlerën 62,813,625 lekë
-Për taksën e ndërtimit,tarifat e pastrimit në vlerën ***135,403,069 lekë****, nga të cila:*
- rreth 6000 familjarë në vlerën 44,944,004 lekë, nuk kanë paguar taksat në Ujësjellës sha Berat.
- 26,225,134 lekë debitor të taksës së ndikimit në infrastrukturë,
-700 familjarë nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastruktrurë për vlerën 26,225,134 lekë.
(Trajtuar në faqen 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. <u>Rekomandimi:</u> Drejtoria e të Ardhurave Vendore **Bashkia Berat**, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën ***267,055,110*** **lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të **ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a) Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

*Nuk është vendosur masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet: *"..... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij*".

*Nga ana e inspektorëve të Njësisë Administrative Otllak, Velabisht, Sinjë, dhe Roshnik nuk është vepruar sipas ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 2. .....*Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore*.

*Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjitn 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1 ku thuhet : " *Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit*".

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta, konstatohet se nga AK (Bashkia Berat), për asnjë rast nuk është bërë i mundur ngritja e KSHA(komisioni i

shqyrtimit të ankesave) për ankesat e paraqitura nga OE gjatë zhvillimit të procedurave, veprime këto në kundërshtim me nenin 63 të LPP dhe neni 78 të VKM 914.
Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet e mbajtura nga NJHDT dhe KVO nuk janë protokolluar, veprim në mospërputhje me nenin 18, "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë".
Pjesa më e madhe e dosjeve të audituara rezultuan se nuk ishin të inventarizuar dhe të numëruara, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03 "Për Arkivat" dhe aktet ligjore në zbatim të tij dhe me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 36. *(Trajtuar në faqet 148-223 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e prokurimeve të marrë masa të mosvijojnë me procedurat e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga OE pa ngritur më parë KSHA si dhe nga ana e këtij të fundit të mbahen procesverbalet përkatës deri në kthimin e përgjigjes OE ankues.
-Drejtoria e prokurimeve të marrë masat e nevojshme që çdo procesverbal i mbajtur nga anëtarët e NJHDT dhe KVO-së të jetë i protokolluar.
- Nga ana e Drejtorisë së prokurimeve të merren të gjitha masat për inventarizimin e plotë të dosjeve të procedurave të prokurimit të zhvilluara.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: KLSH ka dërguar në Bashkinë Berat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. prot 1104/9 datë 14.05.2016, **si më poshtë**:
-Janë rekomanduar 14 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe zbatuar pjesërisht 7 masa dhe janë pjesërisht të zbatuara 3 masa.
-Janë rekomanduar 13 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 13 masa.
-**Shpërblim dëmi janë rekomanduar** *28 masa me vlerë* **55,846,909** *lekë,* nga verifikimi rezultoi se *deri më datë 30.09.2019,*vlera debitore është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të tjerë", të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2018 (bilanci vjetor 2018) vlera prej 44,083,697 lekë.
Deri më datën 30.09.2017 eshtë arkëtuar vlera prej 1,006,892 lekë.
Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej 26,806,859 lekë nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 3 rekomandime në vlerën 81,785 lekë
-Në proces gjyqësor 10 rekomandime në vlerën 26,725,074 lekë
Nga shuma e rekomanduar nga KLSH për vlerën 55,846,909 lekë,deri më datën 30.09.2019 paraqiten:
-Për 28 rekomandime janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe janë arkëtuar 1,006,892 lekë në 17 raste.
-Janë ngritur padi Gjyqësore ndaj Bashkisë dhe janë dhënë Vendime Gjykate të Shkallës së Parë dhe të formë së prerë në favor të punonjësve dhe privatëve të ngarkuar me masa shpërblim dëmi në 65 raste në ***shumën 28,131,378 lekë.***
-Nga punonjësit dhe privat të ngarkuar me masa shpërblim dëmi janë ngritur padi në Gjykatën Administrative Berat dhe janë në proces gjyqësor në 25 raste në shumën ***26,479,574 lekë****. (Trajtuar në faqen 254 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin e Auditimit të kryer **në Bashkinë Berat**, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", nenit 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 *ku*

përcaktohet se;. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht ne këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë subjekteve private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, u konstatua se:

Nga ana e Bashkisë Berat në asnjë rast nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet që janë paisur me leje minerale nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për dhënien me qira për sipërfaqet pyjore dhe kullosore që administrohen nga kjo bashki.

- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1368 datë 18.06.2009, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 7 (shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk,, pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1694 datë 27.03.2014, me vendndodhje në Sinjë, Berat me sipërfaqe 11 (njëmbëdhjetë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,310,000 lekë
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "B." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1379 datë 03.07.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 16.7(gjashtëmbëdhjetë.shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 20,207,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "P." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1359 datë 08.06.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 11.5(njëmbëdhjetë.pesë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 13,915,000 lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "E." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1597 datë 19.11.2012, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 9.2(nëntë.dy) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 11,132,000lekë.
- Nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektin "T." shpk pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin gurë gëlqeror me nr.1101 datë 06.12.2009, me vendndodhje në Roshnik, Berat me sipërfaqe 7(shtatë) ha, detyrimi pa arkëtuar në vlerën 8,470,000 lekë.

Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6. Në gjashtë raste sipas aneksit B/2, në vlerën **75,504,000 lekë** *(Trajtuar në faqen 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Berat, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrime të pa arkëtuara në vlerën **75,504,000 lekë** dhe lidhjen e kontratave me subjektet "B." me vlerë 8,470,000 lekë, "T." me vlerë 13,310,000 lekë , "B." me vlerë 20,207,000 lekë, "P." me vlerë 13,915,000 lekë ,"E." me vlerë 11,132,000lekë, "T." me vlerë 8,470,000 lekë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar

me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 të Bashkisë Berat, për periudhën 2017, 2018 dhe 9 mujori i vitit 2019, **konstatohet se:**
Në bashkinë Berat ushtrojnë 18 subjekte të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët në vlerën **15,300,000 lekë** sipas aneksit 1 në zbatim të pikës B/4. *(Trajtuar në faqe 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1 Rekomandimi: Bashkia Berat të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 15,300,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në zbatim të, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura, blerje mallrash apo investimesh, nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. *(Trajtuar në faqet 67-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2018, u konstatua se mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rriskuar dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimin shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv. *(Trajtuar në faqet 53-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim efiçent të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, 2019 nga Drejtoria e Financës ***nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit*** financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit. Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme. *(Trajtuar në faqet 53-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1 Rekomandimi: Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim:
-njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit,
-programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe
-zvogëlimin e borxhit financiar.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i funksionimit të kontrolleve të vendosura në kuadrin e menaxhimit financiar dhe kontrollit raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 40% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 49% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e njësisë për periudhën 2018-2022 rreth 40% e të intervistuarve nga të cilët 25% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 41% tek plani strategjik dhe 9% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësive; në procesin e rekrutimit janë përfshirë vetëm 40% e drejtuesve. *(Trajtuar në faqet 14-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

Në vazhdimësi

B. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:</u>

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës prokurimit me objekt **"**Blerje materialesh elektrike" Berat Sipas kërkesës së: Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike**"**, me FL në vlerën 1,636,342 lekë, OE i shpallur fitues "K." me vlerë të ofertës 1,570,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 me vlerë 1,884,000 lekë me tvsh, procedurë e cila është anuluar nga AK si pasojë e shkresës së bërë nga OE. Në zbatim të LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24, Sigurimi i kontratës, nga ana e Bashkisë Berat nuk është mbajtur sigurimi i kontratës në shumën **188,400 lekë me dëm ekonomik shkaktuar në buxhetit e Bashkisë Berat.** *(Trajtuar në faqen 170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandim: Bashkia Berat, drejtoria e financës**,** të marë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore arkëtimin e shumës **188,400 lekë** si sigurim kontrate OE "K." SHPK të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt **"**Blerje materialesh elektrike**",** bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914 datë 29.12.2014 neni 24.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 14,983,653 lekë, fituar nga OE "B." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 211,888 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 3080 prot datë 04.07.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe OE "B." Shpk. *(Trajtuar në faqen 238 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **211,888 lekë pa tvsh** nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 3080 prot datë 04.07.2017, me objekt "Riasfaltim segmente të rrugës Antipatrea-Bashkia Berat", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 48,850,889 lekë, fituar nga OE "B." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 464,600 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 5893 prot datë 28.10.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe OE "B." SHPK. *(Trajtuar në faqen 240 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **464,600 lekë pa tvsh** nga OE "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016, me objekt "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat,* me vlerë të kontratës (me tvsh) 312,462,933 lekë dhe kontratës me objekt "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat, me vlerë të kontratës (me tvsh) 46,412,975 lekë, fituar nga BOE "G." shpk & "B." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën totale 6,482,720 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratat e sipërmarrjes së punimeve, përkatësisht Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 dhe Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Berat dhe BOE "G." shpk &"B." SHPK. *(Trajtuar në faqen 244 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Berat të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,482,720 lekë pa tvsh** nga BOE "G." shpk &"B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratat me Nr. 5893 prot datë 28.10.2016 dhe Nr. 6015 prot, datë 29.12.2017, përkatësisht me objekt "Rikonstruksioni i trotuarit, ndriçimi dhe riveshje me shtresa asfaltike, Rruga Antipatrea-Segmenti Ura e varur – Ura e Goricës", Bashkia Berat dhe "Shtesë kontrate për objektin "Rikonstruksioni i rrugës Stadiumi i vjetër – Stadiumi i Ri,rruga Stadiumi, rruga Koli Vesho", Bashkia Berat, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re*", Bashkia Berat,* me vlerë të kontratës 78,347,107 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: "Prishje suvatime tavani"; "Suvatim solete"; "Lyrje me bojë hidroplastike Importi cilësi e I-rë" duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **583,470 lekë** me TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat dhe sipërmarrësit Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK. *(Trajtuar në faqen 248 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Berat, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **583,470 lekë** pa TVSH nga Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK, në

cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, për kryerjen e punimeve me objekt "Rikonstruksion i godinës së Bashkisë së re", Bashkia Berat, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë*", Bashkia Berat,* me vlerë të kontratës 52,263,124 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "T" SHPK & "B." SHPK, rezultoi se nuk janë realizuar zërat e punimeve: "F.V kaseta llamarine xingat"; "Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm; "Shtresë jastek gome me t=3 cm", duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **1,015,500 lekë me TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3082 prot, datë 28.07.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Berat dhe sipërmarrësit Bashkimi i Operatoratorëve Ekonomikë (BOE) "L." SHPK & "S." SHPK & "E." SHPK. *(Trajtuar në faqen 250 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Berat, që t'i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "T." SHPK & "B." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 2538 prot, datë 13.04.2016, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **1,015,500 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Berat, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitet 2017-2018 dhe 9 mujorin e vitit 2019, janë konstatuar 11 procedura me shkelje, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **19,171,364 lekë** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative:

C.1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt **"Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit "Tomorri", në bulevardin Republika"**, me FL në vlerën 72,480,695 lekë, OE i shpallur fitues "Z." SHPK me vlerë të ofertës 70,247,274 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit"*. Duke kualifikuar OE **"Z."** shpk me ofertë 70,247,274 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **2,921,952 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"B."** shpk në vlerën 67,325,322 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt **"Rikonstruksion i Muzeut Historik Sinjë"**, me FL në vlerën 8,446,819 lekë, OE i shpallur fitues "P." me vlerë të ofertës 7,634,330 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për

anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE **"P."** shpk me ofertë 7,634,330 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,677,352 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"C."** shpk në vlerën 5,956,978 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2017 me objekt **"Blerje karburanti për Bashkinë Berat dhe për drejtori"**, me FL në vlerën 13,190,550 lekë, OE i shpallur fitues "P." me vlerë të ofertës 13,127,576 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE **"P."** shpk me ofertë 13,127,576 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,445,678 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"A."** shpk në vlerën 11,681,898 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Restaurim i mureve të Kalasë Berat*"**, me FL në vlerën 7,676,667 lekë, OE i shpallur fitues "M." me vlerë të ofertës 6,826,124 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE **"M."** shpk me ofertë 6,826,124 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **514,569 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"C."** shpk në vlerën 6,311,555 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Mirëmbajtje kanale ujitëse dhe kulluese*"**, me FL në vlerën 3,801,667 lekë, OE i shpallur fitues "S." me vlerë të ofertës 2,965,565 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar OE **"S."** shpk me ofertë 2,965,565 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **359,087 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"A."** shpk në vlerën 2,606,478 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin

publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Rikonstruksion i repartit të pediatrisë në spitalin e Beratit*"**, me FL në vlerën 12,452,108 lekë, BOE i shpallur fitues "B." & "Sh." shpk me vlerë të ofertës 9,638,841 **lekë**. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE **"B." & "Sh." shpk** me ofertë 9,638,841 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **180,596 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"C."** shpk në vlerën 9,458,245 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Rikonstruksion i fasadave në lagjen Murad Çelebiu*"**, me FL në vlerën 37,589,184 lekë, BOE i shpallur fitues "S." & "M." shpk me vlerë të ofertës 37,024,857 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE **"S." & "M." shpk** me ofertë 37,024,857 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **8,822,789 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"C."** shpk në vlerën 28,202,068 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Rikonstruksion i çerdhes Uznovë*"**, me FL në vlerën 7,076,528 lekë, OE i shpallur fitues "B." shpk me vlerë të ofertës 5,101,460 lekë. KVO ka s'kualifikuar OE "C." shpk me ofertë në vlerën 5,056,846 e cili plotësonte të gjitha kriteret e vendosura nga NJP. Duke shpallur fitues OE **"B." shpk** me ofertë 5,101,460 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **44,614 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"C."** shpk në vlerën 5,056,846 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Mirëmbajtje ujësjellës, rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Kostren 1 dhe veprës së marrjes*"**, me FL në vlerën 4,166,588 lekë, OE i shpallur fitues "Z." shpk me vlerë të ofertës 4,134,613 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e*

tenderit". Duke kualifikuar BOE **"Z." shpk** me ofertë 4,166,588 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **458,788 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"Sh."** shpk në vlerën 3,675,824 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.10. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2018 me objekt **"*Sistemi i kondicionimit për godinën e Bashkisë Berat*"**, me FL në vlerën 18,333,332 lekë, OE i shpallur fitues "L." shpk me vlerë të ofertës 17,964,893 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE **"L." shpk** me ofertë 17,964,893 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,293,393 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"M." shpk & "B." shpk** në vlerën 16,671,500 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

C.11. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të vitit 2019 me objekt **"*Ujësjellësi fshati Mbreshtan, Njësia Administrative Sinjë*"**, me FL në vlerën 31,065,619 lekë, OE i shpallur fitues "F." shpk me vlerë të ofertës 21,956,747 lekë. KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për **anullim të procedurës së prokurimit**. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ku citohet "*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit".* Duke kualifikuar BOE **"F." shpk** me ofertë 21,956,747 lekë, KVO ka kryer shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,452,546 lekë,** si diferencë mes ofertës së shpallur fituese dhe asaj më të ulët të ofruar nga OE **"K." shpk** në vlerën 20,504,201 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Trajtuar në faqet 147-238 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

C.(1-11)1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Berat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për gjetjet e më sipërme, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën totale **19,171,364 lekë pa tvsh** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.03.2020

D) Propozim APP-së për përjashtim nga procedurat e prokurimit publik për 1 OE për tenderin me objekt: "Blerje materialesh elektrike" Berat Sipas kërkesës së: Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike" me vlerë të fondit limit 1,636,342 lekë dhe shpallur fitues OE "K." me vlerë të ofertës 1,570,000 lekë, për të cilën është lidhur kontrata me nr. 2518 prot., datë 29.05.2017 me vlerë 1,884,000 lekë me tvsh, me arsyetimin:
Si rezultat i mosparaqitjes së mallrave sipas kushteve të vendosura nga NJHT bazuar:

a.Në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik i ndryshuar" konkretisht: - nenit 13- Agjencia e Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për*

- pika 3ç – ***mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike***, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit

Bashkia Berat ka dërguar shkresa me nr. 3226 prot., datë 17.07.2017 pranë APP-së ku është vënë në djeni për mospërmbushjen e detyrimit kontraktual nga ana e OE "K." për sjelljen e mallrave të tenderuar. Bashkia Berat i ka kërkuar APP-së të marri masat përkatëse në lidhje me këtë OE. App-ja deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk ka marë asnjë masë për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në LPP për përjashtim nga procedurat e prokurimit shoqërinë "K.".

Anekset janë pjesë përbërëse e raportit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

AUDITUESIT SHTETËROR TË KLSH-së **DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

Albert Th. **V. K.**

G. H.

A. Gj.

N. N.

Sh. H.

A. Z.

S. M.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT